

Jehonat e dëshmime

Studim Pilot mbi ndikimin afatgjatë të
dhënies së dëshmisë në TPNJ

Jehonat e dëshmime

Studim Pilot mbi ndikimin afatgjatë të dhënies së dëshmisë në TPNJ

Jehonat e dëshmime

Studim Pilot mbi ndikimin afatgjatë të dhënies së dëshmisë në TPNJ

Botim i përbashkët i University of North Texas dhe Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët (SVD) në
Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ)

Ekipi i Autorëve (në rend alfabetik)

Universiteti i Teksasit Verior dhe Instituti Castleberry për Paqe

Kimi King, J.D./Ph.D., Departamenti i Shkencave Politike

James Meernik, Ph.D., Departamenti i Shkencave Politike

Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët

Sara Rubert, MSc Psikologji, MSc Demokracia dhe Të Drejtat e Njeriut në Evropën Juglindore,
Ndihmësfunkcionare Mbështetëse, Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët, TPNJ

Tiago de Smit, BC punë sociale, Punonjëse Mbështetëse, Seksioni për Viktima dhe Dëshmitarë, TPNJ

Helena Vranov Schoorl, BC punë sociale, BSc Psikologji, Shefe e Njesisë Operative dhe e Mbështetjes së
Viktimave dhe Dëshmitarëve, TPNJ

Ndihma redaktoriale nga

Seksioni për Përkthimet Gojore dhe me Shkrim, TPNJ

University of North Texas

Përkthimi

Seksioni për Përkthimet Gojore dhe me Shkrim, TPNJ

Paraqitja grafike

Kimi King, University of North Texas (përmbledhja grafike)

Leslie Hondebrink-Hermer, Njësia për Grafikët dhe Shumëfishimin, TPNJ (dizajni i faqes të parë dhe
përpunimi grafik i raportit)

Tirazhi: 70 kopje

tetor 2016

Versioni elektronik i botimit në <http://www.icty.org>.

Hollësi mbi kopertinën (wordle): paraqitja vizuale e fjalëve të përdorura më së shpeshti nga dëshmitarët
në përgjigjet e tri pyetjeve që nuk kërkonin përgjigje të prera në fund të intervistës.

E drejta e autorësisë

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky material mund të riprodhohet tërësisht ose pjesërisht dhe në
çfarëdo forme për qëllime arsimimi dhe qëllime të tjera jofitimprurëse pa leje të veçantë nga zotëruesi i
të drejtës së autorësisë me kusht që Universiteti i Teksasit Verior dhe Seksioni për Viktimat dhe
Dëshmitarët-TPNJ të përmenden si burim i këtij materiali.

Dispozita e mospërgjegjësisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë
pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara, përfshirë TPNJ-në, ose të shteteve anëtare të OKB-së.

Pasqyra e Lëndës

Pasqyra e Lëndës	1
Ekipi hulumtues i Studimit Pilot	4
Mirënjohje	5
Parathënie	7
Lista e shkurtimeve	8
Hyrje	9
Kapitulli 1 – Dhënia e dëshmisë në TPNJ dhe roli i SVD-së	11
1.1 Prezantim i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.....	11
1.2 Roli dhe rëndësia e Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët.....	13
1.2.1 Njësia Operative: administrimi dhe logjistika.....	14
1.2.2 Njësia Mbrojtëse: problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes.....	14
1.2.3 Njësia Mbështetëse: mbështetja praktike dhe psikoshoqërore.....	15
1.2.4 Mbështetje për punonjësit mbështetës dhe çmimi i përkrahjes.....	16
1.3 Njësia Mbështetëse: integrimi i konceptit të “këshillave dhe mbështetjes”.....	16
1.3.1 Mekanizmat mbështetëse të SVD-së.....	17
1.3.2 Shtrirja e programit mbështetës në rajonin e ish-Jugosllavisë.....	18
1.3.3 Vijimi i shërbimeve për dëshmitarët.....	19
1.4 Sfidat e SVD-së.....	20
1.4.1 Burimet.....	20
1.4.2 Trajtimi i pritshmërive.....	20
Përmbledhje.....	21
Kapitulli 2 – Studimi Pilot: baza dhe metodologjia	23
2.1 Synimet.....	23
2.2 Procesi i zhvillimit të anketimit.....	24
2.2.1 Hulumtime dhe të dhëna të mëparshme.....	24
2.2.2 Grupet fokusuese dhe pyetësorët.....	24
2.2.3 Miratimi prej Komisionit të Etikës dhe përkthimi.....	25
2.3 Pjesëmarrësit dhe procesi i përzgjedhjes.....	25
2.3.1 Të dhënat e dëshmitarëve të SVD-së.....	25
2.3.2 Modeli dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve të përshtatshëm.....	26
2.3.3 Rekrutimi i pjesëmarrësve.....	27
2.4 Intervistat dhe grumbullimi i të dhënave.....	31
2.4.1 Privatësia dhe fshehtësia.....	31
2.4.2 Vendndodhjet e intervistave.....	31
2.4.3 Intervista.....	32
2.4.5 Pas intervistës.....	33
Përmbledhje.....	34

Kapitulli 3 – Dëshmitarët dhe procesi i dhënies së dëshmisë	35
3.1 Popullata e Studimit Pilot.....	35
3.1.1 Intervistat dhe shpërndarja gjeografike	35
3.1.2 Veçoritë demografike të të intervistuarve.....	37
3.1.3 Të intervistuarit dhe proceset gjyqësore të Tribunalit	41
3.2 Ndikimi i dhënies së dëshmisë	46
3.2.1 Problemet ligjore	46
3.2.2 Përgatitja dhe informacioni mbi dhënien e dëshmisë.....	47
3.2.3 Arsytet e dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë	50
3.2.4 Kënaqësia prej dhënies së dëshmisë	52
Përmbledhje.....	55
Kapitulli 4 – Siguria njerëzore dhe ndikimi i dhënies së dëshmisë.....	57
4.1 Siguria personale dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore në bashkësi	57
4.1.1 Marrëdhëniet intime	57
4.1.2 Marrëdhëniet ndërnjerëzore në bashkësi	59
4.2 Ndikimi ekonomik i dhënies së dëshmisë	60
4.3 Ndikimi i dhënies së dëshmisë ndaj sigurisë	62
4.3.1 Dhënia e dëshmisë dhe kërcënimet	63
4.3.2 Trajtimi i problemeve të kërcënimeve.....	66
4.3.3 Masat mbrojtëse në sallën e gjyqit.....	66
4.3.4 Emigrimi vullnetar.....	69
4.3.5 Gjendja e sigurisë aktuale.....	71
Përmbledhje.....	71
Kapitulli 5 – Gjendja shëndetësore mendore dhe fizike dhe ndikimi i dhënies së dëshmisë.....	73
5.1 Mirëqenia mendore dhe fizike	73
5.1.1 Trauma dhe pasojat prej saj	73
5.1.2 Gjendja shëndetësore para dhënies së dëshmisë dhe aktualisht.....	78
5.1.3 Ndryshimet në gjendjen shëndetësore aktuale.....	82
5.2 Procesi i dhënies së dëshmisë dhe ndikimi i tij	83
5.2.1 Reagimet para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë	83
5.2.2 Faktorët që ndikojnë ndaj dëshmitarëve në procesin e dhënies së dëshmisë	86
5.2.3 Ndikimi i dhënies së dëshmisë mbi gjendjen shëndetësore	90
5.2.4 Rraskapitja prej dëshmisë.....	91
5.3 Strategjitë përballuese dhe kënaqësia prej jetës.....	93
5.3.1 Strategjitë përballuese.....	93
5.3.2 Kënaqësia prej jetës – sot dhe në të ardhmen	95
Përmbledhje.....	97

Kapitulli 6 – Perceptimet për TPNJ-në	99
6.1 Perceptimi i të intervistuarve mbi efektshmërinë e TPNJ-së	99
6.2 Perceptimet e të intervistuarve për ushtrimin e drejtësisë	102
6.3 Perceptimi i intervistuarve për trajtimin me drejtësi nga organet e Tribunalit	104
6.4 Perceptimet e të intervistuarve për efektshmërinë e dëshmime të tyre.....	106
Përmbledhje.....	107
Kapitulli 7 – Pyetjet e Lira	109
7.1 Procesi i intervistave	109
7.2 Përvoja e dhënies së dëshmisë	110
7.3 Këshilla për dëshmitarë të ardhshëm në proceset e krimeve të luftës	114
7.4 Sugjerime për përmirësim.....	116
Përmbledhje.....	119
Kapitulli 8 – Përfundime dhe rekomandime	121
8.1 Rekomandime në lidhje me anketimin dhe metodologjinë.....	121
8.2 Rekomandimet në aspektet kyçe	122
8.2.1 Profili i dëshmitarëve dhe arsyet e tyre për dhënien e dëshmisë	122
8.2.2 Siguria njerëzore dhe pasojat ligjore	122
8.2.3 Mirëqenia psikologjike dhe fiziologjike	123
8.2.4 Perceptimet për Tribunalin.....	125
8.3 Rekomandime tërësore.....	126
8.3.1 Kriteret për strukturat e mbështetjes së dëshmitarëve në institucionet gjyqësore	126
8.3.2 Përkatësia gjinore	127
8.3.3 Vijimësia pas dëshmisë.....	128
8.4 Mendime përmbyllëse	129
Shtojcat	
Shtojca I – Punonjësit dhe struktura e SVD-së	132
Shtojca II – Hapat e rekrutimit të pjesëmarrësve	134
Shtojca III – Pyetësor	135
Bibliografi	161

Ekipi hulumtues i Studimit Pilot

Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët (SVD) është një organ i pavarur dhe i paanshëm i Sekretarisë së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ ose Tribunali) që ndihmon paraqitjen e të gjithë dëshmitarëve¹ në Tribunal, të thirrur nga Trupi Gjykyes, Prokuroria ose Mbrojtja. Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët bën çmos që të gjithë dëshmitarët të mund të dëshmojnë në siguri dhe qetësi dhe që dhënia e dëshmisë të mos u shkaktojë dëm, vuajtje apo trauma të mëtejshme. Ndër veprimtaritë e SVD-së janë edhe bashkërendimi i përpjekjeve në përputhje me kushtet e sigurisë si edhe mbështetja psikoshoqërore dhe ndihma logjistike për dëshmitarët të cilët janë në Hagë dhe në rajonin e ish-Jugosllavisë.

Castleberry Peace Institute në University of North Texas (UNT) mbështet programe shkencore dhe mësimore të avancuara mbi shkaqet dhe pasojat e luftës dhe dhunës ndaj sigurisë së njerëzve dhe kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme për vendosjen e paqes së qëndrueshme. Instituti mbështetet në qasje të shumanshme për një konceptim më të mirë të zgjidhjes së konflikteve, për rrënjosjen e demokracisë, zhvillimin e të drejtave të njeriut, dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të brendshëm e ndërkombëtar. *Qendra Kërkimore e Shëndetit Psikoshoqëror* në UNT është një grup që ngërthen shumë disiplina si antropologjia, mjekësia për sjelljen njerëzore, arsimi, psikologjia, shëndeti publik dhe sociologjia, që ndërmerr hulumtime të cilat përbëjnë risi në studimin e dukurive psikoshoqërore dhe ofron ndihmë për mirëqenien afatgjatë në aspektin psikoshoqëror dhe në lidhje me sjelljen.

¹ Për arsye se në këtë dokument përmenden shpesh cilësime për individët, për hir të qartësisë dhe lexueshmërisë aty nuk përdoren nyjat dhe mbaresat e gjinisë femërore. Konsiderohet se të gjitha shprehjet dhe cilësimet e përdorura në këtë dokument në gjininë mashkullore, janë pa dallim të njëjta edhe për gjininë femërore. Duhet përmendur se gjatë intervistave dhe në pyetësor është bërë dallimi gjinor.

Mirënjohje

Realizimi i një projekti të kësaj shkalle nuk do të kishte qenë i mundur pa mbështetjen bujare dhe punën e madhe të shumë individëve brenda dhe jashtë Tribunalit, Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët (SVD) dhe University of North Texas (UNT). SVD-ja dhe UNT-ja dëshirojnë të falënderojnë nga zemra të gjithë pjesëmarrësit të cilët ndihmuan gjatë tërë procesit dhe e jetësuan këtë projekt.

Punonjësit e Studimit Pilot shprehin mirënjohjen për mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm prej Kryetarit të Tribunalit, Sekretarit të Tribunalit, Zëvendëssekretarit të Tribunalit, Shefit të Seksionit të Shërbimeve për Mbështetje Gjyqësore dhe ish-Shefit të SVD-së.

Realizimi i këtij projekti nuk do të kishte qenë i mundur pa ekspertizën e Seksionit për Përkthime Gojore dhe me Shkrim, Shërbimit të Komunikimit dhe Njësisë për Grafikët dhe Shumëfishimin.

Shpesh të padukshëm, por gjithsesi të rëndësishëm për Tribunalin ishin punonjësit dhe stazhierët e SVD-së si në Hagë po ashtu edhe në zyrat rajonale të cilët krahas kryerjes së një sërë detyrash administrative ndihmuan studimin ndër të tjera, nëpërmjet thirrjeve të para telefonike për rekrutimin e pjesëmarrësve dhe transkriptimet.

Të gjithë ishin të rëndësishëm për jetësimin e këtij projekti: Aida Hasanbegović, Astrit Lleshi, Bojan Andrić, Dita Agoli, Driton Gashi, Dušan Ilić, Elvedin Begović, Erol Gavaz, Jasmina Ravnjak, Kornelija Kirnbauer, Manon Wessel, Renee Schooneman, Svetlana Jovanović, Tamara Slijepčević, Teuta Sejdiu, Sean Swindles dhe të gjithë punonjësit e tjerë të SVD-së të cilët mundësuan vijimësinë e punës kryesore të seksionit. Një falënderim të veçantë për Adisa Agić dhe Marija Marković në përpjekjet e tyre të palodhura dhe kujdesin e madh për mirëqenien e dëshmitarëve gjatë intervistave në terren. Gjithashtu një ndihmë të vyer dhanë stazhierët e SVD-së në zyrën rajonale të Sarajevës, Amela Jakubović, Jasenko Jašarević dhe Rafaela Tripalo.

Krahas këtyre përpjekjeve është edhe puna e personelit dhe studentëve të UNT-së. Ndiha me tyre e paçmuar garantoj besueshmërinë dhe legjitimitetin e procesit studimor. Shprehim mirënjohjen tonë të thellë për punën e shënimit dhe kodimit të të dhënave nga Melissa McKay, Sabra Messer, Kirk Allen, Taylor Ledford, Savannah Leigh Shuffield, Kara Hoffpauir, Ayal Feinberg, Roman Krastev, Rachel Ferris, dhe Eliza Kelly. Brenda Ritz, Menaxhere për Videokonferenca mbikëqyri takimet gjatë gjithë vitit ndërmjet Hagës, Sarajevës dhe Dentonit në Teksas. Sharon McKinnis dhe Cece Hannah në Departamentin e Shkencave Politike mundësuan mbështetjen e nevojshme administrative dhe për udhëtimet. Së fundi Dr. Mark Vosvick dhe Eliot Lopez në Departamentin e Psikologjisë dhe Qendrën Kërkimore për Shëndetin Psikoshoqëror ofruan mendime të vlera dhe këshilla në lidhje me pjesët e anketimit që kishin të bënin me aspektin fiziologjik, psikologjik dhe traumatik.

Një sërë agjencish të jashtme livruan burime dhe ndihmuan në kryerjen e anketimit. UNICEF në Kroaci, Qendra e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Bosnjë-Hercegovinë mundësuan zemërgjerësisht përdorimin e ambienteve të tyre për të garantuar kryerjen e intervistave në siguri dhe me një cilësi të lartë për dëshmitarët.

Së fundi një ndihmesë jetike ishte mbështetja financiare e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë që mbuloi një pjesë thelbësore të shpenzimeve për kryerjen e intervistave sepse pa livrimin e fondeve për shpenzimet e udhëtimeve nuk do të kishte qenë i mundur përfundimi i raportit në afatin e përcaktuar.

Përfundimisht dhe më e rëndësishmja që duhet theksuar është se të gjithë dëshmitarët (të Prokurorisë, Mbrojtjes dhe Dhomave) luajnë një rol kyç në përmbushjen e mandatit të gjykatave ndërkombëtare dhe Tribunali nuk është përjashtim.

Gratë dhe burrat të cilët patën guximin të dilnin e të dëshmonin gjatë njëzet vjetëve të shkuara, vunë vetveten në shërbim të së vërtetës dhe drejtësisë.

Studimi Pilot nuk do të mund të ishte kryer kurrë pa gatishmërinë e të intervistuarve të cilët ofruan me zemërgjerësi kohën dhe mendimet e tyre duke treguar edhe njëherë përvojat e tyre. Kontributi i tyre ishte më shumë sesa mund të pritej dhe tejkaloj të gjitha parashikimet tona.

Ky Studim Pilot u dedikohet *të gjithë* dëshmitarëve dhe familjeve të tyre.

**Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët,
TPNJ**

Helena Vranov Schoorl, BSc
Tiago de Smit, BC
Sara Rubert, MSc

**Castelberry Peace Institute,
UNT**

Kimi King, J.D./Ph.D.
Jim Meernik, Ph.D.

Parathënie

Me përfundimin e mandatit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) natyrisht që mendimet shkojnë te njerëzit të cilët me dëshmitë e tyre e bënë drejtësinë të mundur. Çfarë ndodhi me më shumë se 5000 dëshmitarë të cilët treguan çfarë kishin parë, bërë ose vuajtur gjatë luftërave që përflakën Ballkanin në vitet '90 të shekullit të kaluar? A ndryshoi jeta e tyre pas dhënies së dëshmisë? A gjetën ata drejtësi në vendimet e Tribunalit?

Studimi udhëçelës "Jehonat e Dëshmime"- fryt i partneritetit midis Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët (SVD) i Tribunalit dhe University of North Texas – është përpjekur të gjejë përgjigje për pyetjet e lartpërmendura nëpërmjet grumbullimit sistematik të informacionit nga vetë dëshmitarët dhe analizimit shkencor të këtij informacioni.

Dëshmitarët nuk do të kishin pasur mundësi të dëshmonin për të vërtetën pa punën pararendëse të SVD-së në njëzet vjetët e fundit. Për herë të parë drejtësisë penale ndërkombëtare bashkëkohore iu desh të përballej me detyrën e rëndë të kujdesit për dëshmitarët. Që nga viti 1995 kur lufta ishte ende në kulm, SVD-së së sapokrijuar iu desh të kontaktonte njerëz në fshatra të rrethuara; të krijonte atmosferën e përshtatshme që ata të mund të tregonin përjetimet e tyre të cilat shpesh ishin mbi lëndimet e tyre mendore dhe fizike; dhe të garantonte që siguria dhe mirëqenia e tyre të mos vireshin në rrezik si pasojë e dëshmisë.

SVD-ja zhvilloi një sistem të integruar të ndihmës logjistike, mbështetjes psikoshoqërore dhe mbrojtjes në përshtatje me nevojat konkrete të dëshmitarëve: para, gjatë dhe menjëherë pas dhënies së dëshmisë. Sistemi i SVD-së është shfrytëzuar si model për ngritjen e njëjësive të ngjashme për dëshmitarë në gjykata të tjera si Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën, Gjykata Penale Ndërkombëtare, Gjykata Speciale për Sierra Leonen, Tribunali Special për Libanin dhe gjykatat në ish-Jugosllavi.

Nga kontakti i parë, e më tej gjatë qëndrimit të tyre në Hagë, e deri në kthimin e tyre në shtëpi SVD-ja ka qenë pranë dëshmitarëve gjatë gjithë procesit shpesh emocional të dhënies së dëshmisë. Gjatë këtij rrugëtimi pati dëshmitarë që i treguan SVD-së se ata ende e kishin të vështirë të vazhdonin më tej me jetën e tyre, shumë prej tyre shprehën një ndjenjë çlirimi, por deri më sot nuk kishte pasur asnjë studim për vlerësimin shkencor të përvojës së dhënies së dëshmisë në Tribunal.

Që nga ky moment, kjo zbrazëti fillon e mbushet me këtë studim pilot. Të përzgjedhur në modelin përfaqësues për këtë projekt, 300 dëshmitarë të Prokurorisë, Mbrojtjes dhe Dhomave pranuan të merrnin pjesë, dëshmitarë të cilët banojnë në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë dhe Serbi. Nëpërmjet një pyetësori të përpiluar me kujdes u hulumtuan mendimet e dëshmitarëve mbi sigurinë e tyre, gjendjen ekonomiko – shoqërore, gjendjen shëndetësore, mirëqenien psikologjike dhe perceptimet e tyre rreth punës së Tribunalit. Të dhënat e mbledhura nga SVD-ja në mënyrë konfidenciale dhe duke mos i ekspozuar pjesëmarrësit ndaj rreziqeve, u analizuan prej studiuesve në Castleberry Peace Institute i UNT-së dhe pasqyrohen në këtë botim.

Rezultatet janë interesante dhe inkurajuese. Në tërësi dëshmitarët e gjykuan pozitive dhënien e dëshmisë dhe shprehën mendimin se nëpërmjet tregimit të përjetimit të tyre dhanë kontribut të drejtpërdrejtë në realizimin e drejtësisë. Dëshmitarët në shumicë të madhe mendojnë se janë trajtuar me drejtësi nga Tribunali. Pas këtyre rezultateve fillestare dhe në varësi të disponueshmërisë së fondeve shpresoj që ky studim të përfshijë më shumë dëshmitarë të Tribunalit dhe pres me kënaqësi një hulumtim dhe analizë të ngjashme të dëshmitarëve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën.

Kontributi ndriçues mbi përvojën e dhënies së dëshmisë është një element i rëndësishëm i trashëgimisë së Tribunalit. Ky studim do të shërbejë si udhëzues i domosdoshëm për punonjësit për mbështetjen dhe mbrojtjen e dëshmitarëve në gjykatat ndërkombëtare dhe shtetërore dhe është një thesar i pasur i mësimave të nxjerra në kontekstin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Por ndoshta aspekti më i rëndësishëm i këtij studimi është se u ofroi shumë dëshmitarëve mundësinë që nëpërmjet dhënies së dëshmisë në Tribunal të ndahen nga e shkuara.



John Hocking

Ndihmësekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara
Sekretar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë

Lista e shkurtimeve

BH	Bosnjë-Hercegovinë
BKS	Boshnjakërisht/Kroatisht/Serbisht
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
MTPN	Mekanizmi për Tribunalët Penalë Ndërkombëtarë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SPGSH	Seksioni Përkthimeve Gojore dhe me Shkrim
SVD	Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët
TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICRI	Hulumtimi Ndërrajonal për Krimet dhe Drejtësinë i Kombeve të Bashkuara
UNT	University of North Texas
ZRS	Zyra Rajonale e Sarajevës

Hyrje

Dëshmitarët të cilët dëshmojnë në gjykatat ndërkombëtare për krime lufte janë kontribuesit më vendimtarë në kërkim të së vërtetës dhe drejtësisë. Gjithsesi, relativisht dihet pak mbi ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë që ka dhënia e dëshmisë për viktimat dhe dëshmitarët. Për të përfutur një ide më të qartë mbi përvojën e dëshmitarëve Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët (SVD) i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe fakulteti i Institutit Castleberry për Paqe në Universitetin e Teksasit Verior ndërmorën një Studim Pilot mbi gjendjen aktuale të dëshmitarëve të TPNJ-së.

Në Studimin Pilot përfshihen një anketim në pesë pjesë dhe një intervistë 15-20-minutëshe mbi profilin e dëshmitarit dhe arsyet për dhënien e dëshmisë; pasojat shoqërore dhe ekonomike të dhënies së dëshmisë; faktorët e sigurisë; shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe mendore; dhe perceptimet mbi drejtësinë dhe TPNJ-në. Intervistat u kryen nga punonjësit e SVD-së gjatë një periudhe dyvjeçare (2013-2015) me 300 dëshmitarë faktesh të cilët jetojnë në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë dhe Serbi, të cilët u përzgjedhën mbi bazën e modeleve sasiore dhe rastësore nga dëshmitarët e SVD-së të cilët kishin dëshmuar në procese gjyqësore pas vitit 1998 me përjashtim të katër proceseve gjyqësore që po zhvilloheshin në kohën e Studimit Pilot.

Duke u përqendruar në domethënien e konceptit “të dëshmosh”, synimi i Studimi Pilot ishte të vlerësoheshin shqetësimet e ngritura prej dëshmitarëve dhe të formuloheshin rekomandime për shërbimin e ndihmës së dëshmitarëve në TPNJ si dhe në kontekstin më të gjerë të drejtësisë ndërkombëtare. Nga përfundimet e Studimit Pilot rezulton se dëshmitarët e intervistuar janë në gjendje përgjithësisht të mirë duke mbajtur veçanërisht parasysh pasojat e ngjarjeve që ata përjetuan dhe traumën e madhe që vuajtën. Shumica e dëshmitarëve e përjetuan pozitivisht dhënien e dëshmisë dhe mendojnë se kanë dhënë një kontribut të vyer për të vërtetën dhe drejtësinë. Në lidhje me procesin e dhënies së dëshmisë shihet se perceptimet pozitive janë më të shumta se ato negative. Duhet theksuar se një numër dëshmitarësh u përballën me pasoja shoqërore, ekonomike dhe të tjera për shkak të dhënies së dëshmisë dhe se një numër më i vogël, por gjithsesi i konsiderueshëm dëshmitarësh, u përballën me kërcënime ndaj sigurisë së tyre para dhe pas dhënies së dëshmisë. Dëshmitarët ishin përkrahës të përpjekjeve të TPNJ-së për zbardhjen e së vërtetës dhe vërtetimin e fajësisë, mirëpo jo dhe aq miratues ndaj dënimeve të shqiptuara nga Tribunali si dhe shprehën kritika ndaj tejzgjatjes së proceseve gjyqësore. Një shumicë e konsiderueshme e dëshmitarëve mendojnë se ata u trajtuan me drejtësi nga Dhoma Gjyqësore, Prokuroria, Mbrojtja dhe SVD-ja.

Rezultatet e Studimit Pilot konfirmojnë se procesi i dhënies së dëshmisë është i larmishëm dhe kompleks e për këtë arsye është e nevojshme të kryhet studim i mëtejshëm mbi përvojat e dëshmitarëve.

Kapitulli 1 – Dhënia e dëshmisë në TPNJ dhe roli i SVD-së

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ ose Tribunali) e ngarkoi Seksionin e Viktimave dhe Dëshmitarëve (SVD) me mundësimin e paraqitjes së dëshmitarëve. Ky kapitull fillimisht ofron një prezantim të shkurtër të Tribunalit dhe më tej përshkruan rrethanat e ngritjes së SVD-së që me kalimin e kohës u shndërrua në tri njësi profesionale ku secila prej tyre ofroi ndihmë konkrete në përputhje me nevojat e dëshmitarëve. Gjithashtu ky kapitull hedh dritë mbi zhvillimin e mekanizmave mbështetëse dhe zgjerimin e këtyre shërbimeve në ish-Jugosllavi. Në fund të kapitullit përshkruhen sfidat e dy dhjetëvjeçarëve të kaluar dhe diskutohen mënyrat e trajtimit të tyre.

1.1 Prezantim i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë

Në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, ish-Jugosllavia u përfshi nga një sërë konfliktesh të dhunshme të armatosura. Duke marrë shkas nga lajmet gjithnjë e më të shumta për kryerjen e krimeve në masë të gjerë, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën 827 me anë të së cilës themeloi Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë, Holandë.² Kjo gjykatë e përkohshme ishte gjykata e parë ndërkombëtare për krime lufte që prej gjykatave ndërkombëtare ushtarake të Nurembergut dhe Tokios pas Luftës së Dytë Botërore.

Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit përmban Statutin e Tribunalit i cili përcakton juridiksionin dhe strukturën organizative të Tribunalit. Mandati i Tribunalit përfshin katër objektiva:

- a) nxjerrjen para drejtësisë të individëve fajtorë për shkeljet e së drejtës humanitare ndërkombëtare,
- b) drejtësi për viktimat,³
- c) dhënien fund të kryerjes së krimeve në ish-Jugosllavi, dhe
- d) rikthimin e paqes.

Tribunali është një organizatë e pavarur dhe e paanshme që përbëhet nga tri organe të veçanta: Dhomat, Zyra e Prokurorit dhe Sekretaria. Shih Figurën 1 më poshtë.

Figura 1



² Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit e cila themelon Tribunalin Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë, U.N. Doc. S/RES/827 (25 maj 1993), gjendet në <http://www.icty.org/en/about/tribunal/establishment>

³ Shënim në lidhje me terminologjinë: përdorimi i fjalës *viktimë* kundrejt *mbijetues*. Shumë njerëz të cilët kanë vuajtur në luftë nuk e konsiderojnë veten viktimë dhe fyhen po të cilësohen kështu. Kjo vjen prej faktit se fjala *viktimë* nënkupton pasivitet që shumë njerëz mendojnë se nuk përputhet me "luftën" e tyre. *Mbijetuesit* e luftës ndihen të fyer kur ata karakterizohen apo trajtohen si 'viktima'. Të tjerë e mirëpresin fjalën *viktimë* sepse kjo do të thotë se ata nuk janë përgjegjës për çfarë ka ndodhur me ta. Për më tepër, kjo fjalë me gjasë ua ngarkon fajin të akuzuarve për dhunën e kryer kundër tyre. Statuti i TPNJ-së ngarkon shprehimisht SVD-në që t'u shërbejë 'viktimave dhe dëshmitarëve' duke iu referuar në veçanti 'viktimave të dhunës seksuale'. Duke mbajtur parasysh ndjeshmërinë në lidhje me përdorimin e këtyre termave, punonjësit e SVD-së janë të kujdesshëm kur i përdorin këto terma me dëshmitarët e TPNJ-së.

Në përbërje të **Dhomave** janë gjykatës të propozuar nga shtetet anëtare të OKB-së dhe të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së bazuar në rekomandimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.⁴ Të ardhur nga vende të ndryshme, (ndonëse jo nga ish-Jugosllavia), gjykatësit të cilët përfaqësojnë sistemet juridike kryesore në botë, dëgjojnë dëshmi, shtjellojnë argumente ligjore dhe nxjerrin vendime mbi bazën e provave të administruara. **Zyra e Prokurorit** heton dhe procedon penalisht individët brenda juridiksionit të TPNJ-së dhe funksionon në mënyrë të pavarur si organ i veçantë i TPNJ-së.⁵ Së fundi, **Sekretaria** është përgjegjëse për administrimin dhe drejtimin e Tribunalit ndër të tjera nëpërmjet një sërë funksionesh si ndihma dhe mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve, dhënia e informacionit publik, ndihma juridike për gjykatësit, teknologjia e informacionit, administrimi i sallave gjyqësore, sigurimi, përkthimet me shkrim dhe gojore, ndihma juridike për të akuzuarit dhe paraburgimi⁶. Duhet theksuar se **Mbrojtja** e të akuzuarve (të cilët gëzojnë të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet avokatëve të pavarur dhe të kualifikuar) nuk kryhet nga një organ zyrtar që është pjesë përbërëse e Tribunalit.

Tribunali ngriti aktakuza penale kundër 161 individëve,⁷ dhe që prej arrestimit të Goran Haxhiqit më 20 korrik 2011 asnjë i akuzuar prej TPNJ-së nuk është më i lirë. Dy çështje gjyqësore (Mlladiq dhe Haxhiq) janë në gjykim dhe në dhjetor 2015, Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykimin e Jovica Stanishiqit dhe Franko Simatoviqit për të gjithë pikat e aktakuzës. Vendimet më të fundit gjyqësore për Radovan Karaxhiqin dhe Vojislav Sheshelin u shqiptuan në mars 2016. Janë në fazën e apelit, në pritje të vendimit të formës së prerë dy çështje (Përliq dhe të tjerë dhe Stanishiq & Zhuplanin). Pritet që Tribunali të përmbyllë misionin e vet në fund të vitit 2017.

Që prej vitit 1995, në Tribunal janë paraqitur afërsisht 4650 dëshmitarë për të ndihmuar në zbardhjen e fakteve mbi ngjarjet që ndodhën gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Tribunali është përqendruar më së shumti në figurat kryesore si udhëheqës të lartë shtetërorë dhe ushtarakë dhe krerët e grupeve paraushtarake të palëve të ndryshme ndërluftuese gjatë konflikteve në ish-Jugosllavi. Gjykatat e vendeve përkatëse kanë si objektiv procedimin penal të një numri të madh të të dyshuarve të rangjeve më të ulëta. Në dy dhjetëvjeçarët e kaluar Tribunali ka prodhuar jurisprudencë të gjerë për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin. TPNJ-a i ka përhapur dijenitë dhe përvojën e fituar midis popujve në ish-Jugosllavi nëpërmjet krijimit të kapaciteteve gjyqësore, kontaktit dhe komunikimit me njerëzit në rajon, zhvillimit të programeve dhe materialeve mësimore mbi të drejtën penale dhe humanitare ndërkombëtare, ndihmës ligjore dhe ndihmës për dëshmitarët, kualifikimit të profesionistëve të ligjit dhe publikimin e materialeve të TPNJ-së të përkthyer në gjuhët përkatëse.

Në kuadër të Strategjisë Përmbyllëse të TPNJ-së,⁸ më 2010, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara themeloi Mekanizmin për Tribunalët Penalë Ndërkombëtarë (MTPN, Mekanizmi). MTPN-ja ka si mision kryerjen e një sërë funksionesh të qenësishme të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën dhe të TPNJ-së pas përfundimit të mandateve të tyre përkatëse. Në korrik 2013 dega e MTPN-së në Hagë filloi punën për përfundimin e të gjitha çështjeve të mbetura të mandatit të Tribunalit ndër të cilat përfundimin e fazës së apelit,⁹ dhe ruajtjen, sigurimin dhe përdorshmërinë e mijëra metrave linearë të dokumenteve fizike dhe petabajts të dokumenteve digjitale, fryt i punës së Tribunalit.¹⁰

⁴ Shih <http://www.icty.org/sid/143>

⁵ Shih <http://www.icty.org/en/about/office-of-the-prosecutor>

⁶ Shih <http://www.icty.org/en/about/registry>

⁷ Shih <http://www.icty.org/en/cases/key-figures-cases>

⁸ Që prej vitit 2003, në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, TPNJ-ja inicioi strategjinë përmbyllëse të mandatit të vet nëpërmjet marrjes së të gjitha masave të nevojshme për përfundimin e të gjitha veprimtarive gjyqësore. Në përgatitje të përfundimit të fazës së gjykimit dhe të apelit në Tribunal, TPNJ-ja ka përcaktuar disa funksione që duhet të marrë përsipër Mekanizmi Përmbyllës i Tribunalit. Strategjia përmbyllëse mundëson përmbushjen me sukses në kohë dhe në bashkërendim me juridiksionet e vendeve të ish-Jugosllavisë, të misionit të Tribunalit. Për hollësi mbi strategjinë përmbyllëse të TPNJ-së shih <http://www.icty.org/sid/10016>.

⁹ MTPN-ja do të procedojë të gjithë apelet e çështjeve gjyqësore të TPNJ-së, njoftimet e të cilave janë depozituar pas 1 korrikut 2013.

¹⁰ Shih <http://www.unmict.org/en/about/archives-international-criminal-tribunals>

1.2 Roli dhe rëndësia e Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët

Misioni i SVD-së

SVD-ja kontribuon në funksionimin e efektshëm të TPNJ-së nëpërmjet mundësimit të paraqitjes së dëshmitarëve në Tribunal, të thirrur nga Dhomat, Prokuroria ose Mbrojtja.

SVD-ja zhvillon parime, praktika dhe procedura për të mundësuar që të gjithë dëshmitarët të kenë mundësi të dëshmojnë të sigurtë dhe të mbrojtur dhe që procesi i dhënies së dëshmisë të mos u shkaktojë trauma, vuajtje ose dëm të mëtejshëm dëshmitarëve. SVD-ja krijon një ambient të tillë në kuadër të së cilit dhënia e dëshmisë të mund të përjetohej si një përvojë pozitive, fuqidhënëse dhe pasuruese.

SVD-ja u përmbahet standardeve më të larta të integritetit, paanësisë dhe konfidencialitetit dhe mundëson informimin e të gjithë dëshmitarëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe për trajtimin e barabartë të tyre prej seksionit.

Njësia Mbrojtëse bashkërendon masat në përputhje me kushtet e sigurimit, Njësia Mbështetëse ofron terapi dhe ndihmë shoqërore dhe psikologjike për dëshmitarët, dhe njësia operative është përgjegjëse për veprimet logjistike dhe administrimin e dëshmitarëve.

Për të mundësuar ecurinë efikase dhe pa probleme të proceseve gjyqësore, është e rëndësishme që viktimat dhe dëshmitarët të vijnë në Hagë në kohë dhe të jenë të gatshëm dhe në gjendje për dhënien e dëshmisë. SVD-ja si organ neutral brenda Sekretarisë, mundëson paraqitjen e të gjithë dëshmitarëve, shumica e të cilëve banojnë në ish-Jugosllavi.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ishte i vetëdijshëm se disa dëshmitarë që dëshmuar në TPNJ, kishin përjetuar përvoja traumatike gjatë luftërave në ish-Jugosllavi të cilat do t'u duhej t'i ripërjetonin në një vend të huaj të largët pa praninë dhe përkrahjen e të afërmeve dhe miqve të tyre dhe se dëshmitarët kishin frikë për sigurinë e tyre për shkak të dhënies së dëshmisë. Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, Tribunali krijoi një atmosferë që u mundësoi dëshmitarëve të dëshmonin në siguri dhe me dinjitet, duke iu ofruar mbështetje dhe ndihmë të përshtatshme.¹¹ Gjithashtu Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara njohu nevojën e mbështetjes konkrete për viktimat e dhunës seksuale dhe për këtë arsye iu kushtua vëmendje e posaçme punësimit të femrave të kualifikuara. Kjo rezultoi në krijimin e një zyre të posaçme të Sekretarisë parashikuar prej Statutit të TPNJ-së, dhe më konkretisht prej Rregullës 34 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të TPNJ-së, me dy detyra parësore: rekomandimin e masave mbrojtëse për viktimat dhe dëshmitarët¹² dhe dhënien e këshillave dhe përkrahjes për ta, sidomos në rastet e përdhunimit dhe dhunës seksuale.¹³

SVD-ja unike në kontekstin bashkëkohor ndërkombëtar, filloi funksionimin në prill 1995. Ky organ u përball menjëherë me dy sfida serioze: përkufizimin e këshillimit dhe mbështetjes brenda kornizës ligjore ndërkombëtare dhe zhvillimin e praktikave dhe mekanizmave në mbështetje të funksioneve të përkufizuara të Rregullës 34 përmendur më lart.

¹¹ Shih http://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/AnnualReports/annual_report_1995_en.pdf.

¹² Në Statutin dhe Rregulloren e Procedurës dhe Provave të TPNJ-së nuk bëhet dallim midis viktimës dhe dëshmitarit. Gjithsesi SVD-ja mund t'u shërbejë vetëm viktimave të cilët janë të regjistruar si dëshmitarë në një çështje gjyqësore.

¹³ Shih http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Rules_procedure_evidence/IT032Rev49_en.pdf Rregulla 34 Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve.

Ndryshe nga procedurat penale të shteteve ku qeveritë janë në gjendje të ofrojnë një sërë masash në lidhje me sigurimet shoqërore, kujdesin mjekësor dhe strehimin si dhe kushte të tjera të jetesës, karakteri ndërkombëtar dhe mandati i TPNJ-së nuk mundësonin që Tribunali të ofronte automatikisht shërbime të tilla që janë tipike për shtetet. Për këtë arsye SVD-së i duhej të përcaktonte mënyrën dhe llojin e ndihmës dhe mbështetjes së viktimave dhe dëshmitarëve për kapërcimin e pengesave dhe shqetësimeve lidhur me paraqitjen e tyre në Tribunal. SVD-së iu ngarkua detyra që t'u ofronte shërbime bazë dëshmitarëve dhe u përball me probleme të ndërlikuara. Si mund t'u jepte praktikisht SVD-ja ndihmë njerëzve që udhëtonin nga më shumë se njëzet vende të ndryshme? Si do të krijonte SVD-ja shërbime në përshtatje me kërkesat dhe nevojat e ndryshme të dëshmitarëve të ndryshëm? Çfarë kërkesash punësimi ishin të nevojshme për punësimin e njerëzve që do të ofronin një larmi shërbimesh dhe udhëzimesh shpesh në kombinim me mbështetjen psikologjike për viktimat dhe dëshmitarët? Në çfarë mënyrë do të finançohej puna e SVD-së dhe prej kujt?

Me nisjen e procesit të parë gjyqësor më 1996 dhe përgatitjet për ardhjen e viktimave dhe dëshmitarëve, shpejt u pa qartë se vetëm një qasje e integruar e tri aspekteve do të mundësonte përbushjen e nevojave të ndryshme të dëshmitarëve. U duhej kushtuar vëmendje e duhur dhe e njëkohshme nevojave logjistike, si edhe mbrojtjes dhe mbështetjes së dëshmitarëve. Kjo qasje rezultoi në strukturën aktuale të Seksionit të Viktimave dhe Dëshmitarëve i përbërë nga tri njësi të ndryshme: *Njësia Operative, Njësia e Mbrojtjes dhe Njësia Mbështetëse*.

1.2.1 Njësia Operative: administrimi dhe logjistika

Çfarë nevojitet për të mundësuar udhëtimin në siguri dhe mbrojtje të një dëshmitari për në Hagë ose në një vend të caktuar për dëshmi nëpërmjet videokonferencës? Në tetor 1995, pesëmbëdhjetë dëshmitarë u thirrën që të dëshmonin në çështjen e Dragan Nikoliqit (seanca e parë në bazë të Rregullës 61 të TPNJ-së¹⁴). Ishte një operacion i madh logjistik sepse ishte e vështirë të organizohej vajtja dhe ardhja e njerëzve dhe siguria e tyre në një zonë të shkatërruar nga lufta. Duheshin siguruar dokumentet e nevojshme të identitetit ose të udhëtimit dhe të vendoseshin lidhje pune të mira me autoritetet vendore. Duhej që ndër të tjera, SVD-ja në bashkëpunim me autoritetet holandeze të merrte masa për strehim të sigurt dhe të mbrojtur, për ushqimin dhe për kujdesin mjekësor në Hagë. Në fund, dëshmitarët e parë u transportuan me helikopterë nga Bosnjë-Hercegovina në Kroaci dhe pastaj me avion nga Kroacia në Holandë ku ata u pritën nga katër punonjësit e parë të SVD-së dhe nga policia holandeze. Për zgjidhjen e problemeve logjistike të fillimit brenda SVD-së u formua një njësi operative për krijimin e ekspertizës së nevojshme në lidhje me aspektet operative të paraqitjes së dëshmitarëve. Më tej, njësia operative kishte si detyrë dhënien e ndihmës logjistike për dëshmitarët në TPNJ dhe në rajonin e ish-Jugosllavisë. Këtu përfshiheshin udhëtimi dhe transporti nga rajoni dhe kthimi, transportimi brenda rajonit dhe në Hagë, strehimi, organizimi i udhëtimeve dhe i marrjes së vizave si dhe dhënia e mëditjeve për dëshmitarët.

1.2.2 Njësia Mbrojtëse: problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes

Në vendet e ish-Jugosllavisë të cilat përjetuan dhunë dhe shkatërrime të mëdha dhe ku ende ekzistojnë tensione të trashëguara nga këto luftëra, siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve përbëjnë një sfidë kyçe. Dëshmitarët që dëshmojnë përballen në një masë të konsiderueshme jo vetëm me rrezikun që vjen nga njerëzit e implikuar në krime, por edhe nga përkrahësit e tyre. Megjithatë mbrojtja e dëshmitarëve ka qenë gjithmonë një element përbërës i misionit të SVD-së, me kalimin e kohës dhe sidomos pas një analize të pavarur, rolet dhe detyrat e Njesisë Mbrojtëse u fuqizuan. Pas një analize të kryer më 2003, Njësia Mbrojtëse filloi të funksiononte më e pavarur nga SVD-ja për garantimin e fshehtësisë maksimale dhe për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit absolut të dëshmitarëve të mbrojtur

Krijimi i Njesisë Mbrojtëse dhe detyrave përkatëse të saj u bashkërendua ngushtësisht me programet për dëshmitarët e mbrojtur në kuadrin shtetëror. Rastet e dëshmitarëve të konsideruar në rrezik iu

¹⁴ Shih http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Rules_procedure_evidence/IT032Rev49_en.pdf
Procedura e Rregullës 61 në rastin e moszbatimit të një fletarrestimi

kaluan për vlerësim Njesisë Mbrojtëse e cila në mënyrë të pavarur nga palët gjyqësore në TPNJ, bëri një vlerësim të rrethanave të sigurisë së dëshmitarëve. Në bazë të këtij vlerësimi u përcaktuan veprimet dhe masat përkatëse që duheshin ndërmarrë. Ndonëse ekzistonin masa lehtësuese si p.sh. dhënia e këshillave në lidhje me sigurinë e një dëshmitari ose referimi i çështjes autoriteteve vendore për hetime të mëtejshme, mundësia për zhvendosjen e përkohshme dhe të përhershme të dëshmitarëve në shtete të tjera ishte një faktor vendimtar në aftësinë e Njesisë Mbrojtëse për të mbrojtur dëshmitarët më të rrezikuar.

Për më tepër, rrethanat e krijuara pas konflikteve paraqitën probleme të tjera në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve sepse institucionet që pritej të mbronin njerëzit si policitë e vendeve përkatëse ishin shkatërruar nga konflikti, ose nuk ishin në gjendje të mundësonin mbrojtjen e duhur për qytetarët. Njesisë Mbrojtëse iu desh të kërkonte gjetiu mbështetje.

Një problem tjetër për Njesisë Mbrojtëse ishte perceptimi i qytetarëve për institucionet shtetërore në ish-Jugosllavi dhe besimi i tyre në to. Dëshmitarët e rrezikuar ishin shumë mosbesues kundrejt aftësive të shteteve të tyre për t'u ofruar mbrojtje. Me shtimin e numrit të dëshmitarëve që ishin thirrur për të dëshmuar, Njesisë Mbrojtëse iu desh të mbështetej gjerësisht në bashkëpunimin e shteteve me të cilët TPNJ-ja kishte nënshkruar marrëveshje zyrtare për mbrojtjen e dëshmitarëve.

1.2.3 Njësia Mbështetëse: mbështetja praktike dhe psikoshoqërore

Në përgatitje për ardhjen e dëshmitarëve të parë më 1995, SVD-ja punësoi dy Ndhimës për Dëshmitarë¹⁵ për të ndihmuar dëshmitarët në gjuhën e tyre amtare (boshnjakisht/kroatisht/serbisht ose BKS).¹⁶ Gjatë këtij fillimi u duk qartë se puna e Ndhimësve për Dëshmitarë ishte kyçe në lidhje me mirëqenien e dëshmitarëve dhe se dëshmitarët ndiheshin mirë kur komunikonin drejtpërsëdrejti në gjuhën e tyre dhe merrnin përgjigje të menjëhershme për pyetjet që kishin. Ashtu sikurse arsyetoi edhe një konsulent i jashtëm,¹⁷ puna e Ndhimësve për Dëshmitarët mundësoi që dëshmitarët të ndiheshin të qetë para momentit të rëndësishëm të dhënies së dëshmisë.

Prej kësaj përvoje SVD-ja konkludoi se mbështetja ndaj dëshmitarëve nuk duhej reduktuar thjesht në një seancë terapie njëorëshe. Lipsej të krijohesh një rrjet që do të funksiononte pandërprerë për dhënien e ndihmës së nevojshme dëshmitarëve të cilët vinin në Hagë dhe e gjenin veten në një ambient të panjohur për disa ditë ose disa javë, duke qenë larg familjes dhe jetës së tyre të përditshme. Për t'iu përgjigjur menjëherë shqetësimeve dhe nevojave të dëshmitarëve në gjuhën e tyre amtare dhe nëpërmjet një komunikimi qetësidhënës dhe të kujdesshëm, punonjësit duhej të ishin në dispozicion të dëshmitarëve gjatë tërë qëndrimit të tyre. Funkionarët Mbështetës të SVD-së të cilët ishin psikologë ose punonjës socialë ofruan ekspertizën e tyre nëpërmjet udhëzimeve të tyre të përditshme për Ndhimësit e Dëshmitarëve gjatë punës së tyre intensive me njerëz të prekur nga lufta.

Gradualisht, por në mënyrë të qëndrueshme, me kalimin e viteve SVD-ja adoptoi një qasje integruese të koncepteve dhe shërbimeve psikoshoqërore në funksionimin e vet e cila rezultoi në krijimin e Njesisë Mbështetëse dhe një program të gjerë mbështetës me synim, parandalimin, pakësimin ose eliminimin e vështirësive dhe pengesave gjatë tri fazave të ndryshme të pjesëmarrjes së dëshmitarit, përkatësisht, periudha para dhënies së dëshmisë, periudha e dhënies së dëshmisë dhe periudha pas dhënies së dëshmisë.

¹⁵ Në fillim, Ndhimësit për Dëshmitarë që punonin me dëshmitarët përzgjidheshin në bazë të aftësisë së tyre në BKS dhe holandisht, prej përvojës së tyre me refugjatë ose njerëz të tjerë që nuk ishin holandezë, për aftësi organizuese dhe gatishmërisë për kryerjen e detyrave praktike dhe mbështetëse duke punuar në orar “të pazakontë”. Në periudhën menjëherë pas luftës dhe deri më 2001, SVD-ja nuk punësoi njerëz nga vendet e prekura nga lufta në ish-Jugosllavi me qëllim që të shmangeshin premisa të mundshme që mund të dëmtonin komunikimin midis dëshmitarëve dhe punonjësve të SVD-së.

¹⁶ Që në pikënisje Seksioni për Përkthime Gojore dhe me Shkrim (SPGSH) ka zbatuar vijimësisht politikën gjuhësore në përputhje me përkufizimin e dhënë në çështjet Tadiq dhe Kërsmannoviç (bazuar në mendimet e specialistëve) ku u konfirmua se variantet e gjuhës së folur anembanë ish-Jugosllavisë që më parë quhej serbokroatisht (gjuhë policentrike me variante standarde), kuptoheshin gjerësisht nga njerëzit e atij rajoni. Në një përpjekje për përfshirjen e të tri varianteve, SPGSH-ja krijoi një term të ri “BKS”, sipas rendit alfabetik boshnjakisht-kroatisht-serbisht.

¹⁷ Një psikiatër i jashtëm u kontraktua afërsisht për dy javë për ndihmë profesionale për dëshmitarët dhe punonjësit që punonin me dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar më 1995.

1.2.4 Mbështetje për punonjësit mbështetës dhe çmimi i përkrahjes

Me shtimin e numrit të proceseve gjyqësore dhe të dëshmitarëve që vinin në Hagë për të dëshmuar, punonjësit u përballën gjithnjë e më shumë me përvoja nga koha e luftës dhe me dhimbjen e vuajtjet e shumë viktimave dhe dëshmitarëve. Në Njësinë Mbështetëse u shtua ndërgjegjësimi se punonjësit ishin vazhdimisht dhe intensivisht të ekspozuar ndaj individëve të prekur nga lufta dhe historitë e tyre dhe me shtimin e numrit të punonjësve u bë e nevojshme mbështetja dhe marrja e mendimeve prej tyre. Stresi *profesional* në një situatë të ethshme ku në një ditë zhvilloheshin disa procese për krime lufte rezultoi në stres *nga dhembshuria* si pasojë e ekspozimit intensiv dhe të tejzgatur ndaj traumave dytësore, faktor që i bëri punonjësit të prekshëm nga ajo që quhet rraskapitje prej dhembshurisë.¹⁸

Dukuria e çrregullimit prej stresit traumatik dytësor (ose rraskapitjes prej dhembshurisë) në organizata filloi të shihej më me vëmendje në fund të viteve '90 të shekullit të kaluar. Dëgjimi i rrëfimeve për ngjarje dhe vuajtje traumatike gradualisht dhe pa dashje ndikon në aftësinë përballuese të punonjësve që merren me të. Mbështetja për punonjësit të cilët ofrojnë mbështetje jetike për individët e prekur nga lufta është parakusht kyç për garantimin e shërbimeve cilësore për dëshmitarët, për mirëqenien e punonjësve dhe për parandalimin e rraskapitjes dhe sfillitjes prej ndjenjës së dhembshurisë dhe simptomave të tjera.

SVD-ja ofroi një program parandalues nëpërmjet mekanizmave të edukimit psikologjik dhe mbështetjes sociale ku përfshiheshin edhe takimet e punonjësve në lidhje me efektin emocional të punës me dëshmitarë të traumatizuar dhe prezantime mbi ndjenjën e dhembshurisë për të tjerët dhe përgjigjet përkatëse duke u përqendruar në rreziqet që lidhen me mbipërkushtimin dhe nënpërkushtimin. U krijuan mundësi për shprehjen e mendimeve pas punës dhe u nxitën aktivitetet në shërbim të krijimit të frymës së ekipit.

1.3 Njësia Mbështetëse: integrimi i konceptit të “këshillave dhe mbështetjes”

SVD-ja i përfshiu konceptet e këshillimit dhe mbështetjes në politikat, procedurat dhe praktikën e veta duke mundësuar që viktimat dhe dëshmitarët të trajtohen me ndjeshmëri dhe dinjitet dhe t'u ofrohet mbështetje nëpërmjet terapisë dhe këshillave individuale, ndërhyrjes në situata krizash dhe përkrahjes psikoshoqërore. SVD-ja e ka përkufizuar “këshillim dhe mbështetje” si një model integruar shërbimesh në lidhje me aspekte logjistike, psikoshoqërore dhe të sigurisë në kuadrin e paraqitjes së dëshmitarëve në Tribunal. Koncepti “këshilla dhe mbështetje” përmban tri elemente: (1) këshillim individual i viktimave dhe dëshmitarëve nga Funkionarët Mbështetës;¹⁹ (2) këshilla profesionale dhe këshillime me njësi të tjera brenda dhe jashtë SVD-së për të garantuar që shërbimet e ofruara t'u përgjigjen nevojave të viktimave dhe dëshmitarëve të cenusur dhe të traumatizuar; (3) një gamë shërbimesh për mbështetje konkrete, praktike dhe *psikoshoqërore* në të gjitha fushat e veprimtarisë së SVD-së.

Njësia Mbështetëse ofron ndihmë praktike dhe mbështetëse në përshtatje me rrethanat konkrete individuale duke pasur si synim parësor mirëqenien psikoshoqërore të dëshmitarëve. Sidoqoftë, Njësia Mbështetëse nuk zotëron burime për terapi afatgjatë e kjo nuk është pjesë e misionit të saj. Gjatë dhënies së dëshmisë mund të ndodhë ose të mos ndodhë ritraumatizimi i dëshmitarëve – nevojat e tyre individuale përcaktojnë llojin e shërbimeve që u ofrohen. Instrumentet kryesore për mbështetjen psikoshoqërore të dëshmitarëve janë aftësimi i dëshmitarëve në lidhje me strategjitë përballuese si dhe identifikimi me problemet e dëshmitarëve dhe dhembshuria për ta (shtjellohet me hollësi në kapitullin 5).

¹⁸ Charles R. Figley krijoi termin ‘ rraskapitje prej dhembshurisë’ dhe argumentoi për njohjen e këtij rreziku profesional dhe për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e programeve institucionale për parandalimin (Figley 1995).

¹⁹ Funkionari Mbështetës i SVD-së është i diplomuar si punonjës social, psikolog ose në fusha të tjera përkatëse si dhe është përgjegjës për mirëqenien mendore dhe fizike të viktimave dhe dëshmitarëve si edhe për administrimin e Njësisë Mbështetëse. Për më shumë hollësi në lidhje me strukturën e punonjësve të SVD-së shih Shtojcën I.

Duke mbajtur parasysh se nuk ekziston një zgjidhje e vetme për të gjithë, SVD-ja në kontaktet me dëshmitarët adoptoi një qasje të përqendruar ndaj dëshmitarëve dhe të vëmendshme ndaj ndryshimeve gjinore, veçanërisht për dëshmitarët e cenusshëm. Disa shërbime mbështetëse janë të qarta kurse të tjerat mund të anashkalohen lehtësisht. Të dëshmosh në një gjykatë ndërkombëtare mund të kthehet në një përvojë frikësuese, sidomos duke marrë parasysh se ka dëshmitarë të cilët për herë të parë në jetën e tyre janë larg shtëpisë, larg familjes e ndoshta është hera e parë që largohen nga vendi i tyre, ose udhëtojnë me avion për herë të parë. Ka dëshmitarë të cilët nuk flasin gjuhë tjetër përveç gjuhës së tyre amtare, ose nuk i njohin zakonet e vendit tjetër pa përmendur problemet që lindin prej rikujtimit të ngjarjeve traumatike të luftës. Nevojat e dëshmitarëve mbulojnë një spektër të gjerë kontaktesh që nga kontaktet e gjata dhe intensive me punonjësit e deri në thirrjet e shkurtra telefonike të punonjësve për të pyetur për shëndetin e dëshmitarit.

Ashtu sikurse informojnë shumë dëshmitarë, fakti se shumica prej tyre nuk kanë dëshmuar kurrë në gjyq në vendin e tyre, madje as për kundërvajtje në qarkullimin rrugor, e shton tryshinë ndaj tyre që të dëshmojnë siç duhet, e në të njëjtën kohë duke mos pasur asnjë përvojë të ngjashme ku mund të mbështeten. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në shtimin e stresit, të pasigurive, të varësisë dhe të nevojës për mbështetje dhe ndihmë për dëshmitarët dhe për të tjerë të cilët mund të kenë pasoja nga mungesa e dëshmitarit (fëmijët, prindërit ose dikush për të cilin kujdeset, punëdhënësi, etj.).

Misioni i SVD-së është që të ofrojë kujdes të standardeve më të larta. Njësia Mbështetëse zhvilloi një sërë mekanizmash mbështetëse për të garantuar mirëqenien e dëshmitarëve gjatë kohës që ishin nën kujdesin e SVD-së. SVD-ja është seksion neutral dhe i paanshëm i Sekretarisë, faktor që i mundëson të flasë në emër të dëshmitarëve dhe t'u ofrojë dëshmitarëve mundësi që në mënyrë private dhe konfidenciale të shprehin shqetësimet dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me paraqitjen e tyre në gjyq.

1.3.1 Mekanizmat mbështetëse të SVD-së

Në *periudhën para dhënies së dëshmisë* SVD-ja i informon dëshmitarët në lidhje me hollësitë logjistike për të cilat merr masat përkatëse për ta (vizat, strehimi, transporti, pagesat financiare, informacion në lidhje me procesin gjyqësor, dhe këshillimi individual, shërbimi i urgjencës në situatë krizash). SVD-ja kontakton dëshmitarët para dhënies së dëshmisë për të identifikuar dhe kur është e mundur eliminuar çdo pengesë të mundshme ndaj dhënies së dëshmisë dhe për të pakësuar ndikimin e dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët. Në këto rrethana, nevojat e dëshmitarëve janë të larmishme duke filluar që nga kujdesi për fëmijët, ndihma për një të afërt të sëmurë, këshillimi në lidhje me ankthin e krijuar nga prania në një mjedis të panjohur në Tribunal dhe kujdesi për bagëtinë. SVD-ja punon për kapërcimin e pengesave të cilat pengojnë dëshmitarë të ndryshëm që të vijnë e dëshmojnë lirisht në Hagë.

Periudha e dëshmisë përfshin udhëtimin dhe qëndrimin në Hagë si edhe ditën(t) e dhënies së dëshmisë. Për garantimin me përparësi të mirëqenies së dëshmitarit gjatë gjithë kohës, punonjësit e SVD-së punojnë me ndërrime 24 orë duke ofruar shërbime të qenësishme, praktike dhe mbështetëse si profesionalisht, po ashtu dhe personalisht. Këto shërbime janë të standardeve më të larta të mundshme ndër të cilat: informimi i dëshmitarëve në lidhje me nevojat e tyre praktike, ndihmë në lidhje me aspektin logjistik, organizimi dhe mundësimi në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme i kushteve të strehimit dhe ushqimit, dhënia e pagesave ditore, mbajtje kontaktesh me familjen dhe shoqërinë e dëshmitarit, shoqërimi i dëshmitarit në ambientet e gjykatës nëse nevojitet, ofrimi i aktiviteteve çlodhëse si edhe përkthime gojore te vizita nga mjeku, psikologu, psikiatri, etj. Punonjësit e SVD-së janë kualifikuar që të jenë mbështetës, të përdorin komunikim të përshtatshëm dhe të kujdesshëm, të ndihmojnë për kujdesin për dëshmitarët para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë dhe të vëzhgojnë sa të shqetësuar ose çfarë nevojash kanë dëshmitarët dhe të vënë në dijeni Funkionarët Mbështetës në rast se nevojitet veprim.

Periudha e pasdëshmisë fillon kur dëshmitari kthehet në shtëpi. SVD-ja vazhdon mbështetjen nëpërmjet thirrjeve telefonike vijuese katër deri në gjashtë javë pas dhënies së dëshmisë, për të parë se si po e përballon gjendjen dëshmitari, nëse ka çështje të diskutueshme në lidhje me dëshminë e tyre ose nevoja që kërkojnë mbështetje plotësuese dhe rekomandime. Në përgjithësi SVD-ja funksionon si pikë e

rëndësishme kontakti për dëshmitarët përgjatë gjithë fazave të procesit të dëshmisë në Hagë dhe në rajonin e ish-Jugosllavisë.

1.3.2 Shtrirja e programit mbështetës në rajonin e ish-Jugosllavisë

Kontaktet e herëpashershme me dëshmitarët në rajon si edhe sugjerimet e dëshmitarëve në Hagë e bënë SVD-në që të kuptonte gjithnjë e më qartë rëndësinë e kontakteve më të shumta dhe më të hershme me dëshmitarët e cenueshëm veçanërisht në zonat e thella. Një mbështetje e tillë i bëri dëshmitarët të ndiheshin më të sigurtë dhe më në kontroll dhe ndihmoi në përgatitjen e dëshmitarëve për procesin e vështirë të dhënies së dëshmisë në TPNJ. Një shumicë e gjerë e dëshmitarëve (rreth 70%) jetojnë në ish-Jugosllavi, fakt që përbënte vështirësi për punonjësit e SVD-së të cilëve iu desh të udhëtonin vajtje-ardhje në lidhje me problemet para dhe pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitarët. Për një shërbim sa më efikas, më 2002, SVD-ja ngriti Zyrën Rajonale të Sarajevës (ZRS) dhe mbajti një sërë konferencash për krijimin e lidhjeve bashkëpunuese të cilat ndihmuan për një bashkëpunim më të ngushtë midis punonjësve të sektorëve të shëndetësisë dhe kujdesit profesional në ish-Jugosllavi me synim përmirësimin e shërbimeve për viktimat dhe dëshmitarët.

Zyra Rajonale e Sarajevës

Shtimi i numrit të proceseve gjyqësore të TPNJ-së që zhvilloheshin njëkohësisht (deri në gjashtë njëkohësisht) bëri të nevojshëm fuqizimin e kapacitetit operativ për shkak të shtimit të numrit të dëshmitarëve për të cilët nevojitej mbrojtje, ndihmë logjistike dhe mbështetje psikoshoqërore. ZRS-ja²⁰ luan një rol parësor në përmbushjen e këtyre nevojave e në këtë mënyrë zgjeron dhe fuqizon shërbimet për dëshmitarët në rajon veçanërisht për dëshmitarët e cenueshëm ose të rrezikuar, me qëllim përmirësimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve të SVD-së për viktimat dhe dëshmitarët në rajon. Struktura e ZRS-së pasqyrore strukturën e SVD-së në Hagë në kuadër të një qasjeje të njëtrajtshme dhe përputhëse në zgjidhjen e problemeve të mbështetjes dhe mbrojtjes së dëshmitarëve. ZRS-ja fuqizon kontaktet e drejtpërdrejta në rajon, punon drejtpërsëdrejti dhe në vijimësi me organizata psikoshoqërore dhe mbështetëse të atjeshme, dhe ndihmon në bashkëpunimin midis TPNJ-së dhe autoriteteve vendore.

Që nga viti 2016 ndër veprimtaritë kryesore më të rëndësishme të Zyrës Rajonale të Sarajevës janë:

1. Këshillimi dhe mbështetja për viktimat dhe dëshmitarët që dëshmojnë nëpërmjet videolidhjes nga vendndodhje të ndryshme në ish-Jugosllavi. Për dëshmitarët të cilët për arsye shëndetësore, të sigurisë ose për arsye të tjera nuk janë në gjendje të vijnë në Hagë, TPNJ-ja autorizon dëgjimin e dëshmisë së tyre nëpërmjet videolidhjes.
2. Takime personale me dëshmitarët para dhe pas dëshmisë së tyre për vlerësimin e nevojave të tyre dhe përgjigje ndaj kërkesave të tyre.
3. Identifikimin dhe kontakte me organizata ndërkombëtare dhe vendore, organizata joqeveritare, institucione dhe autoritete vendore me qëllim rekomandimin e dëshmitarëve në këto organizata të cilat mund t'i ndihmojnë në rast se ndihma e TPNJ-së nuk është e mundshme.
4. Propagandim për mbështetjen e dëshmitarëve ndër të cilat pjesëmarrje në konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta dhe shkëmbim përvoja me partnerë vendorë.

Ndonëse nevoja për zgjerimin e veprimtarisë së SVD-së në rajon ishte e dukshme, kjo nuk ndodhi aq shpejt sa dëshirohej. Gjithsesi ZRS-ja arriti të përçonte praninë e shërbimeve mbështetëse në rajon për dëshmitarët. Është e rëndësishme të përmendet se mospasja e një zyre në terren në fillim shkaktoi probleme për shkak të vështirësive logjistike të udhëtimeve vajtje-ardhje në rajon.

²⁰ Nga punonjësit e SVD-së në ZRS janë një Ndhimësfunksionar Mbështetës, një Ndhimësfunksionar për Mbrojtje dhe një Ndhimës për Mbështetje. Për më shumë hollësi mbi strukturën e punonjësve të SVD-së shih Shtojcën I.

Konferencat për krijimin e lidhjeve

Në përgjigje të nevojave ekzistuese psikoshoqërore të dëshmitarëve nevojitet vijimi i shërbimeve aktuale. Për shkak se SVD-ja nuk zotëron burimet e nevojshme për plotësimin e larmisë së nevojave të dëshmitarëve në periudhën pas dhënies së dëshmisë, ajo mbështetet në lidhjet me një sërë organizatash në rajon për rekomandimin e shërbimeve. Më 2004, me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian, SVD-ja organizoi disa konferenca në Hagë²¹ për krijimin e lidhjeve dhe rrjeteve rekomanduese të forta me punonjës të sektorit shëndetësor nga Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, Kroacia, Kosova²² dhe Maqedonia. Objektivi i këtyre konferencave ishte që punonjësit e sektorit shëndetësor dhe shoqëror të informoheshin sa më mirë mbi rolin dhe funksionin e SVD-së, të TPNJ-së dhe për pjesëmarrjen e psikiatërve, mjekëve, psikologëve dhe punonjësve socialë nga sektori publik dhe ai privat. Nëpërmjet këtyre nismave SVD-ja krijoi një rrjet profesionistësh të sektorit shëndetësor dhe shoqëror të cilët u njohën me punën e TPNJ-së dhe dëshmitarëve të saj. ZRS-ja ka rekomanduar shumë dëshmitarë për ndihmë të mëtejshme nëpërmjet këtyre lidhjeve dhe ka vijuar punën për ruajtjen dhe zgjerimin e këtyre lidhjeve në rajon.

1.3.3 Vijimi i shërbimeve për dëshmitarët

Neni 34 i Rregullores të Procedurës dhe Provave kanë çuar në vijimin e shërbimeve të SVD-së edhe në periudhën pas dhënies së dëshmisë. Fillimisht vijimi i shërbimeve për dëshmitarët bëhej rast pas rasti, mirëpo më 2009 SVD-ja i dendësoi përpjekjet për një qasje më koherente gjatë vlerësimit të mirëqenies së dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë. Kjo rezultoi në krijimin e Praktikës së Vijimit e cila përfshin si më poshtë:

1. **Thirrje telefonike të rregullta:** Që nga viti 2009, SVD-ja ka kontaktuar të gjithë dëshmitarët të cilët kishin dëshmuar në TPNJ, katër deri në gjashtë javë pas kthimit të tyre në shtëpi. Synimi i këtyre thirrjeve telefonike ishte që dëshmitarëve t'u krijohej ndjenja e ndarjes nga e shkuara, të vlerësohej mirëqenia e dëshmitarëve dhe të shprehej mirënjohja ndaj dëshmitarëve për kontributin e tyre ndaj drejtësisë. Në të shkuarën u ndërmorën disa nisma (më 2000, 2002, 2004 dhe 2006) në përpjekje për përfshirjen e shërbimeve vijuese në Programin Mbështetës të SVD-së.
2. **Vizitat/kontaktet e drejtpërdrejta:** Qëllimi i vizitave të dëshmitarëve prej SVD-së është vlerësimi i rrethanave dhe nevojave aktuale pas kthimit të tyre nga Haga ose nga vendndodhja e videolidhjes, nëpërmjet takimeve në shtëpinë e dëshmitarit ose në ndonjë vend tjetër ku palët bien dakord të takohen.
3. **Rekomandimet për organizatat dhe institucionet joqeveritare dhe propagandimi i çështjes së dëshmitarëve:** Qëllimi i rekomandimit të një dëshmitari nga SVD-ja në organizata joqeveritare dhe/ose institucione të tjera është mundësimi i ndihmës së nevojshme për dëshmitarin, ndihmë e cila nuk mund të jepet nga TPNJ-ja. Dëshmitarët që jetojnë në vende ku kanë ndodhur konflikte kanë një sërë nevojash të cilat mund të plotësohen vetëm nëpërmjet rindërtimit të strukturave shtetërore ekonomikisht të qëndrueshme dhe të sigurt. Këto nevoja nuk mund të plotësohen kurrë vetëm nga burimet e TPNJ-së. Në mungesë të programeve për dëshmshpërbim ose kompensim, ose një buxheti të posaçëm për mundësimin e nevojave bazë (p.sh. strehimi, ushqimi, arsimit, sigurimet mjekësore dhe shoqërore, etj.), SVD-ja është e detyruar që të negociojë dhe të inkurajojë faktorë të jashtëm për plotësimin e këtyre nevojave bazë për dëshmitarët e cenushtëm.
4. **Ndihma Urgjente:** Ndihma urgjente përfshin kryesisht ndihmë financiare për veshjen e dëshmitarëve para daljes së tyre në gjykatë, ndihmë në periudhën pas dëshmisë, ndihmë (trajtim) mjekësore dhe/ose ndihmë të atypëratyshme në përgjigje të nevojave urgjente të dëshmitarëve të lindura prej dëshmisë së tyre.
5. **Kompensim i humbjeve të jashtëzakonshme:** Veç pagesave standarde, në raste te veçanta dhe bazuar në dokumentacion shtesë, dëshmitarët përfitojnë edhe kompensim për humbje të

²¹ Shih www.icty.org/x/file/Outreach/view_from_hague/balkan_040616_en.pdf

²² Në këtë raport ky emërtim është përdorur pa paragjykim ndaj statusit të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. ICJ Reports, 2010, Advisory Opinion of 22 July 2010.

jashtëzakonshme synimi i të cilit është mbulimi i humbjeve financiare të jashtëzakonshme për shkak të dhënies së dëshmisë. Këto janë humbje të cilat dëshmitari i ka pasur ose do të ketë si pasojë e dëshmisë në TPNJ e të cilat i krijojnë pengesa e vështirësi të mëdha.

Një nga pyetjet më të shpeshta që i bëhen SVD-së është si e përballojnë dëshmitarët dhënien e dëshmisë dhe sa mirë funksionojnë ata pas dhënies së dëshmisë. A kanë nevojë dëshmitarët për ndihmën dhe mbështetjen e SVD-së menjëherë pas përfundimit të dëshmisë, apo gjashtë ose më shumë muaj më vonë? Mënyra e vetme për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve është nëpërmjet kontakteve të rregullta e vijuese me dëshmitarët.

1.4 Sfidat e SVD-së

1.4.1 Burimet

“Këshillimi dhe mbështetja” e SVD-së bën të mundur që dëshmitarët të dëshmojnë me sa më pak ngarkesë psikologjike, emocionale dhe fizike, qofshin këta dëshmitarë të Prokurorisë, të Mbrojtjes apo të Dhomave. Për të garantuar paanësinë e vet dhe për të mundur cilësi dhe transparencë në punën e vet, SVD-ja ka zhvilluar një sërë praktikash bazuar në vlerësimin dhe rivlerësimin e nevojave të dëshmitarëve. SVD-ja është përpjekur gjithmonë që këto praktika të bazohen mbi nevojat konkrete. Për shembull, në fillim dëshmitaret femra ngurronin të dëshmonin sepse atyre u duhej të kujdeseshin për fëmijët e tyre. Për këtë arsye SVD-ja krijoi praktikën përkatëse në përgjigje të shqetësimeve të këtyre dëshmitareve dhe kërkoi burimet në përmbushje të kësaj nevoje.

Pas konceptualizimit të shërbimeve të SVD-së, një nga sfidat e tjera të vështira për Njësinë Mbështetëse ishte të sigurohej numri i nevojshëm i punonjësve në Hagë dhe më vonë në ZRS. Fillimisht shpenzimet për pagat e disa vendeve pune brenda SVD-së mbuloheshin nga kontribues të jashtëm dhe vetëm pas disa vitesh debati dhe lobimi ato u përfshinë në buxhetin e rregullt të TPNJ-së.²³ Paqartësitë në lidhje me financimin dhe numrin e punonjësve vunë në pikëpyetje vijimin e shërbimeve dhe ndikuan negativisht në moralin e punonjësve.

1.4.2 Trajtimi i pritshmërive

Që prej themelimit të Tribunalit ka ekzistuar përherë debati mbi përgjegjësitë e TPNJ-së ndër të cilat edhe lloji e masa e shërbimeve për viktimat dhe dëshmitarët. Të gjitha shërbimet e SVD-së lidhen drejtpërsëdrejti me procesin e dhënies së dëshmisë dhe dëshmitarët të cilët vijnë në TPNJ mund të kenë pritshmëri të ndryshme përsa i përket aspektit se çfarë mund të bëjë Tribunali për ta. Në disa raste pritshmëri të tilla dalin jashtë mandatit të SVD-së. SVD-ja nuk mund të krijojë varësi të dëshmitarëve prej TPNJ-së dhe ka bërë çmos për një riintegrim të plotë e sa më të shpejtë të dëshmitarëve në shoqëritë e tyre brenda mundësive.

Roli i SVD-së kufizohet në mundësimin e paraqitjes së të gjithë dëshmitarëve në gjyq dhe në ndryshim nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN), TPNJ-ja nuk ka fond mbështetës për viktimat.²⁴ Ashtu sikurse përcaktohet në Rregullën 106 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit,²⁵ viktimat mund të kërkojnë dëmshpërblim në gjykatat e vendeve të ish-Jugosllavisë kundër individëve të dënur

²³ Që nga tetori 1995 deri në janar 1999, pesë Ndihmës për Dëshmitarët në Hagë të ngarkuar me shërbim 24-orësh në dispozicion të dëshmitarëve u paguan nëpërmjet një kontributi të Bashkimit Evropian nga Qendra Kërkimore dhe Rehabilituese për Viktimat e Torturave në Danimarkë. Në janar 1999 pagat e Ndihmësve për Dëshmitarë u përfshinë në buxhetin e rregullt të Kombeve të Bashkuara. Nga 2002 deri më 2004, dega e SVD-së në ZRS u mbështet financiarisht nga qeveria kanadeze dhe ajo britanike. Që nga janari 2005, ZRS-ja është e përfshirë në buxhetin e rregullt të Kombeve të Bashkuara. Për më shumë hollësi mbi strukturën e punonjësve të SVD-së shih Shtojcën I.

²⁴ Më 2002, Gjykata Penale Ndërkombëtare krijoi Fondin e Mbështetjes për Viktimat bazuar në Nenin 79 të Statutit të Romës. Shih gjithashtu <http://www.trustfundforvictims.org/>

²⁵ Shih http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Rules_procedure_evidence/IT032Rev49_en.pdf Rregulla 106 Dëmshpërblimi i Viktimave

nga Tribunali. Viktimat nuk gëzojnë të drejtë ligjore të depozitojnë padi për dëmshpërblim ose kompensim në Tribunal.

Në vendet e dala nga konfliktet ku përgjithësisht shërbimet mjekësore, shoqërore ose të kategorive të tjera nuk ekzistojnë, ose nuk mund të përdoren prej dëshmitarëve, ose kur dëshmitarëve u mungon besimi ndaj autoriteteve vendore, mbështetja për ndihmë në institucionet vendore është problematike. Për këtë arsye nuk përbën befasi fakti se ndonjëherë dëshmitarët gabimisht mendojnë se TPNJ-ja si institucion ndërkombëtar mund të mbështesë kërkesat e tyre në institucionet e vendeve të tyre, të rekomandojë ose madje të detyrojë që autoritetet vendore t'i përgjigjen pozitivisht kërkesave të tyre dhe të zgjidhin problemet e tyre brenda një kohe të shkurtër.

Nga shumë kontakte të SVD-së me dëshmitarët para dhe pas dhënies së dëshmisë rezultojnë se ekziston një perceptim i gabuar për Tribunalin dhe rolin e tij në vendimet e autoriteteve të vendeve ku jetojnë dëshmitarët. Këto perceptime të gabuara ndryshojnë me vështirësi dhe kanë shkaktuar zhgënjim të thellë për shumë dëshmitarë të TPNJ-së. Si rrjedhojë, është e nevojshme që dëshmitarët të marrin informacion të saktë dhe në kohë për mandatin dhe rolin e SVD-së dhe TPNJ-së, ku përfshihen edhe rregullat dhe procedurat për dëmshpërblimin, për trajtimin e duhur të pritshmërive të dëshmitarëve dhe eliminimin e zhgënjimeve.

Përmbledhje

Mbështetja për dëshmitarët luan një rol thelbësor në mbarëvajtjen e procesit në TPNJ. Puna udhëçelëse e SVD-së ka ofruar kuptim rrënjësor në konceptin e mbështetjes së dëshmitarëve dhe ka sjellë në jetë procedura praktike.

Ndër mësimet e nxjerra nga zhvillimi i TPNJ-së mund të përmenden. Së pari, për parapërgatitjen e frytshme të dëshmitarit në lidhje me procesin në tërësi të dhënies së dëshmisë dhe pritshmëritë e mundshme të dëshmitarit në lidhje me procesin, është e nevojshme që dëshmitarët t'i jepet informacion përputhës dhe në kohë mbi rolin e dëshmitarit, përgjegjësitë e SVD-së dhe veprimtarinë e TPNJ-së. Së dyti, për të kuptuar sa më mirë nevojat dhe shqetësimet e dëshmitarëve, nevojitet një standardizim dhe përfshirje e veprimtarive vijuese afatshkurtra dhe afatgjata në periudhën pas dëshmisë. Së treti, që viktimave dhe dëshmitarëve t'u jepet kujdesi dhe ndihma e duhur, është e nevojshme që të sigurohet që prej fillimit financim i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm që mundëson numër të mjaftueshëm të punonjësve të kualifikuar, të aftë që t'u ofrojnë mbështetje me cilësi të lartë viktimave dhe dëshmitarëve si në selinë e gjykatës dhe akoma më me rëndësi në terren ku jetojnë edhe dëshmitarët më të shumtë. Burimet e kufizuara njerëzore krijojnë pasiguri në lidhje me shërbimet, vënë në pikëpyetje zgjidhjen e nevojave të dëshmitarëve, ndikojnë keq në dhënien e efikase dhe praktike të shërbimeve dhe gjithashtu kanë ndikim në punësimin dhe mbajtjen e punonjësve me një nivel të lartë kualifikimi. Së katërti, mbështetja e nevojshme për punonjësit të cilët kanë të bëjnë me individë të prekur nga lufta është e domosdoshme për garantimin e cilësisë së shërbimit. Brenda organizatës duhen krijuar programe me objektiv zhvillimin profesional ku të përfshihet edhe kujdesi për vetveten prej punonjësve.

Kapitulli 2 – Studimi Pilot: baza dhe metodologjia

Qëllimi këtij Studimi Pilot ishte të krijohej një kuptim sa më i plotë i ndikimit të dhënies së dëshmisë të dëshmitarët. Ky kapitull përshkruan synimet kryesore të Studimit Pilot dhe ofron më shumë informacion për strukturën e studimit. Këtu trajtohen metoda e përzgjedhjes së modeleve, rekrutimi i pjesëmarrësve dhe procesi i grumbullimit të të dhënave.

2.1 Synimet

SVD-ja dhe UNTja e ndërmorën këtë Studim Pilot për të kuptuar më qartë perceptimet e dëshmitarëve mbi ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë të dhënies së dëshmisë në TPNJ ndaj tyre, me tri synimet e përkufizuara si më poshtë:

1. Kryerja e një analize të gjerë e të shumanshme të efekteve që janë rrjedhojë e pjesëmarrjes së dëshmitarëve në proceset penale të TPNJ-së.

Projekti kontribuon në tërësinë e hulumtimeve ku analizohet ndikimi i dhënies së dëshmisë ndaj dëshmitarëve të cilët dëshmojnë në gjykata ndërkombëtare ose shtetërore për krime lufte. Nga intervistat me viktimat dhe dëshmitarët del se pjesëmarrja në një proces gjyqësor mund të ndihmojë dhe/ose të rëndojë ripërtëritjen psikologjike të mbijetuesve prej dhunës. Në disa studime ekzistuese rekomandohet hulumtimi i mëtejshëm në lidhje me ndikimin afatgjatë të dhënies së dëshmisë me theks të veçantë mirëqenien e viktimave dhe dëshmitarëve me qëllim që gjatë periudhës pas gjyqit të jepet ndihma e duhur (Stover 2005, 2014; Horn et al. 2009, 2011; Henry 2009; O’Connell 2005; Mendeloff 2009; Stepakoff 2014, 2015).

2. Vlerësimi i nevojave të dëshmitarëve.

Informacioni nga Studimi Pilot do t’i mundësojë SVD-së që të bëjë vlerësimin e nevojave të dëshmitarëve në periudhën pas gjyqit dhe do ta ndihmojë në përcaktimin e marrjes së masave të nevojshme, ndër të cilat rekomandime për shërbimet nga institucionet shtetërore, ose nga organizatat joqeveritare që veprojnë në rajon.

3. Kontribut për trashëgiminë e TPNJ-së nëpërmjet dhënies së informacionit të dobishëm dhe udhëzimeve për strukturat e ardhshme të mbështetjes së dëshmitarëve.

Përfundimet dhe rekomandimet e formuluar në Studimin Pilot do të jenë analiza e parë e gjerë dhe e thellë e efekteve dhe pasojave të pjesëmarrjes së dëshmitarëve në procese penale ndërkombëtare duke kontribuar në trashëgiminë e TPNJ-së dhe në zhvillimin e praktikave më të mira në gjykata të tjera ndërkombëtare dhe shtetërore për krime lufte.

Synimet e këtij studimi përbëjnë risi në disa aspekte. Deri më sot, asnjë studim i kësaj shkalle nuk ka përdorur një proces të tillë sistematik dhe shkencor të përzgjedhjes së modeleve nga një popullatë kaq e madhe për të analizuar ndikimin afatgjatë që ka procesi i dëshmitarëve për krimet e luftës ndaj dëshmitarëve. Anketimet dhe intervistat e kryera nga punonjës të kualifikuar dhe me përvojë të SVD-së mundësojnë përfshirjen e dëshmitarëve të cilët në rrethana të tjera nuk do të ishin përfshirë, si për shembull viktimat e dhunës seksuale ndaj të cilëve nevojitet vëmendje e veçantë gjatë procesit të anketimit (Sharratt 2011) dhe dëshmitarët të cilët dëshmuar me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit gjatë një apo më shumë paraqitjeje në gjyq, identiteti i të cilëve nuk mund të bëhet i njohur publikisht (Kravetz 2013). Së fundi, ky studim është më i gjerë se studimet e mëparshme lidhur me dhënien e dëshmisë në TPNJ, sepse përfshin dëshmitarë të thirrur nga të gjitha palët, përkatësisht Prokuroria, Mbrojtja dhe Dhomat (Stover 2005).

2.2 Procesi i zhvillimit të anketimit

2.2.1 Hulumtime dhe të dhëna të mëparshme

Më 2009, SVD-ja filloi si shërbim të rregullt vijues një anketim tërësisht anonim i cili bëhet me të gjithë dëshmitarët pasi ata kanë dëshmuar dhe para se të largohen nga Haga. Ky anketim, ndonëse me objektiv të kufizuar dhe vetëm për përdorim të brendshëm të SVD-së, përfshiu disa parametra në pyetjet ndaj dëshmitarëve për përvojat e tyre me mbështetjen e përgjithshme logjistike dhe psikoshoqërore të dhënë nga SVD-ja. Të dhënat e nxjerra nga këta pyetësorë informojnë mbi mendimin e dëshmitarëve për shërbime të ndryshme të SVD-së, gjegjësisht mbështetje logjistike, psikoshoqërore dhe mbrojtje. Për arsye se ky anketim është bërë në anonimitet (për të garantuar fshehtësinë e identitetit të dëshmitarëve), nuk është e mundur të përcaktohet kohëzgjatja e dhënies së dëshmisë të dëshmitarëve të anketuar, nëse ata kishin dëshmuar në një ose më shumë procese gjyqësore, apo madje në cilin proces kishin dëshmuar. Këta faktorë e kufizuan dobinë e këtij anketimi anonim.

Ekzistojnë edhe studime të tjera të mëparshme mbi dëshmitarët e Tribunalit. Së pari, Stover (2005) intervistoi 87 dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria në TPNJ, si edhe punonjës të TPNJ-së nëpërmjet një procesi të strukturuar intervistash. Ndonëse dëshmitarët u shprehën më së shumti pozitivisht për përvojën e tyre, studimi e vuri theksin në kritikën ndaj procesit të dhënies së dëshmisë. Së dyti, Stover (2014) analizoi paraqitjen e dëshmitarëve-viktima në Gjykatën Penale Ndërkombëtare duke përdorur një instrument anketimi bazuar në intervista para dhënies së dëshmisë (n=104); shpejt pas dhënies së dëshmisë (n=109); dhe gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj pas dhënies së dëshmisë (n=32). Ai konstatoi se procesi i dhënies së dëshmisë ishte në tërësi pozitiv ku femrat u shprehën paksa më pozitivisht se meshkujt. Gjithsesi femrat ndiheshin më pak të sigurta se meshkujt në periudhën pas gjyqit dhe ishin më pak të prirura të mendonin se dëshmia e tyre kishte ndihmuar të vërtetën ose drejtësinë.

Ndoshta të dhënat më të rëndësishme kanë rezultuar nga informacioni i pasur i dalë prej intervistave thelluese të kryera në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen. Ka më shumë të ngjarë që dëshmitarët të kenë pasur përvojë pozitive në qoftë se ata (1) janë ndjerë të respektuar prej punonjësve të Gjykatës, dhe (2) e kanë përjetuar marrjen në pyetje nga pala kundërshtarë si përvojë pozitive (Horn et al. 2009, 2011). Arsyet e dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve janë si publike, po ashtu edhe personale (Stepakoff et al. 2014, 2015). Ndër arsyet publike përfshihen ndihmesa në “njohuritë publike për luftën”; dëshira për “drejtësi ndëshkuese; dhe më shpesh “detyrimi moral ndaj viktimave”. Ndër arsyet personale të dhënies së dëshmisë përfshihen “dhënia e mundësisë për të treguar përjetimet e mia”; “munda të flas për përvoja të vështira/të dhimbshme duke thyer heshtjen”; dhe “ndjeva se më kushtuan vëmendje, më besuan/kuptuan.” Së fundi, i njëjti studim konstatoi se mesatarisht për çdo pesë dëshmitarë, katër i cilësuan pasojat e dhënies së dëshmisë kryesisht pozitive (kundrejt negative ose neutrale) dhe tregoi se kishte tri herë më shumë pasoja pozitive sesa negative.

Përfundimet nga Stover (2005) dhe Horn, et al. (2009, 2011) ofruan informacion bazë për çështjet përkatëse të shtjelluara gjatë anketimit të grupeve të përzgjedhura dhe përpilimit të anketimit të Studimit Pilot.

2.2.2 Grupet fokusuese dhe pyetësorët

Para hartimit të anketimit të gjithë punonjësit e SVD-së të cilët ishin të punësuar në atë kohë morën pjesë në disa grupe fokusuese për të dhënë mendime në lidhje me punën me dëshmitarët e TPNJ-së dhe për shqetësimet përkatëse të dëshmitarëve në atë kohë. U organizuan 16 konferenca nëpërmjet videolidhjes dhe takime të grupeve fokusuese midis SVD-së në Hagë, SVD-së në Zyrën Rajonale në Sarajevë dhe UNT-së në Denton, Teksas, për hartimin e anketimit gjatë vitit 2012. Në ekip u përfshinë 19 punonjës të SVD-së në Hagë, tre punonjës të ZRS-së dhe shtatë anëtarë të fakultetit dhe studentë të diplomuar nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe ai i Psikologjisë i UNT-së, kryesisht specialistë për traumat. SVD-ja dhe UNT-ja krijuan protokolle për kryerjen e anketimit, kontaktet me dëshmitarët,

informimin dhe sigurinë e tyre bazuar në praktikat më të përparuara prej studimeve në terren dhe përvojës (historike) të TPNJ-së.

Viti i hartimit të anketimit ndihmoi në kontaktet e rregullta midis instancave përkatëse. Pas përfundimit të grupeve fokusuese, nga fundi i vitit 2012, SVD-ja dhe UNT-ja filluan mbajtjen e takimeve të përdyjavshme për shqyrtimin e afërsisht 75 faqeve me pyetjet e propozuara për anketimin. Koha e caktuar për intervistat ishte afërsisht 75-120 minuta gjithsej për të parandaluar rraskapitjen e dëshmitarëve. Të gjithë kontaktet ndërmjet zyrave përkatëse u realizuan nëpërmjet lidhjeve të sigurta nëpërmjet videos, në Skype dhe postë elektronike.

Anketimi prej 32 faqesh përmban 149 pyetje me disa mundësi përgjigjeje si dhe 37 pyetje vijuese dhe 31 mundësi që dëshmitarët të shkruajnë përgjigje të shkurtra për pyetjet. Të gjitha pyetjet synojnë të nxjerrin në dukje një ide sa më të qartë të ndikimit afatshkurtër dhe afatgjatë në mirëqenien e dëshmitarëve. Në pesë kapituj të anketimit vlerësohen: (1) profili i dëshmitarit dhe arsyet për dhënien e dëshmisë (28 pyetje dhe dy vijuese); (2) ndikimi shoqëror-ekonomik ndaj dëshmitarëve (tetë pyetje dhe shtatë vijuese); (3) shqetësimet e dëshmitarëve për sigurinë (dhjetë pyetje dhe 21 vijuese); (4) gjendja fizike dhe mendore e dëshmitarëve (82 pyetje dhe 3 vijuese); dhe (5) perceptimet e dëshmitarëve për drejtësinë dhe trashëgiminë e TPNJ-së (21 pyetje dhe katër vijuese). Në pjesën e gjashtë janë tri pyetje që nuk kërkojnë përgjigje të prera të cilat intervistuesit i incizojnë në përfundim të anketimit me shkrim. Kjo pjesë u ofron dëshmitarëve mundësinë të shtjellojnë më hollësisht shqetësimet ose problemet mbi procesin e dhënies së dëshmisë, të japin këshilla për dëshmitarë në gjykime të krimeve të luftës në të ardhmen dhe t'i japin mendime TPNJ-së se çfarë do të ndryshonin ata në procedurën ose procesin e dhënies së dëshmisë.

2.2.3 Miratimi prej Komisionit të Etikës dhe përkthimi

Që nga konceptimi i projektit, UNT-ja u këshillua dhe më në fund mori miratimin e Komisionit Institucional të Etikës për të garantuar që anketimi të ishte në përputhje me normat shtetërore dhe ndërkombëtare.²⁶ Anketimin dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për kryerjen e tij, SVD-ja ia kaloi Seksionit për Përkthimet Gojore dhe me Shkrim të TPNJ-së (SPGSH) për përkthim zyrtar në BKS në gjysmën e parë të vitit 2013 dhe në nëntor 2014, SPGSH-ja përktheu edhe versionin në gjuhën shqipe. SVD-ja në Hagë dhe Sarajevë, SPGSH-ja dhe UNT-ja shqyrtuan në mënyrë të pavarur të gjitha pikat e anketimit për të garantuar njëtrajshmërinë në frazeologji, terminologji dhe strukturat matëse të anketimit me qëllim që të pasqyroheshin përvojat e dëshmitarëve të përfaqësuara në grupet e fokusuara. SVD-ja dhe UNT-ja hartuan gjuhën, terminologjinë, protokollet dhe formularin e dhënies së pëlqimit në një mënyrë të tillë që të ishin të lexueshme dhe të kuptueshme për dëshmitarë niveli arsimor i të cilëve ishte së paku tetë vjet në arsimin fillor.

2.3 Pjesëmarrësit dhe procesi i përzgjedhjes

2.3.1 Të dhënat e dëshmitarëve të SVD-së

SVD-ja administron një arkiv të dhënash për nevoja të përditshme nëpërmjet të cilit gjendet informacion për të gjithë individët të cilët përfitojnë shërbime prej SVD-së dhe dokumenton kontaktet e SVD-së me dëshmitarët. Arkivi i të dhënave të SVD-së është i lidhur me sisteme të tjera të administrimit të dokumentacionit të dëshmitarëve të TPNJ-së të cilët përmbajnë informacion të rëndësishëm në lidhje me dëshmitarët, informacion që buron prej vendimeve gjyqësore (p.sh. masa mbrojtëse, fletëthirrje për paraqitje të detyruar në gjykatë, urdhra për kalim të sigurtë, etj). Si rrjedhojë, arkivi i të dhënave të SVD-së ofron një burim të pasur informacioni për dëshmitarët. Në kuadër të Studimit Pilot, SVD-ja e shfrytëzoi arkivin e vet për krijimin e një liste të anonimizuar dëshmitarësh e cila i mundësoi UNT-së të krijonte një proces filtrimi për identifikimin e një grupi të përshtatshëm të anketuarish të mundshëm,

²⁶ Komisionit Institucional të Etikës 13200-R15 miratimi në mars 2013 dhe përtërihet çdo vit. Aktualisht në fuqi nga prill 2015 deri në maj 2016 arkivuar në University of North Texas së bashku me certifikatat e të gjithë punonjësve të SVD-së dhe UNT-së për trajnimin e Subjekteve Njerëzore të Institutit Kombëtar të Shkencave.

nga numri dhe jo nga identiteti i tyre. Prej kësaj u hartuan lista model të individëve të përshtatshëm për anketim nga Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Kosova. Nuk u përfshinë individë të cilët mbështesnin ose vareshin financiarisht prej dëshmitarëve (të afërm, shokë), të cilët shoqëronin dëshmitarët dhe të cilët nuk dëshmuar. Gjithsesi SVD-ja dokumentoi kontaktet me ta në arkivin e vet. Nuk u përfshinë dëshmitarë të thirrur në cilësinë e ekspertit (p.sh. ata që kishin njohuri për operacione ushtarake, kriminalistikë, demografinë dhe tema të tjera) sepse objektivi ishin dëshmitarët e fakteve. Dëshmitarët të cilët jetonin jashtë ish-Jugosllavisë nuk u përfshinë për shkak të kufizimeve logjistike. Gjithashtu nuk u përfshinë as dëshmitarët që dëshmonin ose që ishin planifikuar të dëshmonin në katër proceset gjyqësore të asaj kohe për arsye të shqetësimeve mbi manipulimin e proceseve gjyqësore. Është fjala për proceset gjyqësor të Ratko Mlladiqit, Radovan Karaxhiqit, Vojislav Sheshelit dhe Goran Haxhiqit. Së fundi, nuk u përfshinë as dëshmitarët të cilët kishin dëshmuar gjatë periudhës 1995-1998, sepse SVD-ja nuk kishte të dhëna kontakti për ta për arsye se gjatë asaj kohe kontaktet kryheshin përmes autoriteteve vendore dhe nuk ruheshin prej TPNJ-së.

2.3.2 Modeli dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve të përshtatshëm

SVD-ja dhe UNT-ja përzgjedhën pjesëmarrës të përshtatshëm për anketimin nga arkivi i të dhënave të SVD-së nëpërmjet një procesi përzgjedhës sasior dhe të shtresuar për të krijuar një model përfaqësues të përbërësve kryesorë. Përzgjedhja e modelit u bazua në individë të cilët: (1) kishin dëshmuar personalisht (*viva voce*) në së paku një proces gjyqësor si “dëshmitarë faktesh” për Prokurorinë, Mbrojtjen dhe/ose Dhomat; (2) aktualisht jetojnë në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Serbi ose Kosovë dhe ishin të përshtatshëm për pjesëmarrje (shpjegohet më poshtë).²⁷ Në këtë model përfshihen dëshmitarë nga të gjitha çështjet për të cilat ka përfunduar faza e gjykimit dhe dëshmitarë nga çështjet që janë në fazën e apelit.

Hulumtuesit e UNT-së bashkëpunuan me SVD-në për të mundësuar që duke u bazuar në kategorinë e dëshmitarëve që kërkoheshin për anketim (dëshmitarë faktesh të cilët jetonin në rajon dhe të cilët në kohën e përzgjedhjes së modelit nuk kishin dëshmuar në asnjë nga proceset gjyqësore që zhvilloheshin në atë kohë), UNT-ja do t'i jepte SVD-së modele rastësore të dhënash mirëpo kjo do të rezultonte në një grup të anketuarish që kishte karakteristika të ngjashme me krejt bashkësinë e synuar të dëshmitarëve nga ish-Jugosllavia. UNT-ja prodhoi numra identifikues rastësorë për dëshmitarët për të garantuar një model rastësor, mirëpo e plotësoi procesin me qëllim që nga çdo grup etnik kryesor të ishte një numër i mjaftueshëm individësh. Ndër të anketuarit ishin dëshmitarë të Mbrojtjes, të Prokurorisë dhe të Dhomave si edhe femra në mënyrë që modeli të ishte i mjaftueshëm për analiza të thelluara. UNT-ja i dërgoi rregullisht SVD-së lista me numra identifikues të dëshmitarëve në lidhje me përpjekjet për marrjen e kontakteve fillestare me dëshmitarët. Ky proces vazhdoi gjatë gjithë kryerjes së anketimit për të garantuar që veçoritë e modelit të Studimit Pilot të përputheshin në tërësi me veçoritë e të gjithë dëshmitarëve në sistemin e të dhënave të TPNJ-së.

Ky studim u përqendrua në bashkësinë e dëshmitarëve të përgjithshëm, pra jo te paria, zyrtarë të lartë apo punonjës të TPNJ-së të cilët dëshmuar. Gjithashtu një synim tjetër i Studimit Pilot ishte mbrojtja e dëshmitarëve të cenueshëm, ose të rrezikuar prej kërcënimeve të mundshme nga pjesëmarrja e tyre. Për këto arsye, në lidhje me përshtatshmërinë për pjesëmarrje në anketim, SVD-ja dhe UNT-ja morën parasysh edhe faktorët vijues. Dëshmitarët ishin të përshtatshëm për pjesëmarrje në qoftë se ata kishin dëshmuar nga viti 1999,²⁸ ose më vonë dhe në qoftë se kishin qenë të pranishëm në TPNJ, ose kishin dëshmuar përmes videolidhjes nga një vendndodhje e largët në së paku një proces gjyqësor. Dëshmitarët nuk mund të përzgjidheshin në qoftë se ata: (1) ishin akuzuar ose dënuar për krimet (të


²⁷ Vendimi i SVD-së në përzgjedhjen e Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe Kosovës u bazua në nevojën për: (a) vlerësimin e drejtpërdrejtë të ndikimit të dhënies së dëshmisë te individët të cilët ende jetonin në rajone të prekura nga luftërat e Ballkanit; (b) kufizimin e shpenzimeve të projektit; dhe më e rëndësishme; (c) garancinë që punonjësit e kualifikuar të SVD-së të ishin me dëshmitarët gjatë procesit të anketimit në rast se do të kishte shqetësime mbi dobësitë, zemërimin dhe stresin pastraumatik të dëshmitarëve, etj. Është e nevojshme që punonjësit e kualifikuar të jenë të pranishëm për të ndihmuar në zgjidhjen e çfarëdo problemi dhe për mbështetje dhe rekomandim të dëshmitarëve në rast nevojë.

²⁸ Para vitit 1999 i gjithë informacioni për dëshmitarët mbahej nga autoritetet shtetërore dhe vendore në ish-Jugosllavi. Pra Tribunali nuk zotëronte të dhënat për adresat apo për kontakt të dëshmitarëve në qoftë se dëshmitarët nuk dëshmonin në procese gjyqësore të mëvonshme.

pandehur); (2) ishin politikanë ose zyrtarë të tjerë të lartë; (3) ishin punonjës aktualë ose të mëparshëm të TPNJ-së; (4) kishin probleme sigurie, probleme ekzistuese ligjore, ose shqetësime në lidhje me mirëqenien e tyre (probleme shëndetësore, fizike dhe mendore). Përjashtimi ishte rezultat i një shqyrtimi tërësor të rasteve individuale të dëshmitarëve nga punonjësit e SVD-së. Gjithashtu SVD-ja u këshillua me Njësinë Mbrojtëse për marrjen e miratimit që SVD-ja të mund të kontaktonte dëshmitarët e shqyrtuar. Për arsytet e lartpërmendura nuk u përfshinë gjithsej 61 dëshmitarë.

Duke filluar nga viti 2014, numri përfundimtar i dëshmitarëve të përshtatshëm në rajon ishte 2136 (shih Figurën 2.1). Për të garantuar numër të mjaftueshëm të dëshmitareve femra në të dhënat, ishte e nevojshme të sigurohej përfaqësimi i duhur gjinor. Përqindja e dëshmitareve femra nga rajoni për anketim shkon nga më pak se 9% në Serbi në më shumë se 16% në Bosnjë-Hercegovinë. Bazuar në objektivat e përcaktuara 80% meshkuj dhe 20% femra, UNT-ja i dha SVD-së lista modelesh. Në rastin e femrave përzgjedhja u bë më e shpeshtë sepse numri i pjesëmarrësve të përshtatshëm është më i ulët (afërsisht 13% të *të gjithë* dëshmitarëve të TPNJ-së) dhe për shkak të shqetësimeve të përmendura gjatë mbledhjeve të grupeve fokusuese se kishte të ngjarë që femrat të ishin më pak të prirura për pjesëmarrje në Studimin Pilot. Duke qenë se numri i dëshmitareve femra nga Kroacia, Kosova dhe Serbia është i ulët, UNT-ja zbatoi modele përzgjedhëse për çdo dëshmitare femre të përshtatshme nga këto vende, kurse rasti i Bosnjë-Hercegovinës ishte i ndryshëm sikurse tregohet në Figurën 2.1.

Figura 2.1 – Përfaqësimi gjinor sipas zonave gjeografike



2.3.3 Rekrutimi i pjesëmarrësve


Si ruajtës të të dhënave të dëshmitarëve të TPNJ-së, punonjësit e SVD-së kontaktuan dhe intervistuan dëshmitarë dhe grumbulluan të dhënat e nevojshme për këtë projekt. Punonjësit e SVD-së u trajnuan që t’ua prezantonin informacionin për Studimin Pilot në një mënyrë të sigurtë dhe të kujdesshme dëshmitarëve-viktima të cilët ndoshta nuk kanë pasur kontakt me TPNJ-në për vite. SVD-ja përgatiti udhëzime operative dhe organizoi videokonferenca me koordinatorin e projektit në ZRS që rezultoi në një ‘Skenar për rekrutim’, ‘udhëzime operative’ për gjurmimin e të dhënave dhe procedura për dhënien e rekomandimeve, përgjigjen e pyetjeve dhe shkëmbim informacioni.

Pas thirrjes së parë telefonike të SVD-së me një dëshmitar të cilit i shpjgoheshin qëllimet e anketimit (ku respektohej procedura për mbrojtjen e sigurisë dhe fshehtësisë së dëshmitarit), pati raste ku SVD-ja bënte një thirrje të dytë telefonike në rast se dëshmitarit i nevojitej kohë për të menduar mbi pjesëmarrjen ose për t’u këshilluar me persona të tjerë. Në rastet kur një dëshmitar konfirmonte pjesëmarrjen, SVD-ja organizonte një takim në një vendndodhje ku dëshmitari ndihej i qetë dhe i sigurtë. Gjatë çdo momenti në këtë proces dëshmitarët mund të refuzonin pjesëmarrjen në anketim, ndër të tjera pas ardhjes në vendin e intervistës dhe madje edhe pas fillimit të anketimit.²⁹

²⁹ Pesë dëshmitarë refuzuan të intervistoheshin pas ardhjes në pikën e takimit dhe para nisjes së anketimit. Intervista me një dëshmitar u ndërpre pas njëzet minutash për shkak të shqetësimeve që punonjësit e SVD-së patën për gjendjen e paqëndrueshme

SVD-ja i bëri thirrjet e para telefonike për rekrutim në korrik 2013 nëpërmjet punonjësve të saj në Hagë dhe Sarajevë. Nga marsi deri në dhjetor 2014, 14 punonjës të SVD-së në Hagë bënë thirrje telefonike për rekrutim çdo ditë. Për realizimin e objektivit që ishte krijimi i një grupi prej 300 dëshmitarësh të përshtatshëm, punonjësit e SVD-së kontaktuan afërsisht 1100-1200 dëshmitarë të përshtatshëm për pjesëmarrje. Figura 2.2 ilustron rezultat e thirrjeve telefonike rekrutuese.

Figura 2.2 – Rezultati i procesit të rekrutimit³⁰



Për shkak se thirrjet telefonike nga TPNJ-ja në vetvete mund të shkaktojnë shqetësim për dëshmitarë të cilët ndoshta nuk kanë qenë në kontakt me TPNJ-në për vite, ishte e nevojshme që atyre t'u jepeshin garancitë e përshtatshme. Bazuar në procedurat e përcaktuara të TPNJ-së për kontaktet me dëshmitarët, punonjësit e SVD-së pa vonesë i qetësonin dëshmitarët duke shpjeguar se arsyeja e kontaktimit nuk kishte të bënte me ardhjen në gjyq, por me pjesëmarrje sipas dëshirës në anketim. Thujse që prej thirrjeve të para telefonike për rekrutim u bë e qartë se dëshmitarët kishin një sërë pyetjesh, nevoja ende të pazgjidhura, sugjerime dhe komente (pozitive dhe negative) në lidhje me TPNJ-në. Në rastet kur kontaktet me dëshmitarët nxorën një sërë problemesh të ndryshme që kërkonin zgjidhje, UNT-ja dhe SVD-ja mbajtën takime të rregullta për gjetjen e përgjigjeve ndaj këtyre problemeve dhe për përcaktimin e mënyrës më të mirë të mundshme të përpunimit, ruajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave. Ky ishte faktor i rëndësishëm për intervistuesit e SVD-së të cilët më tej do të kontaktonin dëshmitarët për planifikimin e intervistave.

Vështirësitë më të mëdha në lidhje me thirrjet telefonike për rekrutim kishin të bënin me kontaktshmërinë e dëshmitarëve. Afërsisht 38.4% e dëshmitarëve nuk mund të kontaktoheshin për shkak të të dhënave të vjetëruara të kontaktit dhe 4.7% e thirrjeve telefonike nuk morën asnjëherë përgjigje edhe pas përpjekjeve të shumta. Këto shifra nuk janë befuesuese po të kihet parasysh se të dhënat më të reja të kontaktit mund të kenë qenë që para 15 vjetësh. Dëshmitarët mund të kenë ndryshuar vendbanim apo numrin e telefonit gjatë viteve të shkuara. Fatkeqësisht, rreth 4% e dëshmitarëve kishin ndërruar jetë gjatë asaj periudhe, përkatësisht 43 dëshmitarë.

të dëshmitarit dhe ata dhanë materialet rekomanduese së bashku me ato vijuese. Dy dëshmitarë refuzuan ta përfundonin intervistën për shkak të zhgënjimit të tyre me Tribunalin. Dy dëshmitarë nuk donin të nënshkruanin formularin e dhënies së pëlqimit pasi ishin informuar dhe para dhënies së intervistës dhe bazuar në rregullat e Komisionit Institucional të Etikës nuk mund të intervistoheshin. Gjithashtu në analizën përfundimtare, SVD-ja dhe UNT-ja nuk përfshinë të dhëna nga dy intervista, sepse të dy dëshmitarëve papritmas iu kërkua të paraqiteshin në një nga proceset gjyqësore gjatë kohës së këtij studimi. Për një pasqyrë të përgjithshme të procesit të rekrutimit të pjesëmarrësve shih Shtojcën II.

³⁰ Për një pasqyrë të përgjithshme të procesit të rekrutimit të pjesëmarrësve shih Shtojcën II.

Për kontaktimin e sa më shumë dëshmitarëve, SVD-ja bëri përpjekje të shumta për sigurimin e të dhënave të përditësuara të kontaktit. SVD-ja analizoi të gjitha burimet e hapëta ekzistuese të informacionit për dëshmitarë pa masa mbrojtëse gjyqësore. Për dëshmitarët me masa mbrojtëse gjyqësore lejohej vetëm verifikimi i burimeve të brendshme për garantimin e sigurisë. Dëshmitarët e pakontaktuar³¹ u thirrën më vonë e kjo rezultoi në disa pjesëmarrës më shumë. Gjithashtu për dëshmitarët e Prokurorisë SVD-ja i kërkoi Zyrës së Prokurorisë që të gjenin të dhëna të përditësuara kontakti në dokumentet e tyre. Kjo nuk ishte e mundur për dëshmitarët e Mbrojtjes sepse ekipet e mbrojtjes nuk ekzistojnë më pas mbarimit të një çështjeje gjyqësore.³²

Sikurse u përmend edhe më lart, për disa dëshmitarë u nevojitën disa thirrje telefonike që t'u jepej kohë të mendonin ose të këshilloheshin me familjen, me avokatë, apo njerëz të tjerë para se të vendosnin për pjesëmarrjen në Studimin Pilot. Dëshmitarë të tjerë e patën të vështirë të refuzonin pjesëmarrjen për shkak të një tradite të bashkëpunimit të sinqertë me Tribunalin dhe e zvarritën përgjigjen përfundimtare. Punonjësit e SVD-së gjatë procesit të rekrutimit përsëritën vazhdimisht se pjesëmarrja ishte me dëshirë, pa detyrim ligjor apo pasoja prej refuzimit. Në disa raste SVD-ja e la në dorë të dëshmitarëve marrjen e vendimit, ndërsa në raste të tjera lindi nevoja për marrjen e një vendimi për hir të interesave të dëshmitarëve, veçanërisht për dëshmitarët e thyeshëm. Thirrjet e shumta telefonike ngadalësuan ritmin e rekrutimit, mirëpo ato nxjerrin në dukje rëndësinë e qasjes së bazuar në përfaqësimin e interesave të dëshmitarëve.


UNT-ja i dha SVD-së një model rastësor të kodeve të dëshmitarëve anonimë për 1116 dëshmitarë duke mbajtur parasysh nevojën për garantimin e përfaqësimit të larmisë gjinore dhe gjeografike në model. Nga 1116 dëshmitarët, 584 prej tyre nuk mund të kontaktoheshin për shkak të të dhënave të vjetëruara të kontaktit, për shkak se kishin ndërëruar jetë, ose për arsye të tjera. SVD-ja mundi të fliste me 532 dëshmitarë (47.7%) dhe i pyeti nëse ishin të gatshëm të merrnin pjesë në anketim. Nga 532 dëshmitarët e kontaktuar, SVD intervistoi 302, kurse të tjerët refuzuan në telefon, pranuan por nuk reagon më tej, ose nuk ishin në gjendje të përfundonin anketimin. Dy dëshmitarë të intervistuar më pas u hoqën nga pjesëmarrja sepse u thirrën për të dëshmuar në një proces të asaj kohe. Pjesëmarrja në anketimin e Studimit Pilot ishte 56.8%. Ky rezultat është llogaritur duke pjesëtuar numrin e dëshmitarëve të kontaktuar të cilët pranuan të merrnin pjesë dhe e kryen anketimin (n=302) me numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve të kontaktuar (n=532).

³¹ Në kategorinë e dëshmitarëve të padisponueshëm përfshihen dëshmitarë numrat e telefonit të të cilëve ishin në përdorim, por të cilët nuk iu përgjigjën thirrjes telefonike ose në rastet kur dikush tjetër iu përgjigj telefonit në vend të dëshmitarit. Në të dy rastet SVD-ja u përpoq të kontaktohej me dëshmitarët për së paku pesë ditë dhe pas pak muajsh sërish për pesë ditë.

³² Në ndryshim nga Prokuroria, Dhomat dhe Sekretaria, Mbrojtja nuk është organ i Tribunalit.

Bisedat gjatë thirrjeve telefonike rekrutuese shkuan nga disa minuta deri në gjysmë orë, varësisht nga nevojat e dëshmitarëve. Ndër reagimet e dëshmitarëve kishte mirënjohje për rivendosjen e kontakteve dhe për mundësinë e pjesëmarrjes në anketim dhe reagime më pak pozitive për anketimin. Shumë dëshmitarë refuzuan për arsye shëndetësore psikologjike dhe fizike, kurse të tjerë shprehën pakënaqësi ndaj TPNJ-së. U evidentuan arsyet e refuzimeve, 206 dëshmitarë refuzuan të merrnin pjesë dhe ata dhanë gjithsej 282 arsye (Figura 2.3).

Figura 2.3 – Arsyet e refuzimit



Ndër arsyet kryesore për refuzim ishin gjendja shëndetësore, stresi dhe agjenda e ngjeshur. Afërsisht 18.9% e dëshmitarëve nuk dhanë asnjë arsye për refuzimin dhe në pesë raste dëshmitarët e ndërprejnë papritmas thirrjen telefonike. I njëjti numër të intervistuarish shprehën pakënaqësi për disa aspekte të Tribunalit—39 individë (18.9%) nuk donin të kontaktoheshin më; nuk donin të kishin të bënin me Tribunalin, ose nuk kishin besim te Tribunali; ishin të zhgënjyer me Tribunalin; ose nuk ishin të kënaqur me Prokurorinë, Mbrojtjen ose Dhomat. Pesë për qind e dëshmitarëve shprehën shqetësime për sigurinë e tyre.

Disa dëshmitarë bënë pyetje praktike në lidhje me intervistën, për shembull: a kishin të drejtë të ndërprisnin apo rishikonin pjesëmarrjen e tyre? A kishin të drejtë të merrnin një kopje të pyetësorit apo të incizimit (lejohej vetëm pas përfundimit të intervistës)? Disa dëshmitarë pyetën nëse ishte e mundur të merrnin pyetësorin para takimit që ta lexonin, apo madje edhe ta plotësonin, ose nëse do të ishte e mundur të merrnin informacion më të hollësishëm për pyetjet. SVD-ja i refuzoi këto kërkesa për të garantuar autenticitetin e intervistës dhe mirëqenien e dëshmitarëve.

Shumë dëshmitarë kërkuan informacion më të përgjithshëm me shkrim dhe morën fletushkën informative të Studimit Pilot “*Jehonat e dëshmitarëve dhe të dëshmive*” (shumica pranuan të merrnin pjesë pasi e lexuan). Një numër i madh dëshmitarësh janë të moshuar dhe shprehën gatishmërinë për pjesëmarrje, mirëpo për arsye të vështirësive në lëvizje pyetën nëse kjo mund të bëhej në shtëpitë e tyre.

Megjithëse ekzistonte një skenar për thirrjet telefonike të rekrutimit, për një numër dëshmitarësh kontakti i beftë i rivendosur ofroi një mundësi të mirëpritur për ngritjen e shqetësimeve apo pyetjeve të tjera dhe për ndihmë të mëtejshme. Disa dëshmitarë e shihnin Tribunalin si një institucion

ndërkombëtar me pushtet dhe për këtë arsye mendonin se në një mënyrë apo tjetër ata mund të ndihmoheshin në lidhje me rrethanat e tyre aktuale. Kërkesat e tyre për ndihmë ishin kryesisht për gjendjen e tyre ekonomike si probleme të pazgjidhura për pronësinë, strehimi, papunësia apo ndihma të llojit të ndryshëm që nuk janë brenda mandatit të Tribunalit. Kurdoherë që ishte e mundur, SVD-ja i rekomandoi dëshmitarët të grupet apo organizatat përkatëse që mund të trajtonin kërkesat e tyre.

2.4 Intervistat dhe grumbullimi i të dhënave

2.4.1 Privatësia dhe fshehtësia

Në bazë të Praktikës së SVD-së mbi Privatësinë dhe Fshehtësinë, intervistat mund të kryheshin vetëm nga punonjës të kualifikuar të SVD-së. SVD-ja mund të shohë një sërë të dhënash personale të viktimave dhe dëshmitarëve, pjesa më e madhe e të cilave nuk mund të përdoren nga të tjerë brenda Tribunalit, madje as njerëz që janë të pranishëm në jetën e dëshmitarëve. Ky informacion përfshin të dhëna mbi gjendjen fizike dhe mendore apo aspekte të tjera personale si familja dhe shoqëria. Dëshmitarët i japin këto të dhëna në mirëbesim, të vetëdijshëm se punonjësit e SVD-së do të veprojnë në mirëbesim. Për arsye se punonjësit e SVD-së gëzojnë këtë privilegj në lidhje me jetën e dëshmitarëve, ata janë të detyruar të zbatojnë standardet më të rrepta të fshehtësisë dhe privatësisë në lidhje me një informacion të tillë. SVD-ja u kushtoi posaçërisht vëmendje dëshmitarëve të cilët gëzonin masa mbrojtëse gjyqësore gjatë procesit gjyqësor.

Mosrespektimi i standardeve të lartpërmendura mund të komprometojë privatësinë dhe sigurinë e dëshmitarëve dhe të ndikojë në masat dhe detyrat e tjera të TPNJ-së (dëshmitarët ndoshta refuzojnë të bashkëpunojnë me TPPNJ-në/MTPNJ-në në të ardhmen në qoftë se ata mendojnë se privatësia e tyre nuk do të respektohet). Për këtë arsye, vetëm punonjësit e SVD-së mund të shohin të dhënat personale të dëshmitarëve si adresat, numrat e telefonave dhe historinë e tyre. Gjatë gjithë Studimit Pilot, SVD-ja u kujdes që UNT-ja të mos merrte të dhëna konfidenciale ose identifikuese të dëshmitarëve.

Meqenëse rikujtimi i ngjarjeve traumatike mund të shkaktojë reagime emocionale dhe fizike, intervistat u kryen nga ata punonjës të SVD-së me përgatitjen profesionale përkatëse për të qenë të gatshëm të ndërhyjnë menjëherë në rast se dëshmitari do të kishte ngarkesë emocionale dhe/ose fizike.³³ Për hir të sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve u përcaktua që intervistat të ndërpriteshin në çfarëdo momenti.

2.4.2 Vendndodhjet e intervistave

Vendndodhjet e intervistave u zgjodhën si në qendra urbane, po ashtu edhe në zona të thella të fshatrave. Për përfshirjen e dëshmitarëve nga të gjitha shtresat, punonjësit e SVD-së udhëtuan anëmbanë Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe Kosovës.

SVD-ja kreu çdo intervistë në vendbanimet e dëshmitarëve, apo çdo vendndodhje tjetër që dëshmitarët e gjyquan të përshtatshme për t'u takuar. Në disa raste, dëshmitarët nuk donin që t'i shihnin publikisht me punonjës të TPNJ-së, ose nuk donin që familja e tyre të dinte që ata kishin dëshmuar. SVD-ja u përpoq t'u jepte përgjigje kërkesave të dëshmitarëve nëpërmjet gjetjes së vendndodhjeve të përshtatshme dhe një mjedisi të sigurtë për çdo intervistë. Si rrjedhojë, intervistat u bënë si në vende publike (restorante, hotele, kafene), por edhe në hapësira private (në vendin e punës ose shtëpinë e dëshmitarit), ose në zyrat në terren të Kombeve të Bashkuara. Disa dëshmitarë mund të intervistoheshin vetëm në shtëpinë e tyre për shkak të largësisë, moshës, problemeve shëndetësore ose paqëndrueshmërisë psikologjike. Praktika tregoi se një mjedis i përshtatshëm ku dëshmitarët ndihen të lirshëm të shprehin ndihmon në një kryerje pa probleme të intervistës.

³³ Të katër intervistuesit kanë formim profesional në psikologji ose punë shoqërore.

2.4.3 Intervista

Gjatë çdo takimi personal intervistuesit përpilonin një ditar për intervistën ku shënonin probleme teknike (gjuhën e përdorur në pyetësor, probleme të incizimit, etj.) si edhe çfarëdo reagimesh emocionale që mund të ishin shkaktuar prej intervistës. Analiza statistikore e të gjithë ditarëve të intervistave tregon se pjesëmarrësit u shprehën kryesisht në mënyrë pozitive dhe të gatshëm për të ndihmuar këtë studim.

Një prej objektivave të Studimit Pilot ishte që dëshmitarëve t'u jepej mundësia për të bërë ndarjen e duhur në lidhjen e tyre me TPNJ-në. Përveç grumbullimit të të dhënave cilësore mbi ndikimin e dhënies së dëshmisë, intervistuesit e SVD-së gjithashtu u mundësuan dëshmitarëve të mendoheshin mbi këtë përvojë dhe të shprehnin pikëpamjet dhe ndjenjat e tyre. Një rëndësi tejet të madhe kishte përshtatja e procesit në përputhje me nevojat, shëndetin dhe sigurinë e dëshmitarëve. Çdo intervistë u krye në përputhje me një kontekst unik në varësi të historisë personale të dëshmitarit, traditave kulturore dhe vendore, dallimeve gjinore si edhe gjendjes aktuale ekonomike dhe politike. Para takimeve me dëshmitarët SVD-ja shqyrtoi dokumentacionin e çështjes në fjalë në mënyrë që kontakti me ta të ishte respektues dhe mirëkuptues.

Intervistuesit u bazuan në udhëzime konkrete për mënyrën e dhënies së ndihmës të intervistuarve në plotësimin e pyetësorit (që mos të ndikonin në përgjigjet e dëshmitarëve) dhe për mënyrën e veprimit në incizimin e pyetjeve që nuk kërkonin përgjigje të prera. Në rastet kur dëshmitarët patën reagime konkrete ndaj intervistës, intervistuesi mundësoi një dialog më të lirë. Rrjedhimisht kohëzgjatja e gjithsejtë për kryerjen e një interviste shkoi nga 40 minuta deri në 4.5 orë. Në kryerjen e intervistave u hasën disa vështirësi për shkak të nivelit arsimor, gjendjes shëndetësore dhe reagimeve të dëshmitarëve ndaj anketimit. Për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë të dëshmitarëve, SVD-ja caktoi për çdo pjesëmarrës një kod anonim për intervistën nëpërmjet të cilit vetëm punonjësit e SVD-së mund të identifikonin dëshmitarin. Të 300 të intervistuarit morën informacion për përmbajtjen, qëllimin dhe procedurat e Studimit Pilot dhe çdo dëshmitari pjesëmarrës iu kërkua të nënshkruante formularin e dhënies së pëlqimit bazuar në informacionin e dhënë (vetëm dy dëshmitarë refuzuan të nënshkruanin formularin dhe për këtë arsye nuk u intervistuan). Për një vlerësim më të mirë të mirëqenies së dëshmitarëve gjatë intervistave, intervistuesit mbajtën në vëzhgim sjelljen e tyre gjatë intervistës dhe koduan reagimet dhe temperamentin e tyre. Figura 2.4 shpalos një larmi sjelljesh gjatë procesit të intervistave. Një numër dëshmitarësh ndryshuan sjellje gjatë intervistës (n=40) dhe disa dëshmitarë patën reagime (n=31).

Figura 2.4 – Sjellja e të intervistuarve gjatë procesit të intervistës





Figura 2.5 – Ndjesitë e të intervistuarve gjatë procesit të intervistës³⁴

Figura 2.5 tregon se të intervistuarit ishin në shumicë dërmuese të përqendruar dhe seriozë (n=133) dhe të qetë ose të rezervuar (n=104), dhe gjithashtu shumë prej tyre ishin të përkushtuar dhe të vendosur (n=82) dhe bashkëpunues (n=80). Ndonëse shumë dëshmitarë ishin pozitivë (n=91), vetëbesues (n=48) dhe të shtendosur (n=45), kjo nuk ishte e njëtrajtshme. Anketimi shkaktoi edhe gjendje emocionale negative, ndër të cilat zhgënjim, zemërim, acarim, padurim dhe nervozitet.

2.4.5 Pas intervistës

Përgjithësisht SVD-ja u dha zgjidhje të menjëhershme të gjitha reagimeve emocionale të dala gjatë intervistave. Duke u bazuar në praktikën dhe rregulloret e SVD-së, SVD-ja i rekomandoi dëshmitarët të cilët bënë kërkesa jashtë mandatit të SVD-së të institucionet dhe organizatat vendore. Arsyet për rekomandimet nuk e kishin burimin të vetë intervista, por përgjithësisht vijnë prej problemeve të pazgjidhura që nga koha e luftës me të cilat dëshmitarët ballafaqohen prej vitesh. Pas intervistave SVD-ja rekomandoi për ndihmë të mëtejshme shtatëmbëdhjetë dëshmitarë të organizatat vendore. Ndër kërkesat më të shumta përfshiheshin: ndihmë psikologjike për pasojat e shkaktuara nga traumat e luftës, ose ndihmë juridike për arsye të ndryshme (marrja e statusit si viktimë lufte, civil, nisja e një padie ligjore për dëmshpërblim ose zgjidhja e problemeve të pronësisë). Katër dëshmitarë kërkuan që të kontaktoheshin nga Njësia Mbrojtëse e SVD-së. Në njëzet raste dëshmitarët kërkuan materiale të llojeve të ndryshme që, ose kishin të bënin me dëshminë e tyre, ose me intervistën e tyre për Studimin Pilot. Këtu përfshiheshin: videofilmimet e dëshmimeve të tyre, transkriptet e dëshmimeve të tyre në BKS ose në gjuhën shqipe, dokumente konkrete lidhur me paraqitjen e tyre në gjyq, publikime të TPNJ-së, kopje të skanuara të pyetësorit të tyre të plotësuar për Studimin Pilot, një skedar të incizimit të pyetësorit mbi

³⁴ Ndjesi përdoret si term përfshirës për emocionet, gjendjen shpirtërore dhe sjelljen.

pyetjet që nuk kërkonin përgjigje të prera. Në tri raste pati kontakte të mëtejshme me dëshmitarët, ose për t'u siguruar sërish për mirëqenien e dëshmitarëve në rastet kur thirrja e parë telefonike e SVD-së i kishte shqetësuar, ose kur dëshmitarët kishin pyetje të tjera për studimin. Pra janë disa dëshmitarë në numër të pakët por të konsiderueshëm, të cilët ende përballen me probleme gjatë periudhës pas konfliktit dhe pas dhënies së dëshmisë dhe SVD-ja mundi t'u përgjigjej shqetësimeve të tyre.

Pas çdo interviste, intervistuesit e SVD-së kishin përgjegjësi për riverifikimin e çfarëdo zbulimi të identitetit në pyetësor, ose gjatë incizimit dhe çdo e dhënë identifikuese hiqej. Çdo pjesë e incizuar transkriptohej dhe rishikohej nga dy persona të ndryshëm dhe transkriptet e korrigjuara dërgoheshin për përkthim zyrtar në SPGSH-në e Tribunalit. UNT-ja përdori vetëm të dhëna anonime për analizat e veta statistikore. Gjatë pjesës së tri pyetjeve përfundimtare që nuk kërkonin përgjigje të prera, tridhjetë e katër dëshmitarë nuk pranuan të incizoheshin ose për arsye se nuk iu pëlqente të incizoheshin, ose sepse deklaruan se ndiheshin të rraskapitur pas pyetjeve të pyetësorit.³⁵ Në disa raste dëshmitarët kërkuan t'u përgjigjeshin pyetjeve që nuk kërkonin përgjigje të prera me shkrim dhe kjo mundësi iu dha (n=7).

Përmbledhje

SVD-ja dhe UNT-ja e hartuan Studimin Pilot për të analizuar në mënyrë kritike ndikimin që pati dhënia e dëshmisë te pjesëmarrësit më jetikë të Tribunalit, dëshmitarët. Punonjësit e SVD-së i kryen intervistat duke u bazuar në formimin e tyre profesional në psikologji dhe ndihmë sociale, si edhe në përvojën e punës në Tribunal që llogaritur si grup shkonte më shumë se 55 vjet. SVD-ja u mundësoi dëshmitarëve njëkohësisht kujdes të standardeve të larta si edhe mbrojtjen e identitetit dhe sigurisë së tyre. Gjithashtu SVD-ja ruajti anonimitetin e përgjigjeve të të intervistuarve për t'i siguruar dëshmitarët se përgjigjet e tyre ishin të fshehta. Pjesëmarrja e UNT-së si analist i jashtëm mundësoi përzgjedhjen rastësore dhe sasiore të të intervistuarve.

Plani, struktura dhe analiza e anketimit mundësuan rekrutimin e një spektri të gjerë dëshmitarësh për pjesëmarrjen në projekt dhe për të garantuar sa më shumë mbrojtjen e identitetit dhe mirëqenies së dëshmitarëve si edhe të sinqeritetit të tyre. Kjo është hera e parë në historinë e drejtësisë ndërkombëtare që një gjykatë për krime lufte ka ndërmarrë një studim sistematik dhe shkencor mbi pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të dhënies së dëshmisë mbi shumë aspekte të jetës së dëshmitarëve e në të njëjtën kohë duke iu ofruar dëshmitarëve mundësinë për ndarjen nga e kaluara dhe shprehjen e mendimeve të tyre.

Ky projekt i mundëson Tribunalit dhe gjykatave të tjera penale ndërkombëtare një vlerësim më të plotë të nevojave të dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë dhe zhvillimin e praktikave më të mira në trajtimin, kujdesin dhe mirëqenien e dëshmitarëve. Së fundi, ky projekt ndihmon që trashëgimia e Tribunalit të bëhet sa më e njohur dhe më e kuptueshme për një ndër kontribuesit më të rëndësishëm të tij, dëshmitarët.

³⁵ 15 në Bosnjë - Hercegovinë, 4 në Kroaci, 10 në Serbi, 5 in Kosovë.

Kapitulli 3 – Dëshmitarët dhe procesi i dhënies së dëshmisë

Në tërë Studimin Pilot ruhet anonimiteti i identiteteve të dëshmitarëve, mirëpo është e rëndësishme të bëhet e qartë larmia e gjerë e dëshmitarëve dhe proceseve gjyqësore të përfaqësuara në këtë studim. Ky kapitull jep më shumë informacion mbi prejardhjen gjeografike dhe demografike të dëshmitarëve, proceset gjyqësore ku ata dëshmuar, arsyet për dhënien e dëshmisë dhe kënaqësinë në lidhje me këtë. Gjithashtu këtu trajtohen rezultatet në lidhje me problemet e mundshme ligjore të dëshmitarëve dhe pasqyrohen nevojat e tyre në kohën kur përgatiteshin për dhënien e dëshmisë.

Temat e shqyrtuara në këtë kapitull kanë lidhje me pyetjet në pjesën A të pyetësorit (Shtojca III).

3.1 Popullata e Studimit Pilot

Cilët janë dëshmitarët të cilët pranuan të merrnin pjesë dhe të intervistoheshin? Ata janë një grup individësh të ndryshëm nga të gjitha trevat e ish-Jugosllavisë të cilët ofruan kohën³⁶ dhe energjinë e tyre për dhënien e mendimeve të vyera mbi përvojat, problemet dhe një tablo mbi domethënien e dhënies së dëshmisë në një gjykatë ndërkombëtare për krime lufte dhe ndikimin e këtij procesi në jetët e tyre.

3.1.1 Intervistat dhe shpërndarja gjeografike

Duke u bazuar në statistikat e përpiluara prej SVD-së, UNT-ja dhe SVD-ja bënë një vlerësim dhe përcaktuan objektivin sasiar të procesit përzgjedhës për përfshirjen në Studimin Pilot të një numri të mjaftueshëm meshkujsh dhe femrash nga vise të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Objektivat jepen në Figurën 3.1, ku në rreshtin e sipërm jepet përqindja e dëshmitarëve të përshtatshëm nga çdo zonë gjeografike dhe në rreshtin e dytë jepet objektivi në përqindje. Në rreshtin e fundit jepet shuma e numrit aktual të dëshmitarëve të intervistuar për Studimin Pilot. Shumica e intervistave (54.3% ose 163) u bënë në Bosnjë-Hercegovinë, pasuar prej Kroacisë (20.7% ose 62 intervista), Serbisë (16.3% ose 49 intervista) dhe Kosovës (8.7% ose 26 intervista).

Figura 3.1 – Objektivat e përzgjedhjes së dëshmitarëve dhe pjesëmarrësit e intervistuar

	BH	Kroaci	Kosovë	Serbi
Dëshmitarë të Tribunalit	62.00%	15.60%	8.30%	14.20%
Objektivat e Studimit Pilot për të intervistuar	50.00%	20.00%	10.00%	20.00%
Të intervistuar (gjithsej)	54.3% (n=163)	20.7% (n=62)	8.7% (n=26)	16.3% (n=49)

³⁶ Kohëzgjatja e gjithsejtë e të gjitha intervistave ishte 532.3 orë: 300.5 orë me dëshmitarët në Bosnjë; 81.1 orë në Kroaci; 101.7 orë në Serbi dhe 49 orë në Kosovë. Kohëzgjatja mesatare e një interviste ishte 1.8 orë; intervista më e shkurtër ishte 45 minuta dhe më e gjata 4.5 orë.


Një nga objektivat më të rëndësishme të procesit përzgjedhës ishte që të mundësohej një përfaqësim sa më i gjerë gjeografik i dëshmitarëve nga anembanë rajoni. Rezultatet e Figurës 3.2 tregojnë gjithashtu një larmi të gjerë dëshmitarësh brenda zonave të zgjedhura gjeografike ku përfshihen të intervistuar nga zonat urbane dhe rurale.³⁷

Figura 3.2 – Larmia gjeografike



Procesi i anketimit u krye pa probleme me afërsisht dymbëdhjetë të intervistuar në muaj. Gjithsesi pjesëmarrja e SVD-së në projekt u bë mbi bazën e “disponueshmërisë”, faktor që shpjegon shpërndarjen e pabarabartë kohore (Figura 3.3). Çdo herë kur TPNJ-ja mundësoi burime shtesë për kryerjen e intervistave, numri mesatar i intervistave për muaj shkoi (fillimi i gushtit 2014) në mesatarisht 17.25 intervista në muaj. Të gjitha intervistat përfunduan brenda gushtit 2015.

Figura 3.3 – Datat e kryerjes së anketimit




³⁷ Në bazë të standardeve ndërkombëtare për qytetet si zona me 100 000 ose më shumë banorë, 154 të intervistuar jetojnë në zona urbane dhe 146 të intervistuar jetojnë në zona rurale dhe në qytete e vendbanime më të vogla. 146 të intervistuarit nga zonat rurale ndahen si vijon: 24 të intervistuar në qytete dhe vendbanime < 100,000 banorë, 54 të intervistuar në qytete dhe vendbanime < 50,000 banorë dhe 78 të intervistuar në qytete dhe vendbanime < 25,000 banorë.

3.1.2 Veçoritë demografike të të intervistuarve


Për të bërë krahasime me popullatën e dëshmitarëve në tërësi, Studimi Pilot analizoi edhe nivelin arsimor të dëshmitarëve. Më shumë se 24% e të intervistuarve kishin diploma të shkollës së mesme (71) dhe 176 individë (61.7%) kishin kryer kurse pas arsimit të mesëm (Figura 3.4). Duke marrë parasysh se kjo është hera e parë ku një studim analizon kaq gjerësisht profilin e dëshmitarëve, ky është një aspekt tjetër kyç ku studimi ka çelur një horizont të ri mbi përvojën e dëshmitarëve.

Figura 3.4 – Niveli i arsimit



Një nga arsyet më të rëndësishme për këtë studim është koha që ka kaluar. Domethënia dhe rëndësia e konceptit “të dëshmosh”, është jetike për këta njerëz që po u kalon mosha³⁸, veçanërisht për meshkujt. Mosha mesatare e të intervistuarve është 59.3 vjeç, me mosha që shkojnë nga 28 deri në 94 vjeç. Ka dallime të konsiderueshme midis gjinive ku dëshmitarët femra mesatarisht janë shtatë vjet më të reja se meshkujt. Bie në sy se ka shumë më pak femra në grup-moshën 60 vjeç e më lart (Figura 3.5).

Figura 3.5 – Të intervistuarit sipas gjinisë dhe moshës




Femrat përbëjnë afërsisht 13% të të gjithë dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar në Tribunal. Sikurse u shpjegua në Kapitullin 2, gjatë procesit përzgjedhës, përzgjedhja e femrave ishte në një shkallë më të lartë (80% meshkuj dhe 20% femra) krahasuar me popullatën e gjithsejtë të dëshmitarëve (87% meshkuj dhe 13% femra), për të garantuar përfaqësimin e mjaftueshëm të gjinive. Sikurse shihet edhe nga Figura 3.6, procesi përzgjedhës rezultoi në një grup përfaqësues të të intervistuarve për studimin. Për shembull, ndonëse femrat në Bosnjë-Hercegovinë përbëjnë 16.4% të dëshmitarëve të përshtatshëm, në modelin e Studimit Pilot përqindja e tyre është paksa më e lartë për shkak se edhe përzgjedhja ishte në

³⁸ Faktikisht katër për qind e dëshmitarëve të cilëve iu kërkua të intervistoheshin, kishin ndërruar jetë, kurse një dëshmitar ndërroi jetë pas thirrjes telefonike së rekrutimit dhe para intervistës së planifikuar.


përqindje më të lartë.³⁹ Gjithsesi prova e ndryshimit të mesatareve nuk zbulon dallime të konsiderueshme midis dëshmitarëve të përshtatshëm dhe atyre aktualë nga të dy gjinitë për çfarëdo zone gjeografike.

Figura 3.6 – Raporti gjinor – popullata e përshtatshme dhe pjesëmarrëse në Studimin Pilot



Duke marrë parasysh mundësinë që dëshmitarët gjatë intervistës mund të mos kishin dëshirë të jepnin prejardhjen e tyre etnike dhe besimin fetar, të anketuarve iu dha mundësia që të shënonin prejardhjen etnike ose fetare, ose të mos jepnin asnjë të dhënë (Figura 3.7). Përgjigjet vetidentifikuese shpalosin një përzgjedhje personash me prejardhje të larmishme etnike ku 81 persona (27%) u vetidentifikuan si kroatë; 78 persona u vetidentifikuan si boshnjakë (26%); 95 persona (31.7%) u vetidentifikuan si serbë, 25 persona (8.3%) u vetidentifikuan si shqiptarë⁴⁰, dhe u evidentuan edhe pak të tjerë ndër të cilët maqedonas (n=2), kroat, boshnjak (n=1), dhe “tokësor” (n=1). Figura 3.7 jep ndarjen në përqindje ku shihet se më shumë se 6% e të intervistuarve nuk u përgjigjën, kurse një i intervistuar u vetidentifikua me etnicitet të dyfishtë.

Figura 3.7 – Vetidentifikimi etnik



Po ashtu si edhe në rastin e prejardhjes etnike, ndër dëshmitarët u zgjodh një model përfaqësues i besimeve të ndryshme fetare (Figura 3.8). Kemi 70 katolikë (23%); 92 myslimanë (31%); 82 ortodoksë

³⁹ Shih 2.3.2 për modelimin dhe përzgjedhjen e pjesëmarrësve të përshtatshëm .

⁴⁰ Në këtë raport termi “shqiptarë” i referohet etnicitetit (dhe jo shtetësisë).

(27%), kurse të tjerët janë ateistë (9 ose 3%) dhe agnostikë (4 ose 1%), ndërsa 15% e të intervistuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Sidoqoftë, ashtu sikurse konfirmohet nga studime mbi regjistrimin e popullsisë në ish-Jugosllavi, identiteti etnik dhe ai fetar në atë rajon janë duke ndryshuar, ku gjithnjë e më pak respektohen kategoritë e ngurta të identitetit të përdorura tradicionalisht nga shteti dhe aktorë të tjerë politikë (Bieber 2015).

Figura 3.8 – Vetidentifikimi fetar





Figura 3.9 tregon se duke u bazuar në vetidentifikimin etnik të dëshmitarëve, përbërja e pjesëmarrësve të Studimit Pilot është mjaft e ngjashme me përbërjen etnike të rajonit.⁴¹

Figura 3.9 – Vetidentifikimi etnik i pjesëmarrësve të Studimit Pilot krahasuar me popullatën në tërësi (përqindjet)




Ndoshta një nga rezultatet më interesante të Studimit Pilot është numri i madh i martesave të përziera etnike që përfaqësohen nga dëshmitarët e përzgjedhur, si dhe numri i dëshmitarëve të cilët janë pakicë etnike aty ku jetojnë. Në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë martesat ndërmjet etnive të ndryshme ishin në shkallë të ndryshme, në varësi të grupit etnik që studiohej (Smits 2010). Teorikisht thuhej se martesat e përziera ishin mjaft të përhapura, mirëpo analizat statistikore të të dhënave para luftërave nuk e tregojnë këtë (Botev 1994). Ndoshta ky perceptim ekziston për shkak të polarizimit teknik (Buric 2012). Për këtë arsye, të intervistuarve iu bënë dy pyetje në lidhje me identitetin e tyre etnik që mund të ketë pasur ndikim në këndvështrimin e tyre si dëshmitarë. Pyetjet ishin: (1) a ishte

⁴¹ Të dhënat mbi identitetin etnik dhe fetar të marra nga Agjencia Qendrore e Zbulimit Factbook (2011, 2013 statistics).

dëshmitari pakicë etnike ose fetare në bashkësinë/mjedisin ku jetonte; dhe (2) a kishte dëshmitari një anëtar të familjes së ngushtë (prind, partner intim, vëlla/motër, ose fëmijë) që kishte një martesë etnikisht të përzierë. Afërsisht 13% (n=39) e të intervistuarve janë pakicë etnike aty ku jetojnë dhe bie në sy se 39.3% (n=118) e të intervistuarve kanë një anëtar të familjes së ngushtë, ose kanë vetë një martesë etnikisht të përzier (Figura 3.10).⁴² Midis këtyre dy bashkësive ka një prerje të përbashkët, 17 persona janë pakicë etnike në vendin ku jetojnë dhe në të njëjtën kohë kanë një martesë etnikisht të përzier në familjen e tyre të ngushtë. Pra, 46.7% e të intervistuarve janë pakicë etnike në bashkësinë ku jetojnë dhe/ose kanë martesa etnikisht të përziera në familjen e tyre ose në familjen e ngushtë.


Figura 3.10 – Pakicat etnike dhe fetare dhe martesat etnikisht të përziera në familjen e ngushtë



Më befases lidhur me të intervistuarit është numri i lartë i martesave etnikisht të përziera anembanë rajonit (Figura 3.11). Veçanërisht, si në Kroaci po ashtu edhe në Serbi, numri i të intervistuarve të cilët kanë martesa etnikisht të përziera në familjen e tyre të ngushtë është pak a shumë i barabartë. Edhe për Bosnjë-Hercegovinën numri është relativisht i madh (61 persona). Nga studimet e tjera ka rezultuar se numri i martesave ekzogamike (jashtë grupit etnik) ra gjatë periudhës 1990-2005, veçanërisht në Kroaci (Mrdjen2010). Ndryshimet në Studimin Pilot të numrit të martesave etnikisht të përziera mund të vijnë pjesërisht prej ndryshimeve midis brezave (duke marrë parasysh moshën e të intervistuarve). Faktikisht rezultatet e Studimit Pilot tregojnë ndërvarësi të konsiderueshme midis dëshmitarëve më të moshuar dhe numrit të martesave etnikisht të përziera (që do të thotë se sa më i moshuar të jetë një i intervistuar aq më shumë të ngjarë ka që ata ose një anëtar i familjes së ngushtë të kenë martesë etnikisht të përzier). Duhet theksuar se rezultatet e Studimit Pilot përputhen me Mrdjen (2010) në lidhje me dallimet gjinore, ka më pak të ngjarë që femrat e intervistuar të kenë martesa etnikisht të përziera në familjen e ngushtë.

⁴² Problemi i statusit të pakicës dhe të “kombësive përbërëse” në Jugosllavi është kompleks, veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë ku pas Marrëveshjeve për Paqe të Dejtonit në Kushtetutë u përcaktua përfaqësimi strukturor bazuar në identifikimin etnik. Për këtë arsye disa dëshmitarë refuzonin të identifikoheshin si pakicë në rast se ata u përkisnin kombësive përbërëse sepse një identifikim i tillë mund “të pakësonte”rëndësinë e tyre. Për më shumë shpjegime të rëndësishme në lidhje me pasojat për sa më sipër shih the Minority Rights Group International (2003) dhe O’Brien (2010). Gjithnjë e më shumë njerëz nga rajoni u rezistojnë etiketimeve tradicionale të identitetit bazuar në krahasimet kombëtare (shih Grim et.al. 2015 dhe Bieber 2015).

Figura 3.11 – Martesat etnikisht të përziera në familjen e ngushtë sipas zonave gjeografike



3.1.3 Të intervistuarit dhe proceset gjyqësore të Tribunalit

Pjesëmarrësit e këtij anketimi kanë qenë dëshmitarë gjatë ekzistencës së Tribunalit. Edhe pse SVD-ja nuk kishte të dhëna kontakti për individët të cilët kishin dëshmuar nga 1995 deri më 1998, disa prej këtyre dëshmitarëve u intervistuan sepse ata dëshmuar në procese gjyqësore të mëvonshme. Të intervistuarit janë dëshmitarë që kanë dëshmuar për Tribunalin nga 1997 deri më 2012, ndonëse shumica e tyre kanë dëshmuar gjatë periudhës 2000-2009 (Figura 3.12).

Figura 3.12 – Paraqitjet e të intervistuarve si dëshmitarë në bazë të vitit






Figura 3.13 – Paraqitjet e të intervistuarve në proceset gjyqësore



Për analizimin e pjesëmarrjes së dëshmitarëve në proceset gjyqësore ka mënyra të shumta (Figura 3.13 dhe 3.14). Dëshmitarët mund të dëshmojnë më shumë se një herë në një proces gjyqësor, ose të dëshmojnë disa herë në disa procese gjyqësore dhe faktikisht mund të dëshmojnë për një ose më shumë palë (Prokuroria, Mbrojtja, ose Dhomat) në të njëjtin proces gjyqësor, ose në procese gjyqësore të ndryshme. Pavarësisht nga mënyra e përdorur, përzgjedhja e përdorur në Studimin Pilot përfaqëson një gamë të gjerë përvojash gjatë një periudhe kohore të caktuar në të gjitha proceset gjyqësore, llojet e proceseve gjyqësore dhe të të akuzuarve. Treqind të intervistuarit u paraqitën në gjyq 448 herë (20 prej tyre u paraqitën dy herë në të njëjtin proces gjyqësor).⁴³

Të intervistuarit dëshmuar në një spektër të gjerë çështjesh gjyqësore me një dhe shumë të akuzuar (nga një deri në shtatë të akuzuar).⁴⁴ Përvoja më e zakonshme e dëshmitarëve është një paraqitje e vetme në një proces gjyqësor me një ose dy të akuzuar (Figura 3.14), mirëpo një grup dëshmitarësh kanë dëshmuar disa herë dhe në procese gjyqësore me tre ose më shumë të akuzuar. Dy të tretat e dëshmitarëve u paraqitën vetëm një herë dhe një shumicë e të intervistuarve kanë dëshmuar në procese gjyqësore me vetëm një të akuzuar ku thuajse një e katërta u paraqitën dy herë. Vihet re se një numër individësh (35%) kanë dëshmuar disa herë.⁴⁵ Duhet përmendur edhe spektri i proceseve gjyqësore me shumë të akuzuar, veçanërisht çështjet gjyqësore të konsideruara komplekse për shkak të kuadrit të aktakuzës dhe problemeve faktike e ligjore (Ford 2014).

Figura 3.14 – Paraqitjet e të intervistuarve në proceset gjyqësore sipas numrit të të akuzuarve



⁴³ Duhet mbajtur parasysh se kategoritë “Paraqitjet e Dëshmitarëve”, “Paraqitjet për Prokurorinë”, dhe “Paraqitjet për Mbrojtjen” nuk korrespondojnë me numrin e gjithsejtë të të intervistuarve, sepse dëshmitarët mund të dëshmojnë disa herë për palë të ndryshme (Prokuroria, Mbrojtja, Dhomat), ose të dëshmojnë për të njëjtën palë në të njëjtin proces gjyqësor më shumë se një herë. Njëzet dëshmitarë të cilët ishin paraqitur dy herë në një proces gjyqësor, u paraqitën në disa procese gjyqësore.

⁴⁴ Numri i të akuzuarve për një proces gjyqësor në Tribunal është si vijon: një i akuzuar (21 procese gjyqësore); dy të akuzuar (shtatë procese gjyqësore); tre të akuzuar (shtatë procese gjyqësore); katër të akuzuar (një proces gjyqësor); pesë të akuzuar (një proces gjyqësor); gjashtë të akuzuar (tre procese gjyqësore); dhe shtatë të akuzuar (një proces gjyqësor).

⁴⁵ Një i akuzuar, Momir Taliqi, vdiq para përfundimit të procesit gjyqësor, por dëshmitarët të cilët ishin thirrur në atë çështje gjyqësore u thirrën edhe në procesin gjyqësor të Radosllav Bërgjaninit që vazhdoi pas vdekjes së Taliqit. Disa prej këtyre dëshmitarëve ishin ndër të intervistuarit. Një i akuzuar tjetër, Sillobodan Millosheviqi, vdiq gjatë procesit gjyqësor pasi një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh kishin dëshmuar. Edhe ndër këta dëshmitarë u përzgjedhën të intervistuar për këtë anketim.


Tabloja e përgjithshme e nxjerrë nga profilet e të intervistuarve tregon se paraqitjet e të intervistuarve në proceset gjyqësore përfaqësojnë punën e Tribunalit në tërësi gjatë periudhës kohore të shqyrtuar (Figura 3.15). Afërsisht dy të tretat e tyre dëshmuar për Prokurorinë, kurse një e treta për Mbrojtjen. Vlen të theksohet se 17 dëshmitarë janë paraqitur 45 herë si për Prokurorinë, po ashtu edhe për Mbrojtjen. Gjithashtu edhe katër dëshmitarë të Dhomave dëshmuar për Prokurorinë.

Figure 3.15 – Të anketuarit – Në bazë të numrave

Gjithsej të intervistuar si dëshmitarë faktesh dhe dëshmitarë ekspertë	3
Gjithsej të intervistuar që kishin dhënë dëshmi me shkrim (jo dëshmi gojore)	7
Të intervistuar që kishin dëshmuar në dy role (Prokuroria, Mbrojtja dhe Dhomat)	45
Numri i proceseve gjyqësore të ndryshme	41
Numri i gjithsejtë i të akuzuarve	90
Gjithsej paraqitjet për Dhomat (gjithashtu u paraqitën edhe për Prokurorinë)	4
Gjithsej paraqitjet për Mbrojtjen	151
Gjithsej paraqitjet për Prokurorinë	293
Të intervistuar që u paraqitën një herë	195
Të intervistuar që u paraqitën më shumë se një herë	105
Numri i të intervistuarve	300
Gjithsej paraqitjet e vetme në një proces gjyqësor	427
Gjithsej paraqitjet e të intervistuarve (përfshihen edhe paraqitjet më shumë se një herë në të njëjtin gjykim)	448


Së fundi, u anketuan dëshmitarë nga një spektër i gjerë procesesh gjyqësore (Figura 3.16). Pati disa kufizime për shkak të nevojës për mospërfshirjen⁴⁶ e dëshmitarëve të proceseve gjyqësore të cilat ende zhvilloheshin në kohën e Studimit Pilot. Figura 3.16 i ndan të intervistuarit në bazë të proceseve gjyqësore dhe palëve për të cilat kanë dëshmuar, Prokurorinë, Mbrojtjen ose Dhomat. Ashtu sikurse mund të pritet, proceset gjyqësore më të mëdha e më komplekse me një numër të madh dëshmitarësh, janë edhe më të përfaqësuara. Në çështjet gjyqësore Kordiq dhe Çerkez, Millutinoviq dhe të tjerët, Popoviq dhe të tjerët, Përliq dhe të tjerët dhe Slobodan Millosheviq, dëshmuar mesatarisht 240-350 dëshmitarë për një proces, kurse në proceset e mëhershme si Dokmanoviq, Aleksovski, Jellishiq, Sikirica dhe të tjerë dhe Kunarac e të tjerë kishin dëshmuar më pak dëshmitarë (afërsisht 40-70 dëshmitarë gjithsej në secilin prej këtyre proceseve). Për krahasimin në përqindje të përfaqësimit të dëshmitarëve, jepen të dhëna për numrin e gjithsejtë të të intervistuarve të cilët morën pjesë në çdo proces (Figura 3.17).

Figura 3.16 – Të intervistuarit sipas procesit gjyqësor dhe palës thirrëse



⁴⁶ Shih §2.3 Pjesëmarrësit dhe procesi i përzgjedhjes.

Figura 3.17 – Paraqitjet e të intervistuarve në raport me numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve për proces gjyqësor



3.2 Ndikimi i dhënies së dëshmisë

Në këtë pjesë shtjellohet procesi përgatitor i dëshmitarëve të cilët mund të ballafaqohen me probleme ligjore gjatë paraqitjeve të tyre, nevojat logjistike dhe për informacion të dëshmitarëve të cilët dëshmojnë dhe në fund të kësaj pjese një diskutim mbi arsyet e dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë.

3.2.1 Problemet ligjore

Dhënia (ose mosdhënia) e dëshmisë në Tribunal sjell pasoja ligjore ndër të cilat fletëthirrjet detyruese për paraqitje, përbalja me padi të mundshme, depozitimi i një padie civile për dëmshpërblim. Juristi i Sekretarisë për çështje të dëshmitarëve mund të ndihmojë gjatë procesit të dhënies së dëshmisë për probleme që kanë të bëjnë me masa mbrojtëse gjyqësore, fletëthirrjet detyruese, mosbindje ndaj Tribunalit, dëshmi të rreme dhe betim të rremë, kalim të sigurtë dhe rrezikun e vetëfajësimit.⁴⁷

Një shumicë e madhe e dëshmitarëve dëshmojnë me vullnet të lirë në Tribunal, mirëpo ashtu si gjykatat penale shtetërore, Tribunali ka kompetencë të detyrojë praninë e dëshmitarëve nëpërmjet lëshimit të një urdhërparaqitjeje.⁴⁸ Frika prej hakmarrjes, shqetësimet për vetëfajësim, ose shqetësimet prej rikujtimit të kujtimeve nga lufta janë probleme të rëndësishme për disa dëshmitarë, mirëpo përgjithësisht ato nuk konsiderohen si justifikim i mjaftueshëm për mosparaqitjen e dëshmitarëve. Mosbindja ndaj urdhërparaqitjes mund të çojë në arrestim dhe në akuza për shpërfillje të gjykatës.⁴⁹ Disa dëshmitarë e mirëpresin urdhërparaqitjen për në gjyq, apo madje e kërkojnë vetë si mjet lehtësimi ndaj trysnisë për t'i justifikuar paraqitjen e tyre në gjyq njerëzve midis të cilëve jetojnë, ose punëdhënësve të tyre. Gjithsesi për dëshmitarë të tjerë të cilët marrin urdhërparaqitje, mungesa e dëshirës së tyre për të dëshmuar ndikon në kontaktet e tyre si me palën që i thërret, po ashtu edhe me SVD-në. Dëshmitarët mund të kenë probleme lidhur me udhëtimin për shkaqe si kufizimet e lëvizjeve ose probleme të tjera udhëtimi. Sa herë që është e realizueshme, Tribunali (nëpërmjet një gjykatësi ose një Dhome) mund të nxjerrë një urdhër për kalimin e sigurtë të dëshmitarëve që vijnë në Holandë ose largohen nga Holanda vetëm në kuadër të dhënies së dëshmisë në Tribunal. Këta urdhra jepen me qëllim që dëshmitarët të mos ndalohen, arrestohen, merren në pyetje ose ndryshe penalizohen nga autoritetet shtetërore gjatë largimit të tyre nga juridiksionet shtetërore.

Nga 300 dëshmitarët e anketuar, më pak se 7% (n=21) u shprehën se kishin marrë urdhërparaqitje, dhe nga këta vetëm dy persona pranuan se ishin ndjerë të detyruar që të dëshmonin për shkak të frikës prej padive që mund të ngriheshin kundër tyre. Shumica e dëshmitarëve me urdhërparaqitje, u shprehën se ata nuk pajtoheshin (n=10) ose nuk pajtoheshin aspak (n=9) se ishin ndjerë të detyruar të dëshmonin për shkak të pasojave të mundshme ligjore. Faktikisht kishte më shumë të ngjarë që dëshmitarët të shqetësoheshin për pasoja ligjore në rast se *nuk* merrnin urdhërparaqitje. Nga dëshmitarët e mbetur të cilët *nuk* kishin marrë urdhërparaqitje, katër prej tyre u pajtuan plotësisht dhe nëntë u pajtuan se ishin ndjerë të detyruar të dëshmonin për shkak të shqetësimit prej pasojave ligjore, kurse 12 të tjerë nuk ishin të sigurtë. Pra më shumë se nëntë për qind e dëshmitarëve kishin shqetësime nëse do të kishin pasoja ligjore si shkak i dhënies së dëshmisë, ose refuzimit për të dëshmuar prej tyre.⁵⁰


⁴⁷ Paragrafi E i Rregullës 90 së Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit konkretizon rrethanat kur një dëshmitar lejohet të refuzojë dhënien e deklaratave që mund ta fajësojnë.

⁴⁸ Në bazë të Nenit 29 të Statutit të Tribunalit dhe Rregullës 54 të Rregullores të Procedurës dhe Provave të Tribunalit, me kërkesën e cilësdo palë ose *proprio motu*, një gjykatës ose Dhomë Gjyqësore mund të lëshojë urdhra, thirrje, urdhërparaqitje, autorizime dhe urdhra transferimi që mund të jenë të nevojshme për hetime ose për përgatitjen apo kryerjen e procesit gjyqësor.

⁴⁹ Rregulla 77 e Rregullores të Procedurës dhe Provave të Tribunalit përcakton se Tribunali ka kompetencë të shpallë fajtor për shpërfillje këdo që “me vetëdije dhe qëllimisht” ndërhyr në ushtrimin e drejtësisë, duke përfshirë çdo person i cili si dëshmitar para Dhomës, refuzon kokëfortësisht t'i përgjigjet, ose nuk i përgjigjet një pyetjeje, një person i cili shkel një urdhër të Dhomës Gjyqësore, një person që duke mos pasur arsye bindëse nuk i bindet një urdhri për paraqitje para një Dhome dhe kushdo që frikëson ose kërcënon një dëshmitar, ose këdo tjetër që u bindet urdhrave të Tribunalit.

⁵⁰ Ndonëse 21 të intervistuar deklaruan se kishin marrë urdhërparaqitje për në gjyq, të dhënat zyrtare të Tribunalit tregojnë se *faktikisht* vetëm dy prej tyre ishin urdhëruar të paraqiteshin. Ekziston qartësisht mundësia që ky ndryshim të shpjegohet prej interpretimit të pyetjes prej të intervistuarit sepse fjala “fletëthirrje detyruese” nuk përkthehet tekstualisht. Pyetja në anglisht është “a u urdhëruat të paraqiteshit në Tribunal?”, gjithsesi në BKS lexohet “Da li Vam je izdat obavezujući nalog (subpoena) za svjedočenje pred Haškim tribunalom” (“A morët urdhër detyruar për paraqitje në Tribunal”). Gjithashtu kujtesa e dëshmitarëve mund të jetë ndikuar nga koha e gjatë e kaluar, paraqitjet e tyre të shumta në gjyq dhe kuptimi i termit ‘urdhër’. Pavarësisht nga sa më sipër, përfundimet konfirmojnë nocionin se dëshmitarët kanë nevojë për informacion të plotë në lidhje me procesin e thirrjes së detyruar në gjyq dhe ndikimit të mundshëm të këtij procesi ndaj gatishmërisë së tyre për të dëshmuar.

Figura 3.18 – A u thirrët për të dëshmuar në gjykatat shtetërore për arsye se kishit dëshmuar në Tribunal?



Disa dëshmitarë përballen edhe me mundësinë ligjore të thirrjes nga gjykatat shtetërore për arsye të dhënies së dëshmisë së tyre përkatëse për Tribunalin (Clark 2014). Të intervistuarit u pyetën nëse ishin thirrur nga autoritetet shtetërore për të dhënë deklaratë për shkak se kishin dëshmuar në TPNJ. Më shumë se 15% (n=46) e të intervistuarve ishin thirrur për të dëshmuar në procese të tjera gjyqësore, por faktikisht vetëm 6.7% (n=20) e të intervistuarve kishin dëshmuar në procese gjyqësore shtetërore. Dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar në gjykata të tjera bënë të ditur se ata nuk ishin thirrur për shkak të dëshmimeve të tyre në Tribunal (n=8), kurse dy prej dëshmitarëve nuk ishin të sigurtë nëse thirrja e tyre kishte të bënte me Tribunalin.

Së fundi ekziston mundësia që dëshmitarët të depozitojnë padi civile për dëmshpërblim kundër të pandehurve të cilët dënohen, mirëpo në praktikë padi të tilla rrallë kanë sukses (Council of Europe 2012, 26-28). Ndër pengesat ndaj këtij procesi mund të përmendet një kornizë ligjore e ndërlikuar, shpenzimet që lindin prej procedimit të këtyre padive, mungesa ose pamundësia e përfitimit të ndihmës juridike për marrjen e dëmshpërblimit, dhe ndikimi negativ në mirëqenien e tyre në tërësi (Hanušić 2015, Bužinkić et al. 2014).⁵¹ Në përputhje me rezultate të tjera në lidhje me dëmshpërblime civile, vetëm dhjetë të intervistuar (3.3%) bënë të ditur se ata kishin paraqitur padi të tilla (Pajić 2014).

3.2.2 Përgatitja dhe informacioni mbi dhënien e dëshmisë

Shkalla e krimeve të akuzuara dhe vështirësia e mbajtjeve të proceseve gjyqësore në një mjedis shumëgjuhësor, në një gjykatë e cila ndodhet jashtë ish-Jugosllavisë ku banojnë shumica e dëshmitarëve, automatikisht çon në vështirësi planifikuese të cilat shkaktojnë vonesa. Për ndryshimin e datave të dhënies së një dëshmie ekzistojnë arsye të ndryshme. Procedurat administrative në sallat gjyqësore mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e dëshmisë së një dëshmitari të mëparshëm ose mund të shkaktojnë ndryshime në renditjen e dëshmitarëve. Gjithashtu pala thirrëse mund të devijojë nga orari paraprak dhe të kërkojë shtyrjen e dëshmisë së një dëshmitari. Në disa raste mund të ndryshojnë rrethanat e dëshmitarit të cilat e pengojnë të udhëtojë si për shembull probleme shëndetësore, ose arsye të ngutshme familjare. Planet e udhëtimit mund të ndryshojnë edhe prej motit apo ngjarjeve të paparashikuara.⁵² Të gjithë këta faktorë mund të kenë ndikim negativ ndaj dëshmitarëve të cilët janë të

⁵¹ SVD-ja konstatoi se disa dëshmitarë janë “të rraskapitur” prej shpjegimeve dhe rishpjegimeve dhe rikujtimeve të përjetimeve të tyre nga lufta në procese gjyqësore për krime lufte, ose në padi civile për dëmshpërblim. Gjithashtu disa e ndjejnë si detyrim të provojnë vuajtjet e tyre me qëllim që të njihen ose regjistrohen si viktima apo mbijetues për të marrë ndihmë.


⁵² Ndër çrregullimet e udhëtimit mund të përmenden nga reshjet e dendura të borës dhe vërshimet në Ballkan deri në shpërthimin vullkanik në Islandë.

gatshëm për të dëshmuar (Wald 2002; Stover 2014). Këtu, 14.7% e të intervistuarve deklaruan se kishin pasur vonesa në udhëtim në lidhje me dhënien e dëshmisë së tyre në Tribunal. Në përputhje me studimin e Stoverit (2014) për dëshmitarët e GJPN-së, të intervistuarit shprehën shqetësim për ndryshimin e datave, ku disa prej tyre thanë se ishin informuar për udhëtimin shumë pak para tij, kurse të tjerë shprehën shqetësimin për vonesa.

Gjithashtu dëshmitarët kanë nevojë për informacion dhe kohë të mjaftueshme gjatë përgatitjes për dhënien e dëshmisë në të mirë të mirëqenies së tyre dhe për garantimin e ndershmërisë së procesit (Stover 2014; Wald 2002). Procesi përgatitor për dëshmitarin fillon që prej kontaktit të parë të Tribunalit me dëshmitarin. Ekzistojnë një larmi faktorësh që ndërthuren me sjelljen e dëshmitarëve shumë prej të cilëve mund të mos kenë shkelur asnjëherë në gjyq në jetën e tyre, aq më pak në një gjykatë në një vend të huaj për të dëshmuar mbi përjetimet e tyre traumatike nga lufta (UNICRI 2009). SVD-ja ka mandat të informojë të gjithë dëshmitarët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe për të gjitha aspektet praktike, logjistike dhe juridike të nevojshme gjatë dhënies së dëshmisë.

Për disa dëshmitarë dhënia e dëshmisë para një gjykate për krime lufte shkakton një ndjesi frikësuese për shkak se struktura e Tribunalit është risi në sistemin ndërkombëtar duke qenë hibrid i së drejtës anglosaksone me atë kontinentale.⁵³ Sasia e informacionit që u jepet dëshmitarëve mund të ndryshojë ndjeshëm në varësi të profilit të tyre dhe përvojës së tyre në gjykatat para dhënies së dëshmisë. Të intervistuarit u pyetën sa dinin për Tribunalin para herës së parë kur dëshmuar dhe pas herës së fundit kur dëshmuar (Figura 3.19). Një numër i madh dëshmitarësh (68%; n=204) dinin shumë, ose kishin të dhëna edhe para se të dëshmonin, kurse një pjesë e madhe (75%; n=277) dinin shumë ose kishin të dhëna pas herës së fundit kur dëshmuar.


Figura 3.19 – Dijenitë mbi punën e Tribunalit



⁵³ Një ndryshim thelbësor midis të drejtës anglosaksone dhe asaj kontinentale është roli i gjykatësit. Në të drejtën anglosaksone gjykatësit janë arbitra neutralë dhe ua lënë palëve ballafaqimin ligjor. Përkundrajt kësaj gjykatësit në të drejtën kontinentale kanë kompetencë më të gjerë dhe luajnë një rol më aktiv në bërjen e pyetjeve ose rol hetimor në proces (Crawford et al. 2013).

Ekziston ndryshim ndërmjet nivelit të dijenive të fituara pas dhënies së dëshmisë, të raportuara nga femrat në krahasim me meshkujt. Figura 3.20 krahason dijenitë e të intervistuarve para herës së parë të dhënies së dëshmisë dhe pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë.

Figura 3.20 – Përqindja e personave me dijeni më të shumta për Tribunalin pas dhënies së dëshmisë




Më shumë se 40% e femrave dhe 52.6% e meshkujve nuk morën më shumë dijeni për Tribunalin para herës së parë dhe pas herës së fundit që dëshmuar. Vlen të përmenden pesë individë (një femër dhe katër meshkuj) të cilët u shprehën se dinin *madje më pak* për Tribunalin pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë. Së fundi kishte dukshëm më shumë të ngjarë që femrat të dinin shumë për Tribunalin pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë, në krahasim me meshkujt (Figura 3.20). Ndoshta femrat janë më të prirura të pranojnë se kanë marrë më shumë dijeni. Një mundësi tjetër është që femrat të kenë pasur më pak informacion për Tribunalin para dhënies së dëshmisë për herë të parë si pasojë e pikëpamjeve të tyre mbi problemet e drejtësisë penale dhe asaj ndërkombëtare (Barbarett 2014), ose më përgjithësisht për shkak të ndryshimeve në procesin e përpunimit të informacionit midis meshkujve dhe femrave (Halpern 2013). Për këto arsye, shtimi i dijenive të tyre pasqyrohet edhe në përgjigjet e tyre për anketimin.

Dëshmitarëve u duhet kohë e mjaftueshme në përgatitjet për të dëshmuar. Duke filluar që nga thirrja e parë telefonike me dëshmitarët, SVD-ja u jep atyre informacion mbi procesin e dhënies së dëshmisë në Tribunal. Takimi i parë fizik ndodh zakonisht në hotelin e dëshmitarit në Hagë me përjashtim të rasteve kur SVD-ja gjykon se dëshmitarët duhen informuar paraprakisht në vendin e tyre para udhëtimit. Aty ku duhet, dëshmitarëve u jepet ndihmë në BKS ose në gjuhën shqipe dhe takimet informative përqendrohen në informacionin logjistik dhe praktik i nevojshëm gjatë qëndrimit të tyre në Hagë (p.sh. ndërtesa ku do të qëndrojnë, roli i SVD-së, ndihma mjekësore dhe aspekte të tjera). Gjithashtu sesionet informative të SVD-së janë edhe për çështje të tjera logjistike si oraret, procedurat teknike në sallën e gjyqit, shpjegime mbi përkthimin gojor të njëkohshëm, roli i palëve, dhe masat mbrojtëse në sallën e gjyqit duke u mundësuar në këtë mënyrë dëshmitarëve informacionin e nevojshëm. Informacioni mbi procedurën juridike, veçanërisht për masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, është kompleks dhe mund të keqkuptohet lehtësisht. Është e mundshme që dëshmitarët të mos jenë të vetëdijshëm se Prokuroria, Mbrojtja dhe i akuzuari/të akuzuarit janë në dijeni të identitetit të tyre edhe kur janë nën masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, ose se i akuzuari do të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit, ose se seancat mund të shihen prej njerëzve të ulur në vendet për publikun (Elias-Bursać 2015; Stepakoff et al. 2014; Stover 2014, 2005; Wald 2002) dhe nëpërmjet transmetimit në internet.

Të intervistuarit u pyetën nëse kishin pasur: (1) kohë të mjaftueshme për përgatitje; (2) informacion të mjaftueshëm që nevojitej për dhënien e dëshmisë; dhe (3) nëse ishin të kënaqur me ndihmën e dhënë nga SVD-ja. Sikurse shihet nga Figura 3.21, deri diku femrat pajtohen më pak se kanë pasur kohë të mjaftueshme për përgatitje, 89.4% e femrave dhe 92% e meshkujve u pajtuan (ose u pajtuan plotësisht) se kishin pasur kohë të mjaftueshme për përgatitje. Gjithashtu ka ndryshime në rezultatet e përgjigjeve nga të dy gjinitë ku 85.1% e femrave dhe 93.7% e meshkujve pajtohen se kanë pasur informacion të mjaftueshëm për dhënien e dëshmisë dhe 87.2% e femrave e 94% e meshkujve pajtohen se ishin të kënaqur me ndihmën e SVD-së. Kjo ndryshon me Stover (2014) ku u konstatua se femrat ishin më të kënaqura me ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët në GJPN.

Figura 3.21 – Përgatitja, informacioni dhe kënaqësia para nisjes së procesit gjyqësor



Veç problemeve juridike dhe logjistike me të cilat përballen dëshmitarët, luajnë rol edhe faktorë personalë të cilët kanë të bëjnë me arsyet e dhënies së dëshmisë dhe pasojat e pjesëmarrjes në dhënien e dëshmisë.

3.2.3 Arsyet e dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë

Vetëm në dhjetëvjeçarin e fundit ka filluar një hulumtim sistematik mbi arsyet që i bëjnë dëshmitarët të dëshmojnë (Stover 2005). Rëndësia e rolit të dëshmitarëve në gjykatat për krime lufte zë fill që nga proceset gjyqësore të Nurembergut ku pati kritika se dëshmitarët- viktima nuk u përdorën aq sa duhej për dhënien e dëshmimeve okulare mbi ngjarjet që përfshiheshin në aktakuzat kundër udhëheqësve nazistë (Arendt 1963). Duke mbajtur parasysh se dëshmitarët janë “shpirti” i punës së Tribunalit, një analizë e hollësishme e arsyeve dhe ndikimeve për dhënien e dëshmisë ka rendësi jetike për përmbushjen e mandatit të Tribunalit (Wald 2001).


Ndoshta hulumtimi më i gjerë i derisotëm mbi arsyet e dëshmitarëve përbëhet nga intervistat e 109 meshkujve dhe 38 femrave të cilët dëshmuar për Gjykatën Speciale të Sierra Leones (Stepakoff et al. 2014). Hulumtuesit identifikuan dy aspekte të gjera të dhënies së dëshmisë (1) ndihmë për vetveten; (2) ndihmë ndaj të tjerëve. Ndër arsyet kryesore përfshiheshin: denoncimi i “të këqijave bërë kundër meje gjatë luftës”; kontributi “në njohuritë publike për luftën”; dëshira “për drejtësi ndëshkuese”; dhe “detyrim moral ndaj viktimave të tjera”.

Këto rezultate nxjerrin në dukje elemente të përbashkëta të dala nga hulumtime të mëhershme; nevoja e dëshmitarëve për të treguar përvojën e tyre; nevoja për të hedhur dritë mbi çfarë u ka ngjarë atyre dhe njerëzve të tyre të dashur; vënia në vend e drejtësisë; dhe dëshira për të kontribuar në historinë mbi krimet e luftës (Stover 2005; Stover et. al 2011).

Një studim i dëshmitarëve ruandezë të prokurorisë dhe të mbrojtjes (n=60) të cilët dëshmuar në gjykata shtetërore, në gjykatat gacaca⁵⁴, dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën pasqyron arsye të ngjashme. Po ashtu si në studime të tjera dëshmitarët dhanë disa arsye ndër të cilat: (1) detyrim për të dëshmuar mbi gjenocidin; (2) detyrim moral për tregimin e të vërtetës dhe për të mësuar më shumë çfarë kishte ndodhur (p.sh. gjetja e familjes dhe e miqve, identifikimi i keqbërësve, etj.); (3) njohja publike e vuajtjeve dhe krimeve; dhe (4) angazhimi për rindërtimin e shoqërisë pas konfliktit (Clark and Palmer 2012). Së fundi, viktimat e dhunës seksuale mund të kenë arsye të ndryshme. Femrat të cilat dëshmuar në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen deklaruan se për to ishte e rëndësishme të dëshmonin për të treguar mbi krimet e kryera dhe përjetimet e tyre (Staggs-Kelsall and Stepakoff 2007). Viktimat e dhunës seksuale të cilat dëshmuar në Tribunal dhe në Dhomen për Krime Luftë të Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës theksuan nevojën për nxjerrjen para drejtësisë të keqbërësve, parandalimin e krimeve në të ardhmen, dhe për të treguar të vërtetën mbi çfarë kishte ndodhur (Mischkowski and Mlinarevic'2009).

Të gjitha këto arsye janë të pranishme në përvojën e dëshmitarëve të Tribunalit. Për shkak të gjerësisë dhe spektrit të arsyeve dhe karakterit intensiv e personal të dhënies së dëshmisë, në anketim u përfshinë pyetje konkrete dhe pyetje që nuk kërkonin përgjigje të prera për këto aspekte (Doak 2011; Bonomy 2007; Wald 2002). Të intervistuarit ishin të lirë të jepnin më shumë se një arsye për dhënien e dëshmisë, gjë që shumë prej tyre e bënë (Figura 3.22).

Figura 3.22 – Arsyet për dhënien e dëshmisë



Gjatë analizimit të kategorive “Pajtohem plotësisht” ose “Pajtohem” në lidhje me arsyet e dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë, arsyet më mbizotëruese ishin “të ndihmoja gjykatësit që të nxirrnin vendim të saktë” (97.7%) dhe si “detyrim moral ndaj gjithë viktimave të luftës” (95.3%). Të dyja këto arsye pasqyrojnë përfundimet e nxjerra në Stepakoff et al. (2014) i cili konstatoi arsye të jashtme të rëndësishme për dhënien e dëshmisë. Është me interes të theksohet se arsyet më të pakta nga përgjigjet e dhëna ishin ato që kishin të bënin me aspektin personal të individit në dhënien e dëshmisë. Ndonëse 81.3% e dëshmitarëve shprehin pajtim ose pajtim të plotë se dhënia e dëshmisë ishte e rëndësishme sepse, “Doja të tregoja përjetimet e mia”, vetëm 58.3% u shprehën se dëshmuar për “t’i hequr nga mendja ngjarjet nga luftërat në ish-Jugosllavi”. Një pjesë më e vogël, kryesisht dëshmitarë të Prokurorisë (49%, ose 147 persona), u pajtuan ose u pajtuan plotësisht se për ta dhënia e dëshmisë ishte e rëndësishme për t’u ballafaquar me të akuzuarin/akuzuarit në sallën e gjyqit, kurse 28%, ose 54 persona nuk u pajtuan, ose nuk u pajtuan aspak se ballafaqimi me të akuzuarin përbënte një arsye të rëndësishme për dhënien e dëshmisë.


Gjithashtu në Studimin Pilot dëshmitarëve iu ofrua mundësia që të jepnin arsyet për dhënien e dëshmisë nëpërmjet një pyetjeje me disa mundësi përgjigjeje (Figura 3.23). Një numër të intervistuarish dhanë përgjigje të ngjashme në përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve konkrete. Sërish dëshmitarët dhanë më

⁵⁴ Qeveria ruandeze krijoi gjykatat gacaca pas gjenocidit të vitit 1994 në Ruanda për të ndihmuar në procedimin e një numri të madh çështjes penale ende të paproceduara. Këto gjykata përdorin metoda gjithëpërfshirëse ndër të cilat praktikat e së drejtës perëndimore dhe praktika tradicionale afrikane për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të ndihmuar në pjesëmarrjen e viktimave në proceset gjyqësore. Nga njëra anë analistët i lëvduan gjykatat gacaca për efikasitetin e tyre (deri në vitin 2012 kur përfunduan të gjithë proceset gjyqësore u proceduan më shumë se një milion çështje) dhe nga ana tjetër i kritikuan për mungesën e procedimit të duhur dhe përcaktimin e “përgjegjësisë kolektive” që mund të ketë ndikuar në ndarjet brenda shoqërisë ruandeze (Bornkamm 2012).

së shumti përgjigje që pasqyrojnë përfundimet e hulumtimeve të tjera mbi motivet e dëshmitarëve. Dëshmitarët priren të përmendin arsye altruiste të jashtme më shumë se arsye të brendshme (Stepakoff 2014). Dëshmitarët përgjithësisht përmendin interesin shoqëror në tërësi dhe nevojën e tregimit të së vërtetës mbi ngjarjet. Arsye të tjera të përmendura shpesh kanë të bëjnë me arsye më të forta, konkretisht që i akuzuari të marrë ndëshkimin e merituar, apo të lirohet prej fajësisë si dhe detyrimin moral për të dëshmuar.

Është e qartë se dëshmitarët e kuptojnë rolin e tyre brenda kontekstit të gjerë të kauzës së të vërtetës dhe drejtësisë dhe parandalimin e krimeve të luftës. Botëkuptimi i tyre shumëpërmasor përfshin ndjenjën e detyrës ndaj të tjerëve (Clark 2014; Doak 2011), si dhe arsye më personale për dhënien e dëshmisë. Është interesant se përfundimet e këtushme në disa aspekte pasqyrojnë përfundimet e studimeve mbi arsyet e dëshmitarëve në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen (Stepakoff et al. 2014) dhe në GJPN (Stover 2014). Pamja që shpaloset është se dëshmitarët kanë arsye më të gjera dhe më komplekse për dhënien e dëshmisë të cilat shkaktohen nga faktorë të brendshëm dhe më shumë nga faktorë të jashtëm.

Figura 3.23 – Arsye të tjera për dhënien e dëshmisë⁵⁵



3.2.4 Kënaqësia prej dhënies së dëshmisë

Ndonëse arsyet e dëshmitarëve kanë të bëjnë më shumë me vlerat dhe përvojat e tyre individuale, kënaqësia e dëshmitarëve prej dëshmisë së tyre ka të bëjë më shumë me faktorë të ndryshëm që mund të mos jenë në kontroll të dëshmitarëve. Ka më shumë të ngjarë që kënaqësia e dëshmitarëve prej dëshmisë së tyre të varet prej faktit se si e gjykojnë ata këtë përvojë: pozitive ose negative (Clark 2014, Horn et al 2009; Stepakoff 2014, Stover 2005), çliruese ose traumatizuese (Brounéus 2010; Mendeloff 2009; Dembour and Haslam 2007; Stover 2005), e rëndësishme për tregimin e së vërtetës (Findlay and Ngane 2012; Doak 2011), e rëndësishme për tregimin e një historie personale (“të tregoja përjetimin tim”) (Hodžić 2010; Horn, et al. 2009). Ndonëse hulumtimet mbi kënaqësinë e dëshmitarëve janë shtuar, ka pasur më pak përpjekje teorike për të përcaktuar çfarë ndihmon apo dëmton kënaqësinë e dëshmitarit. Së pari, ka më shumë të ngjarë që dhënia e dëshmisë të japë kënaqësi në qoftë se ekziston: (1) aftësia për dhënien e një rrëfimi gojor apo me shkrim mbi çfarë ka ndodhur; (2) mundësia për zbulimin e së vërtetës; (3) një element i procesit që i shërben drejtësisë; dhe (4) një ballafaqim diskutues për dëshmitarin (Doak 2011). Së dyti, ka të ngjarë që dhënia e dëshmisë të jetë më pozitive në qoftë se dëshmitari: (1) paraprakisht është më pak i tensionuar për dhënien e dëshmisë; (2) është ndjerë i


⁵⁵ Pyetja A19 (shih pyetësin në Shtojcën III) u mundëson dëshmitarëve që nëpërmjet pyetjeve me disa mundësi përgjigjeje të qartësojnë arsyet e dhënies së dëshmisë. Për këtë arsye përgjigjet prej pyetjeve të shkurtra të të intervistuarve në lidhje me arsyet e dhënies së dëshmisë (pyetjet A10-A18) kanë gjëra të përbashkëta me pyetjen A19, sepse dëshmitarët nuk u kufizuan prej formulimit të pyetjeve të mëparshme. Ndonëse disa përgjigje ishin kopjuese të pyetjeve me shumë përgjigje (për shembull “të tregoja përjetimet e mia”), është e rëndësishme që të mos “eliminohen” zërat e dëshmitarëve mbi mendimet e para që u vijnë në mendje, kur ata mendojnë lirisht mbi arsyet e dhënies së dëshmisë (Stepakoff 2015; Stover 2014).

respektuar nga punonjësit e gjykatës; dhe (3) i ka përjetuar pyetjet nga pala kundërshtare si përvojë pozitive (Horn et al. 2009).

Kënaqësia e dëshmitarëve ndër të intervistuarit ndryshonte ndjeshëm. Kënaqësia e dëshmitarëve në lidhje me paraqitjen e tyre ishte e ndryshme nga kënaqësia me vetë procesin gjyqësor. Kënaqësia e dëshmitarëve pas daljes nga salla e gjyqit varej prej faktit se çfarë prisnin të fitonin nga kjo përvojë. Disa dëshmitarë shkuan në sallën e gjyqit me vetëbesim dhe dolën andej të acaruar, veçanërisht në rastet kur mendonin se nuk kishin mundur të tregonin përjetimet e tyre dhe ishin ndërprerë rregullisht apo ishin kundërshtuar në mënyrë agresive dhe/ose akuzuar se po gënjenin në pyetjet e bëra nga pala kundërshtare. Herë pas here gjykatësit i lejuan dëshmitarët të thoshin diçka në fund të dëshmisë gjë që mund të ketë ose mund të mos ketë rëndësi në lidhje me kënaqësinë e tyre (Moffett 2014). Pas përfundimit të dëshmisë prej një dëshmitari, shpesh Dhoma Gjyqësore e falënderon dëshmitarin për ardhjen në gjyq për të dëshmuar dhe në disa raste shpreh simpati për vuajtjet e dëshmitarit. Në raste të rralla Dhoma Gjyqësore mund ta ftojë një dëshmitar që të japë një deklaratë mbi pasojat që ka pasur si viktimë në kuadër të procesit të dhënies së dënimt.⁵⁶ Punonjësit e SVD-së vunë re se gjeste të tilla të Dhomës Gjyqësore dhe informimi i mëpasshëm i dëshmitarit prej palës që e kishte thirrur u mundësoi dëshmitarëve që të ngrinin shqetësimet e tyre në lidhje me dëshminë në sallën e gjyqit.

Për vlerësimin e kënaqësisë së dëshmitarëve lidhur me arsyet e tyre për dhënien e dëshmisë, të intervistuarve iu kërkua të mendoheshin për arsyet e dhënies së dëshmisë dhe u pyetën nëse ishin të kënaqur me dëshminë e tyre.⁵⁷ Të intervistuarit në shumicë dërrmuese u shprehën se ishin të kënaqur (Figura 3.24). Thujse 91% u shprehën se ishin të kënaqur dhe 4.7% të pakënaqur, kurse 4.7% të pjesës së mbetur nuk dhanë mendim ose përgjigje. Këto përfundime përputhen me përfundimet e një hulumtimi sistematik të kohëve të fundit mbi dhënien e dëshmisë prej dëshmitarëve (Stover et al. 2014). Në lidhje me kënaqësinë nuk kishte ndryshime të konsiderueshme midis atyre që kishin dëshmuar për Prokurorinë dhe dëshmitarëve të Mbrojtjes. Gjasa e kënaqësisë së dëshmitarëve të Prokurorisë dhe të Mbrojtjes prej dëshmitarëve të tyre është thujse e barabartë (përkatesisht 93% dhe 90%), ndonëse kishte pak më shumë të ngjarë që dëshmitarët e Prokurorisë të ishin më të pakënaqur me dëshminë e tyre (7% kundrejt 1% për dëshmitarët e mbrojtjes).

Figura 3.24 – A është i intervistuari i kënaqur me dëshminë e tij kur mendon mbi arsyet e dhënies së dëshmisë



Po ashtu si për pyetjet mbi arsyet e dëshmitarëve, të intervistuarit dhanë përgjigje përmbledhëse pse ishin të kënaqur apo të pakënaqur me dëshmitë e tyre.⁵⁸ Intervistuesit dhanë arsye të ndryshme. Kjo pyetje pati edhe përgjigjet më të shumta ndër pyetjet me përgjigje konkrete (n=253). Përgjigjet ishin nga më të ndryshme, mirëpo ato pasqyrojnë tema të tjera të konstatuara në hulumtime të tjera mbi dëshmitarë, si edhe përvojat e punonjësve të SVD-së që ofrojnë mbështetje të menjëhershme për dëshmitarët pas dëshmitave të tyre (Stover 2005, 2014; Stepakoff et al. 2014).


⁵⁶ Deklaratat mbi pasojat si viktimë janë deklarata me shkrim ose me gojë në kuadër të procesit nëpërmjet të cilit viktimave të krimeve u jepet mundësia t'u tregojnë gjykatësve domethënien e krimeve për ta personalisht dhe shkallën e pasojave të këtyre krimeve mbi ta (Rregulla 92 bis Rregullorja e Procedurës dhe Provave të Tribunalit, IT/32/Rev.50, 8 korrik 2015). Këto deklarata janë përdorur në masë të kufizuar në TPNJ (Moffett 2014), dhe dobia e këtyre deklaratave është lëvdur (Ciorciari and Heindel 2016) dhe vënë në pikëpyetje (për një diskutim të zgjeruar shih Ochoa 2013, kapitulli 4).

⁵⁷ Shih pyetjen A20a në pyetësor (Shtojca III).

⁵⁸ Shih pyetjen A20a në pyetësor (Shtojca III).

Sikurse shihet nga Figura 3.25, të intervistuarit në shumicë dërmuese ndjejnë kënaqësi kryesisht në lidhje me tregimin e së vërtetës (n=108) dhe në dhënien e ndihmës për zbardhjen e fakteve dhe të dokumentimit historik. (n=105). Veç këtyre dy arsyeve, ekzistojnë edhe një sërë arsyesh të tjera që janë më të lidhura me ndihmën apo pjesëmarrjen në arritjen e një rezultati përfundimtar të drejtë. Këto arsye kanë të bëjnë me ndjenjën e ndihmesës së dhënë në vendimet e gjykatësve ose në aktgjykimet; mbi shpalljen e fajësisë ose të pafajësisë së të akuzuarve; ose kishin ndihmuar në realizimin e drejtësisë. Jo të gjithë dëshmitarët ishin të kënaqur me dëshmitë e tyre duke qenë se disa prej tyre mendonin se nuk kishin mundur të tregonin përjetimet e tyre, ose ishin të pakënaqur me Prokurorinë, ose më përgjithësisht me Tribunalin, ose mendonin se nuk kishin kontribuar në vendime.

Figure 3.25 – Mendimet e të intervistuarve në lidhje me kënaqësinë



Përmbledhje

Studimi Pilot rreket të ofrojë një përzgjedhje përfaqësuese të dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar në proceset gjyqësore të TPNJ-së pas vitit 1998. Përzgjedhja sasiore dhe rastësore e përdorur nga UNT synonte të garantohej përgjithësimi më i madh i mundshëm për përfshirjen e një spektri të gjerë dëshmitarësh me profile të ndryshme gjeografike dhe demografike e në të njëjtën kohë të garantohej mbrojtja më e lartë për sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve. Përfundimet e këtushme ofrojnë një pamje unike të përvojës së dëshmitarëve.

Së pari, dëshmitarët në shumicë të gjerë u përgjigjën se kishin pasur kohë të mjaftueshme për përgatitje dhe informacion të mjaftueshëm në lidhje me dhënien e dëshmisë. Së dyti, shumë pak dëshmitarë depozituan padi civile për dëmshpërblime në gjykatat shtetërore në bazë të dënimeve të dhëna nga Tribunali në çështjet gjyqësore në të cilat ata dëshmuar. Së treti, të dhënat tregojnë se të intervistuarit dëshmuar për një sërë arsyesh, shumica e të cilave i bëjnë jehonë nevojës për të mirën e përbashkët, qoftë në formën e kontributit për të vërtetën dhe drejtësinë, apo në pakësimin e gjasave për përsëritjen e dhunës në të ardhmen. Së katërti dhe më e rëndësishme, dëshmitarët bëjnë të ditur se janë tejet të kënaqur me arsyet dhe motivet e dhënies së dëshmisë prej tyre. Gjithashtu kënaqësia e dëshmitarëve me dëshminë e tyre është shenjë pozitive për TPNJ-në dhe më gjerë për drejtësinë ndërkombëtare.

Kapitulli 4 – Siguria njerëzore dhe ndikimi i dhënies së dëshmisë

Studimi Pilot bazohet në konceptin e Kombeve të Bashkuara të “sigurisë njerëzore” i cili përfshin dy elemente: “liria prej frikës” (mungesa e konfliktit të dhunshëm) dhe “liria prej skamjes” (siguria shoqërore-ekonomike). Të dy këto elemente janë jetike në shoqëritë pas konfliktit ku liritë shoqërore dhe ekonomike janë pjesë e një bashkësie më të gjerë të drejtash (Kaldor 2007; Lautensach and Lautensach 2013; UNDP 1994). Siguria njerëzore ekziston kur individët jetojnë pa kërcënimin e dhunimit të tërësisë së tyre fizike dhe individuale dhe në kushte të favorshme për nevojat njerëzore bazë si puna, shëndeti, siguria dhe begatia. Siguria njerëzore ka rëndësi të veçantë për dëshmitarët të cilët dëshmojnë në gjykata ndërkombëtare. Thujse të gjithë këta individë janë viktime të luftës të cilët kanë përjetuar humbje dhe thirren për të treguar përjetimet e tyre larg vatrave të tyre. Pra, ata janë edhe njerëz me kurajë të cilët dalin për të ndihmuar drejtësinë e vendit të tyre dhe drejtësinë ndërkombëtare.

Ky kapitull trajton sigurinë shoqërore-ekonomike dhe pasojat e dhënies së dëshmisë në marrëdhëniet intime dhe marrëdhëniet me njerëzit në bashkësinë ku jeton dëshmitari. Në pjesën e dytë të kapitullit trajtohet ndikimi i dhënies së dëshmisë ndaj sigurisë së dëshmitarit. Aty shtjellohet ndjesia në tërësi e sigurisë prej dëshmitarit dhe jepet një pamje më e hollësishme mbi perceptimin e kërcënimeve prej dëshmitarit, përballimin e këtyre kërcënimeve prej dëshmitarëve dhe çfarë ndikimi patën masat mbrojtëse në sallën e gjyqit.

Temat e trajtuara në këtë kapitull kanë lidhje me pyetjet në pjesën B dhe C të pyetësorit (Shtojca III).

4.1 Siguria personale dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore në bashkësi

4.1.1 Marrëdhëniet intime

Rëndësi të veçantë për individin dhe shoqërinë ka rikrijimi i lidhjeve midis njerëzve dhe rikthimi i besimit të dëmtuar gjatë konfliktit. Ky është një hap drejt ripajtitimit (Clark 2014). Marrëdhëniet me njerëzit në vendin ku jetojnë janë të rëndësishme për dëshmitarët kur ata kthehen në mjedisin e tyre ku përballen me pasojat e dhënies së dëshmisë (Hodžić 2010; Bloomfield et al. 2003, kap. 4). Pasojat e dhënies së dëshmisë mund të bien edhe mbi shokët, të afërmit, partnerët intimë dhe madje edhe mbi brezin e ardhshëm që bart barrën e marrëdhënieve negative dhe të mosbesimit shoqëror (Björkdahl and Selimovic 2014). Gjithsesi, në qoftë se pasojat e luftës dhe të vendimeve të drejtësisë ndërkombëtare mbi marrëdhëniet njerëzore individuale dhe shoqërore nuk trajtohen, kjo mund të sjellë pasoja negative afatshkurtra dhe afatgjata në gjendjen mendore të dëshmitarëve (Stepakoff et al. 2015).


Nga përvoja e SVD-së nuk është e pazakontë që të afërmit ose shokët e një dëshmitari të kundërshtojnë vendimin e tij për të dëshmuar. Ky kundërshtim mund të vijë nga frika prej pasojave negative të dhënies së dëshmisë, nga dëshira për të harruar të shkuarën, ose për shkak të mosbesimit ndaj Tribunalit. Në disa raste punonjësit e SVD-së konstatuan se dëshmitarët vendosën të mos u thoshin gjë të afërmeve të tyre për dëshminë, ose sepse ata nuk dëshironin të zbulonin trauma nga koha e luftës, ose sepse kundërshtonin pjesëmarrjen e tyre në një proces gjyqësor. Probleme lindën edhe në bashkësitë lokale, në qyteza ose vendbanime të vogla. Disa dëshmitarë u shprehën se dëshmia e tyre mund të perceptohet e dëmshme për një grup të tërë etnik. Pavarësisht nga arsyet e dhënies së dëshmisë, disa dëshmitarë janë të shqetësuar prej perceptimeve të të tjerëve dhe kanë frikë se mos quhen tradhtarë apo përkrahës të një grupi të caktuar.

Dhënia e dëshmisë ka ndikim më të madh negativ për dëshmitarët dhe marrëdhëniet e tyre me të tjerët kur ata përballen me kritika ose izolim shoqëror nga njerëzit e tyre më të afërt (p.sh,

bashkëshorti/bashkëshortja, familja dhe shokët e miqtë). Pranimi ose izolimi shoqëror i dëshmitarëve prej të tjerëve në mjedisin ku jetojnë (paria, përfaqësues të fesë dhe persona të tjerë në atë bashkësi) mund të ndihmojnë ose dëmtojnë drejtësinë, ripajtimin dhe rivendosjen e marrëdhënieve shoqërore pas një konflikti të gjerë (Spini et al. 2013).


Për vlerësimin e pasojave të dhënies së dëshmisë në lidhje me marrëdhëniet dhe sigurinë njerëzore, dëshmitarët u pyetën për pasojat në martesën e tyre dhe perceptimin e tyre mbi mënyrën e trajtimit pas dhënies së dëshmisë nga të afërmit, shokët e miqtë dhe njerëz të tjerë të rëndësishëm në bashkësinë ku jetojnë. Sa i përket gjendjes civile të të intervistuarve, të intervistuarit ishin në shumicë të gjerë të martuar (n=244), kishin marrëdhënie me një tjetër (n=3) ose vejan/vejushë (n=22), dhe pak beqarë (n=14), ose të shkurorëzuar (n=13) (Figura 4.1).⁵⁹

Figura 4.1 – Gjendja civile



Të intervistuarit në shumicë të gjerë u përgjigjën se dhënia e dëshmisë nuk kishte pasur asnjë ndikim negativ në lidhjen e tyre intime (n=260), kurse 11 persona (3.7%) u përgjigjën se dëshmia e tyre kishte pasur ndikim pozitiv në lidhjen e tyre bashkëshortore (Figura 4.2). Ashtu sikurse u shpreh një i intervistuar me mprehtësi, “kur tregon të vërtetën, sado e vështirë të jetë, lë gjithmonë një mbresë të mirë te partneri dhe pret një sjellje të njëjtë në marrëdhënie.” Dy të intervistuar raportuan pasoja negative në lidhjet e tyre, ku një dëshmitar bëri të ditur se bashkëshorti/bashkëshortja i saj/e tij ishte kundër dhënies së dëshmisë për arsye se mendonte që Tribunali nuk ishte i paanshëm dhe i drejtë. Pas daljes së vendimit në çështjen ku kishin dëshmuar dëshmitarët, martesat e tyre patën pasoja negative. Afërsisht 9% e të intervistuarve nuk dhanë përgjigje, ose nuk ishin të sigurtë për ndikimin e dhënies së dëshmisë në lidhjet e tyre intime.

Figura 4.2 – Ndikimi në marrëdhëniet intime



⁵⁹ Proceset gjyqësore të krimeve të luftës zgjasin dhe gjendja civile e dy dëshmitarëve ndryshoi gjatë procesit të dhënies së dëshmisë. Një dëshmitar/dëshmitare ishte i/e martuar dhe më pas humbi bashkëshortin/bashkëshorten (ndërroi jetë). Dëshmitari/dëshmitarja i/e dytë e cilësoi gjendjen civile njëkohësisht si “i/e shkurorëzuar” dhe “në një marrëdhënie”. Asnjë nga dëshmitarët nuk tha se dhënia e dëshmisë kishte ndikuar negativisht në lidhjen e tyre.

4.1.2 Marrëdhëniet ndërnjerëzore në bashkësi


Ripajtimi dhe aftësia për t'i lënë pas ndasitë e shkaktuara nga lufta varet prej aftësive dhe gatishmërisë së individëve për ndreqjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve në mjedisin ku jetojnë. Veçanërisht atje ku ekzistojnë tensionet etnike (Halpern and Weinstein 2004; Clark 2014) dhe ku ekzistojnë shqetësime mbi perceptimet e brezit të ardhshëm për konfliktin (Spini et al. 2013; Hjort and Frisén 2006), gjetja e zgjidhjeve për këto marrëdhënie përkundrejt përvojave traumatike mund të fuqizojë ndjenjën e bashkësisë që ndihmon për ripajtimin afatgjatë (Hutchison and Bleiker 2008). Për këto arsye është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i perceptimit të dëshmitarëve për trajtimin e tyre në bashkësinë ku jetojnë pas dhënies së dëshmisë. Studimi Pilot ofron një vlerësim të tillë.

Të intervistuarit u pyetën nëse kishin përjetuar kritika apo humbje të lidhjeve shoqërore si pasojë e dhënies së dëshmisë. Përgjigjet ishin nga më të larmishmet me pika të përbashkëta midis dëshmitarëve të cilët ishin kritikuar, kishin humbur lidhjet shoqërore ose të dyja (Figura 4.3). Prej 39 të intervistuarve (13%) të cilët raportuan lloje të caktuara pasojash, dymbëdhjetë persona (4%) përjetuan humbje të lidhjeve shoqërore dhe izolim shoqëror si pasojë e dhënies së dëshmisë, kurse 16 persona të tjerë bënë të ditur se ata ishin kritikuar (n=28 ose 9.3% gjithsej të kritikuar). Pra një numër i vogël, por i konsiderueshëm dëshmitarësh gjatë periudhës pas dhënies së dëshmisë përjetuan nënçmim dhe përjashtim shoqëror. Vlen të theksohet se një numër të intervistuarish (n=54 ose 18%) nuk dhanë përgjigje, nuk ishin të sigurtë, ose nuk kishin asnjë mendim në lidhje me trajtimin e tyre pas dhënies së dëshmisë duke lënë të paqartë masën e kritikave ose të izolimit shoqëror me të cilin përballeshin dëshmitarët si pasojë e dhënies së dëshmisë prej tyre (nuk tregohen rezultate).

Figura 4.3 – Kritikat dhe humbja e lidhjeve shoqërore (n=39)

	Po, humba lidhjet shoqërore	Nuk humba lidhjet shoqërore
Po, u kritikova	12	16
Nuk u kritikova	11	207

Figura 4.4 – Persona të cilët u distancuan nga të intervistuarit dhe i kritikuan ata⁶⁰



Intervistuesit u kërkuan dëshmitarëve të përcaktonin kategoritë e personave për të cilët ata mendonin se ishin sjellë negativisht ndaj tyre si pasojë e dëshmisë së tyre. Kjo u bë për të kuptuar më mirë natyrën

⁶⁰ Ndër përgjigjet 'e tjera' jo të prera përfshihej një për "njerëz ziliqarë", "viktima", "kritikues të Tribunalit", dhe "dezertorë lufte".

e këtyre kërcënimeve dhe ndikimin e tyre duke qenë se izolimi shoqëror i dëshmitarëve krijon kërcënimin më të madh ndaj sigurisë së tyre (Stover 2005; Clark 2014). Figura 4.4 jep një pasqyrë të faktorëve të renditur nga më të lartët deri në më të ulët për sa i përket izolimit shoqëror. Sipas intervistuesve përjashtimi më i madh shoqëror dhe kritikak më të shumta vijnë nga persona të një grupi tjetër etnik dhe në vend të dytë vjen izolimi shoqëror nga i akuzuari (përfshirë edhe rrethin e tij shoqëror dhe familjar). Gjithsesi të intervistuarit mendonin se kritikak më të shumta që i bënë të ndiheshin të pasigurtë vinin nga drejtues fetarë dhe njerëz nga paria në bashkësinë ku jetonin (n=15).


Përfundimi i lartpërmendur është veçanërisht i rëndësishëm duke qenë se siç është përmendur gjetiu, kushtet e jetesës në bashkësinë ku jeton dëshmitari mund të përbëjnë faktorët më problematikë për dëshmitarët (Clark 2014). Së fundi, përgjithësisht dëshmitarët nuk përballen me izolim apo përjashtim shoqëror nga njerëz të cilët nuk janë të përkatësisë së tyre etnike ose fetare, por nga njerëz të etnisë dhe besimit të tyre fetar.

4.2 Ndikimi ekonomik i dhënies së dëshmisë

Për shkak të dhënies së dëshmisë në Tribunal dëshmitarët përjetuan edhe pasoja ekonomike negative (Clark 2014; Stover 2005). Konfliktet e armatosura mund ta shkatërrojnë ekonominë dhe ripërtëritja ekonomike pas konfliktit mund të jetë e ngadaltë, faktor që kufizon mundësitë ekonomike (Blattman and Miguel 2010; Kondylis 2010). Pra, si rrjedhojë, për Studimin Pilot ishte e rëndësishme të bëhej një vlerësim i perceptimeve të të intervistuarve mbi humbjet ekonomike si pasojë e dhënies së dëshmisë, ndër të cilat humbja e të ardhurave dhe mundësive të tjera për biznes, kufizimet e qeverisë mbi të ardhurat dhe shkatërrimi i zotërimeve.

Dëshmitarët mund të përjetojnë pasoja ekonomike për shkak të dhënies së dëshmisë gjatë një periudhe të gjatë. Çfarë lloj ndryshimesh ekonomike dhe në çfarë periudhe sipas dëshmitarëve shkaktohen prej dhënies së dëshmisë në Tribunal? Dëshmitarët u pyetën nëse ata (ose familjet e tyre) përjetuan ndryshime ekonomike pozitive ose negative: (1) para se të dëshmonin; (2) menjëherë pasi kishin dëshmuar për herë të fundit; dhe (3) aktualisht (Figura 4.5).

Figura 4.5 – Ndryshime ekonomike pozitive dhe negative në periudha të ndryshme




Pesëdhjetë e gjashtë dëshmitarë (18.7%) raportuan pasoja të ndryshme pozitive ose negative ekonomike para se të dëshmonin për herë të parë, pasi kishin dëshmuar për herë të fundit, ose aktualisht. Ekzistojnë pika të përbashkëta ndër dëshmitarë të cilët përjetojnë ndryshime ekonomike për arsye se dëshmitarët mund të përjetojnë ose mund të mos përjetojnë ndryshime në të gjitha periudhat kohore.⁶¹ Nga 56 të intervistuar, shumica e tyre raportuan ndryshime dhe një shumicë e gjerë përjetuan

⁶¹ Shih pyetjet B3a, B4a, dhe B5a në pyetësor (Shtojca III). Për shembull, një dëshmitar mund të përjetojë ndryshim negativ para dhënies së dëshmisë për herë të parë, ndryshim pozitiv dhe negativ pasi ka dëshmuar për herë të fundit, mirëpo aktualisht nuk përjeton asnjë ndryshim. Në bazë të grafikut kjo llogaritet si dy përgjigje nga një i intervistuar.

pasoja vetëm negative (n=47). Shqetësimi më i madh është ndryshimi negativ në kushtet e jetesës pas dhënies së dëshmisë për herë të fundit nga dëshmitarët (n=41) dhe aktualisht (n=13). Është një grup i vogël, por i konsiderueshëm dëshmitarësh të cilët përjetuan pasoja negative në të tri periudhat (n=7), pasoja të cilat ata i lidhin me dëshminë e tyre për Tribunalin. Ky numër rritet ndjeshëm deri në 24 nga 300 të intervistuar (8%) në qoftë se merren parasysh ata të cilët raportuan humbje ekonomike në kohën e dhënies së dëshmisë deri më sot (nuk tregohen rezultate). Si rrjedhojë, SVD-ja dhe UNT-ja shprehin shqetësim për pasojat ekonomike negative afatshkurtra dhe afatgjata të dhënies së dëshmisë në gjykata për krime lufte (Stover 2005; Clark 2014). Këto pasoja nuk mund të maten saktësisht për arsye se ky anketim bazohet në perceptimin e raportuar prej dëshmitarëve. Gjithsesi, rezultatet nxjerrin në dukje rëndësinë e një analize më të saktë të ndryshimeve ekonomike që përjetojnë dëshmitarët për shkak të dhënies së dëshmisë. Rezultatet janë gjithashtu shumë të ndryshme nga rezultatet e dëshmitarëve të GJPN-së të cilët janë thujse neutralë në lidhje me faktin nëse kanë përjetuar humbje financiare si rezultat i dhënies së dëshmisë (Stover 2014).

Çfarë lloj humbjesh përjetojnë dëshmitarët? Të intervistuarit u shprehën se pasiguria ekonomike përfshinte humbjen e të ardhurave, mosmarrjen e ndihmave financiare prej qeverisë, mundësi të humbura për të ardhura shtesë dhe humbje të pronës dhe aseteve bujqësore. Po ashtu si në rastin e izolimit shoqëror dhe kritikave në bashkësinë ku jetojnë, ekziston një numër i vogël, por i rëndësishëm dëshmitarësh të cilët pësojnë humbje (Figura 4.6). Jo të gjithë të intervistuarit të cilët raportuan humbje negative përcaktuan llojin e humbjeve. Nga humbjet e raportuara problemi më i madh është humbja e të ardhurave pas herës së fundit të dëshmisë, kurse një numër dëshmitarësh bënë të ditur se ata kanë përjetuar humbje të tilla deri më sot për shkak të dëshmisë. Të intervistuarit të cilët raportuan ndryshime pozitive, ndër këto ndryshime përmendën të ardhura shtesë dhe ndihma për strehim, si dhe lëvdata nga rrethi i tyre shoqëror dhe kolegët e tyre për dhënien e dëshmisë. Së fundi, nga dëshmitarët të cilët kishin dëshmuar në më shumë se një proces gjyqësor, tetë prej tyre u përgjigjën se kishin vënë re ndryshime në statusin e tyre ekonomik në periudhën midis proceseve gjyqësore. Një dëshmitar konstatoi më shumë probleme në vendin e punës, kurse një tjetër theksoi se nuk përfitoi rritje të pagës pasi kishte dëshmuar për herë të dytë. Për këta dëshmitarë ndikimi afatgjatë i dhënies së dëshmisë ka lënë pasoja të dukshme. Në qoftë se dëshmitarët vazhdojnë të përjetojnë humbje ekonomike, ky faktor mund të ndikojë në kënaqësinë e tyre kundrejt Tribunalit dhe misionit të tij (Miller 2008).

Figura 4.6 – Humbje ekonomike që perceptohen si pasoja të dhënies së dëshmisë në periudha të ndryshme⁶²




Bazuar në një praktikë të shkruar, Udhëzimi mbi Mëditjet e Dëshmitarëve, Tribunali hartoi rregulla për pagesa për dëshmitarët, për lehtësimin e pasojave ekonomike negative gjatë qëndrimit të tyre larg familjes dhe punës për dhënien e dëshmisë.⁶³ Është hartuar një listë me tarifat e Kombeve të Bashkuara

⁶² Të ardhurat përfshijnë rreziqet ndaj të ardhurave shtesë (paga, mundësi biznesi, punë stinore) si edhe kërcënime për heqje nga puna ndër të cilat ndërhyrja shtetërore, zbritja në detyrë ose pushimi nga puna. Pasuri e paluajtshme përfshin bagëtinë, asete bujqësore dhe prona të tjera fizike. Ndër humbjet e tjera financiare përfshihen shpenzime për ndryshimin e udhëtimeve për shkak të Tribunalit.

⁶³ Udhëzim mbi Mëditjet e Dëshmitarëve dhe Dëshmitarëve Ekspertë
[http://www.icty.org/x/file/Legal Library/Miscellaneous/it200_rev1_corr2_en.pdf](http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Miscellaneous/it200_rev1_corr2_en.pdf)

për vendin ku banon dëshmitari (pagesa e pjesëmarrjes), ku përfshihen shpenzimet për ushqime, shuma ditore dhe kompensim për dëshmitarët për kohën e kaluar larg shtëpisë. Në disa raste (kur provohet) dhe në bazë të përlogaritjes, Tribunali u jep dëshmitarëve kompensim shtesë për humbjet e jashtëzakonshme që ata kanë përjetuar për shkak të dhënies së dëshmisë. Afërsisht tre e katërta e të intervistuarve ishin të kënaqur me pagesat financiare të Tribunalit (mëditja që ata marrin gjatë kohës së dhënies së dëshmisë). Afërsisht një e dhjeta e të intervistuarve ishin të pakënaqur (Figura 4.7).⁶⁴ Rezultatet e këtushme gjithashtu pasqyrojnë rezultatet e anketimit të dëshmitarëve të GJPN-së, ku përgjithësisht dëshmitarët ishin të kënaqur dhe vetëm një numër i vogël ishin të pakënaqur me kompensimet e marra (Stover 2014).

Figura 4.7 – Kënaqësia prej kompensimeve financiare të dhëna nga Tribunali gjatë procesit të dëshmisë



Në tërësi, në qoftë se “pasiguria ekonomike-shoqërore neto” matet në parametrat e: (1) ndikimit negativ në marrëdhëniet intime; (2) kritikave; (3) izolimit shoqëror; dhe (4) ndikimit ekonomik negativ, ose gjatë kohës së dëshmisë, ose pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë, ose aktualisht, afërsisht një e katërta e të intervistuarve (n=80 ose 26.7%) përgjigjen se si rezultat i dhënies së dëshmisë, ata kanë pasur një ose më shumë nga pasojat e lartpërmendura.⁶⁵

Është e nevojshme që dëshmitarët të jenë të sigurtë në aspektin shoqëror dhe ekonomik, por gjithashtu element thelbësor për dhënien e dëshmisë në Tribunal është siguria fizike dhe pasojat e mundshme ndaj sigurisë personale të dëshmitarit si rezultat i dhënies së dëshmisë.

4.3 Ndikimi i dhënies së dëshmisë ndaj sigurisë

Siguria e viktimave dhe dëshmitarëve është një nga sfidat kyçe për mekanizmat e drejtësisë kalimtare. Për shkak të rëndësisë të jashtëzakonshme të fatit të krerëve politikë dhe ushtarakë të cilët dalin në gjyq, të qeverive të tyre dhe shteteve të tjera të rajonit si edhe të bashkësisë ndërkombëtare, nuk përbën befasi fakti që disa të akuzuar dhe veçanërisht përkrahësit e tyre në vendin e origjinës i kërcënojnë dëshmitarët me qëllim që t’i shkurajojnë prej dhënies së dëshmisë. Rrjedhimisht është shumë e rëndësishme të analizohet perceptimi i dëshmitarëve mbi sigurinë e tyre. Ekzistenca e kërcënimeve, frikësimeve dhe frika dëmtojnë çfarëdo procesi juridik. Ndonëse frika e perceptuar nuk mund të anashkalohej, masat e marra nga SVD-ja duhet të jenë në përpjesëtim me nivelin e

⁶⁴ Para vitit 2001 disa dëshmitarë e kritikuan Tribunalin se kompensimet që jepte nuk mjaftonin për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të tyre që kishin lidhje me udhëtimet për dhënien e dëshmisë (Stover 2005). Në fillim dëshmitarët të cilët kërkonin kompensim për pagat e humbura për shkak të mungesës në punë duhej të: (a) paraqisnin një deklaratë të fitimeve në rast se ishin të vetëpunësuar; ose (b) merrnin një deklaratë me shkrim nga punëdhënësi që vërtetonte se gjatë mungesës së tyre për shkak të dhënies së dëshmisë nuk ishin paguar. Kompensimi bazohej në pagën më të ulët të vendeve përkatëse. Më 2002 shqetësimet lidhur me humbje ekonomike të ndryshme, mashtrimet, si dhe të sigurisë për dëshmitarët, punëdhënësit e të cilëve mund të mos dinin se ata po dëshmonin, çuan në vendosjen e pagesës për pjesëmarrje bazuar në një tarifë të sheshtë sipas vendit të jetesës pavarësisht nga vendi i punës.

⁶⁵ Për të shqyrtuar nëse pasiguria ishte dukshëm më e lartë në grupe të ndryshme etnike, brenda vendeve të ndryshme u analizuan krahasime përcaktuese midis femrave, persona të cilët janë pakicë etnike aty ku jetojnë dhe personave në martesë etnikisht të përziera. Pas përcaktimit të etnicitetit dhe përkatësisë gjinore, personat që jetojnë në bashkësi etnikisht të përziera dhe personat në martesë etnikisht të përziera kanë gjasë më të madhe që të përjetojnë pasoja shoqërore-ekonomike negative.


kërcënimeve. Me fjalë të tjera, një masë e pakët apo e dobët kundrejt një kërcënimi të identifikuar dhe të vlerësuar mund të çojë në pasoja të rënda, kurse një masë tejet e ashpër dhe drastike mund të çojë sërish në pasoja afatgjata të dëmshme.

Në lidhje me vlerësimin e rreziqeve përgjithësisht SVD-ja përdor një qasje të shkallëzuar për pakësimin e rrezikut. Kjo qasje e shkallëzuar në tri faza përfshihet: (1) masa lokale; (2) zhvendosje të përkohshme; dhe (3) zhvendosje të përhershme. Kohët e fundit institucionet e ligjit e të rendit në ish-Jugosllavi kanë përjetuar përmirësime në zhvillimin e kapacitetit të tyre. Menjëherë pas konfliktit, kapaciteti ligjzbatues në rajon ishte shkatërruar dhe midis institucioneve dhe njerëzve ekzistonte mosbesimi i madh. Për fat, gjendja e tanishme ka ndryshuar dhe kallëzimet për kërcënime shpesh mund t'i kalojnë policisë shtetërore për hetim dhe masa të mëtejshme. Kjo bëhet gjithmonë në këshillim me dëshmitarin që raporton problemin dhe ka rezultuar si mënyrë efektive për zgjidhjen e kërcënimeve joserioze apo frikësimeve. Gjithashtu institucionet vendore kanë mundësi më të mirë për ndërmarrjen e hetimeve dhe për identifikimin e burimeve të kërcënimeve. Pavarësisht nga këto, prej përvojës së SVD-së rezultojnë se disa dëshmitarë ende nuk dëshirojnë të angazhojnë autoritetet vendore. Kjo ndodh më së shumti me dëshmitarë nga zona të vogla rurale të cilët i frikësohen keqtrajtimit ose thjesht nuk dëshirojnë të bien në sy.

4.3.1 Dhënia e dëshmisë dhe kërcënimet

Kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore, veçanërisht kërcënimet ndaj sigurisë fizike të dëshmitarëve janë kërcënimet më të rënda, dhe një nga pengesat më të mëdha për institucionet e drejtësisë kalimtare (Cryer 2013; Stover 2005). Ndër këto kërcënime përfshihen kërcënimet gojore dhe fizike para dhënies së dëshmisë e deri tek aktet e dhunës pasi dëshmitari ka dëshmuar.

Në qoftë se dëshmitarët ndihen të pasigurtë kjo cenon aftësinë e Tribunalit për krijimin e një mjedisi të sigurtë për dëshmitarët para dhe pas procesit (Wald 2002). Kërcënimet e para ndaj sigurisë së një dëshmitari mund të fillojnë sapo të tjerët mendojnë se ai/ajo mund të dëshmojë për Tribunalin (Trotter 2013), dhe vazhdojnë gjatë udhëtimit për të dëshmuar si edhe pas kthimit në shtëpi (Stover 2005, 2014; Stepakoff et al. 2014). Kërcënimet nuk u drejtohen vetëm vetë dëshmitarëve, por me gjasë edhe të afërme të tyre e rrethit të tyre shoqëror si edhe pronave të tyre. Ky është një aspekt kyç duke qenë se nga studime të mëhershme është provuar se individët të cilët perceptojnë kërcënime ndaj sigurisë së tyre janë më të ekspozuar ndaj Çrregullimit prej Stresit Pastraumatik dhe depresionit (Basoglu et al 2005), dhe se pasiguria mund të pengojë përpjekjet për ripajtim (Clark 2014).

Figura 4.8 – Kërcënimet ndaj sigurisë sipas kategorive⁶⁶

Të intervistuarit iu përgjigjën pyetjeve mbi sigurinë e tyre në tërësi dhe mbi natyrën e kërcënimeve me të cilat mund të jenë përballur për shkak të dëshmisë së tyre (Figura 4.8). Afërsisht 14.7% (n=44) e 300 të intervistuarve raportojnë kontaktim ose kërcënim që ka lidhje me dëshminë e tyre. Kërcënimet e vetëkallëzuara erdhën më së shumti nga të intervistuar të cilët kishin dëshmuar gjatë periudhës 2001-2006 (nuk tregohen rezultate). Numrin më të madh të kërcënimeve e përbënin kërcënimet gojore pas dhënies së dëshmisë (n=25). Nga 44 të intervistuar të cilët kishin raportuar probleme sigurie, 23 bënë të ditur se para dhënies së dëshmisë ata (ose të afërmit e tyre) ishin kontaktuar nëse duhej apo nuk duhej të dëshmonin.

Gjatë shqyrtimit të kërcënimeve fizike dhe gojore ndaj dëshmitarëve, nga 25 të intervistuarit të cilët ishin kërcënuar gojarisht pas dhënies së dëshmisë, 13 gjithashtu theksuan se kërcënimet gojore përfshinin edhe kërcënime fizike (nuk tregohen rezultate). Si rrjedhim, ndonëse kërcënimet gojore ishin më të shpeshta, gjysmën e kohës ato u pasuan edhe me kërcënime më të rënda fizike. Një problem që kishin avokatët e dëshmitarëve ishte se 13 dëshmitarë u kërcënuan fizikisht dhe gojarisht dhe katër prej tyre bënë të ditur se kishte pasur dëmtime ose lëndime ndaj tyre ose të afërmit si pasojë e drejtpërdrejtë e dhënies së dëshmisë. Të katër dëshmitarët ishin meshkuj, tre kishin qenë dëshmitarë të Prokurorisë dhe një i Mbrojtjes.


Ka pak studime në lidhje me identitetin e kërcënuesve dhe mënyrën e kërcënimit të dëshmitarëve përveç rasteve të njohura në proceset gjyqësore për krime lufte (Cryer 2014). Ruajtja e drejtpeshimit midis mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të të drejtave të akuzuarve për gjykim të drejtë e të paanshëm kërkon që gjykatat ndërkombëtare të kenë kompetenca vendimmarrëse që ndihmojnë në mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve dhe pakësojnë mundësinë e rrezikut nga individët të cilët janë kundër dëshmisë së dëshmitarit (Brady 2014). Ky është një problem me të cilin janë përballur TPNJ-ja dhe gjykatat e tjera, duke qenë se kanë ndodhur incidente të kërcënimit të dëshmitarëve, publikimi i paautorizuar i të dhënave sekrete të identitetit të dëshmitarëve dhe e drejta më e përgjithshme e publikut për t'u informuar mbi proceset gjyqësore për krimet e luftës (Trotter 2013; Haider and Welch 2008; Elias-Bursać 2015).

Për të kuptuar më mirë “kërcënimet” dhe kryerjen e tyre, të intervistuarit të cilët raportuan se ndaj tyre ishin bërë kërcënime para apo pas dhënies së dëshmisë (n=33) iu përgjigjën pyetjeve për identifikimin e mëtejshëm të individëve të cilët kishin bërë kërcënimet, mënyrën si edhe formën e tyre dhe çfarë ishte thënë (Figura 4.9). Nga të intervistuarit të cilët u përgjigjën se kishin pasur kërcënime (kërcënime para

⁶⁶ Duhet mbajtur parasysh se ka kategori me elemente të përbashkëta midis tyre sepse dëshmitarët patën kërcënime të shumta në mënyra të ndryshme. Gjithashtu tre dëshmitarë të ndryshëm raportuan tri kategori të tjera të pasojave negative që vinin nga dhënia e dëshmisë: (1) thirrje telefonike natën vonë; (2) hetim penal i të intervistuarit; dhe (3) izolim nga të tjerët në lidhje me tema të caktuara (në grafik nuk tregohen rezultate).


dhe kërcënime fizike ose gojore më pas), 30 të intervistuar identifikuan personin ose grupet që ata i konsideronin përgjegjës. Vetëm tre të intervistuar thanë se kërcënimet ishin “anonime”. Të intervistuarit theksuan se të akuzuarit (përfshirë edhe rrethin e tyre familjar dhe shoqëror) shpesh kishin lidhje me kërcënimet, mirëpo edhe se këto kërcënime shpesh erdhën edhe nga “persona jo të përkatësisë sime etnike”. Këto ishin dy kategoritë me numër më të madh përsa u përket kritikave dhe izolimit shoqëror (shih Figurën 4.4 më lartë).

Figura 4.9 – Identiteti i kërcënuesve sipas të intervistuarve



Kërcënimet ndaj sigurisë fizike të thëna sy më sy janë drejtpërdrejti më të prekshme dhe më frikësuese për dëshmitarin (Stover 2005; Clark 2014). Të intervistuarit iu përgjigjën pyetjeve mbi mënyrën sesi ishin kërcënuar (Figura 4.10). Më shumë se një e treta e kërcënimeve ishin bërë ose personalisht në telefon, ose nëpërmjet shokëve dhe të njohurve. Pesë dëshmitarë u përgjigjën se ata ishin kërcënuar personalisht dhe ishin kërcënuar *nëpërmjet telefonit*, kurse tetë dëshmitarë të tjerë thanë se kishin pasur kërcënime nëpërmjet dy ose më shumë mjeteve të komunikimit (p.sh. nëpërmjet postës elektronike ose telefonit).

Figura 4.10 – Format e kërcënimeve të bëra




4.3.2 Trajtimi i problemeve të kërcënimeve

Dëshmitarët e kërcënuar mund ta kenë të vështirë të kërkojnë ndihmë, veçanërisht kur kërcënimet vijnë prej individëve me pushtet. Në rastet kur të intervistuarit nuk kishin kontaktuar asnjë person apo institucion pas kërcënimit (n=22), ata u pyetën pse nuk e kishin bërë këtë. Një i intervistuar tha se nuk kishte kuptim të kontaktoheshin autoritetet sepse kërcënimet ishin anonime, kurse një tjetër nuk i kishte kontaktuar autoritetet sepse nuk u besonte. Një i intervistuar tjetër shprehu vendosmëri duke deklaruar “Sepse unë nuk jam nga ata që frikësohen lehtë.” Një i intervistuar u shpreh në mënyrë filozofike se ai nuk kontaktoi askënd “Për arsye se teknikisht askush nuk mund të mbrohet. Kryesorja është nëse ke apo nuk ke frikë.”

Nga të intervistuarit të cilët ishin kërcënuar dhe të cilët faktikisht kontaktuan autoritetet (n=22), shumica e tyre shprehën kënaqësi për masat e marra nga autoritetet e kontaktuar (Figura 4.11). Në rast se kërcënohen, ka më së shumti të ngjarë që të intervistuarit të kontaktojnë SVD-në, ose drejtpërsëdrejti në Hagë, ose nëpërmjet zyrave rajonale. Kontakti me SVD-në dhe zyrtarët vendorë jep rezultate më të kënaqshme, kurse me Prokurorinë e TPNJ-së jo dhe aq të kënaqshme.

Figura 4.11 – Organizatat e kontaktuar dhe kënaqësia e të intervistuarve



Në tërësi, duke hedhur një vështrim në problemet e sigurisë me të cilat përballen dëshmitarët sërish del një grup i konsiderueshëm të intervistuarish (nga 10-15% në varësi të kërcënimit përkatës) të cilët kanë pasojat afatshkurtra dhe afatgjata pas dhënies së dëshmisë.⁶⁷ Vetëm gjysma e dëshmitarëve të cilët kishin raportuar kërcënime, kontaktuan autoritetet dhe ndër këta vetëm gjysma dhanë përgjigje të kënaqshme, ndërsa gjysma tjetër kishte përgjigjet të pakënaqur, nuk dhanë mendim, ose nuk u përgjigjën. Fakti që aktualisht ka ende dëshmitarë në një numër të vogël, por jo të papërfillshëm të cilët ndihen ende të pasigurtë për shkak të dhënies së dëshmisë, përbën një faktor të rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh nga gjykatat ndërkombëtare në lidhje me pasojat ndaj dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë.

4.3.3 Masat mbrojtëse në sallën e gjyqit

Mënyra kryesore nëpërmjet së cilës TPNJ-ja është përpjekur të fuqizojë sigurinë e dëshmitarëve që dëshmojnë është caktimi i masave mbrojtëse në sallën e gjyqit bazuar në Rregullën 75 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit. Vetëm një gjykatës ose një Dhomë mund të urdhërojë masa për privatësinë dhe mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Janë disa kategori masash mbrojtëse të mundshme në sallën e gjyqit: përdorimi i pseudonimit, redaktimi i emrit dhe i të dhënave identifikuese të dëshmitarit, shformimi i zërit, shformimi i fytyrës, dhënia e dëshmisë në seancë me dyer të mbyllura,

⁶⁷ Kërcënime të tilla nuk duhen minimizuar, mirëpo rezultatet tregojnë një realitet shumë të ndryshëm nga shqetësimet në lidhje me procedimin penal të krimeve të luftës në gjykatat e vendeve përkatëse ku kërcënimet ndaj sigurisë janë “të përhapura” dhe masat për përballimin e këtyre kërcënimeve konsiderohen të pamjaftueshme (OSCE 2010, 13; Orentlicher 2008; Zoglin 2005).

dhe dhënia e dëshmisë nëpërmjet transmetimit të mbyllur filmik.⁶⁸ Dhoma Gjyqësore ka të drejtë të mos miratojë kërkesa për masa mbrojtëse në sallën e gjyqit dhe si pasojë dëshmitari mund të refuzojë të japë dëshminë. Varësisht nga rrethanat individuale, dëshmitari mund të hiqet nga lista e dëshmitarëve, ose të detyrohet të dëshmojë (të urdhërohet për paraqitje), pa masa mbrojtëse në sallën gjyqësore.

SVD-ja mund të fuqizojë sigurinë e dëshmitarëve edhe nëpërmjet një programi mbrojtës për dëshmitarët të cilët përballen me rrezik më të lartë ndaj sigurisë së tyre.⁶⁹ Në rrethanat kur vlerësohet se kërcënimi është shumë i afërt, i madh dhe kërkon reagim të menjëhershëm, ekziston mundësia për zhvendosjen e përkohshme të dëshmitarit nga ajo zonë. Ky hap përbën përshkallëzim të konsiderueshëm dhe SVD-ja e ndërmerret këtë masë vetëm në rrethanat më urgjente. Zhvendosja e një dëshmitari nga vendbanimi dhe vendi i punës është një masë drastike që shkakton probleme të mëdha. SVD-ja bën çmos që koha e shpenzuar nga dëshmitari gjatë zhvendosjes së përkohshme të jetë sa më e shkurtër.


Në rrethanat kur rreziku vazhdon dhe SVD-ja e konsideron të pasigurt kthimin e dëshmitarit në vendbanimin e vet, SVD-ja mund të kërkojë zhvendosje të përhershme. Kjo është një masë e skajshme dhe zbatohet vetëm në rast se nuk ekziston asnjë masë tjetër që zgjidh në mënyrë të kënaqshme problemin e kërcënimit. Në situata të tilla, TPNJ-ja mbështetet në dashamirësinë e shteteve për pranimin dhe ngulimin e dëshmitarëve të zhvendosur (dhe familjes së tyre të afërt), proces i përcaktuar përmes marrëveshjeve zyrtare.

Masat mbrojtëse në sallën e gjyqit sjellin në vëmendje të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm me theks të veçantë nëse i akuzuari do të ushtrojë të drejtën të ballafaqohet publikisht me dëshmitarët, apo nëse do të ndërhyhet në këtë të drejtë prej nevojës për mbrojtjen e sigurisë dhe privatësisë së dëshmitarit. Si rrjedhojë, janë ngritur shqetësime nëse përdorimi i lirshëm ose i shtrënguar i masave mbrojtëse në sallën e gjyqit cenon drejtësinë (Trotter 2013; Brady 2014). Me gjithë debatin në lidhje me masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, më shumë se dy të tretat (69.4%) të paraqitjeve të dëshmitarëve në Tribunal bëhen *pa* masa mbrojtëse në sallën e gjyqit (Figura 4.12).

⁶⁸ **Pseudonim:** kod i përdorur në vend të emrit të vërtetë të dëshmitarit dhe fshirja e emrit dhe të dhënave identifikuese të dëshmitarit nga të gjitha dokumentet gjyqësore publike – të dhënat identifikuese mund të mbyllen me vulë ose të mos përfshihen; **shformimi i zërit:** ndryshimi i tingullit të zërit të dëshmitarit; **shformimi i fytyrës:** ndryshimi ose thërrmijëzimi i imazhit filmik të pamjes së dëshmitarit; **seancë me dyer të mbyllura:** dëshmitari deponon në një seancë gjyqësore të mbyllur për publikun (*in camera*) ku në sallën e gjyqit janë të pranishëm vetëm gjykatësit, avokatët, të akuzuarit dhe nëpunësit gjyqësore dhe transkriptet mbahen të mbyllura me vulë; **dhënia e dëshmisë nëpërmjet transmetimit të mbyllur filmik:** Në këtë rast dëshmitari nuk e sheh të akuzuarin sepse ai/ajo dëshmon nga një dhomë tjetër. Dëshmitari mund të dëgjojë çfarë thuhet në sallën e gjyqit dhe gjykatësit e shohin dëshmitarin në ekranet mbi tavolinat e tyre.


⁶⁹ Në Studimin Pilot nuk u përfshinë dëshmitarët e zhvendosur dhe dëshmitarët me rrezik më të lartë ndaj sigurisë së tyre. Nëpërmjet programit për zhvendosje, SVD-ja ka zhvendosur më pak se një për qind të dëshmitarëve. Dëshmitarët kanë të drejtë të emigrojnë me dëshirën e tyre në një rajon apo në një vend tjetër.

Figura 4.12 – Masat mbrojtëse në sallën e gjyqit të të intervistuarve



TPNJ-ja miratoi masa mbrojtëse në sallën e gjyqit për 86 të intervistuar (28.7%) në një ose më shumë nga paraqitjet e tyre. Nga këta 64 përmendën se kishin kërkuar masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.⁷⁰ Tetë të intervistuar raportuan se kërkesa e tyre për masa mbrojtëse në sallën e gjyqit nuk ishte miratuar (shkalla e marrjes së miratimit për Masa Mbrojtëse ishte 87,5%).⁷¹ Masa mbrojtëse më e kërkuar prej dëshmitarëve ishte shformimi i fytyrës dhe pseudonimi, pasuar prej seancave të mbyllura dhe shformimit të zërit (Figura 4.13). Të intervistuarit bënë të ditur se më e ngjashme ishte që Dhomat të miratonin pseudonim dhe shformim të fytyrës (pseudonim-94.1% dhe fytyra-91.2%), kurse shformimi i zërit u miratua në masën 45.8% dhe ndër kërkesat për seanca të mbyllura miratimi ishte më pak i shpeshtë (vetëm 12.5% e këtyre kërkesave u miratuan) (nuk tregohen rezultate).⁷²

Figura 4.13 – Masa mbrojtëse në sallën e gjyqit të kërkuara sipas kategorive




⁷⁰ Arsye për ndryshimet midis perceptimeve të të intervistuarve dhe të dhënave të TPNJ-së mund të jetë formulimi i pyetjes e cila është si vijon “a kërkuat masa mbrojtëse për dhënien e dëshmisë suaj?” Ndoshta të intervistuarit kanë menduar se për arsye se ata vetë nuk kanë kërkuar masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, përgjigjja duhet të jetë jo, fakt që shpjegon numër më të pakët përgjigjesh se të dhënat zyrtare të TPNJ-së. Pavarësisht nga sa më sipër, përfundimet mbështesin rëndësinë kyçe që ka informimi i plotë i dëshmitarëve mbi masat mbrojtëse në sallën e gjyqit, mbi mundësinë që ata kanë për të kërkuar masa të tilla, dhe mbi realitetin që TPNJ-ja mund të miratojë masa mbrojtëse në sallën e gjyqit edhe kur vetë dëshmitarët nuk bëjnë kërkesë konkrete.

⁷¹ Duhet rikujtuar se dëshmitarët mund të dëshmojnë në disa procese gjyqësore dhe se masat e tyre mbrojtëse në sallën e gjyqit mund të ndryshojnë (ndonëse nuk është e zakonshme) nga një proces në tjetrin dhe madje edhe gjatë një procesi.

⁷² Në tërësi, për njëzet të intervistuar, pati ndryshim të masave mbrojtëse në sallën e gjyqit, ose gjatë një procesi gjyqësor ose në një proces tjetër ku ata dëshmuan (ndër të cilat modifikim, shfuqizim ose shtim të këtyre masave, ku për njëmbëdhjetë dëshmitarë masat u pakësuan kurse për nëntë dëshmitarë pati shtim të masave mbrojtëse në paraqitjet e mëtejshme).

Ndaj Tribunalit ka pasur kritika për mosmarrjen e masave mbrojtëse në sallën e gjyqit duke i bërë dëshmitarët të ndiheshin të pambrojtur si gjatë dhënies së dëshmisë, po ashtu edhe pas kthimit në shtëpi (Stover 2005; Clark 2014). Për këtë arsye për Studimin Pilot kishte rëndësi të përcaktohej nëse masat mbrojtëse në sallën e gjyqit të miratuara për dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmisë dhe pas kthimit të tyre në shtëpi u dhanë atyre ndjenjën e sigurisë. Të intervistuarit raportuan se ata ndiheshin mjaft të sigurtë si gjatë dhënies së dëshmisë, po ashtu edhe pas kthimit të tyre në shtëpi (Figura 4.14) sa herë që Dhomat kishin miratuar masa mbrojtëse në sallën e gjyqit. Duke e krahasuar me ndjenjën e sigurisë që kanë dëshmitarët aktualisht, 15 nga 56 të intervistuar me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit bënë të ditur se në gjashtë muajt e fundit ata ishin ndjerë shumë të pasigurtë (n=9), ose deri diku të sigurtë (n=6) (nuk tregohen rezultate).

Figura 4.14 – Masat mbrojtëse në sallën e gjyqit dhe ndjenja e sigurisë në tërësi



Për të parë nëse kishte lidhje statistikisht të qenësishme midis sigurisë fizike njerëzore në tërësi dhe përkatësisë etnike (me fjalë të tjera, a përjetuan të intervistuarit ndonjë pasojë negative ndaj sigurisë ndër të cilat kërcënime, vandalizëm, etj.), kërcënimet ndaj sigurisë kishin më shumë të ngjarë të bëheshin ndaj boshnjakëve dhe pjesëtarëve të pakicave etnike në vendet ku jetonin. Gjithashtu rritja e numrit të paraqitjeve të dëshmitarëve në proceset gjyqësore shtoi edhe gjasën e përjetimit të kërcënimeve të çfarëdollojshme (shih edhe Horn, Charters, dhe Vahidy 2009; Charters et al. 2008).

Një shumicë e gjerë e të intervistuarve u shprehën se ata ndihen më të sigurtë aktualisht (duhet mbajtur parasysh se gjashtë dëshmitarë të tjerë nuk ndihen aq të sigurtë aktualisht sa ndiheshin pas dhënies së dëshmisë). Rezultatet e Studimit Pilot gjithashtu shkojnë në mbështetje të konstatimit të nxjerrë nga hulumtime të tjera, se Dhomat nuk miratojnë shumë shpesh masa mbrojtëse në sallën e gjyqit (Cryer 2014), dhe se këto mund të ndryshojnë gjatë procesit të deponimit të dëshmitarëve. Së fundi, hulumtime të tjera nuk kanë analizuar ndryshimet midis dëshmitarëve që dëshmojnë vetëm në një proces dhe dëshmitarëve të cilët dëshmojnë në disa procese. Është e rëndësishme që në të ardhmen këto ndryshime të analizohen, sepse shtimi i herëve të dhënies së dëshmisë mund të çojë në një gjasë më të madhe të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sigurisë së dëshmitarit.


4.3.4 Emigrimi vullnetar

Një tregues i fundit i sigurisë është nëse dëshmitarët janë zhvendosur si pasojë e dhënies së dëshmisë. Rezultatet e Studimit Pilot bazohen në zhvendosjet vullnetare të një familjeje në një vendndodhje të ndryshme. Ndonëse TPNJ-ja gëzon kompetencë dhe zotëron burime për zhvendosjen e dëshmitarëve, kjo ndodh jashtëzakonisht rrallë. Për më tepër, dëshmitarët e zhvendosur nuk janë përfshirë në Studimin Pilot për hir të sigurisë së tyre. Njëzet e katër të intervistuar raportuan se ishin zhvendosur ose brenda vendit të tyre (n=17), në një vend tjetër (n=4), ose ishin zhvendosur edhe brenda, edhe jashtë

vendit të tyre (n=3). Pesë të intervistuar bënë të ditur se fakti që kishin dhënë dëshmi në TPNJ ishte një faktor i rëndësishëm që kishin marrë parasysh në marrjen e vendimit për zhvendosje ose për emigrim, kurse nëntëmbëdhjetë të tjerë u shprehën se ishte “jo i rëndësishëm”.⁷³ Sikurse theksohet më poshtë, një grup i vogël qartësisht përballen me rrezik shumë real dhe që përlligj zhvendosjen (Clark 2014).

Për një shikim më të thellë të këtyre vendimeve, të intervistuarit u pyetën për arsyen e zhvendosjes. Sikurse shihet nga Figura 4.15, arsyet e emigrimit të dëshmitarëve në rrethanat pas një konflikti janë komplekse. Ndonëse shumica e dëshmitarëve bënë të ditur se dhënia e dëshmisë ishte “jo e rëndësishme” për emigrimin e tyre, dëshmitarët në fakt bëjnë të qartë se ndryshimi i kushteve të jetesës së tyre ishte i nevojshëm kryesisht për shkak të rrethanave të gjendjes pas konfliktit. Ndonëse arsyeja mbizotëruese ishte “bashkim me familjen”, të rëndësishme ishin edhe arsye të tjera si nisja e një jete të re, siguria, kushtet ekonomike, mundësitë më të mira të punësimit dhe një ambient i shëndetshëm. Gjithashtu, në lidhje me emigrimin ekzistojnë edhe arsye që kanë lidhje me problemet themelore që burojnë prej luftërave në ish-Jugosllavi ndër të cilat ngjashmëria kulturore, përpjekja për të shmangur kriminelët e luftës dhe pamundësia për rikthim në jetesë normale.

Figura 4.15 – Arsyet e emigrimit të të intervistuarve




⁷³ Nga të intervistuar të cilët kishin ndryshuar vendbanim, shumica ishin zhvendosur vetëm një herë, mirëpo pesë dëshmitarë raportuan se ata ishin zhvendosur dy ose më shumë herë, ndër të cilët njëri ishte zhvendosur pesë herë pas dhënies së dëshmisë. Askush nga dëshmitarët të cilët kishin ndryshuar vendbanim më shumë se një herë, nuk tha se në vendimin e tyre për zhvendosje kishte pasur rëndësi dhënia e dëshmisë.

4.3.5 Gjendja e sigurisë aktuale

Ndoshta një nga pyetjet më të rëndësishme në lidhje me sigurinë e dëshmitarëve është nëse të intervistuarit ndihen *përgjithësisht* të sigurtë aktualisht. Bie në sy se një shumicë e madhe e të intervistuarve përgjigjen se ndihen shumë të sigurtë (64%), ose disi të sigurtë (13%) aktualisht. Megjithatë, 13% e të intervistuarve aktualisht ndihen të pasigurtë ose shumë të pasigurtë (Figura 4.16).⁷⁴ Edhe pse një numër i madh dëshmitarësh ndihen të sigurtë, është e rëndësishme të pohohet se pavarësisht nga numri i dëshmitarëve, kërcënimet ndaj sigurisë së dëshmitarëve vënë në rrezik të drejtpërdrejtë drejtësinë dhe procesin e pajtimit (Bartlett 2016; Spini et al. 2013; Hutchison and Bleiker 2006).

Figura 4.16 – Ndjenja e përgjithshme e sigurisë aktualisht



Përmbledhje

Siguria e dëshmitarëve të TPNJ-së përmban elemente të rëndësishme morale dhe politike për Tribunalin, SVD-në dhe veçanërisht për ata të cilët përjetojnë kërcënime ndaj sigurisë së tyre shoqërore, ekonomike dhe fizike. Ndonëse shumica e gjerë e dëshmitarëve nuk kishin përjetuar dëm personal, ekonomik dhe ndaj sigurisë së tyre si pasojë e dhënies së dëshmisë, numri i dëshmitarëve të cilët u përballën me pasoja negative për shkak të dhënies së dëshmisë në TPNJ, është i konsiderueshëm.

Ndër këto pasoja negative përfshihen kritikrat, izolimi shoqëror, pasoja ekonomike, kërcënime ndaj sigurisë së tyre fizike dhe të familjeve të tyre. Dëshmitarët bënë të qartë se kërcënimet vijnë nga burime të ndryshme brenda ose jashtë përkatësisë së tyre etnike, përfshirë edhe të akuzuarit (dhe rrethin e tyre shoqëror ose familjar) si dy grupet kryesore përgjegjëse për kërcënimet. Një shumicë e gjerë e dëshmitarëve raportuan se aktualisht ndihen të sigurtë (pavarësisht nga mungesa ose prania e masave mbrojtëse në sallën e gjyqit), mirëpo nuk del qartë nëse ndjenja e sigurisë ka të bëjë me kohën e kaluar që nga hera e fundit të dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit.

⁷⁴ Në bazë të një modeli paraprak për përcaktimin e grupeve që ndihen më pak të sigurtë—sipas përkatësisë gjinore, vetidentifikimit etnik, martesave etnikisht të përziera në familjen e ngushtë dhe pakica etnike ose fetare në bashkësinë ku jetojnë, gjasa më e madhe e ndjenjës së pasigurisë aktualisht është te femrat dhe pjesëtarë të pakicave etnike ose fetare në bashkësinë ku jetojnë.

Kapitulli 5 – Gjendja shëndetësore mendore dhe fizike dhe ndikimi i dhënies së dëshmisë

Përveç kërcënimeve ndaj sigurisë ekonomike dhe njerëzore, dhënia e dëshmisë në një gjykatë për krime lufte mund të shkaktojë edhe pasoja afatgjata fizike dhe mendore (Hamber 2009). Ky kapitull përshkruan gjendjen fizike dhe psikologjike të dëshmitarëve dhe mendimet e dëshmitarëve mbi pasojat e dhënies së dëshmisë në mirëqenien e tyre. Së pari analizohen traumat e dëshmitarëve, ndikimi i këtyre traumave dhe gjendja e përgjithshme shëndetësore e dëshmitarëve. Në ndihmë të debatit ekzistues nëse dhënia e dëshmisë përbën moment çlirues apo përjetim ritraumatizues (Mendeloff 2009; Hamber 2009; Doak 2011; Brounéus 2010; Stover 2005), ky kapitull analizon reagimet e dëshmitarëve para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë së bashku me faktorë të jashtëm të cilët patën ndikim mbi ta gjatë kësaj periudhe kritike. Gjithashtu analizohet edhe koncepti relativisht i ri “rraskapitje prej dëshmisë” në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me deponimin e disahershëm. Së fundi, ky kapitull përqendrohet në strategjitë përbaluese të dëshmitarëve kundrejt situatave të vështira si edhe në kënaqësinë e tyre prej jetës së tanishme dhe aspiratat e tyre për të ardhmen.

Temat e trajtuara në këtë kapitull kanë lidhje me pyetjet në pjesën D të pyetësorit (Shtojca III).

5.1 Mirëqenia mendore dhe fizike

Para se të shqyrtohet mirëqenia mendore dhe fizike, është e rëndësishme të kuptohen përjetimet e dëshmitarëve nga lufta. Sikurse disa dëshmitarë i kanë treguar SVD-së, me kalimin e kohës dhe duke qenë se njerëzit rreth tyre duan të heqin nga mendja ngjarjet e luftës, shkëmbimi i përvojave nga lufta nuk është gjithmonë i mirëpritur. Disa kanë vështirësi që të shprehen në lidhje me çfarë kanë parë dhe kanë vuajtur, ose thjesht nuk duan të tregojnë për përvojat e tyre sepse nuk duan që të afërmit më të ngushtë të dinë çfarë u ka ndodhur.

Me të ardhur në Hagë, në raste të shpeshta dëshmitarët e shfrytëzuan mundësinë që të flisnin për përjetimet dhe ndjenjat e tyre me punonjësit e SVD-së, ose me dëshmitarë të tjerë, sepse menduan se ishin në një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm në kohën e duhur. Shumë punonjës të SVD-së rikujtojnë se tregimet e dëshmitarëve ishin të larmishme ku përmbledheshin kujtimet e bukura po ashtu si edhe tmerret e përjetuara. Në momentet e nxjerrjes së kujtimeve të dhimbshme, disa dëshmitarë thanë se ndjenin sikur po i rijetonin ato ngjarje dhe provuan dhimbje të fortë shpirtërore dhe fizike që ishte pasojë e drejtpërdrejtë e lëndimeve dhe përjetimeve të atëhershme dhe patën probleme me ushqimin dhe fjetjen. Disa nga dëshmitarët thanë se edhe pas kaq shumë vitesh, kujtimet dhe pamjet ishin kaq të gjalla sa ata ndjenin sikur ishin të vërteta dhe po ndodhnin në atë moment. Disa të tjerë raportuan tjetër lloj stresi dhe pati edhe dëshmitarë të cilët thanë se nuk kishin probleme të tilla.


5.1.1 Trauma dhe pasojat prej saj

Prokuroria, Mbrojtja dhe Dhomat Gjyqësore zakonisht i ftojnë dëshmitarët e tyre për të dëshmuar mbi përvojat e tyre prej luftës. Ndër këto përjetime apo përvoja të mundshme janë edhe mungesa e skajshme e ushqimit dhe shërbimit mjekësor, shkatërrimi i shtëpive të tyre dhe i bashkësisë ku jetojnë, mbajtja si i burgosur, ndarja nga të afërmit dhe zhdukja e të afërmeve, rrahje të rënda, dhunë seksuale dhe përdhunime, të qenët dëshmitar në keqtrajtimin, torturimin dhe vrasjen e njerëzve të tjerë, ikje e rrezikshme dhe mërgim i detyruar. Këto ngjarje janë vetë arsyeja e themelimit të Tribunalit dhe nevojës për dëshmitë e dëshmitarëve.

Traumat e pësuar nga këta dëshmitarë janë të forta e të konsiderueshme ashtu sikurse ilustron edhe prej të dhënave. Në konfirmim të një nga studimeve më të gjera deri më sot në këtë rajon ku u analizuan

përjetimet nga lufta⁷⁵, dëshmitarët e këtij Studimi Pilot kanë pësuar trauma fizike dhe mendore të skajshme. Të intervistuarve iu kërkua të përgjigjeshin nëse kishin: “Përjetuar”; “Parë”; “Dëgjuar tregime” ose “Asgjë” në lidhje me kategori të ndryshme traumash.⁷⁶ Rezultatet janë ndarë në dy figura: Figura 5.1 përmban numrin e përgjigjeve të atyre që zgjidhën “Përjetova” dhe/ose “Pashë”, kurse Figura 5.2 përmban numrin e përgjigjeve “Dëgjova tregime” ose “Asgjë”.⁷⁷ Për kategoritë “Pashë” dhe “Dëgjova tregime” rezultatet renditen nga numri më i lartë te ai më i ulët.


Figura 5.1 – Traumat e kohës së luftës të përjetuara dhe të para nga të intervistuarit



⁷⁵ Projekti i Anketimit Social për Evropën Juglindore jep të dhëna nga anketimet sociale për studimin sociologjik dhe të historisë sociale të Ballkanit Perëndimor. Anketimi i kryer nga Universiteti Norvegjez për Shkencë dhe Teknikë i periudhës 2003-2004, mundëson analiza bazë të ndryshimeve të përgjithshme midis vendeve dhe atyre ndëretnike brenda rajonit dhe përmban të dhëna për 23000 të anketuar me 1000 ndryshore dhe 32 mostra të ndryshme. Ky informacion u grumbullua nëpërmjet një instrumenti anketues 75-minutësh dhe intervistave. <http://www.svt.ntnu.no/iss/ringdalweb/SEESSP%20Surveys.html>

⁷⁶ Studimi Pilot u mbështet në një variant të modifikuar të Pyetësorit për Trauma të Harvardit i cili rendit ngjarjet ose veprimtaritë tipike në kohë konfliktesh (Palić et al. 2105). Për më shumë informacion shih <http://hprt-cambridge.org/screening/harvard-trauma-questionnaire/>.

⁷⁷ Shih pyetjen D24 në pyetësor (Shtojca III) për përkufizimet *Përjetova*, *Pashë*, *Dëgjova tregime* dhe *Asgjë*.

Figura 5.2 – Njohuritë mbi përjetimet nga lufta të të intervistuarve


Bie në sy se disa përjetime nga koha e luftës ishin mbizotëruese ndër të intervistuarit e Studimit Pilot ku më shumë se 200 të intervistuar përmendën granatimet, vdekjen që ishte afër, apo rrezikun që i kanosej jetës së tyre. Gjithashtu 185 të intervistuar bënë të ditur se kishin përjetuar situata luftimesh si edhe mungesë uji dhe ushqimesh. Faktikisht të intervistuarit janë përballur me trauma dhe përvoja të forta nga lufta që tregojnë se ata kanë vuajtur shumë gjatë luftës. Gjithsej 300 të intervistuarit raportuan se kishin përjetuar drejtpërsëdrejti 2884 ngjarje (nga këto për 2813 pati pyetje konkrete në pyetësor dhe pjesa tjetër e ngjarjeve u përshkruan shkurtimisht në përgjigjet e të intervistuarve). Shihet qartë se këta njerëz kanë vuajtur jashtëzakonisht shumë.

Figura 5.2 tregon përgjigjet e të intervistuarve të cilët ose kishin dëgjuar tregime, ose nuk kishin përjetuar, porë apo dëgjuar tregime për asnjë prej këtyre ngjarjeve. Bie në sy se rezultatet në këtë figurë janë në shifra më të ulëta se në Figurën 5.1, që tregon se gjasa e përjetimeve ose dëshmime të drejtpërdrejta të të intervistuarve mbi dhunën dhe shkatërrimin e luftës, është shumë më e madhe. Me gjithë traumat e mëdha që kanë vuajtur dëshmitarët e zgjedhur për Studimin Pilot, një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve nuk kishin përjetuar, porë, apo madje as dëgjuar për ngjarjet më të shpeshta në luftë. Për shembull, megjithëse dhuna seksuale ishte e përhapur gjatë luftërave në ish-Jugosllavi dhe TPNJ-ja e media u kushtuan vëmendje këtyre krimeve, 157 të intervistuar thanë se ata nuk dinin asgjë për kryerjen e këtyre krimeve nga ndonjë i njohur dhe 98 të intervistuar thanë se nuk dinin asgjë për kryerjen e këtyre krimeve nga të panjohur. Me gjithë traumat prej së cilave kanë vuajtur një shumicë e madhe e të intervistuarve, duket se është edhe një numër i konsiderueshëm individësh të cilët kanë shumë pak dijeni për dhunën dhe shkatërrimet e këtyre luftërave. Për 25 pyetje të ndryshme u morën gjithsej 1601 përgjigje.

Gjithashtu dëshmitarëve iu dha mundësia të jepnin shkurtimisht përgjigje “të tjera”, nëpërmjet pjesëve me përgjigje jo të prera për kategori konkrete traumash të përjetuara prej tyre, duke u bazuar në


parimin se çdo konflikt është unik dhe se kategori të caktuara dhune mund të mos dalin nëpërmjet pyetjeve standarde të pyetësorit. Faktikisht kjo pyetje nxiti përgjigje të shpeshta - vetëm tri pyetje “të tjera” me përgjigje të shkurtra nxitën përgjigje më të shumta (konkretisht: arsytet për dhënien e dëshmisë, strategjitë përballuese të përdorura, dhe problemet psikologjike/fiziologjike). Afërsisht 20% e të intervistuarve, nëpërmjet përgjigjeve jo të prera ofruan informacion afërsisht për 61 ngjarje të tjera traumatike nga koha e luftës të cilat ata i kishin përjetuar ose i kishin parë (nuk tregohen rezultate). Shumë të intervistuar përmendën ngjarje si sulmet ajrore, kushtet e kohës së luftës, detyrimin për të marrë pjesë në ekzekutime dhe operacionet e ushtrisë dhe të paraushtarakëve. Më të dhimbshme ishin të dhënat e të intervistuarve të cilët rikujtuan pamje të gjalla që ishin tejet tronditëse. Të intervistuarit ofruan një kontekst unik të konfliktit në ish-Jugosllavi dhe traumat e rënda që përjetuan kur treguan vrasjen e të afërme të tyre në dhomën përbri, ekzekutimin e një të moshuari me plumb në kokë, apo vrasjen e një foshnjeje nga shtypja e çizmes.⁷⁸

Nuk ekziston rreziku i teprimit të ndikimit të këtyre traumave në shëndetin fizik dhe mendor të personave të cilët “bëhen dëshmitarë”. Kjo do të thotë se jo vetëm që ata vuajtën trauma të thella me të cilat u duhet të përballen çdo ditë, por vetë fakti i deponimit në një ose më shumë procese gjyqësore i bëri t’u riktheheshin kujtimeve të dhimbshme, të përballeshin me periudhat e pritjes (të cilat mund të zgjasin me vite) përpara se të thirreshin për të dëshmuar dhe të përballeshin me pasojat pas dhënies së dëshmisë. Pas përshkrimit të traumave të luftës së përjetuara nga këta individë, më poshtë trajtohen strategjitë përballuese në rrethana të tilla.

Ndikimi afatshkurtër dhe afatgjatë i dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët e TPNJ-së ka qenë temë që ka ngjallur interes që prej fillimit të Tribunalit (Wald 2002). Punonjësit e SVD-së përmendin se gjatë të gjithë kohës që kanë punuar me dëshmitarë, kanë vëzhguar se çdo person është i ndryshëm në aspektin e nevojave dhe të qëndrueshmërisë. Disa dëshmitarë janë më të thyeshëm, kurse të tjerë janë çuditërisht të pavarur dhe të përmbajtur megjithëse u duhet të tregojnë ngjarje të tmerrshme. Studimi Pilot ka studiuar në hollësi gjendjen emocionale të dëshmitarëve dhe strategjitë aktuale përballuese të tyre.

Pasojat e ballafaqimit me traumat të cilat kanë përjetuar të intervistuarit krijojnë probleme që kanë të bëjnë me ritraumatizimin dhe që krijojnë vështirësi thelbësore për ndarjen nga e shkuara (Bandes 2009; Başoğlu 2005). Studimi Pilot përdori pyetje standarde psikologjike për mirëqenien e dëshmitarëve në gjashtë muajt e fundit si edhe pyetje për strategjitë e tyre përballuese kundrejt stresit në jetën e tyre. Figura 5.3 jep rezultatet e një sërë pyetjesh për të intervistuarit për të dhënë ndjenja konkrete të lidhura me përjetimet traumatike të ta.

⁷⁸ Studimi Pilot analizoi lidhjen midis numrit të përjetimeve të të intervistuarve dhe përkatësisë gjinore, etnike dhe numrit të herëve që një individ dëshmoi. Në lidhje me përkatësinë gjinore raporti ishte negativ, që do të thotë se femrat raportuan më pak vuajtje prej traumave sesa meshkujt, dhe nuk kishte asnjë lidhje midis përjetimeve dhe numrit të herëve të dhënies së dëshmisë. Në modelin e përzgjedhur për Studimin Pilot, gjasa statistikore e traumave nga koha e luftës ishte më e lartë ndër boshnjakët dhe shqiptarët; për serbët gjasa e traumave të rënda ishte më e ulët, kurse për kroatët nuk ekzistonte lidhje midis traumave të përjetuara dhe kësaj përkatësie etnike.

Figura 5.3 – Rezultatet për simptomat pastraumatike të të intervistuarve në gjashtë muajt e fundit


Të renditura nga numri më i lartë te ai më i ulët, rezultatet tregojnë shpeshtësinë e ndjenjave të përjetuara nga të intervistuarit dhe nxjerrin në dritë pasojat afatgjata të luftërave në ish-Jugosllavi. Tri ndjenja të përjetuara më së shpeshti nga të intervistuarit janë: ndjenja se nuk mund të hiqen nga mendja njerëzit të humbur gjatë luftërave në ish-Jugosllavi; ndjenja se nuk mund të hiqen nga mendja ngjarjet dhe përjetimet nga konflikti në ish-Jugosllavi; poashtu edhe ndjenja se njerëzit nuk kuptojnë se çfarë u ka ndodhur tyre. Vlen të theksohet se të intervistuarit u shprehën se ndiheshin të tradhtuar dhe të izoluar të cilat janë pika të rëndësishme që duhen marrë parasysh nga punonjësit e shërbimit shëndetësor të cilët punojnë për problemet e mirëqenies së dëshmitarëve. Nga hulumtime të tjera janë konstatuar pasojat të ngjashme prej traumave të luftës (Palić et al. 2015; Opačić et al. 2006; Van der Kolk 2014; Başoğlu 1999), dhe kjo ka pasojat të konsiderueshme në ringritjen e shoqërive pas konflikteve (Biruski et al. 2014).

Përgjithësisht, përgjigjet më të shumta u përkasin kategorive “ndonjëherë” deri në “kurrë” që tregojnë se është e mundur që ata nuk përballeshin me shumë vështirësi të tilla. Gjithsesi disa kategori pyetjesh

tregojnë se një grup i vogël, por i konsiderueshëm dëshmitarësh mund të kenë nevojë për mbështetje të mëtejshme pas konfliktit si edhe në periudhën pas dhënies së dëshmisë. Gjashtë pyetjet ku shumica e të intervistuarve u përgjigjen se kishin përjetuar këto ndjenja “ndonjëherë”, “përgjithësisht shpesh” ose “shumë shpesh” janë: (1) nëse ndihen të tradhtuar nga një person i besuar (51%); (2) nëse e mbajnë mendjen shumë në ngjarjet e luftërave në ish-Jugosllavi (58.3%); (3) nëse kalojnë shumë kohë duke menduar mbi arsyen se çfarë ka ndodhur me ta (61%); (4) nëse mendojnë vazhdimisht për personat që humbën gjatë luftës (66%); (5) nëse mendojnë se njerëzit nuk i kuptojnë; (66%) dhe më e shpeshta, (6) nëse kanë reagime emocionale ose fizike kur u kujtohen ngjarje të veçanta (72.3%).⁷⁹

5.1.2 Gjendja shëndetësore para dhënies së dëshmisë dhe aktualisht

Një ndër pikat më të debatuar, në mos më e debatuar në literaturën mbi drejtësinë kalimtare në përgjithësi, është nëse individët që dëshmojnë para gjykatave, komisioneve të së vërtetës dhe institucione të tjera, ndihmohen, dëmtohen apo kanë pasoja prej procesit të dhënies së dëshmisë (Doak 2011; Brounéus 2010; Stover 2005). Sidoqoftë, shumë pak hulumtime empirike kanë bërë analizë sistematike dhe shkencore të këtij elementi kyç të procesit të dhënies së dëshmisë (Stepakoff et al 2014, 2015; Doak 2011; Mendeloff 2009).

Konfliktet në masë të gjerë si luftërat në ish-Jugosllavi shkaktojnë pasoja në shëndetin publik që shkojnë përtej pasojave të menjëhershme të luftës dhe shtrihen në periudhën pas luftës. Faktikisht këto pasoja mund të jenë më të mëdha se vetë vdekshmëria nga lufta (Ghobarah et al. 2003, 2004; Poole 2012). Në kohët e fundit, janë bërë gjithnjë e më shumë përpjekje për analizën e pasojave të konfliktit nëpërmjet treguesve psikoshoqërorë, fiziologjikë dhe ekonomikë si veçori të ish-Jugosllavisë (Shemyakina and Plagnol 2013). Sidoqoftë, me gjithë hulumtimet e kryera në dhjetëvjeçarin e fundit, kritikët (Clark 2014; Subotić 2009; Hayden 2011) dhe përkrahësit e Tribunalit (Orentlicher 2008, 2010) ende nuk kanë nxjerrë rezultate sistematike, shkencore dhe përfundimtare mbi ndikimin në nivel individual të dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët.

Për trajtimin e drejtë, objektiv dhe të saktë të këtij problemi duhen të dhëna të shumta për një kohë të gjatë të dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar, për të vlerësuar gjendjen e tyre mendore dhe fizike para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë.⁸⁰ Vetëm së fundi janë ndërmarrë përpjekje të tilla në lidhje me Gjykatën Penale Ndërkombëtare (Stover et al. 2014) dhe Gjykatën Speciale për Sierra Leonen (Stepakoff et al. 2014, 2015), dhe rezultatet më të reja tregojnë se procesi i dhënies së dëshmisë nuk çon domosdoshmërisht në ritraumatizimin ose pasoja negative për dëshmitarët. Është një proces kompleks në të cilin shumë dëshmitarë raportojnë ndjenja pozitive mbi ndikimin e dhënies së dëshmisë.

Duke marrë parasysh mungesën relative të hulumtimeve mbi ndikimin e dhënies së dëshmisë dhe masat ligjore për viktimat e krimeve në përgjithësi (Herman 2003), rezultatet e Studimit Pilot kontribuojnë në pasurimin e të dhënave. Gjithsesi ky kontribut është eksperimental sepse Studimi Pilot mat *perceptimet* e gjendjes fiziologjike/psikologjike të dëshmitarëve dhe këto të dhëna nuk janë nxjerrë nga raporte mjekësore apo profesionistë të kualifikuar. Duke marrë parasysh se dëshmitarëve iu kërkua të ktheheshin pas në kohë dhe të jepnin kujtime pas ngjarjeve në lidhje me se si “menduan” se u ndjenë para dhe pas procesit të dëshmisë, këto rezultate duhen interpretuar me rezervë. *Sidoqoftë, perceptimet e dëshmitarëve mbi gjendjen e tyre shëndetësore-psikoshoqërore janë një tregues legjitim dhe i rëndësishëm sepse këndvështrimi i tyre është i rëndësishëm dhe këto perceptime ndikojnë në sjelljet dhe strategjitë përbaluese të dëshmitarëve.* Një nga pikat e forta të hulumtimeve nga Stover (2005, 2014) dhe Stepakoff et al. (2014, 2015) është se ata kanë bërë çmos që t’i bëjnë viktimat të japin

⁷⁹ Studimi Pilot shqyrtoi raportet midis këtyre treguesve dhe përkatësisë gjinore, etnike dhe numrit të herëve të dhënies së dëshmisë dhe në veçanti këto gjashtë pika për të cilat shumica u shprehën se kishin pasur ndjenja të tilla ndonjëherë, përgjithësisht shpesh, ose shumë shpesh. Rezultatet janë shumë të ngjashme me konstatimet e nxjerra nga analizimi i traumave të luftës. Midis përkatësisë gjinore dhe të gjithë këtyre kategorive me përjashtim të njëjës ekzistojnë raporte negative dhe statistikisht të konsiderueshme. Midis përkatësisë etnike boshnjake dhe të gjitha me përjashtim të njëjës prej këtyre kategorive ekzistojnë raporte negative dhe statistikisht të konsiderueshme; dhe raportet midis përkatësisë etnike serbe dhe këtyre ndjenjave janë negative dhe statistikisht të konsiderueshme.


⁸⁰ Janë bërë disa studime për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të njerëzve në ish-Jugosllavi duke u kthyer pas në kohë (Mollica et al 1999; Cardozo et al 2000, Salama et al. 2000) dhe analiza të dhënash masive të pasojave mbi gjendjen mendore dhe fizike për personat e shpërngulur ose që kanë përjetuar konflikt në shkallë të gjerë (Steel et al. 2009; Percival and Sondorp 2010; Başoğlu et al. 2005).

këndvështrimin e tyre personal. Edhe Studimi Pilot ka synuar të njëjtën gjë dhe gjithashtu ka ndërmarrë një hap sistematik dhe shkencor për një pasqyrim sasior të kësaj gjendjeje shëndetësore (Mendeloff 2009; Doak 2011). Këto rezultate gjithashtu kontribuojnë në punime gjithnjë e më të shumta që synojnë të hedhin dritë mbi pasojat e traumave të konsiderueshme ndaj personave të cilët u mbijetojnë konflikteve në shkallë të gjerë, sepse këto pasoja mund të ndryshojnë ndjeshëm në varësi të konfliktit në fjalë dhe popullatës së prekur prej këtij konflikti (Silove 1999; O’Donnell et al. 2004; De Jong 2001).

Dëshmitarët përballen me probleme të shumta shëndetësore si pasojë e traumave të luftës dhe si çdo popullatë tjetër në plakje, hasin vështirësi fizike gjatë periudhës/periudhave kur dëshmojnë. Punonjësit e SVD-së kanë konstatuar një sërë gjendjesh shëndetësore dhe sjelljesh të cilat në disa raste kërkojnë kujdes mjekësor⁸¹ gjatë kohës që dëshmitarët presin të fillojnë dëshminë e tyre. Ndryshimet fizike shpesh kanë të bëjnë me udhëtimin, stresin dhe dëshminë.

Krahasuar me studimet në lidhje me gjendjen mendore, ka më pak hulumtime mbi shëndetin fizik në nivelin individual (Shemyakina and Plagnol 2013). Analiza e pasojave të luftës në shëndetin publik tregon se pasojat janë afatgjata duke marrë parasysh disa tregues (Ghoborah et al 2003, 2004; Poole 2012; Kerridge et al. 2013; Letica-Crepulja et al. 2011; Mollica et al. 1999; Salama et al. 2000). Studimet të përqendruara në ish-Jugosllavi tregojnë numër më të madh të njerëzve me çrregullime mendore gjatë periudhës më të hershme të pasluftës, mirëpo duket se kjo zbehet me kalimin e kohës (Do and Iyer 2012). Nuk është kuptuar plotësisht natyra e pasojave të përhershme të ngjarjeve të luftës në gjendjen fizike. Mirëqenia mendore mund të ndikohet nga gjendja fizike, nga rajoni, përkatësia gjinore ose faktorë të tjerë.

Figura 5.4 – Gjendja shëndetësore e përgjithshme e të intervistuarve para dhënies së dëshmisë dhe në tre muajt e fundit



Në këtë Studim Pilot të intervistuarit u pyetën për gjendjen e tyre fizike duke e krahasuar gjendjen e tyre shëndetësore para herës së parë që kishin dëshmuar dhe në tre muajt e fundit. Në Figurën 5.4 shtylla e parë tregon gjendjen shëndetësore të të intervistuarve pas luftës dhe para se të dëshmonin për herë të parë dhe shtylla e dytë tregon gjendjen shëndetësore të të intervistuarve sot⁸². Këto rezultate


⁸¹ Gjatë fazës së dëshmisë, dëshmitarët mund të sëmuren, mund të mos kenë marrë barna të mjaftueshme, ose kanë nevojë të vizitohen nga personeli mjekësor për mjekimin e një gjendjeje konkrete shëndetësore (p.sh. dentisti). SVD-ja bashkëpunon me mjekët specialistë vendorë për trajtimin dhe terapi në rast nevojë, për zbutjen e pasojave të gjendjes jo të mirë shëndetësore gjatë kohës kur dëshmitarët janë nën kujdesin e SVD-së.

⁸² Arsyeja e pyetjeve për dëshmitarët mbi gjendjen e tyre shëndetësore në periudhën “pas luftës dhe para dhënies së dëshmisë për herë të parë” kishte të bënte me faktin se dëshmitarët kishin pësuar shumë lëndime gjatë luftës të cilat lanë pasoja drastike në

pasqyrojnë gjendjen shëndetësore të përgjithshme të grupit të të intervistuarve dhe mbështesin idenë se gjendja shëndetësore e të intervistuarve është përgjithësisht në rënie, sidomos në kategoritë “shumë mirë” dhe “jashtëzakonisht mirë”. Vihet re se aktualisht ka një rritje të ndjeshme në kategorinë “njëfarësoj”. Këto rezultate nuk janë kaq befusuese po të merret parasysh se disa të intervistuar flasin për gjendjen shëndetësore të 15 vjetëve më parë, ndërsa procesi i plakjes natyrale ndikon në keqësimin e mirëqenies së përgjithshme. Është e rëndësishme të përmendet se mosha mesatare e të intervistuarve është 60.3 vjeç për meshkuj dhe 54.3 vjeçe për femrat.

Bazuar në përkatësinë etnike, gjinore, dhe duke parë moshën, rezultatet e Studimit Pilot tregojnë se të intervistuarit të cilët janë pakicë në bashkësinë ku jetojnë, raportojnë gjendje shëndetësore dukshëm më të mirë para herës së parë të dhënies së dëshmisë krahasuar me gjendjen shëndetësore në tre muajt e fundit kur janë marrë rezultatet e anketimit. Meshkujt raportojnë gjendje shëndetësore aktuale dukshëm më të mirë krahasuar me gjendjen shëndetësore para herës së parë kur dëshmuuan, që tregon se ndoshta pas një kohe të gjatë femrat kanë më shumë pasoja shëndetësore negative (ose ndryshe femrat raportojnë gjendje fizike më pak të kënaqshme) (nuk tregohen rezultate).

Figura 5.5 – Problemet konkrete shëndetësore para dhënies së dëshmisë dhe në tre muajt e fundit



Fakti se femrat raportojnë gjendje shëndetësore më pak të mirë, nuk do të thotë se dhënia e dëshmisë në TPNJ është shkak i shëndetit jo të mirë. Për një rrëhim më të thellë të problemit të perceptimit prej dëshmitarëve të gjendjes së tyre shëndetësore në lidhje me TPNJ-në, dëshmitarëve të intervistuar të projektit iu bënë pyetje për aspekte konkrete që kanë rëndësi për parametrat standardë të gjendjes


gjendjen e tyre shëndetësore pas konfliktit. Shih pyetjen D1 dhe D2 në pyetësor (Shtojca III). Për më tepër në kuadër të këtij Studimi Pilot, dëshmitarëve të cilët kishin dëshmuar disa herë, iu kërkua të mendonin mbi periudhën para dhënies së dëshmisë për herë të parë dhe pas paraqitjes së tyre të fundit në lidhje me para dhe pas dëshmisë.

shëndetësore fiziologjike të dëshmitarëve (Figura 5.5). Të intervistuarit patën mundësi të shënonin disa opsione në lidhje me problemet shëndetësore që përkonin me gjendjen e tyre (mundësi që ata e shfrytëzuan shpesh). Në analizimin e problemeve konkrete shëndetësore para dhënies së dëshmisë për herë të parë krahasuar me gjendjen shëndetësore në tre muajt e fundit, të intervistuarit raportojnë *në tërësi* më shumë probleme shëndetësore aktuale krahasuar me gjendjen shëndetësore të tyre para herës së parë kur dhanë dëshminë.

Aktualisht disa kategori problemesh shëndetësore kanë një shpeshtësi *më të pakët* ku tri problemet kryesore janë pagjumësia, ankthi dhe lëndimet nga granatimet (renditja e rezultateve është bërë në bazë të shtimit të shpeshtësisë në tre muajt e fundit). Ndoshta ka të ngjarë që këto probleme shëndetësore të vijnë si pasoja të luftës, kurse problemet shëndetësore më të përmendura prej të intervistuarve në tre muajt e fundit kanë të bëjnë pak a shumë me plakjen e njerëzve, siç janë dobësimi i shikimit, shtypja e gjakut dhe probleme me lëvizshmërinë/zhdërvjelltësinë.

Gjithashtu të intervistuarit patën mundësi të shënonin në përgjigjet e lira problemet shëndetësore që kanë pasur para dhënies së dëshmisë për herë të parë dhe aktualisht (në kohën e dhënies së intervistës). Problemet më të shpeshta shëndetësore të përmendura nga të intervistuarit kanë të bëjnë me shpinën, me vështirësi emocionale dhe me probleme të organeve që kanë një rënie të konsiderueshme aktuale krahasuar me periudhën para dhënies së dëshmisë për herë të parë (Figura 5.6). Këto rezultate mbështesin përfundimet e studiuësve të tjerë të cilët kanë konstatuar se edhe sikur të pakësohen problemet shëndetësore të shkaktuara nga konflikti, ende ka pasoja shëndetësore afatgjata që mund të ndikojnë te dëshmitarët (Eber et al. 2013; Ghobarah et al. 2004).


Figure 5.6 – Përgjigje të shkurtra për probleme konkrete shëndetësore para dhënies së dëshmisë dhe në tre muajt e fundit



5.1.3 Ndryshimet në gjendjen shëndetësore aktuale

A janë disa dëshmitarë më të ekspozuar ndaj rrezikut për shëndetin e tyre aktualisht? Studimi Pilot analizoi faktorë të ndryshëm që mund të ndikojnë në gjendjen shëndetësore të cilët kanë lidhje me përkatësinë gjinore, etnike dhe numrin e paraqitjeve në gjyq duke marrë parasysh moshën e të intervistuarve, perceptimet mbi gjendjen shëndetësore dhe traumat e përjetuara gjatë konfliktit. Boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët në mënyrë konstante raportojnë më shumë probleme shëndetësore se serbët, si sot, po ashtu edhe para herës së parë që dëshmuan. Në ndryshim nga ata, serbët raportojnë dukshëm më pak probleme shëndetësore aktuale se para se të dëshmonin për herë të parë (nuk tregohen rezultate). Femrat raportojnë më shpesh keqësim të shëndetit të tyre se meshkujt, si para dhënies së dëshmisë për herë të parë, po ashtu edhe në tre muajt e fundit (Figura 5.7 vetëm për perceptimet e gjendjes shëndetësore aktuale). E vetmja kategori e qenësishme për çdo model analitik të mirëqenies së dëshmitarëve është përkatësia gjinore. Në tërësi, femrat raportojnë se gjendja e tyre shëndetësore nuk është aq e fortë sa e meshkujve, rezultat që përputhet me përfundimet se në konflikte femrat raportojnë më shumë pasoja shëndetësore (Hudson et al. 2012; Eber et. al 2013; Stepakoff et al. 2014, 2015).⁸³

Figura 5.7 – Ndryshimet gjinore në perceptimet e gjendjes shëndetësore aktuale



⁸³ Gjithashtu ekziston një gjasë e konsiderueshme që gratë të kenë perceptimin se ato "sëmuren pak më lehtë se njerëzit e tjerë." Shih pyetjen D6 në pyetësor (Shtojca III).

5.2 Procesi i dhënies së dëshmisë dhe ndikimi i tij

5.2.1 Reagimet para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë

Thuajse të gjithë dëshmitarët reagojnë në njëfarë mënyre para, gjatë ose pas dhënies së dëshmisë. Shpjegimi i ngjarjeve traumatike që mund të kenë ndodhur vite më parë në ambientin formal të një salle gjyqësore në prani të njerëzve të panjohur mund të çojë në ritraumatizim të dëshmitarit apo në shuarjen e emocioneve. Punonjësit e SVD-së kanë konstatuar se reagimet e dëshmitarëve shpesh janë më të forta gjatë herës së parë të dhënies së dëshmisë, sepse ata rikujtojnë në mënyrë të gjallë ngjarje të vështira dhe stresuese. Në disa raste dëshmitarët ua bëjnë të njohur mendimet dhe ndjenjat e tyre punonjësve të SVD-së sepse janë të tejmbushur, apo sepse në vendin e tyre ata nuk kanë askënd të cilit mund t'i besojnë mendimet dhe ndjenjat e tyre në lidhje me dhënien e dëshmisë. Në raste të tjera dëshmitarët kanë nevojë për dikë i cili t'i dëgjojë në qetësi kur ata shprehin dhe përpunojnë ndjenjat e tyre. Gjithashtu punonjësit e SVD-së janë menjëherë të disponueshëm për mbështetje të dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë.

Në 10-15 vitet e shkuara janë kryer një sërë studimesh mbi mirëqenien emocionale dhe psikologjike të dëshmitarëve, viktimave dhe individëve të cilët janë mbijetues të konflikteve në ish-Jugosllavi. Ka pasur debat në lidhje me ndikimin e dhënies së dëshmisë në shërimin psikologjik (Bandes 2009; Henry 2009, 2010; Herman 2003). A ndikon procesi i dhënies së dëshmisë për mirë apo për keq në gjendjen emocionale të dëshmitarëve? Disa kanë argumentuar se procesi i dhënies së dëshmisë mund të çojë në shërim, ndarje me të kaluarën ose në një katarsis për kapërcimin e ngjarjeve traumatike (Moghalu 2004, 216; Stover 2005). Të tjerë argumentojnë se provat në lidhje me ndikimin ndaj viktimave janë të kufizuara dhe të diskutueshme (Bandes 2009, 16), dhe veçanërisht për dëshmitarët e TPNJ-së (Clark 2009a, 2009b, 2009c, 2009d, 2014). Gjithsesi e vërteta është se pak dihet mbi “pasojat emocionale dhe psikologjike individuale të zbulimit të së vërtetës në shkallë vendi dhe mekanizmave të nxjerrjes së përgjegjësisë, ose në një plan më të gjerë për përvojën e viktimave me drejtësinë penale” (Mendeloff 2009, 596).

Studiuesit përgjithësisht kanë konstatuar se dëshmitarët kanë reagime pozitive dhe negative ndaj procesit të dhënies së dëshmisë, pavarësisht nëse dëshmojnë për një komision të së vërtetës dhe pajtimit (Byrne 2004; Hamber et al. 2000), për një gjykatë popullore (Brounéus 2010), apo për një gjykatë për krime lufte (Stepakoff et al., 2014, 2015; Stover 2014). Për më tepër, idetë dhe sjelljet e dëshmitarëve në lidhje me procesin e dhënies së dëshmisë mund të ndryshojnë me kalimin e kohës (Backer 2010).

Anketimi u ofroi dëshmitarëve mbi tridhjetë përgjigje të mundshme të cilat punonjësit e SVD-së i kishin formuluar nga kontaktet e tyre me dëshmitarët në vite si edhe nga të dhënat e grumbulluara nga një anketim ekzistues i SVD-së.⁸⁴ Të intervistuarit mund të zgjidhnin ato ndjenja dhe emocione që pasqyronin sa më saktësisht gjendjen e tyre mendore para hyrjes në sallën e gjyqit dhe menjëherë pas dhënies së dëshmisë. Përgjigjet u ndanë në dy kategori: (1) ndjesitë pozitive⁸⁵ (n=15); dhe (2) ndjesitë negative (n=19). Është me rëndësi të ritheksohet se ky është një rikthim i dëshmitarëve në kohë dhe vlerësim i tanishëm për ndjesitë e tyre në periudhën para dëshmisë dhe pas dhënies së dëshmisë.


Në tërësi, kur dëshmitarët mendohen mbi përvojën e dhënies së dëshmisë dhe krahasojnë ndjesitë pozitive dhe negative, rezultatet tregojnë ndryshime të konsiderueshme midis gjendjes së tyre para dhënies së dëshmisë dhe pas dhënies së dëshmisë (Figura 5.8, renditur sipas pakësimit më të madh të ndjesive pas *dhënies së dëshmisë*). Shumica e të intervistuarve raportuan se kishin përjetuar më shumë

⁸⁴ Që nga viti 2009, SVD-ja është duke kryer një anketim me shkrim, të brendshëm dhe anonim të dëshmitarëve pasi ata dëshmojnë. Ky anketim vlerëson perceptimet dhe kënaqësinë e dëshmitarëve në lidhje me shërbimet e SVD-së menjëherë pas dhënies së dëshmisë dhe si rrjedhojë, në ndryshim nga Studimi Pilot është një pasqyrë më e saktë kohore e emocioneve të dëshmitarëve. Duhet theksuar se rezultatet paraprake tregojnë se Studimi Pilot në shumë aspekte pasqyron rezultatet e anketimit të brendshëm dhe anonim të SVD-së. Në të dy anketimet, dëshmitarët shprehin ndjesi dukshëm më pozitive dhe ndjesi më pak negative pas dhënies së dëshmisë. Një ndryshim kyç është se në anketimin e brendshëm dhe anonim të SVD-së, pakësimi i ndjesive negative është më i madh se në Studimin Pilot (nuk tregohen rezultate). Përveç dy kategorive të ndjesive negative, në të gjitha kategoritë e tjera, ndjesitë negative të anketimit të SVD-së ishin më të pakta në periudhën pas dhënies së dëshmisë.

⁸⁵ Këtu ndjesi përdoret si term përfaqësues i emocioneve, gjendjeve shpirtërore dhe sjelljeve.

ndjesi pozitive para dhe pas dhënies së dëshmisë dhe një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve raportuan një pakësim të ndjesive negative pas dhënies së dëshmisë për herë të fundit (Figura 5.8 renditur nga rënia më e madhe në gjendjet *pas dëshmisë*). Ndjesia pozitive dukshëm më e raportuar prej të intervistuarve ishte “bashkëpunues”, ku 184 të intervistuar u shprehën se kishin këtë ndjesi *para* se të dëshmonin. Të intervistuarit raportuan se ishin më pak “bashkëpunues” (n=109) pas dhënies së dëshmisë, por kjo mund të ketë të bëjë me faktin se ata e perceptojnë “bashkëpunimin” e tyre si përfundim të suksesshëm të dhënies së dëshmisë. Ndër ndjesi të tjera të përjetuara në rritje nga një numër i madh të anketuarish pas dhënies së dëshmisë ishin “i kënaqur”, “i çliruar”, “pozitiv”, dhe “i realizuar”. Figura 5.8 tregon se janë edhe disa ndjesi të tjera për të cilat të intervistuarit u përgjigjën më pak pozitivisht (shënuar me të kuqe).


Figura 5.8 – Ndjesitë pozitive: para dhe pas dëshmisë



Gjithashtu të intervistuarve iu dha mundësia të zgjidhnin midis një sërë ndjesish negative. Gjatë përpilimit të anketimit, punonjësit e SVD-së supozuan se ndjesitë negative do të ishin më të shumta se ndjesitë pozitive, mirëpo faktikisht është e kundërta (Figura 5.9). Ndjesitë negative janë dukshëm më të pakta se ndjesitë pozitive si para, po ashtu edhe pas dëshmisë. Për më tepër, të intervistuarit raportojnë ndjesi negative dukshëm më të pakta pas dhënies së dëshmisë. Në përshkrimin e gjendjes së tyre mendore para dhënies së dëshmisë, përgjigjet më të shumta të të intervistuarve ishin “i tensionuar”, “i detyruar”, dhe “i hutuar”. Gjithsesi në të njëjtën kohë ka të ngjarë që këto ndjesi të pakësohen dukshëm pasi një individ dëshmon për herë të fundit. Përgjigjet më të shumta menjëherë pas dhënies së dëshmisë janë “i detyruar” pasuar prej “i raskapitur” dhe “i lodhur”. Në lidhje me ndryshimin e mesatareve, pati ndryshim të konsiderueshëm statistikor midis ndjesive “ankth”, “i tensionuar” dhe “i hutuar”.⁸⁶

⁸⁶ Të intervistuarit kishin mundësi të jepnin përgjigje të shkurtra dhe ata raportuan paksa më shumë emocione negative sesa pozitive. Ndër përgjigjet e dhëna përfshihen: fizike (shtim i adrenalinit, paretati); psikologjike (i qetë, kureshtar, i kënaqur, i shqetësuar, panik prej pranisë në publik, i parëndësishëm, keqardhje, respektues, i zhgënjyer), dhe filozofik (i gatshëm për të ndihmuar, luftëtar për të vërtetën dhe drejtësinë, jolëshues, përbushës i detyrës qytetare).

Figura 5.9 – Ndjesitë negative: para dhe pas dëshmisë



Në përmbledhjetazi, në krahasimin e ndjesive pozitive të raportuara nga të intervistuarit, reagimet *pozitive* janë më të shumta dhe reagimet *negative* më të pakta para dhe pas dhënies së dëshmisë. Ky përfundim i jep shtysë debatit nëse procesi i dhënies së dëshmisë është ritraumatizues apo çlirues (Stover 2014, cf. Brounéus 2010). Gjithashtu ai tregon se kur dëshmitarët kujtojnë reagimet e tyre, ata me gjasë kujtojnë më shumë reagime pozitive sesa negative pas dhënies së dëshmisë.


Edhe pse më lart u tregua se ekziston prirja që ndjesitë pozitive të mbizotërojnë, dëshmitarët mund të përjetojnë edhe reagime të tjera. Përgjithësisht është shënuar përparim në analizimin e këtyre reagimeve psikologjike dhe fiziologjike, ndonëse ende nuk dihet shumë mbi vështirësitë që ndeshin dëshmitarët në bankën e dëshmitarëve, apo çfarë ndihmon për pakësimin e shqetësimeve shkaktuar prej dhënies së dëshmisë (Stover 2005; Stepakoff et al. 2014, 2015). Nëpërmjet, Ndihmësve për Dëshmitarët (ND), SVD-ja jep mbështetje të pandërprerë për të garantuar qëndrim të rehatshëm për të gjithë dëshmitarët si edhe të çdo personi mbështetës, shoqërues apo në ngarkim që mund të sjellin ata me vete.⁸⁷ Ndihmësit e Dëshmitarëve janë të vetmit me të cilët kontakton dëshmitari pas fillimit të dëshmisë për arsye të kufizimeve ligjore.⁸⁸ Punonjësit e SVD-së u shërbejnë të gjithë dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria, Mbrojtja dhe Dhomat dhe ata duhet të jenë të paanshëm gjatë kohës kur ofrojnë mbështetje logjistike dhe emocionale. Në këtë rol punonjësit e SVD-së janë afër dëshmitarëve gjatë gjithë seancave gjyqësore dhe janë me ta gjatë gjithë këtij procesi përfshirë edhe reagimin e dëshmitarëve pas dhënies së dëshmisë.

⁸⁷ Në raste konkrete është e rëndësishme që SVD-ja të garantojë që dëshmitarët më të thyeshëm të shoqërohen nga një **person mbështetës** gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Hagë. SVD-ja përcakton cenusshmërinë e dëshmitarit duke u bazuar në moshën, gjendjen psikologjike, rrezikun e ritraumatizimit, gjendjen shëndetësore apo sëmundjen që kërkon mbështetje intensive të përditshme, apo çfarëdo rrethanash të tjera konkrete të dëshmitarit që diktojnë mbështetje konkrete. Gjithashtu dëshmitari mund të shoqërohet nga një **person në ngarkim të tij** për të cilin dëshmitari është kujdesdhënësi i parë dhe në rast se për personin në ngarkim të tij nuk ka dispozita të tjera gjatë kohës që dëshmitarit i duhet të paraqitet në Tribunal. Afërsisht 13 % e dëshmitarëve të Tribunalit erdhën në Hagë me një person shoqërues ose në ngarkim të tyre.

⁸⁸ Në bazë të Rregullës 90 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, dëshmitarët bëjnë betim solemn në fillim të dhënies së dëshmisë pas të cilit është i ndaluar çfarëdo komunikimi me Prokurorinë ose ekipin e Mbrojtjes deri në përfundimin e dhënies së dëshmisë, në rast se nuk udhëzohen ndryshe nga Dhoma. Ndonëse ata mund të flasin me punonjësit e SVD-së, dëshmitarëve nuk u lejohej të diskutojnë me SVD-në përmbajtjen e dëshmisë së tyre.

Gjatë procesit të dhënies së dëshmisë, dëshmitarët përjetojnë reagime emocionale dhe fizike. Për vlerësimin e ndjenjave të dëshmitarëve gjatë procesit të dhënies së dëshmisë, të intervistuarit u pyetën nëse kishin përjetuar një sërë simptomash që zakonisht kanë lidhje me shqetësimin, përfshirë edhe përgjigjet e shkurtra jo të prera për reagime të tjera fizike që kishin përjetuar. Përgjigja më e shpeshtë është më së shumti “çrregullim emocional” e dhënë nga më shumë se një e treta e të intervistuarve. Tharja e gojës ose rrahjet e shpeshta të zemrës u raportuan nga afërsisht një e treta e të intervistuarve, Veç këtyre, simptoma të tjera më të raportuara janë mosmbushja me frymë, dhimbja e kokës dhe qarjet. Nga dëshmitarët të cilët kishin dëshmuar më shumë se një herë, rreth 15% prej tyre raportuan pakësim të simptomave në paraqitjet në proceset gjyqësore të mëvonshme (nuk tregohen të dhëna). Sidoqoftë, tetë për qind e të intervistuarve të cilët u paraqitën në disa procese gjyqësore të Tribunalit, raportuan *shtim* të simptomave të tyre, duke konfirmuar shqetësimet në lidhje me idenë e rraskapitjes prej dëshmisë, me fjalë të tjera, sa më shumë herë dëshmitarët dëshmojnë, aq më shumë pasoja negative psikologjike dhe fizike kanë. Përgjigjet e shkurtra për reagimet fizike shënohen me “*” në figurën 5.10. Të intervistuarit shpesh shfrytëzuan mundësinë për të shënuar përgjigje të gjata që nuk kishin lidhje me reagimet fizike.⁸⁹ Kjo do të thotë se në studime të ardhshme duhet analizuar më hollësisht përvoja e dëshmitarëve në gjyq për të kuptuar më mirë kompleksitetin e përjetimeve të dëshmitarit gjatë procesit të dhënies së dëshmisë.

Figura 5.10 – Reagimet në bankën e dëshmitarëve gjatë procesit të dhënies së dëshmisë




5.2.2 Faktorët që ndikojnë ndaj dëshmitarëve në procesin e dhënies së dëshmisë

Veç reagimeve fizike dhe emocionale që dëshmitarët mund të përjetojnë gjatë procesit të dhënies së dëshmisë, ata mund të hasin edhe pengesa të vështira. A ekzistojnë rrethana apo ngjarje të caktuara që e bëjnë të vështirë dhënien e dëshmisë (Figura 5.11)? Thujse një e treta (29%) e të intervistuarve raportuan se vështirësi të tilla ekzistojnë. Më të zakonshmet, shtyrja ose ndryshimi i datës së dhënies së dëshmisë, përfshirë vonesat dhe periudhat e pritjes së zgjatur, por gjithashtu edhe largësia nga shtëpia,

⁸⁹ Të intervistuarit raportuan “përqipen të jenë sa më të përqendruar,” “të zemëruar” me përfaqësuesin e Prokurorisë, të Mbrotjtjes ose me të akuzuarin, ndjenja e “trishtimit”, “i parëndësishëm”, “i padobishëm.” Një e intervistuar rikujtoi se kishte dëgjuar “fëmijë që qanin si pula gjatë shpërnguljes,” kur po jepte mbresa të gjalla gjatë dëshmisë së saj. Mirëpo një dëshmitar tjetër u ndje i fuqizuar kur doli në bankën e dëshmitarëve dhe tha se mendonte se po kontribuonte “në barazinë dhe lumturinë njerëzore të të gjithë kombeve dhe popujve të botës.”

familja dhe rrethi shoqëror.⁹⁰ Këto përfundime përputhen me rezultate të studimeve të tjera (Stover 2005, 2014; Stepakoff et al. 2014). Në rastet kur një dëshmitar është i shqetësuar për pasojat e dhënies së dëshmisë, atëherë për të është e vështirë të përqendrohet. Në disa raste prania e dëshmitarëve ose personave të tjerë në Tribunal mund të ketë ndikim negativ te dëshmitarët. Të intervistuarit aluduan për probleme të tjera logjistike si kohëzgjatja e seancave parapërgatitore, përgatitja dhe pyetjet nga pala kundërshtare, si probleme shqetësuese për ta (përgjigjet e shkurtra shënuar me “*”).

Figura 5.11 – Probleme që e bëjnë më të vështirë dhënien e dëshmisë



Largimi nga shtëpia dhe përgjigjet ndaj pyetjeve të vështira në një mjedis të panjohur mund të jetë një përvojë frikësuese. Ajo bëhet edhe më e vështirë prej faktit se të gjitha deklaratat duhen përkthyer për të gjitha palët në sallën e gjyqit. Tribunali u kritikua në lidhje me përkthimet me shkrim dhe gojore (Elias-Bursac 2015; Karton 2008). Duke mbajtur parasysh se ky faktor sjell pasoja për të gjitha palët në sallën e gjyqit si edhe rrjedhoja në interpretimin e ligjit, është e domosdoshme të kuptohet ndikimi i përkthimit me shkrim dhe gojor mbi dëshmitarët (Buss 2013; Elias-Bursac 2012).

Me çfarë vështirësish ndeshen dëshmitarët në një mjedis shumëgjuhësh në sallën e gjyqit? Në një mjedis të tillë dëshmitarët hasin vështirësi të paprovuara më parë, sepse atyre u duhet të ngadalësojnë të folurën për hir të përkthimit gojor të njëkohshëm, të dëgjojnë përkthyesit me vëmendje dhe t'u kushtojnë vëmendje pyetjeve që mund të jenë të vështira për t'u kuptuar për shkak të mënyrës së ndërlikuar të bërjes së tyre (Karton 2008). Të intervistuarit përmendën vështirësi të ngjashme në Studimin Pilot.⁹¹

⁹⁰ I njëjti dëshmitar mund të shënojë disa kategori, si rrjedhojë numrat për çdo kategori nuk pasqyrojnë numrin aktual të dëshmitarëve të cilët mund të kenë shënuar edhe kategori të tjera.

⁹¹ Në anketimin fillestar nuk kishte pyetje në lidhje me problemet e përkthimit gojor, mirëpo kjo pyetje u përfshi pas një sërë anketimesh të kryera (e mundshme gjithsej n=162 në vend të n=300).

Figura 5.12 tregon se dy problemet kryesore që identifikuan dëshmitarët në lidhje me përkthimin gojor është se nuk pasqyroi saktësisht çfarë donin të thoshin ata dhe egzistonjin ndryshime gjuhësore midis tyre dhe përkthyesve (përgjigjet e shkurtra shënuar me “*”). Shpejtësia e përkthimit, vetë karakteri shpërqendruar i procesit të përkthimit gojor dhe problemet dëgjimore në lidhje me dëgjimin e përkthimit janë shqetësime shtesë për dëshmitarët. Vlen të theksohet se personat e vetidentifikuar si shqiptarë (n=11) ose serbë (n=24) kanë të ngjarë të raportojnë më shumë vështirësi në përkthimin gojor, rezultat që përputhet me hulumtime të tjera për TPNJ-në dhe përkthimin gojor (nuk tregohen rezultate, shih Elias-Bursac 2015).


Figura 5.12 – Vështirësitë e përkthimit gojor



Duke marrë parasysh vështirësitë e lartpërmendura gjatë dhënies së dëshmisë, të intervistuarit u pyetën nëse kishin strategji për pakësimin e shqetësimeve të tilla (Figura 5.13).⁹² Sikurse shihet nga rezultat, dëshmitarët mbështeten në një sërë faktorësh, por më mbizotëruesi është qartazi “ndihma nga SVD-ja”, përgjigje e cila u shënuar nga 56.8% e të anketuarve. Ndër strategji të tjera përballuese përfshihen “periudha pushimi”, dhe është e rëndësishme të theksohet vendosmëria psikologjike e dëshmitarëve për të dëshmuar (“nuk ka rëndësi sa e vështirë është, duhet bërë”). Përgjigje të tjera më të shpeshta mbi strategjitë përballuese ishin “biseda me familjen”, “prania e një personi mbështetës që nuk ishte punonjës i SVD -së”, “biseda me dikë për procesin”, ose mbështetja në aftësinë e mbijetesës dhe përqendrimi. Një numër të intervistuarish (n=53) u përgjigjën se marrja e një personi mbështetës shoqëruar ndihmoi në lehtësimin e stresit prej dhënies së dëshmisë. Personat mbështetës më të zakonshëm ishin bashkëshortët (n=21), fëmijët (n=8), shokët (n=7) dhe vëllezër/motra/të afërm të tjerë (n=5).

⁹² U morën 951 përgjigje për pyetjet e përfshira në anketim dhe të intervistuarit dhanë edhe 11 përgjigje më shumë në rubrikën e përgjigjeve të shkurtra.

Figura 5.13 – Lehtësimi i ngarkesës fizike/emocionale gjatë procesit të dhënies së dëshmisë



Sërish të anketuarve iu dha mundësia të jepnin përgjigje të shkurtra dhe po të shihen pyetjet që nuk kërkojnë përgjigje të prera të intervistuarit nuk kanë dhënë aq përgjigje sa për temat e tjera (n=11 të intervistuar- nuk tregohen rezultate). Gjithsesi në përgjigjet e shkurtra ka diçka të përbashkët, se ka gjëra të paharrueshme nga kjo përvojë si dashamirësia e punonjësve të Tribunalit, shkëmbimi i përjetimeve me dëshmitarë të tjerë dhe trajtimi mjekësor. Disa të intervistuar përmendën ngjarje konkrete si "shëtitje në breg të oqeanit" dhe "vizita në Keukenhof."⁹³


⁹³ Keukenhof në Holandë është një nga kopshtet më të mëdha të luleve në botë.

5.2.3 Ndikimi i dhënies së dëshmisë mbi gjendjen shëndetësore

Pasojat e dhënies së dëshmisë mund të jenë edhe pas një kohe të gjatë pas dëshmisë (Stover 2005), dhe duke marrë parasysh se këta dëshmitarë kanë përjetuar trauma të rënda, ata mund të kenë pasoja negative edhe sot e kësaj dite. A *perceptojnë* dëshmitarët pasoja afatgjata prej dhënies së dëshmisë?

Shqetësim kryesor është shëndeti i dëshmitarëve. Të intervistuarve iu kërkua të raportonin gjendjen shëndetësore aktuale (diskutuar më lart në 5.1.2) dhe u pyetën nëse: (a) gjendja e tyre shëndetësore është më e keqe aktualisht *sepse ata dëshmuuan në Tribunal*, ose (b) shëndeti i tyre *do të* keqësohet *sepse ata dëshmuuan në Tribunal*. Sikurse shihet qartë nga rezultatet në Figurën 5.14, perceptimet e të intervistuarve se shëndeti i tyre aktualisht është më keq ose do të keqësohet, nuk konfirmohen. Shumica e të intervistuarve *nuk* mendojnë se shëndeti i tyre aktualisht është më keq për shkak të dhënies së dëshmisë në TPNJ (77.4%). Gjithsesi shtatë për qind (n=21) pajtohen ose pajtohen plotësisht se shëndeti i tyre është më keq për shkak të dhënies së dëshmisë në TPNJ. Perceptimet e të intervistuarve mbi gjendjen shëndetësore aktuale kanë ndërvarësi të konsiderueshme me numrin e problemeve shëndetësore të raportuara duke marrë parasysh edhe përkatësinë gjinore. Si rrjedhojë, të intervistuarat femra të cilat raportojnë më shumë probleme shëndetësore aktuale, janë më të prirura të mendojnë se shëndeti i tyre është më keq për shkak të dhënies së dëshmisë. Duhet theksuar se ky efekt nuk ndikohet prej moshës kur bëhet prova e ndryshimit të mesatareve për të dy grupet.


Figura 5.14 – Gjendja aktuale shëndetësore më keq për shkak të dhënies së dëshmisë në TPNJ



Është e arsyeshme të mendohet se shumica e personave të një popullate në plakje presin keqësim të shëndetit të tyre me kalimin e kohës, mirëpo është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i perceptimit të dëshmitarëve mbi çfarëdo pasojë të veçantë afatgjatë që *Tribunali ka shkaktuar* në shëndetin e tyre (Figura 5.15).⁹⁴ Thujse 73% e dëshmitarëve *nuk* mendojnë se shëndeti i tyre do të keqësohet si pasojë e dhënies së dëshmisë. Një pakicë e të intervistuarve ishin më pak të qartë në lidhje me të ardhmen e shëndetit të tyre duke qenë se më shumë se një në pesë të intervistuar thanë se “nuk e di” nëse shëndeti *do të* keqësohet për shkak të dhënies së dëshmisë. Po ashtu si me perceptimet rreth gjendjes shëndetësore aktuale, dëshmitarët të cilët raportuan më shumë probleme shëndetësore janë dukshëm më të prirur të mendojnë se shëndeti i tyre do të keqësohet për shkak të dhënies së dëshmisë. Ndoshta personat me probleme shëndetësore janë më të prirur t’ia atribuojnë gjendjen shëndetësore përvojës së tyre në TPNJ.

⁹⁴ Për këtë pyetje janë 221 përgjigje sepse pjesa e dytë e pyetjes në versionin original në anglishte nuk u përfshi për shkak të një pakujdesie.

Figura 5.15 – Shëndeti do të keqësohet për shkak të TPNJ-së



Veç perceptimeve mbi keqësimin e gjendjes shëndetësore, faktorë kyç që kanë lidhje me mirëqenien fizike të dëshmitarëve janë moshja, përkatësia gjinore dhe traumat e kohës së luftës që kishin të bënin në një masë të konsiderueshme me problemet fizike në tërësi (nuk tregohen rezultate). Femrat të cilat përjetuan ose panë ngjarje traumatike gjatë luftës dhe të cilat janë më të moshuara, raportuan më shumë probleme shëndetësore. Përfundimet e këtushme mbi ngjarjet traumatike përputhen me përfundime të studimeve të tjera mbi ndikim e dhënies së dëshmisë ndaj dëshmitarëve (Stepakoff et al. 2015) dhe me përfundimet se pasojat afatgjata të traumave të luftës mund të vazhdojnë me breza (Hong and Kang 2015).

5.2.4 Rraskapitja prej dëshmisë

Punonjësit e SVD-së vunë re se paraqitjet e vazhdueshme dhe të shumta në procese gjyqësore të ndryshme ishin ngarkesë e madhe për dëshmitarët dhe kërkonin prej tyre energji, durim dhe aftësi përballuese shtesë. “Lodhja e grumbulluar” të cilën SVD-ja e emëron “*rraskapitje prej dëshmisë*” është koncept relativisht i ri, mirëpo është i nevojshëm hulumtim i mëtejshëm, sepse ka të ngjarë që të njëjtët dëshmitarë të thirren dhe rithirren për të dëshmuar në procese gjyqësore për krime lufte në vendet e ish-Jugosllavisë.

Në hulumtime mbi ndikimin e procesit të dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët togfjalëshi “*rraskapitje prej dëshmisë*” përdoret për : (1) marrjen e përsëritur të deklaratave dhe ribërjen e pyetjeve ndaj dëshmitarëve para procesit gjyqësor (Human Rights Watch 2004); (2) vonesat dhe pritjet për fillimin ose mbarimin e proceseve gjyqësore (Orentlicher 2010); dhe (3) thirrjet në procese gjyqësore të përsëritura dhe dhënien e së njëjtës dëshmi (Harmon 2009; Vukušić 2012). Dëshmitarët mund të thirren për të dëshmuar disa herë në Tribunal për shkak të numrit të madh të të akuzuarve dhe lidhjen midis çështjeve. Ata mund të thirren edhe nga gjykatat e vendeve përkatëse për të dëshmuar për të njëjtat krime lufte. SVD-ja ka folur me dëshmitarë të cilët informuan se ata nuk kuptonin pse ishin thirrur ata “në veçanti” për të dëshmuar disa herë, sidomos kur kishte të tjerë të cilët dinin çfarë kishte ndodhur dhe mund të jepnin të njëjtën dëshmi. Pasoja e dhënies së dëshmisë disa herë mund t’i bëjë dëshmitarët të ndihen gjithë kohën të lidhur me rolin e dëshmitarit. Ashtu sikurse një dëshmitar u shpreh me vend, “*Po u bëre një herë dëshmitar, mbetesh gjithmonë dëshmitar*”.

Dëshmitarët i kanë shpjeguar SVD-së, se shpesh ndihen si të zënë në grackë. Nga një anë, ata janë të vendosur të ndihmojnë drejtësinë dhe ndihen të detyruar të mos qëndrojnë të heshtur. Nga ana tjetër, ata ndihen të rraskapitur prej faktit që janë të detyruar të kujtojnë në mënyrë të përsëritur ngjarje traumatike. Për disa dëshmitarë kjo do të thotë të jesh intensivisht i zënë me të shkuarën, ose madje të jetosh me të shkuarën për periudha të gjata. Koha që nevojitet për përgatitjen e dhënies së dëshmisë dhe për trajtimin e pasojave prej dhënies së dëshmisë është shumë më e gjatë se koha aktuale e shpenzuar në sallën e gjyqit. Si rrjedhojë, në vend që t’i kthejë dëshmitarët menjëherë në shtëpi pas dhënies së dëshmisë, SVD-ja u jep dëshmitarëve “një ditë pushim”, duke u dhënë kohë që të përpunojnë përjetimin e tyre gjatë dhënies së dëshmisë para se të kthehen në shtëpi.

Për të përcaktuar nëse të intervistuarit kishin rraskapitje prej dëshmisë si në rastin kur dëshmitarët kanë dëshmuar disa herë, ose kanë pasur kohë të tejzgjatur qëndrimi, rraskapitje e cila ndikon në mirëqenien e tyre emocionale, Studimi Pilot përdori dy teste të ndryshme. I pari ishte testi i ndryshimit të mesatareve për gjithsej të gjitha ditët që një dëshmitar ishte paraqitur dhe numrin e herëve që një dëshmitar kishte dëshmuar për secilën prej pyetjeve në lidhje me pasojat emocionale (pyetjet D25-D42). Së dyti, për të verifikuar nëse ekzistonin veçori të tjera të dëshmitarëve që mund të ndikonin në rraskapitjen e dëshmitarëve, për çdonjërin nga pyetjet D25-D42 u ndërtua një model logjistik.⁹⁵ Duke marrë parasysh përkatësinë gjinore, moshën dhe traumat e gjithsejta të luftës, nuk rezultuan ndryshime të konsiderueshme në ndonjë nga pyetjet. Me fjalë të tjera, dëshmitarët të cilët ishin paraqitur disa herë në Tribunal nuk kishte të ngjarë të raportnin më shumë simptoma që kishin lidhje me trauma emocionale në gjashtë muajt e fundit. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që mund të mos ketë faktorë të tjerë që ndikojnë ndaj dëshmitarit dhe në rraskapitjen prej dëshmisë. Për shembull duhen analizuar rrethanat kur dëshmitarët thirren në mënyrë të përsëritur për të dëshmuar në gjykime me të akuzuar të rangjeve të larta, në gjykime me shumë të akuzuar (të ashtuquajturit “megagjykime”), ose në procese gjyqësore ku përfundimisht i akuzuari u lirua prej akuzave, për të kuptuar nëse këta faktorë ndikojnë në mirëqenien në tërësi të dëshmitarëve.


⁹⁵ Për shembull, në D25 pyetet se sa shpesh dikush përjeton “reagim të beftë emocional ose fizik kur i kujtojnë ngjarjet më të dhimbshme ose më tronditëse”. Shih pyetësin (Shtojca III).

5.3 Strategjitë përballuese dhe kënaqësia prej jetës

5.3.1 Strategjitë përballuese

Mënyra e reagimit të një personi ndaj përvojave të jetës, sidomos përvojat e traumave të rënda varen në një masë të madhe prej përvojave të tyre të mëparshme si edhe mekanizmave përballuese (Herman 1993, 2003). Sikurse u përmend më lart në lidhje me ndikimin e ngjarjeve traumatike (pjesa 5.3), si edhe në lidhje me ndjesitë pozitive dhe negative në kontekstin e procesit të dhënies së dëshmisë (pjesa 5.10), është gjithashtu e rëndësishme se si e përballojnë dëshmitarët këtë përvojë në kohën në fjalë. Si rrjedhojë, të intervistuarve iu bënë një sërë pyetjesh me disa mundësi përgjigjesh në lidhje me mënyrat e përballimit prej tyre të situatave të vështira në jetën e përditshme (Figura 5.16)⁹⁶.

Figura 5.16 – Strategjitë përballuese



Përgjigjet janë ndarë sipas kategorisë më të ngjashme të strategjisë përballuese ku mbështetet dëshmitari: (1) *e jashtme* (ngjyrë e gjelbër-kërkon mbështetje nga familja, shokët, kolegët, etj.); (2) *e brendshme* (ngjyrë e kaltër-kanë një filozofi jetese, i mbajnë gjërat përbrenda, etj.); ose (3) përdor substanca (ngjyrë portokalli-përdor më shumë substanca, ndër të cilat kafeinë, alkool, duhan, etj.). ngjyrat më të çelëta për çdo kategori tregojnë "Kurrë/thuaje kurrë", nuanca e mesme tregon "Ndonjëherë" dhe ngjyra më e errët tregon "Përgjithësisht/shumë shpesh".


Është e qartë se strategjitë përballuese ndërmjet të intervistuarve mund të ndryshojnë ndjeshëm. Të intervistuarit raportojnë përpjekje të pakta për kontakt me njerëzit për mbështetje qofshin këta shokë, kolegë ose të afërm. Punonjësit e SVD-së vënë në dukje se në disa zona të ish-Jugosllavisë shërbimet shëndetësore profesionale mund të mos ekzistojnë, ose të jenë të disponueshme për dëshmitarët. Ky mund të jetë një shpjegim që ndihma profesionale psikologjike dhe rrjetet e mbështetjes shoqërore përmenden jo shpesh. Pavarësisht nëse mund të shfrytëzojnë shërbimet mbështetëse, në tërësi të intervistuarit nuk shfaqën prirje për të parë jashtë vetes së tyre në përballimin e vështirësive që kanë në vetvete. Faktikisht strategjia më e përdorur është mbështetja në forcën mendore vetjake ose

⁹⁶ Shih pyetjet D43-D61 në pyetësor (Shtojca III).

këndvështrime të tilla si “mbështetja te humori”, “përqendrimi në sukseset e veta”, ose “të jetosh nga dita në ditë”. Ky brendësim për disa të intervistuar mund të jetë edhe izolim, ku thuhet gjysma e tyre shprehen se ata “shmangin situata të vështira” dhe më shumë se një e treta shprehen se “heshtin” dhe “i mbajnë gjërat përbrenda”. Studimi Pilot analizoi ndryshimet gjinore nëpërmjet përdorimit të testit të ndryshimit të mesatareve midis meshkujve dhe femrave për secilën prej tri strategjive përballuese të ndryshme. Ndryshimet e vetme të konsiderueshme ishin në përdorimin e substancave ku meshkujt kanë gjasë ndjeshëm më të lartë se femrat në përdorimin e shtuar të substancave kur u duhet të përballen me situata të vështira (nuk tregohen rezultate).

Për një kuptim më të mirë të përvojës së dëshmitarëve, të intervistuarve iu dha mundësia të shkruanin përgjigje shtesë për strategji të tjera përballuese që ata përdorin në situata të vështira. Kjo i shtyu të intervistuarit të tregonin përvojat e tyre dhe kjo është ndër pyetjet që ka marrë më shumë përgjigje në anketim (Figura 5.17). Ndër strategjitë më të shpeshta janë më shumë kontakt me mjedisin e jashtëm, dalja jashtë shtëpisë dhe kryerja e një sërë aktiviteteve, si dhe shoqërimi me të afërm dhe shokë. Gjithashtu përdoren megjithëse jo në të njëjtën masë edhe strategji të brendshme si leximi, shkrimi, qëndrimi në shtëpi etj si edhe pasja e një filozofie të caktuar jetese.

Figura 5.17 – Strategjitë përballuese (shënimet e të intervistuarve)




5.3.2 Kënaqësia prej jetës – sot dhe në të ardhmen

Një element tjetër i rëndësishëm i gjendjes së përgjithshme shëndetësore të dëshmitarëve është kënaqësia që ata marrin prej mjedisit që i rrethon. Perceptimet e dëshmitarëve mbi jetën e tyre, bashkësinë ku jetojnë dhe qeverinë e tyre ndikojnë në dëshirën e tyre për pajtim (Meernik and Guerrero 2014) dhe në mbështetjen e tyre për Tribunalin (Meernik 2015). Si e perceptojnë të intervistuarit botën e tyre dhe botën që i rrethon? Për këtë qëllim dëshmitarëve iu bënë disa pyetje në lidhje me rrethanat e tyre personale aktuale, cilësinë e marrëdhënieve në bashkësinë ku jetojnë, si edhe gjendjen politike dhe ekonomike në vendin e tyre. Të intervistuarve iu kërkua të bënin komente për gjendjen ekonomike dhe politike aktuale, si dhe për 2-5 vitet e ardhshme.

Dëshmitarët shpesh i raportuan SVD-së se faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në mirëqenien e tyre të përgjithshme janë përjetimet e luftës, humbjet e pësuar dhe pasojat rrjedhuese. Disa prej tyre janë ende refugjatë ose persona të shpërngulur brenda vendit të cilët e kanë të pamundur të kthehen në shtëpitë e tyre origjinale, kurse të tjerë janë pakicë ose të rikthyer në bashkësinë e tyre. Shumë dëshmitarë deklaruan se jeta e tyre nuk do të jetë kurrë më si ajo para konfliktit, ndonëse disa u shprehën se për hir të brezit pasardhës dhe në nderim të të humburve, ata duhet të vazhdojnë me jetën e tyre pavarësisht sa e keqe mund të jetë. Për shkak të papunësisë së lartë në shumë rajone të ish-Jugosllavisë⁹⁷ dhe vështirësive në gjetjen e punës së përshtatshme, dëshmitarët shprehën ankesa të shpeshta për vështirësinë e sigurimit të të ardhurave të mjaftueshme dhe të rregullta për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe për sigurimin e fondeve për shkollimin e fëmijëve të tyre.

Figura 5.18 – Kënaqësia me jetën e tashme dhe të ardhshme



Në përgjithësi rezultatet e Studimit Pilot tregojnë se të intervistuarit janë optimistë për situatën e jetës së tyre në tërësi në të tashmen (Figura 5.18), mirëpo ky optimizëm bie kur të intervistuarit mendojnë për 2-5 vitet e ardhshme. Më shumë se 60% e të intervistuarve u shprehën se ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me jetën e tyre në të tashmen, kurse vetëm 36% e tyre prisnin të ishin të kënaqur me situatën e tyre në 2-5 vitet e ardhshme. Pjesërisht ky problem lidhet me numrin e të intervistuarve të cilët u shprehën se nuk e dinin çfarë të ardhme do të kishin. Faktikisht nga 248 të intervistuarit të cilët zgjodhën njëri nga tri përgjigjet “i kënaqur” në të tashmen, 51 u shprehën se ata nuk e dinin të ardhmen e tyre. Ajo që në pamje të parë mund të duket si rënie e optimizmit është kryesisht shtim i pasigurisë apo i pamundësisë për të parashikuar të ardhmen.

⁹⁷ <http://data.worldbank.org/indicator/SU.UEM.TOTL.ZS>

Sidoqoftë rezultatet janë të ndryshme, në Figurën 5.19, kur të intervistuarit pyeten për marrëdhëniet e tyre me njerëzit në bashkësinë ku jetojnë. Ky është një tregues veçanërisht interesant sepse tërthorazi lidhet me perceptimet e të intervistuarve mbi cilësinë e marrëdhënieve të njerëzve në bashkësinë e tyre ose ndoshta në pajtimin me të tjerët. Shumica e të intervistuarve u përgjigjën se ata janë të kënaqur ose deri diku të kënaqur me marrëdhëniet e tyre me njerëzit në bashkësinë ku jetojnë (57%), kurse 49% presin të jenë të kënaqur në 2-5 vitet e ardhshme. Ka më pak individë të cilët shfaqën pesimizëm për të ardhmen, gjithsej vetëm 15% presin të jenë deri diku të pakënaqur, të pakënaqur ose shumë të pakënaqur në 2-5 vitet e ardhshme, kurse 31% janë të pakënaqur prej marrëdhënieve të tyre të tanishme me njerëzit në bashkësinë ku jetojnë. Gjithashtu ishin një numër i konsiderueshëm individësh (19%) të cilët u shprehën se nuk dinin për të ardhmen.

Figura 5.19 - Kënaqësia me marrëdhëniet ndërnjerëzore të tanishme dhe në të ardhmen në bashkësinë ku jetoj





Figura 5.20 analizon qëndrimin e të intervistuarve ndaj gjendjes së tyre ekonomike të tanishme dhe në të ardhmen. Shumica e të intervistuarve janë të kënaqur me gjendjen e tanishme ekonomike, mirëpo ky numër bie kur ata pyeten për të ardhmen, ndonëse një numër të intervistuarish të cilët ishin kënaqur me të tashmen, nuk dinë për të ardhmen. Faktikisht 40 prej të intervistuarve të cilët u përgjigjën se ishin të kënaqur ose deri diku të kënaqur nga e tashmja, zgjodhën përgjigjen “nuk e di” për të ardhmen. Përgjithësisht të intervistuarit janë pak a shumë të kënaqur për të tashmen, por të pasigurtë, apo nuk janë në gjendje të parashikojnë të ardhmen.


Figura 5.20 – Kënaqësia me gjendjen ekonomike të tanishme dhe në të ardhmen



Studimi Pilot konstatoi pakënaqësinë më të madhe kur të intervistuarit u pyetën për gjendjen politike të tanishme dhe në të ardhmen në vendin e tyre. Në ndryshim nga pyetjet e mëparshme, ka shumë më tepër të ngjarë që të intervistuarit të shprehën të pakënaqur për gjendjen e tanishme politike dhe shpesh prirjen të shprehin kënaqësi më të madhe sesi e përfytyrojnë ata gjendjen politike në të ardhmen (Figura 5.21).

Afërsisht 70% e të intervistuarve u përgjigjën se ishin deri diku të pakënaqur, të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me gjendjen e tanishme politike në vendin e tyre. U bënë analiza të tjera (nuk paraqiten këtu) për të përcaktuar nëse përkatësia gjinore apo etnike ndikonin në kënaqësinë prej jetës, në marrëdhëniet me njerëzit, etj. Sidoqoftë faktorë të tillë nuk ishin përgjithësisht parashikues të pikëpamjeve të individëve për të ardhmen (ndoshta për shkak të numrit të madh të përgjigjeve “nuk e di”).

Figura 5.21 – Kënaqësia me gjendjen politike të tanishme dhe në të ardhmen



Përmbledhje

Përfundimet e Studimit Pilot tregojnë se nevojitet një qasje më sistematike (para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë) për të kuptuar më mirë pasojat pozitive dhe negative, afatshkurtra dhe afatgjata të dhënies së dëshmisë në mirëqenien psikologjike dhe fizike të dëshmitarëve. Bazuar në parametra të ndryshëm fizikë dhe psikologjikë, dëshmitarët kanë përjetuar trauma të rënda dhe megjithatë e ndihmojnë Tribunalin ku një e treta prej tyre kanë dëshmuar disa herë. Rezultatet e Studimit Pilot tregojnë se procesi i dhënies së dëshmisë është më i gjerë dhe shkon përtej përfundimeve të thjeshta se në fund të fundit dhënia e dëshmisë është akt “ritraumatizimi”, ose “katarsis”. Përgjithësisht, në Studimin Pilot konstatohet se dëshmitarët përjetojnë më shumë ndjesi pozitive se negative, si para po ashtu edhe pas dëshmisë, konstatim që konfirmon nocionin se dhënia e dëshmisë nuk është në vetvete traumatike. Vështirësitë e brendaqenësishme të procesit të dhënies së dëshmisë mund të lehtësohen nga prania e personave mbështetës shoqëruar, punonjësit e SVD-së dhe strategjitë përballuese të brendshme të dëshmitarëve.

Duke pasur parasysh traumat e rënda (të para dhe të përjetuara) si edhe faktin që grupi i të intervistuarve është në plakje, dëshmitarët tregojnë forcë mendore sikurse pasqyrohet në pikëpamjet e tyre për gjendjen e tyre psikologjike dhe fizike në lidhje me Tribunalin. Dëshmitarët përdorin strategji përballuese të ndryshme kundrejt traumave të kohës së luftës ku shumë prej tyre mbështeten në strategji përballuese të brendshme të vetënxitura dhe jo në sisteme të mbështetjes së jashtme. Është me interes të theksohet se ekziston një numër i rëndësishëm i të intervistuarve të cilët dinë pak për dhunën dhe shkatërrimin gjatë luftës. Studimi Pilot sikurse dhe studime të tjera, jep të dhëna shpesh që janë sugjeruese për pika të tilla, mirëpo në asnjë mënyrë konkluduese. Në përputhje me përfundime të tjera të Studimit Pilot, një pjesë e dëshmitarëve vazhdojnë të përjetojnë pasoja negative në shëndetin e tyre dhe disa prej tyre ia atribuojnë këtë gjendje procesit të dhënies së dëshmisë. Në tërësi, dëshmitarët u shprehën të kënaqur me jetën e tanishme dhe mjaft të pavendosur në lidhje me të ardhmen.

Në përmbledhje, në Studimin Pilot shumica e dëshmitarëve e kalojnë procesin e dhënies së dëshmisë pa probleme të konsiderueshme, ndonëse për disa prej tyre procesi mund të jetë emocionalisht dhe fizikisht i vështirë.

Kapitulli 6 – Perceptimet për TPNJ-në

Deri më sot studimet mbi efektshmërinë dhe paanësinë e gjykatave ndërkombëtare janë përqendruar kryesisht mbi ndikimin e tyre për paqen dhe për mandatin më të gjerë të TPNJ-së. Në studime janë analizuar tregues të tillë si konfliktet, të drejtat e njeriut, viktimat civile, dhe parametra të ngjashëm të vlerësuar në bazë vendi (Akhavan 2009; Barria and Roper 2005; Clark 2014; Gilligan 2006; Kim and Sikkink 2010; McAllister 2014; Meernik 2005; Simmons and Danner 2010; Stover and Weinstein 2004). Kohët e fundit janë shtuar anketimet shkencore të opinionit publik mbi drejtësinë ndërkombëtare të cilat japin të dhëna të çmuara se cilët janë faktorët më përcaktues për mbështetjen dhe vlerësimin e drejtësisë ndërkombëtare nga individët (Arzt 2006; Ford 2012; Hagan and Ivkovic 2006; Klarin 2009; Meernik 2015; Orentlicher 2009; Subotic 2009). Duke pasur parasysh rolin qendror të dëshmitarëve në drejtësinë ndërkombëtare, është e rëndësishme të vlerësohen ndikimi dhe trashëgimia e Tribunalit, për shtjellimin e pikëpamjeve të tyre mbi këto tema.


Në këtë kapitull shqyrtohen pikëpamjet e të intervistuarve mbi efektshmërinë e Tribunalit në përmbushjen e objektivave të gjera si zbulimi i të vërtetës, gjetja e fajtorëve të krimeve dhe dënimi i tyre, dhe parandalimi i shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare në të ardhmen. Gjithashtu në këtë kapitull trajtohen perceptimet e dëshmitarëve në lidhje me drejtësinë e procedurave të Tribunalit, zyrat me të cilat kanë kontaktuar dhe efektshmërinë e dëshmisë së tyre.

Temat e trajtuara në këtë kapitull kanë lidhje me pyetjet në pjesën E të pyetësorit (Shtojca III).

6.1 Perceptimi i të intervistuarve mbi efektshmërinë e TPNJ-së

Në këtë pjesë së pari shqyrtohen mendimet e të intervistuarve nëse ata besojnë se Tribunali ka bërë një punë përgjithësisht të mirë në synimet e tij themelore si e vërteta, drejtësia, ndëshkimi dhe parandalimi. Figura 6.1 tregon se një numër i të intervistuarve (48%) mendojnë se Tribunali ka ndihmuar në zbulimin e të vërtetës së ngjarjeve në ish-Jugosllavi dhe i ka identifikuar fajtorët e kryerjes së krimeve të rënda (41%). Shumica e të intervistuarve mendojnë se Tribunali ka ndihmuar në parandalimin e rikryerjes së këtyre krimeve (53%), dhe 31% mendojnë se Tribunali ka bërë punë të mirë në ndëshkimin e fajtorëve. Sidoqoftë 30-35% e të intervistuarve nuk shprehin mendim ose përgjigjen “nuk e di” mbi punën e Tribunalit, veçanërisht kur u pyetën mbi efektshmërinë e Tribunalit në ndëshkimin e fajtorëve. Arsye për këtë nuk janë të qarta, por mund të kenë të bëjnë me mungesën e njohurive të dëshmitarëve për proceset penale, punën e TPNJ-së, ose ngurrimin e tyre për të dhënë mendim mbi një temë të tillë komplekse dhe të shumanshme.

Figura 6.1 – Të intervistuarit të cilët mendojnë se TPNJ-ja përgjithësisht ka bërë një “punë të mirë”⁹⁸




⁹⁸ Për pyetjet e plota shih pyetjet E1, E2, E3 dhe E4 në pyetësor (Shtojca III).

Studiuesit e opinionit publik dhe drejtësisë ndërkombëtare (Arzt 2006; Clark 2009; Hagan and Ivkovic 2006; Klarin 2009; Meernik 2014; Nettelfield 2010; Orentlicher 2008; Subotic 2009; UNDP 2005) përgjithësisht kanë zbuluar se pikëpamjet mbi plotësimin e objektivave prej Tribunalit kushtëzohen prej faktit se çfarë objektivash analizohen dhe çfarë grupesh anketohen. Studiuesit përgjithësisht kanë konstatuar se vlerësimet pozitive për Tribunalin dallojnë dukshëm ndërmjet grupeve të ndryshme etnike. Për shembull, zakonisht shqiptarët në Kosovë shprehin mbështetje më të madhe për Tribunalin, pasuar nga boshnjakët, kroatët dhe serbët (Arzt 2006; Hatay 2005; Nettelfield 2010; Peskin 2005, 2008; UNDP 2005). Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm i Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (2005) që kreu një anketim, konstatoi se 23.3% e të anketuarve në Bosnjë-Hercegovinë mendonin se TPNJ-ja kishte “bërë një punë të mirë dhe e justifikonte ekzistencën e vet”, kurse 36.8% mendonin se Tribunali nuk kishte punuar mirë, por ishte ende i nevojshëm.⁹⁹ Klarin (2009) dhe Ford (2012) argumentojnë se elitat dhe mediat vendore krijojnë histori mbi viktimizimin dhe fajësimin e grupit dhe se shpesh opinioni publik shkon pas këtyre historive.

Duke marrë parasysh rezultate të hulumtimeve të tjera në lidhje me Tribunalin se përkatësia etnike luan rol, nuk përbën befasi fakti që rezultatet e Studimit Pilot mbi punën e TPNJ-së ndryshojnë ndjeshëm sipas identiteteve etnike. Përfundimet e Studimit Pilot konfirmojnë dhe në të njëjtën kohë kundërshtojnë konstatimet e nxjerra në studime të tjera të mëdha mbi dëshmitarët në gjykatat ndërkombëtare dhe ndikimin e TPNJ-së (Stover 2014; Clark 2014). Figurat 6.2 deri në 6.5 analizojnë nëse pikëpamjet e të intervistuarve ndryshojnë në varësi të vetidentifikimit etnik. Rezultatet tregojnë trajta përputhëse në lidhje me perceptimet e Tribunalit brenda grupeve etnike.

Figura 6.2 – Të intervistuar të cilët mendojnë se TPNJ-ja ka bërë përgjithësisht “punë të mirë në zbulimin e së vërtetës”



⁹⁹ Raport Special i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara. (2005). ‘Justice and Truth in Bosnia and Herzegovina: Public Perceptions/Drejtësia dhe E Vërteta në Bosnjë-Hercegovinë: Perceptime Publike.

Figura 6.3 - Të intervistuar të cilët mendojnë se TPNJ-ja ka bërë përgjithësisht “punë të mirë në gjetjen e fajtorëve për krime të rënda”




Figura 6.4 - Të intervistuar të cilët mendojnë se TPNJ-ja ka bërë përgjithësisht “punë të mirë në ndëshkimin e fajtorëve”





Figura 6.5 - Të intervistuar të cilët mendojnë se TPNJ-ja ka bërë përgjithësisht “punë të mirë në parandalimin e përsëritjes së krimeve të rënda në ish-Jugosllavi”




Rezultatet e kësaj pjese të anketimit janë pak a shumë në përputhje me përfundime nga studime të tjera (p.sh., Meernik 2014). Nga të gjitha grupet, boshnjakët shprehin miratimin më të madh për efektshmërinë e Tribunalit në zbulimin e së vërtetës (73%); gjetjen e fajtorëve të krimeve (73%); dhe ndëshkimin e individëve të shpallur fajtorë (42%). Gjithashtu, boshnjakët janë më shumë të prirur të mendojnë se TPNJ-ja ka bërë punë të mirë në parandalimin e përsëritjes së krimeve (58%). Përgjithësisht, serbët në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Serbi shprehin mbështetjen më të ulët, kurse shqiptarët në Kosovë janë zakonisht grupi i dytë më mbështetës, ndonëse kroatët në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci shprehin më shumë miratim në lidhje me pyetjen për parandalimin (Figura 6.5). Ka shumë pak përgjigje në kategoritë “Grupe etnike të tjera” (4) dhe “Nuk u vetidentifikuan etnikisht” (17) e për pasojë nuk mund të nxirren përfundime me vlerë.

6.2 Perceptimet e të intervistuarve për ushtrimin e drejtësisë

Të anketuarve iu kërkuan të shprehnin mendimin edhe për mënyrën e ushtrimit të drejtësisë prej Tribunalit. Ata u pajtuan plotësisht ose u pajtuan se proceset gjyqësore kishin qenë shumë të ngadalta (70%) (Figura 6.6), kurse 54% mendonin se dënimet e dhëna në çështjet ku ishte bërë vetëdeklarimi i fajësisë nuk u shërbejnë interesave të drejtësisë. Dënimet e dhëna në rastet e pranimit të fajësisë kanë shkaktuar kundërshti dhe ashtu sikurse është konstatuar edhe në studime të tjera, mendohet se cenojnë drejtësinë (Ivković and Hagan 2011). SVD-ja ka konstatuar se viktimat mund të kenë një perceptim të ndryshëm të pranimit të fajësisë. Disa prej tyre shprehin shqetësim se pranimi i fajësisë do të çojë në një dënim ndjeshëm më të lehtë dhe këtë e gjykojnë të papranueshme duke parë krimet e rënda që janë kryer. Të tjerë mund të kenë interes të dëgjojnë informacion që i akuzuari mund t’i japë Prokurorisë/Dhomave në shkëmbim të një dënimi më të lehtë. Konkretisht, dëshmitarë të cilët kanë të afërm të zhdukur, mund të kenë dobi nga marrja e informacionit mbi rrethanat e vdekjes së të afërmeve të tyre apo të vendndodhjes së kufomës së tyre, në rast se ky informacion jepet në kuadër të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.¹⁰⁰


Figura 6.6 – Perceptimet për drejtësinë



Sikurse tregohet në Figurën 6.7, të intervistuarit shprehin më shumë kritika për dënimet e dhëna në rastet e pranimit të fajësisë. Pjesa më e madhe e të intervistuarve (34%) mendojnë se dënimet kanë qenë shumë të lehta dhe 25% mendojnë se janë pak a shumë të drejta. Shumë të intervistuar—32%—nuk shprehin asnjë mendim. Përgjithësisht mendimet e të intervistuarve për dënimet janë ndarë thuhet barabar, duke qenë se 30% mendojnë se janë shumë të lehta, 28% mendojnë se janë pak a shumë të drejta dhe 30% nuk e dinë. Vetëm 9% mendojnë se dënimet kanë qenë shumë të rënda.

¹⁰⁰ Në lidhje me konfliktet e viteve '90 të fundshekullit të kaluar, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq i ishin raportuar gjithsej 34891 njerëz të zhdukur. Sipas Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, 70% e të zhdukurve janë gjetur. Për informacion më të shumtë mbi personat e zhdukur dhe familjet e tyre në Ballkanin Perëndimor shkoni në faqen e internetit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (www.icrc.org) dhe të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur www.icmp.int

Figura 6.7 – Perceptimet për dënimet



Për një shikim më të thellë në perceptimin e dëshmitarëve në lidhje me një aspekt që ka ngjallur shumë debat, të intervistuarve iu kërkua mendimi për ndikimin e politikës ndërkombëtare dhe të brendshme në punën e Tribunalit dhe shumica dhanë vlerësime negative (Figura 6.8). Shumica e të anketuarve (61%) u shprehën se politika ndërkombëtare kishte ushtruar ndikim negativ, kurse një pjesë e të intervistuarve (37%) kishin të njëjtin mendim për ndikimin e politikës së brendshme mbi punën e Tribunalit. Krahas me aspektin e ndikimit të politikës ndërkombëtare dhe të brendshme mbi punën e Tribunalit, janë edhe mendimet e të intervistuarve se cilat gjykata janë më të përshtatshme për gjykimin e krimeve të Tribunalit, gjykatat ndërkombëtare apo të vendeve. Figura 6.9 tregon se ndërsa një pjesë e të intervistuarve (47%) nuk besojnë se gjykatat e vendeve janë më të përshtatshme për gjykimin e çështjeve si ato të Tribunalit, një pjesë tjetër e konsiderueshme e tyre nuk dhanë përgjigje, nuk kishin mendim apo nuk e dinin (39%).

Figura 6.8 – Perceptimet rreth ndikimit të politikës ndërkombëtare dhe të brendshme mbi Tribunalin






Figura 6.9 – Perceptimet se gjykatat shtetërore janë më të përshtatshme për gjykimin e çështjeve të krimeve të luftës



6.3 Perceptimi i intervistuarve për trajtimin me drejtësi nga organet e Tribunalit

Të anketuarit u pyetën për trajtimin me drejtësi të dëshmitarëve dhe të akuzuarve (Figura 6.10). Ndonëse 33% mendonin se të akuzuarit e përkatësisë së tyre etnike ishin trajtuar me drejtësi nga Tribunali, numri bie në 26% kur pyetja është nëse përkatësitë “e tjera” etnike ishin trajtuar me drejtësi nga Tribunali. Përfundime të ngjashme janë nxjerrë edhe në studime mbi trajtimin privilegjuës të përkatësive të tjera etnike (Stover 2005). Ka edhe një numër të konsiderueshëm të grupit të parë (39%) dhe të grupit të dytë (45%) të cilët janë të pasigurtë dhe nuk kanë asnjë mendim. Nga ana tjetër, 63% e të intervistuarve besojnë se dëshmitarët e përkatësisë së tyre etnike janë trajtuar me drejtësi dhe 48% besojnë se dëshmitarët nga grupet e tjera etnike janë trajtuar me drejtësi.

Figura 6.10 – Drejtësia e trajtimit të të akuzuarve dhe dëshmitarëve nga Tribunali



Është interesante se të intervistuarit mendojnë se të akuzuarit dhe dëshmitarët nga grupet e tjera etnike ishin trajtuar me më pak drejtësi nga Tribunali, se ata të përkatësisë së tyre etnike. Shumë hulumtime në kontekstin e ish-Jugosllavisë dhe në vende të tjera me ndarje etnike kanë konstatuar se pjesëtarët e grupeve etnike priren të shohin veten si të viktimizuar, ose si pala e dëmtuar që në njëfarë mënyre është trajtuar padrejtësisht dhe shpesh ngurojnë të mendojnë kështu për grupet e tjera etnike (Clark 2014). Si rrjedhojë, është mbresëlënëse që të intervistuarit këtu i perceptojnë “të tjerët” si ata që ka më shumë të ngjarë të jenë trajtuar padrejtësisht.

Vlen të përmendet se përkufizimi i “trajtimit i të akuzuarit me drejtësi” është interpretuar dhe diskutuar në mënyra të ndryshme nga pjesëmarrësit e Studimit Pilot. Për shembull, disa të intervistuar shprehën mendimin se Tribunali i trajton me drejtësi të akuzuarit kur u jep një dënim në përpjesëtim të duhur me krimet e kryera. Disa të tjerë thanë se të akuzuarit e grupeve etnike “të tjera” kishin pasur trajtim pozitiv të tepruar (objektet e paraburgimit dhe kushtet e jetesës) që sipas tyre krijon “drejtësi” të tepruar dhe nuk është i merituar. Të intervistuar të tjerë bënë të ditur se të akuzuarit trajtohen me drejtësi kur ata kanë ndihmën e duhur juridike dhe kushtet e duhura të paraburgimit. Duket se koncepti i “drejtësisë” kundrejt të akuzuarve mund të ketë kuptimin e dënimit të duhur, ose të një procesi të ndershëm e të paanshëm gjyqësor.¹⁰¹

¹⁰¹ Ekzistojnë ndryshime themelore midis sistemit të së drejtës kontinentale në ish-Jugosllavi të cilin dëshmitarët e njohin dhe sistemit të përzier kontinental-anglosakson të TPNJ-së. Analiza e këtyre ndryshimeve nuk është brenda objektivit të Studimit Pilot (për një ide të përgjithshme shih Carter and Pocar 2013). Brenda kuadrit të këtij studimi, aspekte kyçe që kanë të bëjnë me ndryshime midis të drejtës kontinentale dhe asaj anglosaksone pasqyrohen në përgjigjet e të intervistuarve mbi “drejtësinë”. Koncepti i “pranimit të fajësisë”, qëllimi dhe roli i Prokurorisë dhe Mbrojtjes si edhe roli i gjykatësve si kërkues të së vërtetës kundrejt kërkues të drejtësisë ndryshojnë dukshëm në këto dy sisteme juridike. Këto ndryshime kanë pasoja jo vetëm për perceptimet nëse të akuzuarit janë trajtuar me drejtësi, por edhe në perceptimin e dëshmitarëve mbi trajtimin e tyre. Për shembull, është e mundshme që një dëshmitar nuk e kupton rolin e pyetjeve nga pala kundërshtare të bëra në një mënyrë intensive dhe rrjedhimisht mendon se trajtohet padrejtësisht dhe pyet pse gjykatësi nuk e ndërpret mënyrën e ashpër të pyetjeve.

Anketimi gjithashtu analizoi nëse dëshmitarët kishin pikëpamje pozitive mbi mënyrën e trajtimit të tyre individual nga Tribunali. Plot 93% e tyre mendojnë se janë trajtuar me drejtësi nga Dhomat; 79% mendojnë se u trajtuan me drejtësi nga Prokuroria; dhe 71% mendojnë se u trajtuan me drejtësi nga Mbrojtja (Figura 6.11). Gjithashtu rezultatet tregojnë se nga të gjitha organet e Tribunalit, 95% e të intervistuarve mendojnë se u trajtuan me drejtësi nga SVD-ja. Për të përcaktuar nëse këto mendime vareshin nga pala thirrëse e dëshmitarit u bënë analiza të mëtejshme (Figura 6.12). Përqindjet ndryshojnë shumë pak kur shihet perceptimi i trajtimit të dëshmitarëve të Prokurorisë dhe Mbrojtjes prej Dhomave Gjyqësore dhe SVD-së ku 93-96% e këtyre dëshmitarëve shprehen se ata u trajtuan me drejtësi nga këto dy organe. Ndonëse 88% e dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria mendonin se ishin trajtuar me drejtësi nga Prokuroria, nga dëshmitarët e mbrojtjes vetëm 63% e tyre kishin këtë mendim për Prokurorinë. Mendimet ndryshojnë kahun kur shqyrtohen perceptimet e dëshmitarëve mbi trajtimin e tyre nga Mbrojtja. Ndër dëshmitarët e Mbrojtjes, 89% e tyre mendojnë se ata u trajtuan me drejtësi nga Mbrojtja, kurse vetëm 60% e dëshmitarëve të Prokurorisë mendonin se ishin trajtuar me drejtësi nga Mbrojtja. Sidoqoftë, dëshmitarë të thirrur nga të gjitha palët u shprehën në shumicë të gjerë se ishin trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët.

Figura 6.11 – Perceptimi i të intervistuarve mbi trajtimin nga TPNJ-ja





Figura 6.12 – Perceptimi i të intervistuarve për trajtimin sipas kategorive të dëshmitarëve



Gjithashtu të intervistuarve iu dha mundësia të shprehnin mendimet dhe perceptimet e tyre mbi Dhomat Gjyqësore, Prokurorinë, Mbrojtjen dhe SVD-në (nuk tregohen rezultate). Pati nga të intervistuarit të cilët mendonin se gjykatësit ishin sjellë me profesionalizëm dhe kishin bërë komente në mënyrën e duhur (38 të intervistuar shkruan këtë lloj përgjigje), kurse dymbëdhjetë të tjerë thanë se gjykatësit nuk ishin sjellë kështu. Gjithashtu të intervistuarit përmendën shpesh se ata mendonin se gjykatësit u kishin besuar (10) dhe kishin treguar kujdes për mirëqenien e tyre (8). Kur u pyetën konkretisht për trajtimin e tyre nga Prokuroria, një numër i të intervistuarve gjithashtu u shprehën se Prokuroria kishte treguar kujdes për mirëqenien e tyre (39); se Prokuroria ishte treguar profesionale dhe ishte sjellë si duhej kundrejt tyre (12); se ata ishin lejuar të dëshmonin pa ndërprerje (17), dhe se

Prokuroria i kishte mbrojtur nga pyetje armiqësore të Mbrojtjes (13). Sidoqoftë, nëntë të intervistuar u shprehën se në njëfarë mënyre Prokuroria i kishte diskredituar apo poshtëruar gjatë dëshmisë së tyre. Ndonëse përgjigjja më e shpeshtë për Mbrojtjen ishte se Mbrojtja kishte treguar kujdes për mirëqenien e tyre (39 të intervistuar), 38 të intervistuar thanë se avokatët e Mbrojtjes kishin vepruar joprofesionalisht. Gjithashtu të intervistuar të shumtë përmendën se SVD-ja i kishte trajtuar profesionalisht (44 të intervistuar) dhe shprehën përgëzime (10 persona). Sidoqoftë, duhet përmendur se disa të intervistuar bënë vërejtje për gjykatësit dhe Mbrojtjen në një kohë që u ishte kërkuar të komentonin për Prokurorinë dhe SVD-në. Për shembull, kur iu ofrua mundësia të bënin komente për SVD-në, 53 të intervistuar shkruan se mendonin se ishin trajtuar joprofesionalisht nga Mbrojtja.

Perceptimet e dëshmitarëve mbi trajtimin e tyre nga palët shpesh ndikohet nga perceptimi i tyre mbi çfarë ndodh në sallën gjyqësore dhe nga përgatitja e tyre për procesin e vështirë të dhënies së dëshmisë (Stepakoff et al. 2014, 2015). Temat që do të ceken gjatë dëshmisë, zakonisht përcaktohen nga pala thirrëse, mirëpo ka dëshmitarë të cilët e kanë të vështirë të përqendrohen në një pjesë konkrete të përvojës së tyre gjatë luftës dhe i shpërfillin pjesë të tjera të cilat nuk i konsiderojnë të rëndësishme. SVD-ja konstatoi se në disa raste dëshmitarët e konsiderojnë sallën e gjyqit si vendi i duhur për të treguar krejt të vërtetën mbi çfarë kanë përjetuar dhe mund të ndihen të fyer në rast se u pritet fjala në momentin që flasin për ngjarje shumë të rëndësishme të jetës së tyre. SVD-ja konstatoi se kur për një sërë pyetjesh të palëve dhe/ose Dhomës Gjyqësore, dëshmitarëve u kërkohet të përgjigjen vetëm ‘po’ ose ‘jo’, ata mund të mendojnë se kompleksiteti i përjetimeve të tyre dhe vuajtjet e tyre shpirtërore nuk vlerësohen ashtu siç duhet. Këto konstatime konfirmohen edhe nga hulumtime të tjera (Wald 2002).


Shpesh dëshmitarët befasohen kur pala kundërshtare përpiqet të diskreditojë besueshmërinë e tyre. Disa përjetuan zemërim dhe iu shprehën SVD-së se ishin ndjerë sikur kishin qenë të akuzuar. Veçanërisht dëshmitarët të cilët dëshmojnë përvojat e tyre të keqtrajtitimit dhe dhunës (dhunë seksuale, tortura, humbja e të afërmeve të ngushtë, etj) mund të lëndohen shumë shpirtërisht gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare në rast se mendojnë se pala kundërshtare nuk e beson dëshminë e tyre. Për më tepër, dëshmitarët mund të trazohen së tepërmi kur pyetjet shkojnë në hollësi të cilat ata do të kishin dashur t'i harronin.

Dhomat Gjyqësore kanë kompetencë të mbajnë në kontroll procedimin e çështjes dhe të trajtojnë shkeljet e kodit të sjelljes gjatë pyetjeve të dëshmitarëve të palës tjetër. Dëshmitarët janë mirënjohës kur Dhoma Gjyqësore ndërhyt në mbrojtje të tyre. Gjithashtu ata i kanë përshëndetur deklaratat e bëra nga Dhomat në përfundim të dhënies së dëshmisë së tyre ku shprehet simpati për vuajtjet personale të dëshmitarit (Stepakoff et al 2015). Po ashtu, në fund të dëshmisë së tyre shumë dëshmitarë kërkojnë nëse është e mundur të bëjnë një deklaratë përmbyllëse para gjykatësve. Në përvojën e SVD-së deklarata të tilla janë zakonisht të shkurtra dhe se dëshmitarët janë mirënjohës kur ata lejohen të flasin në fund të dëshmisë së tyre (Bandes 2009).

6.4 Perceptimet e të intervistuarve për efektshmërinë e dëshmive të tyre

Së fundi, Studimi Pilot shqyrtoi perceptimet e dëshmitarëve mbi kontributin e tyre për drejtësinë nëpërmjet dhënies së dëshmisë. Studime të mëparshme kanë provuar se njerëzit janë më të prirur t'i atribuojnë legjitimitet dhe japin mbështetje institucioneve të drejtësisë kur ata besojnë se kanë njëfarë roli apo ndikimi në institucionet në fjalë (Doak 2015; Tyler 1990; Tyler and Darley 2000). Të intervistuarit u pyetën nëse bazuar në reflektimet e tyre mbi dëshminë që kishin dhënë, dëshmia e tyre (1) kishte kontribuar në realizimin e drejtësisë dhe (2) kishte kontribuar në zbulimin e të vërtetës për luftërat në ish-Jugosllavi (Figura 6.13). Shumica e të intervistuarve u pajtuan plotësisht ose u pajtuan (67%) se dëshmia e tyre kontribuoi në realizimin e drejtësisë dhe 71% mendonin se dëshmia e tyre kontribuoi në zbulimin e të vërtetës. Vetëm një pjesë e vogël e të intervistuarve nuk u pajtuan aspak, ose nuk u pajtuan me këto pohime (përkatësisht 8% dhe 6%), kurse një numër i të intervistuarve nuk dinin, ose nuk ishin të sigurtë. Ky është një përfundim me rëndësi të veçantë për të ardhmen afatgjatë të drejtësisë ndërkombëtare, sepse perceptimi i efektshmërisë është kyç për legjitimitetin e institucioneve të drejtësisë, ndërkombëtare dhe të brendshme.

Figura 6.13 – Perceptimet e të intervistuarve mbi efekshmërinë e dëshmime të tyre



Ajo çfarë u intereson më shumë dëshmitarëve është nëse dëshmitë e tyre do të ndihmojnë në zbulimin e të vërtetës për luftërat në ish-Jugosllavi. Ka raste kur ata ndihen të paqartë dhe të pasigurtë mbi dhënien e dëshmisë së tyre në sallën e gjyqit dhe dyshojnë në dobinë e dëshmisë së tyre. Veç mundësisë që u jepet për të treguar publikisht përjetimet e tyre, dëshmitarët e çmojnë kur kontributi i tyre njihet nga Tribunali dhe kur shohin se aktgjykimi përfundimtar është mbështetur në dëshmitë e tyre.

Përmbledhje

Rezultatet konfirmojnë përgjithësisht disa konstatime themelore të studimeve të mëparshme mbi mbështetjen publike për drejtësinë ndërkombëtare. Studimi Pilot tregon se mbështetja e të intervistuarve për punën e Tribunalit në zbulimin e të vërtetës, përcaktimin e përgjegjësisë, dhënien e dënimeve dhe parandalimin ishte përgjithësisht e mirë, ndonëse e ndikuar nga përkatësia etnike. Gjasa më e madhe për mbështetje të punës së Tribunalit ishte ndër boshnjakët dhe shqiptarët, kurse serbët dhe kroatët ishin dukshëm më pak të prirur për mbështetje. Perceptimet e të intervistuarve ashtu sikurse ka dalë edhe në studime të tjera, janë se proceset gjyqësore kanë qenë shumë të ngadalta, dënimet shpesh kanë qenë shumë të lehta dhe dënimet në rastet e pranimit të fajësisë nuk u kanë shërbyer interesave të drejtësisë.

Ndonëse po të shihen rezultatet e studime të tjera përfundimet e Studimit Pilot nuk përbëjnë befasi, shihet se të intervistuarit përgjithësisht japin vlerësim shumë të mirë për trajtimin me drejtësi prej TPNJ-së në tërësi si edhe trajtimin e tyre individual. Në përgjithësi të intervistuarit janë më shumë të prirur të mendojnë se Tribunali i ka trajtuar me drejtësi dëshmitarët dhe të akuzuarit e përkatësishë të tyre etnike dhe të tjerët. Ndoshta çfarë tërheq më shumë vëmendjen është se të intervistuarit japin vlerësime shumë të larta për njësi të caktuara të Tribunalit për trajtimin e tyre individual, ku afërsisht 90-95% e të intervistuarve shprehin se ata u trajtuan me drejtësi nga Dhoma Gjyqësore dhe nga SVD-ja. Gjithashtu një shumicë e gjerë u shpreh se edhe Prokuroria e Mbrojtja i kishin trajtuar me drejtësi, pavarësisht se cila palë i kishte thirrur si dëshmitarë.

Kapitulli 7 – Pyetjet e Lira

Zëri i dëshmitarëve-historia e tyre—në sallën e gjyqit, është vetëm një pjesë e një procesi shumë më të gjerë i cili është më shumë se dëshmia e tyre, pyetjet nga pala tjetër dhe rikthimi i tyre në shoqëri. Dëshmitarët të cilët morën pjesë në Studimin Pilot kanë përvojë të pasur dhe nëpërmjet përgjigjeve të tyre bënë të njohur rëndësinë e dhënies së dëshmisë në një gjykatë ndërkombëtare. Hulumtimi i përvojave të tyre është i rëndësishëm si për dëshmitarët që duan ndarjen me të shkuarën, po ashtu edhe për zhvillimin e praktikave më të mira në Tribunal dhe në gjykata të tjera.

Në pjesën e fundit të Studimit Pilot, të intervistuarve iu dha mundësia të flisnin lirisht për tri pika të rëndësishme: (1) ndikimi i dhënies së dëshmisë; (2) këshillat e tyre për dëshmitarë të ardhshëm në procese për krime lufte dhe (3) çfarë donin të ndryshonin në procesin e dhënies së dëshmisë. Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte që prej dëshmitarëve të merreshin mendimet dhe perceptimet e tyre në lidhje me përvojën e tyre në tërësi dhe rëndësinë e dhënies së dëshmisë për ta. Gjithashtu, të intervistuarve iu dha mundësia të përmendnin tema që nuk ishin cekur në pyetësor.

7.1 Procesi i intervistave

Studimi udhëçelës i Stoverit (2005) në të cilin u përdorën intervistat e strukturuar, ofroi informacion të shumtë jo vetëm në lidhje me Tribunalin dhe ndikimin e tij mbi dëshmitarët, por edhe në vendosjen e standardeve për konceptimin e studimeve të tilla. Studimi i GJPN-së dhe dëshmitarëve të vet (Stover 2014) dhe i pjesëmarrësve-viktima (Stover 2015) zbuluan se në zhvillimin e praktikave më të mira duhen përfshirë anketime vijuese standarde të dëshmitarëve dhe rekomandime mbi mënyrat e përmirësimit të procesit të dhënies së dëshmisë me qëllim shtimin më të madh të mundshëm të mirëqenies së dëshmitarëve dhe pakësimin më të madh të mundshëm të stresit që ata përjetojnë. Ndoshta anketimi më i rëndësishëm deri më sot ka qenë ai ku dëshmitarët u pyetën çfarë mendonin dhe ndjenin për pasojat e dhënies së dëshmisë në jetën e tyre (Stepakoff et al. 2015; Stepakoff et al. 2015a; Stepakoff 2014).

Pjesa e fundit të Studimit Pilot pasoi pyetjet me disa mundësi përgjigjesh, zgjati 15-30 minuta, dhe ishte intervistë e pastrukturuar dhe e pakufizuar ku të intervistuarit mund të jepnin mendimet e tyre përfundimtare mbi dhënien e dëshmisë. Këto pyetje tërësisht të hapura u mundësuan dëshmitarëve të jepnin mendimet e tyre për tri pika të rëndësishme që kanë lidhje të ngushtë me studimet mbi dhënien e dëshmisë në gjykata ndërkombëtare. Së pari, çfarë rëndësie kishte pasur dhënia e dëshmisë në jetën e tyre? Ishte pozitive, negative dhe çfarë ndikimi kishte pasur? Së dyti, bazuar në përvojën e tyre, çfarë këshillash do t'u jepnin ata dëshmitarëve të ardhshëm në procese për krime lufte në lidhje me përgatitjen dhe përballimin e përvojës së dhënies së dëshmisë? Së treti, dëshmitarët u pyetën se çfarë do të ndryshonin në procedurat ose procesin e dhënies së dëshmisë. Qëllimi i kësaj pyetjeje ishte që dëshmitarët të kishin mundësi të bënin kritika mbi procesin e dhënies së dëshmisë, si edhe të jepnin sugjerime mbi mënyrat e mundshme të përmirësimit të Tribunalit dhe gjykatave të tjera. Pyetjet nuk kishin kufizime dhe kishin synim të nxisnin mendime dhe ide të lira nga dëshmitarët, në disa raste të nxitura edhe nga pyetjet e mëparshme me disa mundësi përgjigjesh në pyetësor.

Sikurse është përmendur në Kapitullin 2, punonjësit e SVD-së me formim dhe përvojë në punë sociale, psikologji dhe në punë me dëshmitarë dhe viktimat e traumave, u stërvitën për kryerjen e intervistave. Ata nuk duhej të kërkonin përgjigje konkrete nga të intervistuarit për të shmangur komprometimin e rezultateve, mirëpo ishin të lejuar të ofronin sqarime në rast se dëshmitarët bënin pyetje konkrete. Në rast se dëshmitarët ishin të pasigurtë se çfarë informacioni kërkohej prej tyre, atyre u jepej një sqarim i kufizuar. Në rast se dëshmitarët shpreheshin se faktikisht nuk dinin çfarë komenti të bënin apo çfarë të thoshin, punonjësit e SVD-së ritheksonin se pyetja ishte për të marrë pikëpamjen e dëshmitarit dhe se ishte një mundësi për sugjerime anonime për Tribunalin. Përparësi kishin mirëqenia dhe siguria e

dëshmitarëve për arsye se intervistat ishin në fund të një anketimi që mori kohë i cili mund të shkaktojë emocione nga ngjarjet traumatike të së shkuarës.¹⁰²

SVD-ja i incizoi intervistat (kasetat asgjësohen nga SVD-ja sipas marrëveshjes për “Dhënien e Pëlqimit pas Informimit” nënshkruar nga dëshmitarët) ku materiali i intervistave mund të shihet vetëm nga SVD-ja. Tridhjetë të intervistuar nuk pranuan të jepnin intervista zanore, mirëpo shtatë prej tyre pranuan të jepnin përgjigje me shkrim. Incizimet zanore dhe transkriptet me shkrim u transkriptuan dhe në fund u redaktuan në rastet kur dëshmitarët zbuluan identitetin e tyre. Së fundi, transkriptet u përkthyen në anglisht nga SPGSH-ja dhe iu dorëzuan UNT-së për kodimin dhe analizimin.

Para së të fillohej analizimi i të dhënave të Studimit Pilot, ishte e qartë se afatet kohore për përfundimin e projektit nuk do të mundësonin një analizë të plotë të brendisë në gjuhët amtare ose në anglisht. Rrjedhimisht *rezultatet e paraqitura këtu janë paraprake*. Gjithashtu duhet përmendur se ndonëse pyetjet u paraqitën në tri pika të veçanta dhe të ndryshme, jodomosdoshmërisht dëshmitarët janë përgjigjur sipas kësaj forme. Për shembull një dëshmitar duke iu përgjigjur pyetjes dy, i vinte diçka në mendje që kishte lidhje konkrete me pyetjen një. Çdo intervistë e përkthyer u lexua dhe u kodua për përgjigjet e secilës prej tri pyetjeve ashtu sikurse doli në procesin e intervistave. Si rrjedhojë ka prerje të përbashkët në temat e cekura nga dëshmitarët, mirëpo analiza është strukturuar sipas pyetjes që ka nxitur përgjigjen përkatëse.

Bazuar në kodimin nga tre individë të ndryshëm, ekipi kodues përmbledhi të gjitha komentet e dëshmitarëve në një kategorizim përfundimtar të cilin më pas e kontrolluan dhe konfirmuan hulumtuesit kryesorë. Përgjigjet e përsëritura u llogaritën si një përgjigje.

7.2 Përvoja e dhënies së dëshmisë

Pyetja 1: A mund të përshkruani çfarë rëndësie ka pasur në jetën tuaj dhënia e dëshmisë prej jush? Ju lutemi shënoni çfarëdo aspektesh pozitive dhe negative që kanë pasur ndikim te ju.

Studiuesit kanë filluar të analizojnë nëse dhënia e dëshmisë apo pjesëmarrja si viktimë në një proces (p.sh., në GJPN) ka pasur ndikim pozitiv ose negativ mbi individët e përfshirë në konflikte të dhunshme. Ky ka qenë objektivi kryesor për vlerësimin e ndikimit mbi dëshmitarët si në GJPN (Stover et al. 2014; 2015) po ashtu edhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen (Stepakoff et al. 2014, 2015).¹⁰³ Përfundimet e këtushme pasqyrojnë rezultatet e këtyre studimeve dhe kontribuojnë në zgjerimin e njohurive mbi ndikimin e gjykatave. Procesi i dhënies së dëshmisë është kompleks, mirëpo shumica e dëshmitarëve raportojnë nivel të lartë ndjenjash pozitive për ndikimin tërësor të procesit të dhënies së dëshmisë, kurse thuajse një e treta e dëshmitarëve theksuan ndikim negativ të dhënies së dëshmisë.


Duke iu kthyer së pari komenteve pozitive të rëndësishme të “të japësh dëshmi”, u lexua çdo transkript për Pyetjen Një për të përcaktuar nëse ishte pozitiv, negativ, të dyja njëkohësisht, apo asnjë prej të dyjave (Figura 7.1.).¹⁰⁴ Në tërësi, të intervistuarit japin shumë komente pozitive në lidhje me përvojën (n=124), kurse 66 të intervistuar shprehen si për ndikim pozitiv, po ashtu edhe negativ prej dhënies së dëshmisë. Duke qenë se 30 të intervistuar shprehen për ndikim vetëm negativ dhe 66 të intervistuar për të dyja, kjo do të thotë se më shumë se një e treta (35%) e të intervistuarve shprehën së paku një ose më shumë komente negative.

¹⁰² Për shkak të gjendjes së një dëshmitari, intervista në fjalë u ndërpre para se të përfundonte dhe dëshmitari u rekomandua për ndihmë. Në tërësi, u dhanë rekomandime për 21 të intervistuar dhe 20 të intervistuar kërkuan informacion shtesë, faktor që hedh dritë mbi nevojën e kontakteve pas dhënies së dëshmisë me një grup të vogël, por të rëndësishëm dëshmitarësh. Për më shumë informacion shih pjesën 2.4.5.

¹⁰³ Pjesëmarrësit-viktima (ose palët civile) që kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre, shqetësimet e tyre dhe të marrin dëmshpërblim, janë veçori unike e GJPN-së, Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (DHJGK) dhe e Tribunalit Special për Libanin. Ndonëse nuk është traditë e së drejtës anglosaksone përfshirja e viktimave nëpërmjet këtij mekanizmi mundëson që zëri i tyre të dëgjohet në proces duke u mundësuar që nëpërmjet avokatëve të marrin pjesë më drejtpërdrejtë, sesa vetëm nëpërmjet dhënies së dëshmisë dhe përgjigjeve ndaj pyetjeve të palës kundërshtare. Vlerësimet janë të ndryshme për sa i përket efekshmërisë së mekanizmave të GJPN-së dhe DHJGK-së mbi plotësimin e nevojave të pjesëmarrësve-viktima dhe të shqetësimeve të tyre (Vianney-Liaud 2015; Morrison and Pountney 2014).


¹⁰⁴ Që ndikimi të konsiderohet “pozitiv”, të intervistuarit duhet të kenë përdorur një cilësim epror për ndikimin e dhënies së dëshmisë si për shembull, i shkëlqyer, i jashtëzakonshëm, i dobishëm, i kënaqur etj. Që ndikimi i dhënies së dëshmisë të konsiderohet negativ duhet që i intervistuarit të ketë përdorur cilësime ulëse si për shembull zhgënjyes, i dhimbshëm, i dëmshëm, i pakënaqur, etj.

Figura 7.1 – Vlerësimi prej të intervistuarve i përvojës së dhënies së dëshmisë në tërësi



Për shqyrtimin e hollësishëm të ndikimit pozitiv dhe negativ, kategoritë e mëposhtme ndihmojnë për të kuptuar përvojat pozitive (n=249 të intervistuar), ose negative (n=152 të intervistuar). Shumica e të intervistuarve deklaruan se aspekt pozitiv i dhënies së dëshmisë ishin kontributi, për të vërtetën, drejtësinë dhe ndihma për Tribunalin në nxjerrjen e vendimeve (56% ose n=153) (Figura 7.2). Si aspekt të dytë pozitiv të intervistuarit përmendën kontributin e tyre për historinë, zbardhjen e fakteve dhe rëndësinë ligjore të procesit të dhënies së dëshmisë në Tribunal. Faktikisht, thuajse dy të tretat e të intervistuarve iu përgjigjën Pyetjes Një me një nga dy përgjigjet e para. Tri kategoritë e tjera më të përmendura kishin të bënin me përfundime më personale. Këto përfundime ndihmojnë për një kuptim më të gjerë të pikëpamjeve të dëshmitarëve për gjykatat. Njëzet e tetë për qind (n=78) u shprehën se ishin trajtuar mirë (profesionalisht) nga punonjësit e Tribunalit përfshirë edhe ata të SVD-së, ndiheshin të përgatitur, ose ishin të kënaqur me masat logjistike. Thuajse një e katërta (23.8%) e të gjithë të intervistuarve diskutuan efektin çlirues dhe terapeutik të dhënies së dëshmisë, ndër të cilat ndjenja e çlirimit prej një barre të rëndë, perceptimi i një pozitive sociale më të lartë në bashkësinë ku jetonin, kontributi për një perspektivë më optimiste, ose kënaqësia e kryerjes së detyrës qytetare. Një e pesta e të intervistuarve (n=58 ose 20.8%) raportuan ndikim pozitiv bazuar në arsyet e tyre personale për dhënien e dëshmisë – përfaqësim të viktimave, detyrim moral ose detyrim shoqëror. Vlen të përmendet se kategoritë pozitive më pak të përmendura përfshijnë kontributin për parandalimin e krimeve të luftës në të ardhmen dhe kontributin për paqen dhe kategoria e fundit ishte në lidhje me përgatitjen e Tribunalit për procedimin e krimeve të luftës dhe sa të kënaqur ishin të intervistuarit me vendimet (përfshirë edhe dënimet).


Figura 7.2 – Vlerësimet pozitive prej të intervistuarve të përvojës së dhënies së dëshmisë



Ndonëse në tërësi të intervistuarit ishin më pozitivë se negativë dhe pati më pak përgjigje negative nga një numër më i vogël të intervistuarish (krahasuar me më shumë përgjigje pozitive nga një numër më i madh të intervistuarish), gjithsesi të intervistuarit ngritën shqetësime që pasqyrojnë më së shumti gjithë çfarë është shkruar për Tribunalin (Figura 7.3).

Kategoritë kryesore të ndikimit negativ kishin të bënin me trajtimin e tyre gjatë procesit të dhënies së dëshmisë (n=44) ndër të cilat: probleme me parapërgatitjen, përkthimi gojor, ndjenja e të ndjerit ngushtë prej procedurave juridike anglosaksone, ose prania për herë të parë në një sallë gjyqi; pakënaqësia e të ndjerit si kriminel ose i mosdhënies së mundësisë për të treguar historinë personale. Në vend të dytë si faktorë të ndikimit negativ përfshihen: pakënaqësia prej aktgjykimeve dhe dënimeve – që jepnin ndjenjën e mohimit të drejtësisë, ose se vendimet e pafajësisë së Dhomës së Apelit cenuan legjitimitetin e Tribunalit (n=43). Këtu të intervistuarit shprehën pakënaqësi në lidhje me aktgjykimet e çështjeve gjyqësore veçanërisht në lidhje me realizimin e drejtësisë, plotësimin e pritsmërive dhe shqiptimin e dënimit të duhur. Faktori i tretë negativ më i përmendur kishte të bënte me trajtimin nga avokatët gjyqësorë (n=41), konkretisht nga përfaqësuesit e Prokurorisë ose avokatët e Mbrojtjes, ose të dy, ku të intervistuarit rikujtuan shpesh e me hollësi shqetësimet e tyre për incidente konkrete. Në lidhje me këta tre faktorë kryesorë negativë më shumë se një e treta e dëshmitarëve të intervistuar (34.8% ose n=95, nuk tregohen rezultate) raportuan ndikim negativ përse i përket trajtimit të tyre gjatë procesit të dhënies së dëshmisë, ose pakënaqësi me dënimet dhe vendimet e dhëna. Gjithashtu të intervistuarit shprehën shqetësime në lidhje me probleme mbi procesin e dhënies së dëshmisë dhe përgatitjen nga Prokuroria dhe Mbrojtja (n=32, nuk tregohen rezultate). Ndër shqetësimet e përmendura ishin edhe keqardhja që kishin dëshmuar, ose kërkesa për më shumë mbrojtje të sigurisë së tyre.

Figura 7.3 – Vlerësimet negative prej të intervistuarve të përvojës së dhënies së dëshmisë




Faktori tjetër më i përmendur i ndikimit negativ ka të bëjë me pasojat fiziologjike ose psikologjike negative prej dhënies së dëshmisë (n=34). Në këtë kategori përfshihet jo vetëm shprehja e ankthit prej pranisë në një sallë gjyqësore, por edhe raportime prej dëshmitarëve të ndjenjës së “tmerrit”, të “traumatizimit”, ose të “raskapitjes” si pasojë e dhënies së dëshmisë ose e rikujtimit të ngjarjeve tronditëse. Dy kategoritë vijuese me të njëjtin numër përgjigjesh përfshijnë të intervistuar të cilët shprehin pakënaqësi me: (1) masat logjistike në kohën e dhënies së dëshmisë prej tyre (n=31) ose ndryshe; (2) pasojat personale me të cilat ata u përballën pas kthimit prej dhënies së dëshmisë, ndër të cilat ndikimi negativ në jetën e tyre shtëpiake dhe në vendin e punës, si edhe në kontaktet e tyre me të tjerët të cilët i trajtuan negativisht ose me dyshim (n=31). Duhet theksuar se kategoria e fundit në Figurën 7.3 “ende ekzistojnë vështirësi aktualisht” gjithashtu përfshin pasojat e Tribunalit në jetën aktuale të të intervistuarve (n=15). Këtu dëshmitarët reflektuan mbi faktin se “asgjë nuk ka ndryshuar”, ose se tensionet etnike janë ende gjithandej të pranishme në ish-Jugosllavi. Në këtë kategori gjithashtu përfshihen edhe aspekte në lidhje me pasojat më të thella dhe më afatgjata negative që dëshmitarët ende i ndjejnë si rezultat i dhënies së dëshmisë në Tribunal. Pra, këtu mund të shihet reflektimi në një perspektivë afatgjatë prej disa dëshmitarëve se Tribunali mund të mos ketë kontribuar për pajtimin aktual në rajon.

Gjithashtu, disa të intervistuar shprehën shqetësime nëse Tribunali është i njëanshëm në lidhje me përkatësitë etnike, nëse persona me prejardhje të ndryshme u trajtuan njësoj, apo nëse brenda institucionit dhe njësive të tij ekziston anësia (n=29). Kjo kategori përfshin gjithashtu probleme të ndikimit të tepruar të medias dhe politikës së rajonit mbi procesin vendimmarrës të Tribunalit. Më tej duhet shtuar se mandati dhe statuti i TPNJ-së ishin burim zhgënjimi për të intervistuarit. Këtu përfshihej fakti i vendndodhjes të Tribunalit jashtë rajonit të ish-Jugosllavisë e deri në kundërshtimin se Tribunali nuk përdorte gjykatës të rajonit, por në vend të tyre zgjodhi gjykatës nga vendet e të drejtës anglosaksone (n=25).

Së fundi, dëshmitarët shfaqën një këndvështrim mjaft të gjerë të vështirësive me të cilat përballen Tribunali dhe rajoni i ish-Jugosllavisë pas konfliktit në një mënyrë që jodomosdoshmërisht kishte lidhje personale me përvojën e tyre si dëshmitarë. Shumë të intervistuar bënë komente të tilla gjatë rrjedhës së intervistës. Këto përgjigje nuk mund të kategorizoheshin qartësisht si pozitive ose negative, por u kategorizuan si “neutrale”. Në disa raste të intervistuarit e interpretuan filozofikisht rolin e tyre në procesin e dhënies së dëshmisë (n=19), ose ofruan një vështrim në ndikimin që lufta dhe shpërbërja e ish-Jugosllavisë kishte pasur në jetën e tyre (n=22). Pesë individë u shprehën se dhënia e dëshmisë nuk kishte pasur asnjë ndikim në jetën e tyre.

Figura 7.4 – Vlerësimet neutrale prej të intervistuarve të përvojës së dhënies së dëshmisë




7.3 Këshilla për dëshmitarë të ardhshëm në proceset e krimeve të luftës

Pyetja 2: Çfarë këshillash do të jepnit për të ndihmuar përgatitjen e dëshmitarëve të ardhshëm në procese gjyqësore të krimeve të luftës në lidhje me procesin e dhënies së dëshmisë?

Dëshmitarët e intervistuar ofrojnë një ide dhe një sërë këshillash të urta për të ndihmuar publikun në përgjithësi dhe dëshmitarët e ardhshëm në procese për krime lufte për një kuptim më të mirë të rëndësisë së dhënies së dëshmisë. Institucionet e drejtësisë kalimtare po bëjnë gjithmonë e më shumë analiza të ndikimit të dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët në lidhje me rreziqet afatgjata ndaj mirëqenies së dëshmitarëve dhe sigurisë njerëzore (OSCE 2010; Stepakoff et al. 2015). Bazuar në përvojat e individëve të cilët kanë dëshmuar dhe duke marrë parasysh se Tribunali është afër përfundimit të proceseve të veta gjyqësore, qeveritë në Evropë po miratojnë masa për mbrojtjen e dëshmitarëve në ish-Jugosllavi nga kërcënimet, ngacmimet dhe frikësimet (Council of Europe Resolution 1784, 2011). Praktikata më të mira për mirëqenien e dëshmitarëve janë përqendruar në sistemet mbështetëse ku përfshihet shkëmbimi i informacionit midis kolegëve (Mujkanović 2014) dhe rekomandimet për dhënien e ndihmës psikoshoqërore dhe juridike dëshmitarëve për të mundësuar mbarëvajtjen e procesit të dhënies së dëshmisë.

Të intervistuarit u pyetën çfarë këshillash do t'u jepnin dëshmitarëve të ardhshëm dhe rezultatet në Figurën 7.5 përforcojnë përfundime të tjera të Studimit Pilot. Përvojat e dëshmitarëve janë unike dhe të larmishme. Këshillat e tyre për dëshmitarët e ardhshëm pasqyrojnë pak a shumë përvojat e tyre. Shpesh dëshmitarët u shprehën se këshilla më e rëndësishme që kishin për dëshmitarë të tjerë ishte që të tregonin të vërtetën (n=158). Ndonëse më shumë se 25% theksuan se përgatitja për dhënien e dëshmisë ishte e rëndësishme (n=79), bie në sy se një numër më i vogël shprehën mendimin se sado që të përgatitesh, nuk mund të ishte kurrë plotësisht i përgatitur – duke nxjerrë në dritë një fakt se çdo dëshmitar ka një këndvështrim të ndryshëm të procesit të dhënies së dëshmisë. Të intervistuarit i nxitën dëshmitarët e ardhshëm të mbajnë parasysh rëndësinë historikë të asaj që bëjnë dhe të mendojnë mbi kontributin e tyre nëpërmjet tregimit të përjetimeve të tyre dhe dokumentimit të fakteve për brezat e ardhshëm (n=61).

Figura 7.5 – Këshilla për dëshmitarë të ardhshëm



Gjithashtu të intervistuarit dhanë këshilla në lidhje me adoptimin e një mendësie konkrete- të jesh sa më objektiv dhe të kufizosh paragjykimet (n=57), si edhe të përpiqesh të mbash në kontroll dhe të pakësosh stresin që shkaktohet prej thirrjes për të dëshmuar (n=53). Bie në sy se një numër i të intervistuarve bënë të ditur se për dëshmitarët është e rëndësishme që të kenë vetëbesim dhe të jenë krenarë për dhënien e dëshmisë (n=49).

Me rëndësi për dëshmitarët e ardhshëm, mbi procesin e dhënies së dëshmisë është këshilla që të intervistuarit kanë në lidhje me kontaktet e dëshmitarëve me institucionet dhe procesin e dhënies së dëshmisë në Tribunal. Përgjigjet ishin nga më të larmishmet dhe përgjigjet e të intervistuarve mund të jenë në funksion të drejtpërdrejtë të përvojës së individualizuar të dhënies së dëshmisë. Në dy pyetjet e tjera herë pas here të intervistuarit i qartësuan përgjigjet edhe nëpërmjet shembujve, kurse për këtë pyetje kjo ndodhi më pak dhe të intervistuarit ishin më të përqendruar në fakte në dhënien e këshillës. Të intervistuarit folën më së shpeshti për rolin e Dhomave dhe të Tribunalit në zgjidhjen e problemeve juridike (n=46). Për këtë pikë ata theksuan se u takonte gjykatësve të vendosnin çfarë ishte e vërtetë ose e drejtë. Dëshmitarët këshilluan bashkëpunim të plotë me Dhomat dhe përgjigje për të gjitha pyetjet e bëra – t'u tregohet gjykatësve gjithë çfarë dihet. Disa shkuan edhe më tej dhe thanë se dhënia e dëshmisë është detyrë në mënyrë që gjykatësit të mundësojnë realizimin e drejtësisë.

Intervistuesit ishin më të prirur për t'i këshilluar dëshmitarët e ardhshëm mbi probleme me avokatët e Mbrojtjes (n=14) dhe probleme lidhur me ballafaqimin me të akuzuarin në sallën e gjyqit (n=6), sesa probleme që kishin të bënin me Prokurorinë (n=5). Këtu të intervistuarit përmendën shqetësime të shumta ai për shembull avokati nuk ishte ndihmues në lidhje me deklaratat, ose se paraqitja e dëshmitarëve të Mbrojtjes në Tribunal ishte më e vështirë. Ata që shprehën kritika për Prokurorinë thanë se Prokuroria krijonte vështirësi gjatë marrjes në pyetje. Gjithashtu të intervistuarit i këshilluan dëshmitarët e ardhshëm të jenë të përgatitur ta shohin të akuzuarin nga afër në sallën e gjyqit. Për këtë pikë të intervistuarit donin t'u rikujtonin dëshmitarëve të ardhshëm se në sallën e gjyqit gjykohet i akuzuari, jo dëshmitari. Disa të intervistuar dhanë këshilla të përgjithshme në lidhje me pyetjet gjatë procesit të dhënies së dëshmisë, pavarësisht nëse pyetjet ishin nga Prokuroria, Mbrojtja ose Dhomat (n=5): ku përfshihen komente se nuk ekzistojnë metoda "të përkryera" të dhënies së dëshmisë, se dëshmitarët duhet të përqendrohen në pyetjet që u bëhen, të përgjigjen vetëm për çfarë dinë dhe t'u përgjigjen me po dhe jo pyetjeve që kërkonin vetëm po dhe jo.

Një numër shumë i vogël i të intervistuarve u shprehën se dëshmitarët duhet të jenë të përgatitur për vështirësi logjistike në lidhje me procesin e dhënies së dëshmisë (n=11), mirëpo përvoja e dhënies së dëshmisë mund t'i bëjë më të fortë (n=18). Së fundi duhet përmendur se 12 të intervistuar thanë se nuk kishin sugjerime, ose u shprehën se ata nuk mendojnë më për dëshminë që dhanë.

7.4 Sugjerime për përmirësim


Pyetja 3: Çfarë do të ndryshoni në lidhje me procedurat ose procesin e dhënies së dëshmisë?

Të intervistuarve iu dha mundësia të jepnin sqarime ose shpjegime të zgjeruara për aspekte në lidhje me të cilat ata e konsiderojnë të nevojshme që të shqyrtohen nga Tribunali ose gjykatat e ardhshme për përvojat e dëshmitarëve dhe të bënin sugjerime (Figura 7.6). Po ashtu si edhe në Pyetjen Një, çdo intervistë u kodua në bazë të përgjigjes pozitive, negative, të dyja ose asnjë (Figura 7.6).

Kjo pyetje mori më shumë përgjigje negative sesa pyetja e parë dhe komentet cekën probleme që kishin të bënin me Tribunalin të përmendura në pyetësor. Këto reagime negative pasqyrojnë mendimet tashmë të shprehura të shumicës së intervistuesve në pyetjet me disa mundësi përgjigjesh. Një mundësi qartësisht e dallueshme është se vetë pyetja prej natyrës së saj nxiti përgjigje negative sepse të intervistuarve iu kërkua të jepnin sugjerime konkrete kritike për përmirësime të mundshme.

Thuajse pesë herë më shumë të intervistuar dhanë përgjigje negative (n=157) krahasuar me ato pozitive (n=32), kurse 18% e të intervistuarve u përgjigjën me asnjë (n=25). Nga përgjigjet asnjë, shtatë të intervistuar mendonin se nuk ishin të aftë të jepnin sugjerime.

Figura 7.6 – Vlerësimet në tërësi të procedurave dhe procesit të dhënies së dëshmisë



Duke iu kthyer hollësisë konkrete lidhur me përgjigjet pozitive dhe negative, pika më e komentuar pozitivisht kishte të bënte me punonjësit e Tribunalit në përgjithësi dhe ata të SVD-së në veçanti. Dy temat kryesore që morën më shumë komente negative nuk përbëjnë befasi për kritikët e Tribunalit. Nuk është i ri konstatimi se Tribunalit i është dashur një kohë shumë e gjatë në përmbushjen e mandatit, ose se proceset gjyqësore janë ndërlikuar në mënyrë të panevojshme (n=84). Faktikisht, Kryetari i tretë i Tribunalit, gjykatësi Claude Jorda e bëri këtë konstatim thuajse një dekadë më parë (Wilson 2011, 59). Përveç kohëzgjatjes dhe kompleksitetit të proceseve gjyqësore, kritika e dytë më e përmendur ka të bëjë me ata që mbetën *pa* u ndëshkuar. A kishte individë që i shpëtuan fajësisë? Gjashtëdhjetë e pesë të intervistuar ngritën pyetjen nëse kishte pasur ndëshkime të njëjta. Disa të intervistuar u shprehën se udhëheqësit më të lartë kishin shpëtuar prej aktakuzave, një numër i të intervistuarve thanë se nuk ishin gjykuar të gjitha krimet dhe të gjithë kriminelët, kurse të tjerë deklaruan se për arsye se të gjitha grupet etnike kishin kryer krime, të gjithë këto grupe etnike duhet të përballeshin me akuza të njëjta. Disa të intervistuar theksuan se NATO-ja ishte fajtorë për krime dhe duhej të ishte gjykuar (përfshirë edhe udhëheqësit e saj).

Figura 7.7 – Sugjerime dhe komente konkrete për procedurat dhe procesin e dhënies së dëshmisë



Me rëndësi për mbështetësit e dëshmitarëve të krimeve të luftës është grupi i tretë i përmendur i aspekteve që kanë lidhje me nevojat e dëshmitarëve *pas* procesit gjyqësor (n=58). Nevoja për mbështetjen pas dhënies së dëshmisë të dëshmitarëve të cilët kthehen në shoqëri ende të shkatërruara do të thotë se për disa dëshmitarë vazhdojnë të ekzistojnë pasojat e dhënies së dëshmisë. Dëshmitarët gjithashtu duan të sigurohen se të tjerët nuk mund të mohojnë ngjarjet që ndodhën, apo të mbështesin të akuzuarit. Gjithsesi, dëshira për të parë realizimin e drejtësisë mund të ketë një çmim për ata që dëshmojnë. Nga 58 të intervistuar të cilët përmendën nevojën për mbështetje pas dëshmisë, 13 dëshmitarë thanë se ata ishin dëmtuar përjetësisht dhe bënë të qartë nevojën e kontakteve vijuese në periudhën pas dhënies së dëshmisë (përveç thirrjeve telefonike të rregullta dhe të zakonshme të bëra nga SVD-ja katër deri në gjashtë javë pas kthimit të tyre në shtëpi). Në lidhje me këtë, tetë të intervistuar komentuan se ata e vlerësonin kryerjen e Studimit Pilot, disa theksuan se do të kishin dashur të ishte bërë më herët dhe një person u shpreh se dëshmitarët ishin intervistuar shumë herë pa marrë asgjë pozitive (nuk tregohen rezultate).

Të intervistuarit japin një sërë sugjerimesh të ndryshme në lidhje me procesin e dhënies së dëshmisë dhe mënyrat e mundshme për përmirësimin e aspekteve logjistike të proceseve gjyqësore (n=50). Këto

pika kanë më shumë të bëjnë me procedurën dhe jo me trajtimin thelbësor të dëshmitarëve që dëshmojnë. Këtu të intervistuarit ngritën shqetësime për procesin parapërgatitor (zgjati shumë ose ishte i paqartë) dhe për dhënien e deklaratave në gjyq. Të intervistuarit sugjeruan se duhet informacion më i mirë në lidhje me çfarë mund të pritët, ose se procesi i përkthimit gojor ka qenë problematik. Të intervistuarit gjithashtu shprehën shqetësime në lidhje me dëshmitarë të tjerë – se disa dëshmitarë folën shumë gjatë dhe se duheshin më shumë pyetje të cilave mund t'u përgjigjeshe vetëm me po ose jo. U shprehën mendime se vetëm dëshmitarët okularë duheshin lejuar të dëshmonin, e për më tepër se Tribunali duhet të kërkojë cilësi më të mirë nga dëshmitarët që dëshmojnë.

Dy kategoritë e tjera që janë pranë njëra-tjetrës, kanë të bëjnë me institucionin e Tribunalit në tërësi – problemet në lidhje me aktgjykimet dhe dënimet e shqiptuara (n=42) dhe mangësitë e institucionit (n=40). Përgjigjet në lidhje me dënimet ilustrojnë vështirësitë që ka pasur Tribunali kundrejt opinionit publik për ndëshkimet. Sipas të intervistuarve dënimet ishin edhe “shumë të lehta”, edhe “shumë të rënda”, por gjithashtu edhe “kundërrthënëse”. Dëshmitarët dhanë përgjigje edhe në lidhje me vendimet e pafajësisë, shfuqizimin e vendimeve të fajësisë, marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe lirin e përkohshëm me kusht. Këto praktika u konsideruan si të papajtueshme me interesat e viktimave, të drejtësisë, të së vërtetës dhe vetë Tribunalit. Të intervistuarit të tjerë e konsideruan fyes faktin se të akuzuarit u trajtuan me mirë se ç'duhej nga sistemi i Kombeve të Bashkuara pas burgimit. Në lidhje me mangësitë institucionale, sërish të intervistuarit shprehën shqetësim për politikën nga jashtë, korrupsionin e pretenduar, Prokurorinë dhe ndikimin e supozuar të NATO-s në veprimet dhe rezultatit e punës së Tribunalit. Dëshmitarët shprehën mendimin se Tribunali favorizonte disa grupe etnike ndaj të tjerëve dhe për më tepër ngritën pikëpyetje mbi larminë e përbërjes së punonjësve nga pikëpamja e prejardhjes etnike dhe gjinore.

Kategoria vijuese përfshin aspektet thelbësore të trajtimit të dëshmitarëve në gjyq që ishte një aspekt tjetër për të cilin dëshmitarët e Tribunalit sugjeruan se ka vend për përmirësim (n=31). Në këtë kategori përfshihen tema që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat dhe shqetësimet e dëshmitarëve mbi mënyrën se si zhvillohet procesi i dhënies së dëshmisë për dëshmitarët. Shumica e komenteve janë për çështje konkrete që kanë mbetur në kujtesën e dëshmitarëve që kur kanë dëshmuar. Janë një numër i vogël, por i rëndësishëm dëshmitarësh të cilët thanë se ishte e nevojshme që TPNJ-ja të kuptonte se dhënia e dëshmisë krijon vështirësi për ata dhe familjet e tyre, ose se dëshmitarët kanë nevojë për ndihmë në rikujtimin e ngjarjeve të shkuara (n=13), kurse të tjerët mendonin se nuk ishin lejuar të tregonin plotësisht historinë e tyre (n=10). Vëzhgimet e tjera në këtë kategori përfshijnë tema që kanë të bëjnë me ndjenjën e të trajtuarit si kriminel, se dëshmitarët duhen mbajtur veç nga të akuzuarit, ose se të njëjtët dëshmitarë thirren në mënyrë të përsëritur dhe dëshmitarët donin të dinin arsyen pse ishin thirrur (n=8).

Pyetja Tre nxiti përgjigje për masat mbrojtëse, por ishte interesante se të intervistuarit shprehën pikëpamje të ndryshme. Gjashtëmbëdhjetë të intervistuar mendonin se duheshin përmirësime në masa mbrojtëse dhe donin më shumë mbrojtje gjatë udhëtimit për në Hagë dhe gjatë qëndrimit në Hagë, kurse shtatë të intervistuar argumentuan pikërisht të kundërtën-se nuk duheshin lejuar masa mbrojtëse ose deklarata të mbrojtura. Ndonëse intuitivisht mund të mendohet se kjo ndarje kushtëzohet prej faktit se ishin dëshmitarë të Prokurorisë, ose dëshmitarë të Mbrojtjes, në çdo kategori përfaqësohen të intervistuar nga të dy krahët.

Të intervistuarit gjithashtu ngritën problemin e kompensimit financiar për humbjet e shkaktuara (n=20). Shumica raportuan se kishin pësuar humbje nga konflikti që duhej të ishin dëmshpërblyer (n=18). Dy të intervistuar shprehën mendimin se pagesat financiare që u takonin nuk mjaftonin për mbulimin e shpenzimeve që rridhnin prej dhënies së dëshmisë. Këtu nënvizohet sërish nevoja e një mbështetjeje më të mirë të dëshmitarëve nëpërmjet informacionit dhe ndihmës lidhur me të drejtat dhe mundësimin e informacionit për dëmshpërblim.

Së fundi, gjashtë kategoritë e fundit të përgjigjeve negative sollën në vëmendje kundërshtitë që ekzistojnë që nga koha e themelimit të Tribunalit dhe që janë përmendur vijimisht që atëherë. Në tërësi, Prokuroria (n=20) në krahasim me Dhomat (n=8) dhe Mbrojtjen (n=5) mori komentet më negative. Pas kësaj të intervistuarit theksuan se para dhe gjatë procesit gjyqësor nevojitet mbështetje më e madhe psikologjike dhe mjekësore (n=17). Një numër i vogël, por i konsiderueshëm i të

intervistuarve vunë në dyshim efektshmërinë e sistemit të përzier të Tribunalit i së drejtës anglosaksone me të drejtën kontinentale (n=16). Sigurisht që disa dëshmitarë mendonin se ky sistem shkaktonte paqartësi, ose bënte më të vështirë dhënien e dëshmisë. Në të njëjtën frymë, të intervistuar të tjerë theksuan se vendosja e selisë së Tribunalit në Hagë kishte qenë zgjidhje jo e duhur për drejtësinë ndërkombëtare (n=16) dhe se gjykatat në rajon do të bënin punë më të mirë në procedimin e këtyre çështjeve.

Përmbledhje

Rezultatet e pyetjeve të pakufizuara nxjerrin në pah hollësitë e ilustruara nga të dhënat e pyetësorit: përvojat e dëshmitarëve janë të larmishme dhe komplekse ku shumica e problemeve kanë lidhje me rrethanat që i paraprijnë procesit të dhënies së dëshmisë dhe me dhënien e dëshmisë. Ndonëse shumica e të intervistuarve e konsideruan përvojë pozitive, është edhe një numër i vogël, por i konsiderueshëm i dëshmitarëve të cilët përvoja e dhënies së dëshmisë ka pasur ndikim negativ që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Sikurse është theksuar edhe në fillim, është e rëndësishme të bëhet një analizë e gjithanshme e përmbajtjes së këtyre të dhënave, duke përdorur veçanërisht programe që bazohen në gjuhën amtare të të intervistuarve.

Komentet dhe sugjerimet e marra nga dëshmitarët në pyetjet e pakufizuara të anketimit janë tejet të çmuara. Ato ishin një moment i rëndësishëm për dëshmitarët që të reflektonin mbi gjithë përvojën e tyre gjatë procesit të dhënies së dëshmisë dhe për këtë arsye duket se ka pasur rëndësi psikologjike të madhe për ta. Ky ishte gjithashtu një moment dhe mundësi për ndarje nga e shkuara dhe një moment kyç për drejtësinë ndërkombëtare. Ka të ngjarë që për shumë nga këta dëshmitarë ky të jetë kontakti i fundit zyrtar me TPNJ-në duke qenë se Tribunali po e përfundon mandatin e vet. Si rrjedhojë ka rëndësi të madhe që urtësia e grumbulluar e këtyre dëshmitarëve të ruhet për të ardhmen dhe në funksion të përmirësimit të drejtësisë në arenën ndërkombëtare dhe vendore. Bashkësia ndërkombëtare ka bërë një investim të jashtëzakonshëm në kohë, fonde dhe përpjekje në sistemin e sapolindur të drejtësisë penale ndërkombëtare. Dëshmitarët kanë luajtur një rol të madh. Përvojat e vështira të përjetuara që dëshmitarët çiltërsisht u treguan intervistuesve, çojnë në një drejtësi më të mirë ndërkombëtare dhe bëjnë që zëri i tyre të mbetet në histori.

Kapitulli 8 – Përfundime dhe rekomandime

Dëshmitarët janë jetikë për zbulimin e së vërtetës dhe për drejtësinë në situatat pas konflikteve. Ndonëse studiuesit dhe profesionistët e fushës përkatëse janë duke analizuar ndikimin e dhënies së dëshmisë në jetën e dëshmitarëve, ende mbetet shumë për t'u studiuar. Studimi Pilot hulumtoi perceptimet e dëshmitarëve mbi këtë ndikim para, gjatë dhe pas procesit të dëshmisë. Veçantia tjetër e Studimit Pilot është se në kuadër të tij u intervistuan 300 dëshmitarë dhe u vendosën kontakte me dëshmitarë identitetet e të cilëve mbaheshin të fshehtë me urdhër të gjykatës.

Në këtë kapitull paraqiten përfundimet paraprake të Studimit Pilot të bazuara në konstatimet më të rëndësishme të nxjerra nga 300 intervistat e kryera dhe jepen rekomandime. Duke bërë një analizë të thellë të arsyeve të dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë, të shqetësimeve të tyre për sigurinë, të gjendjes së tyre mendore dhe fizike dhe të perceptimit të tyre në tërësi për drejtësinë ndërkombëtare, SVD-ja dhe UNT-ja shpresojnë që rezultatet e këtij Studimi Pilot të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të praktikave më të mira dhe në një konceptim më të hollësishëm të rëndësisë së dhënies së dëshmisë.

8.1 Rekomandime në lidhje me anketimin dhe metodologjinë

Studimi Pilot përbën një hap më shumë në studimet për dëshmitarët dhe mbi ndikimin e procesit të dhënies së dëshmisë ndaj tyre. Duke u bazuar në hulumtimin dhe metodologjinë empirike, ky studim ka çelur një dritare dhe duke qenë se profesionistët e fushës përkatëse dhe studiuesit do të bazohen në të, është e rëndësishme të trajtohen dhe përmirësohen mangësitë e këtij studimi. Rrjedhimisht në frymën e përparimit shkencor, autorët ofrojnë konstatimet dhe rekomandimet e mëposhtme.

Rekomandime

- **Të përfshihen në anketim edhe dëshmitarët të cilët dëshmuar në katër proceset gjyqësore të Tribunalit që po zhvilloheshin në kohën e Studimit Pilot.** Në këtë studim nuk u përfshinë dëshmitarë të çështjeve Ratko Mlladiq, Radovan Karaxhiq, Vojislav Sheshel dhe Goran Haxhiq për të shmangur ndërhyrje në proceset gjyqësore në fjalë. Shumë prej tyre të cilët dëshmuar në këto katër procese, gjithashtu kishin dëshmuar edhe më herët në procese që kishin lidhje, si për shembull për Srebrenicën.
- **Të përfshihen në anketim edhe dëshmitarët të cilët jetojnë jashtë ish-Jugosllavisë.** Gjithashtu në Studimin Pilot nuk u përfshinë dëshmitarë të cilët jetonin jashtë ish-Jugosllavisë për arsye logjistike dhe financiare.
- **Të hulumtohet ndikimi i punonjësve të TPNJ-së që kryen anketimin në përgjigjet e dëshmitarëve.** Anketimi u krye nga punonjës të kualifikuar të SVD-së për arsye të të dhënave konfidenciale dhe të mbrojtura në lidhje me mirëqenien dhe sigurinë e dëshmitarëve. Ekziston mundësia që perceptimet e të intervistuarve në krahasim me dëshmitarët në përgjithësi, të jenë shtrembëruar për shkak të kryerjes së anketimit nga punonjësit e SVD-së. Studime të mëtejshme duhet të analizojnë nëse një metodologji e tillë çon në përgjigje të anshme.
- **Të hulumtohet ndikimi i gjendjes fizike dhe emocionale të dëshmitarëve në përgjigjet e anketimit.** Ndër arsyet më të përmendura prej dëshmitarëve të cilët nuk donin të merrnin pjesë në Studimin Pilot ishin problemet shëndetësore. Në rast se dëshmitarët të cilët përjetonin më shumë vështirësi në gjendjen e tyre fizike dhe emocionale sistematikisht ishin më pak të prirur për pjesëmarrje në këtë anketim, atëherë dhe rezultatet e këtushme mund të jenë të

shtrembëruara. Është e nevojshme një analizë e mëtejshme për të përcaktuar nëse kjo përbën problem.

- **Të bëhet një analizë më e thellë e rraskapitjes prej dëshmisë dhe forcës mendore të dëshmitarëve.** Dëshmitarët të cilët dëshmojnë disa herë për gjykatat mund të përjetojnë rraskapitje ose të bëhen më të qëndrueshëm mendërisht. Duhet trajtuar ndikimi i kësaj dukurie të pastudiuar nëpërmjet përfshirjes së individëve që kanë dëshmuar disa herë në gjykatat ndërkombëtare dhe të brendshme.

8.2 Rekomandimet në aspektet kyçe

8.2.1 Profili i dëshmitarëve dhe arsyet e tyre për dhënien e dëshmisë

Vlerësimet për arsyet e dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve dhe kënaqësinë e tyre prej dhënies së dëshmisë janë vendimtare për të mundësuar pjesëmarrjen dhe përgatitjen e tyre të plotë në procesin gjyqësor. Është e rëndësishme të theksohet se të intervistuarit u përzgjedhën nga një larmi demografike dhe etnike ku 81 të intervistuar (27%) u vetidentifikuan si kroatë; 78 individë u vetidentifikuan si boshnjakë (27%); 95 individë (31.7%) u vetidentifikuan si serbë, 25 individë (9%) u vetidentifikuan si shqiptarë dhe disa përkatësi të tjera. Një larmi e tillë fuqizon përgjithësueshmërinë e këtyre rezultateve. Tribunali si edhe të gjitha gjykatat e tjera ndërkombëtare kanë përgjegjësi t'u japin dëshmitarëve informacionin e nevojshëm për t'i ndihmuar të kuptojnë sistemin e ri dhe unik të drejtësisë ndërkombëtare dhe veçanërisht rolin e tyre kyç në këtë sistem. Sikurse pritej, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve (25%) kishin mjaft dijeni edhe para se të dëshmonin, pjesa më e madhe dhe më thelbësore e të intervistuarve (75%) kishin mjaft dijeni ose njëfarë dijenie pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë.

Duke pasur parasysh traumat e luftës të përjetuara prej të intervistuarve dhe vështirësitë e paraqitjes në një gjykatë të panjohur larg vendit të tyre, rezultatet tregojnë se dëshmitarët shqetësohen për pasojat ligjore, morale dhe personale të dhënies së dëshmisë. Pavarësisht nga larmia demografike dhe etnike dhe nga numri ose kategoria e proceseve gjyqësore në të cilat kishin dëshmuar, një shumicë e madhe e të intervistuarve mendojnë se është e rëndësishme të ndihmohen gjykatësit në nxjerrjen e një "vendimi të saktë", si "detyrim" ndaj viktimave, ose "për të treguar përjetimet e tyre". Për më tepër, kënaqësia prej përvojës së dhënies së dëshmisë ishte thujtë e barabartë si për dëshmitarët e Prokurorisë, po ashtu edhe për ata të Mbrojtjes (përkatësisht 93% dhe 90%). Pa dëshmitarë nuk mund të bëhet drejtësi dhe prej kësaj shihet qartë pse është e rëndësishme që përvoja e tyre me drejtësinë ndërkombëtare të jetë pozitive.

Rekomandime

- **Të shpërndahet informacion në bashkësinë ku jeton dëshmitari.** Është e rëndësishme që në bashkësitë ku ka ndodhur konflikt të rritet ndërgjegjësimi mbi procesin e dhënies së dëshmisë si një proces që ofron mundësi për të ndihmuar drejtësinë kalimtare dhe që përvoja e dhënies së dëshmisë të mos konsiderohet automatikisht e vështirë ose negative.

8.2.2 Siguria njerëzore dhe pasojat ligjore

Duke qenë se për drejtësinë ndërkombëtare dhe sigurinë e dëshmitarëve është shumë e rëndësishme që dëshmitarët të dëshmojnë lirisht dhe pa pasur frikën e pasojave të qenësishme, është i nevojshëm një vlerësim i perceptimeve të dëshmitarëve mbi trajtimin e tyre në mjedisin dhe bashkësinë ku jetojnë si rezultat i dhënies së dëshmisë. Një grup i vogël por i rëndësishëm i dëshmitarëve kanë vuajtur pasoja negative për shkak të dhënies së dëshmisë në Tribunal dhe kanë hasur vështirësi më pas në mjedisin dhe bashkësinë ku jetojnë pasi kishin dëshmuar për ngjarjet e luftës. Ndër këto pasoja negative përfshihen kritikrat dhe humbja e rrethit shoqëror, dëme ekonomike dhe kërcënime ndaj sigurisë së tyre fizike dhe të familjeve të tyre. Izolimi shoqëror dhe kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për drejtësinë dhe procesin e pajtimit.

Në Studimin Pilot u konstatua se më shumë se një e teta e të intervistuarve kishin pasur pasoja negative si kritika ose humbje të lidhjeve shoqërore, dhe një e shtata deklaruan se ishin kontaktuar ose kishin pasur kërcënime si rezultat i dhënies së dëshmisë. Kritikën, izolimi shoqëror dhe kërcënimet vinë nga një shumëllojshmëri individësh ndër të cilët njerëz që janë ose nuk janë të grupit etnik të dëshmitarit ku përfshihen të akuzuarit dhe përkrasit e tyre, si edhe paria e bashkësisë ku jetojnë ata dhe drejtues fetarë. Nga 44 të intervistuarit të cilët kishin pasur kërcënime, vetëm 22 kishin kontaktuar autoritetet dhe pesë theksuan se kishin ndërruar vendbanim si rezultat i problemeve të sigurisë. Ky përfundim është veçanërisht i rëndësishëm sepse tregon se dëshmitarët mund të mendojnë që nuk kanë një rrjet sigurie në bashkësinë ku jetojnë në rast kur kërcënohet siguria e tyre. Duhet përmendur se 13% e të intervistuarve ndihen deri diku të pasigurtë edhe sot, ndonëse nuk mund të provohet prej rezultateve të këtushme nëse kjo ndjenjë pasigurie është pasojë e dhënies së dëshmisë apo e tensioneve vijuese në rajon. I rëndësishëm është fakti se në lidhje me problemet e sigurisë dëshmitarët janë më të kënaqur me Tribunalin, zyrat rajonale dhe autoritetet vendore sesa me avokatët dhe median.

Edhe kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike cenojnë aftësinë e gjykatave në përmbushjen e mandatit të tyre. Ka më shumë të ngjarë që humbjet ekonomike të ndodhin pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve, ndonëse një grup më i vogël por i konsiderueshëm i dëshmitarëve vazhdojnë të kenë humbje edhe sot e kësaj dite. Ndonëse parimisht dëshmitarët gëzojnë të drejtën ligjore të depozitohen padi civile për dëmshpërblim, vetëm dhjetë të intervistuar deklaruan se kishin kërkuar dëmshpërblim nga të akuzuarit e dënuar nga Tribunali. Gjithashtu vlen të theksohet se thuajse një e teta e të intervistuarve ishin thirrur për të dëshmuar në gjykatat vendore për shkak të paraqitjeve të tyre në Tribunal. Kjo tregon se paraqitja e dëshmitarëve në Tribunal mund të rezultojë në paraqitje në procese të tjera, gjë që nuk ishte parashikuar nga dëshmitarët.

Një nga problemet kyçe me të cilat përballen mekanizmat e drejtësisë kalimtare është siguria e viktimave dhe dëshmitarëve. Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të fatit të udhëheqësve politikë dhe ushtarakë të cilët dalin në gjyq, të qeverive të tyre dhe shteteve të tjera të rajonit si edhe të bashkësisë ndërkombëtare, nuk përbën befasi fakti që disa të akuzuar dhe veçanërisht përkrasit e tyre në vendin e origjinës përpiqen t'i pengojnë dëshmitarët që të dëshmojnë. Për këtë arsye është me rëndësi të shfrytëzohet ky studim për të gjetur mënyrën më të mirë të garantimit të sigurisë së dëshmitarëve.

Rekomandime

- **Të identifikohen faktorët që i vënë dëshmitarët “në rrezik”.** Ndonëse siguria e dëshmitarëve nuk mund të garantohet kurrë tërësisht, është e rëndësishme të ndërmerren të gjitha masat e arsyeshme për mbrojtjen e sigurisë së dëshmitarit para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë dhe të identifikohen faktorët që mund të ekspozojnë dëshmitarët dhe familjet e tyre ndaj rreziqeve më të mëdha.
- **Të fuqizohet ndihma dhe bashkëpunimi me zyrat rajonale.** Dëshmitarët shprehen se zyrat rajonale japin zgjidhje të kënaqshme ndaj rreziqeve të sigurisë dhe për këtë arsye duhen bërë përpjekje për vendosjen dhe zhvillimin e lidhjeve të forta në mjedisin dhe bashkësinë ku ndodhen zyrat rajonale dhe ku jetojnë dëshmitarët.
- **Të përcaktohen masat në ndihmë të dëshmitarëve për ushtrimin e së drejtës së tyre për dëmshpërblim.** Është e nevojshme që dëshmitarëve t'u jepet informacion dhe ndihmë për kuadrin ligjor, shpenzimet dhe mundësinë e mbështetjes ligjore për marrjen e dëmshpërblimeve ose kompensimeve.

8.2.3 Mirëqenia psikologjike dhe fiziologjike

Ndikimi i dhënies së procesit të dëshmisë në gjendjen shpirtërore dhe fizike të dëshmitarëve vazhdon të jetë i ndryshueshëm. Ndonëse Studimi Pilot kontribuon në debatin mbi masën e pasojave pozitive ose negative të dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve, nevojiten studime të tjera të mekanizmave juridike ndërkombëtare, rajonale dhe vendore për ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë të dhënies së dëshmisë. Një mangësi e rekomandimeve përkatëse të këtushme është se në modelin e përzgjedhur të të

intervistuarve për këtë Studim Pilot mund të jenë përfshirë individë më të fortë fizikisht dhe mendërisht krahasuar me grupin më të madh të dëshmitarëve në përgjithësi. Duke qenë se shqetësimet shëndetësore dhe shpirtërore ishin dy arsyt kryesore të dëshmitarëve që refuzuan të merrnin pjesë, është e rëndësishme të hulumtohet nëse në modelin përzgjedhës të studimeve si ky ekziston një prirje për zgjedhjen e dëshmitarëve që ka të ngjarë të jenë më të shëndetshëm. Shumica e të intervistuarve kanë përjetuar trauma të rënda fizike dhe shpirtërore si pasojë e përvojës së tyre gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Ndër traumat më mbizotëruese të raportuara nga më shumë se dy të tretat e të intervistuarve ishin granatimet, afërsia me vdekjen dhe ndjenja se jetët e tyre ishin në rrezik. Më shumë se gjysma e të intervistuarve thanë se kishin përjetuar situata luftimesh si dhe mungesë ushqimesh dhe uji. Është interesante të theksohet se ndonëse një numër i madh të intervistuarish kishin dëgjuar histori mbi një sërë përvojash traumatike gjatë luftës, ende ekziston një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve të cilët nuk kishin përjetuar, parë, madje as dëgjuar histori të ngjarjeve që ndodhin më shpesh në luftë.

Pasojat e trajtimit të traumave në masën që përjetojnë të intervistuarit krijojnë probleme që kanë të bëjnë me ritraumatizimin gjatë dhënies së dëshmisë dhe mund të krijojnë vështirësi thelbësore për ndarjen nga përjetimet e tyre të luftës. Rezultatet e Studimit Pilot tregojnë se për një numër të konsiderueshëm të të intervistuarve ekzistojnë pasoja shpirtërore të përhershme prej ngjarjeve të luftës. Shumë të intervistuar deklaruan se shpesh, ose thuajse shpesh ata mendojnë për të afërmit e tyre të humbur (37%) dhe për ngjarjet dhe përjetimet nga konflikti (25%), kurse të intervistuar të tjerë ende mendojnë për përvojën e dhënies së dëshmisë (33%). Të intervistuarit përgjithësisht treguan se strategjitë përballuese që ata përdorin janë të orientuara nga vetvetja dhe thuajse gjysma e tyre, shpesh, ose thuajse shpesh mbështeten në forcën e tyre mendore duke e marrë jetën “ditë pas dite”, duke shmangur situatat e vështira, duke përdorur humorin ose duke u përqendruar në sukseset e tyre. Të intervistuarit raportuan mbështetje të pakët të jashtme psikoshoqërore (të kontaktojnë me njerëz të afërt me ta, të kërkojnë ndihmë nga profesioniste të cilët mund të ndihmojnë ose të marrin mbështetje nga grupet mbështetëse). Është interesat fakti se gjatë kohës që ndodheshin në Hagë për të dëshmuar, të intervistuarit u shprehën se mbështetja nga SVD-ja dhe prania e një personi shoqërues ndihmonin në lehtësimin e stresit, fakt që lë pa përgjigje pyetjen pse dëshmitarët nuk kërkojnë një mbështetje të tillë pas kthimit në vendin e tyre pas përfundimit të dëshmisë.

Përsa i përket gjendjes shëndetësore fizike, një shumicë e konsiderueshme e të intervistuarve nuk mendojnë se shëndeti i tyre aktualisht është keqësuar, e nuk mendojnë se do të keqësohet si pasojë e dhënies së dëshmisë për Tribunalin. Duke marrë parasysh moshën mesatare të dëshmitarëve të intervistuar, nuk përbën befasi fakti që ata raportojnë stres më të lartë gjatë dhënies së dëshmisë dhe një keqësim të gjendjes së përgjithshme shëndetësore aktuale si grup. Veçanërisht femrat bëjnë të qartë se shëndeti i tyre nuk është aq i fortë sa i meshkujve, rezultat që përputhet me përfundime të tjera se në konflikte femrat raportojnë më shumë pasoja shëndetësore nga konflikti.

Në lidhje me pasojat psikologjike gjatë dhënies së dëshmisë, duke reflektuar për përvojën e tyre, të intervistuarit u përgjigjën se ndjesitë pozitive janë më të shumta se ndjesitë negative gjatë këtij procesi. Të intervistuarit në numër të konsiderueshëm raportuan shtim të ndjesive pozitive pas dhënies së dëshmisë dhe pakësim të ndjesive negative pas herës së fundit të dhënies së dëshmisë. Këto rezultate janë mjaft të ngjashme me anketimin e brendshëm anonim që po kryhet nga SVD-ja me të gjithë dëshmitarët që janë paraqitur në Tribunal që nga viti 2009. Këto rezultate konfirmojnë edhe rezultatet e anketimeve të kryera në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen.

Sidoqoftë, duke u bazuar në përvojën e SVD-së ka shenja se disa dëshmitarë të cilët kanë dëshmuar disa herë mund të përjetojnë “*rraskapitje prej dëshmisë*”. Thuajse një e treta e të intervistuarve kishin dëshmuar më shumë se një herë (tre të katërtat kishin dëshmuar dy herë dhe një numër i vogël por i konsiderueshëm i të intervistuarve kishin dëshmuar tri ose më shumë herë). Vetëm prej kësaj analize paraprake nuk mund të kuptohet tërësisht nëse të intervistuarit hasin vështirësi fizike dhe psikologjike prej përvojës së dhënies së dëshmisë, apo shtim të rrezikut ndaj sigurisë së tyre prej dëshmime të disahershme. Është e nevojshme të bëhet analizë e mëtejshme e ndërveprimit ndërmjet dëshmime të disahershme, gjendjes shëndetësore dhe sigurisë së dëshmitarëve, duke qenë se studime të tjera kanë treguar se individët të cilët perceptojnë kërcënime ndaj sigurisë janë më të ekspozuar ndaj Çrregullimit

prej Stresit Pastraumatik dhe depresionit. Duke qenë se shumë pak dihet mbi ndikimin e dëshmisë së përsëritur ndaj dëshmitarëve, në këtë fushë lipsen studime të mëtejshme.

Janë edhe dy faktorë të tjerë që kanë ndikim në procesin e dhënies së dëshmisë – problemet logjistike dhe të përkthimit gojor, si edhe këndvështrimi i dëshmitarëve për jetën e tyre aktuale dhe në të ardhmen e afërt. Së pari, më shumë se një e treta e të intervistuarve raportuan probleme logjistike dhe në lidhje me dhënien e dëshmisë (vonesa, ndryshim të datave të dhënies së dëshmisë, periudha pritëse dhe largësia nga shtëpia, familja dhe shoqëria). Për shkak të këtyre vështirësive të përjetuara nga të intervistuarit, shpesh SVD-së iu desh të tregonte më shumë vëmendje. Më shumë se gjysma e të intervistuarve bënë të ditur se ndihma e SVD-së ose prania e një personi mbështetës ishin të rëndësishme për pakësimin e stresit në lidhje me dhënien e dëshmisë. Disa dëshmitarë gjithashtu u ankuan për vështirësi në përkthimin gojor dhe saktësinë e përkthimit midis gjuhës së folur prej tyre dhe gjuhës së përkthyesve. Ky ishte veçanërisht një problem për shqipfolësit.

Në përgjithësi të intervistuarit ishin optimistë për jetën e tyre në tërësi. Më shumë se 60% e të intervistuarve u shprehën se ishin shumë të kënaqur, ose të kënaqur me jetën aktuale, ndonëse vetëm 36% prisnin të ishin të kënaqur në 2-5 vitet e ardhshme. Shumica e të intervistuarve thanë se janë të kënaqur ose deri diku të kënaqur me marrëdhëniet që kanë aktualisht në bashkësinë ku jetojnë (57%), kurse 49% presin të jenë të kënaqur në 2-5 vitet e ardhshme. Shumica e të intervistuarve gjithashtu u shprehën se janë të kënaqur me gjendjen e tyre ekonomike të tanishme, ndonëse sërish ishin të pasigurtë për të ardhmen, ose thjesht nuk ishin në gjendje të parashikonin çfarë mund të ndodhë në 2-5 vitet e ardhshme. Një pakënaqësi e përbashkët e shumicës së të intervistuarve nga të gjitha grupet etnike ishte pakënaqësia me gjendjen politike aktuale në vendin ku ata banojnë. Ky problem nuk duhet anashkaluar, sepse ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi njerëzit atje dhe eventualisht mbi mundësinë e dëshmitarëve në përbalimin e rrethanave të pasluftës dhe të dhënies së dëshmisë.

Rekomandime

- **Të standardizohet vlerësimi i nevojave para dhënies së dëshmisë.** Pati të intervistuar në një numër të vogël për të cilët përvoja e dhënies së dëshmisë pati më shumë ndikim negativ. Gjithashtu traumat e rënda të përjetuara dhe të para prej dëshmitarëve gjatë luftërave, kërkojnë vetëdijesim për dobësi dhe nevoja të mundshme si përgjigje parapritëse ndaj problemeve psikologjike, mjekësore, logjistike dhe gjuhësore për minimizimin e pasojave negative. Në rast se është e mundshme, duhet shqyrtuar mundësia e angazhimit të mbështetjes së organizatave vendore dhe të jashtme për dëshmitarët që kanë nevojë për ndihmë afatgjatë. Gjithashtu zyrat rajonale duhet të luajnë një rol kyç në këtë fazë.
- **Të rritet ndërgjegjësimi për terapatë ekzistuese të traumave dhe dobite psikologjike përkatëse.** Mungesa e shërbimeve mbështetëse të përshtatshme në zonat e shkatërruara nga lufta krijon probleme për njerëzit të cilët kanë nevojë për këto shërbime. Rezultatet e studimit konfirmuan se të intervistuarit të cilët kanë vuajtur trauma të rënda, nuk janë të prirur të kërkojnë ndihmë profesionale të jashtme, por mbështeten në strategji përbaluese të brendshme. Duhet bërë përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit të dëshmitarëve mbi zhvillimet më të reja në fushën e trajtimit të traumave dhe të organizatave të cilat mund t'i ndihmojnë. Nevojat e dëshmitarëve janë nga më të ndryshmet dhe për këtë arsye ato nuk mund të gjejnë zgjidhje vetëm nga një organizatë. Vendorsja e pikave përkatëse të kontaktit në institucione të caktuara shtetërore dhe joshtetërore mund të ndihmojë në trajtimin e nevojave psikoshoqërore të dëshmitarëve në periudhën pas dëshmisë.

8.2.4 Perceptimet për Tribunalin

Përfundimet e kësaj pjese zbulojnë në mënyrë spikatëse perceptimin e dyfishtë të të intervistuarve për drejtësinë ndërkombëtare. Nga njëra anë të intervistuarit shprehën pakënaqësi në lidhje me makronivelin e punës së Tribunalit për elemente si kohëzgjatja e proceseve gjyqësore dhe dënimet e dhëna për fajtorët. Nga ana tjetër, ata personalisht mendonin se ishin trajtuar pak a shumë me drejtësi nga Tribunali dhe se kishin ndihmuar për drejtësinë dhe të vërtetën.

Rezultatet e Studimit Pilot tregojnë se me gjithë larminë demografike të të intervistuarve, kategoritë e proceseve ku dëshmuar dhe arsyet për dhënien e dëshmisë, përgjithësisht të intervistuarit përjetuan kënaqësi të madhe personale nga dhënia e dëshmisë përse i përket kontributit të tyre për drejtësinë ndërkombëtare.

Shumica e të intervistuarve mendonin se Tribunali ka ndihmuar në zbulimin e së vërtetës të ngjarjeve në ish-Jugosllavi dhe ka identifikuar se kush ishte përgjegjës për kryerjen e krimeve të rënda. Sidoqoftë, vetëm një e treta e të intervistuarve mendonin se Tribunali ka bërë punë të mirë në ndëshkimin e fajtorëve. Po ashtu, shumica e të intervistuarve thanë se proceset kishin qene shumë të ngadalta dhe se dënimet e dhëna në rastet e pranimit të fajësisë nga të akuzuarit nuk u kishin shërbyer interesave të drejtësisë. Përgjithësisht, të intervistuarit i kritikuan dënimet e dhëna në rastet e pranimit të fajësisë, ku një e treta i konsideronin këto dënime shumë të lehta. Duhet theksuar se në këtë pjesë të Studimit Pilot të intervistuarit në një numër të madh thanë se nuk dinin, nuk kishin mendim ose nuk iu përgjigjën pyetjeve. Po ashtu, thuajse gjysma e të intervistuarve u përgjigjën se ata nuk mendonin se gjykatat vendore ishin më të përshtatshme për procedimin e çështjeve gjyqësore si ato të Tribunalit.

Gjithashtu, rezultatet tregojnë se nga të gjithë organet e Tribunalit, të intervistuarit priren të mendojnë se u trajtuan me drejtësi më së shumti nga SVD-ja pasuar prej Dhomave Gjyqësore. Po ashtu një shumicë e gjerë e të intervistuarve u përgjigjën se ishin trajtuar me drejtësi nga Prokuroria dhe Mbrojtja, pavarësisht se cila palë i kishte thirrur. Trajtimi me drejtësi nga organet e Tribunalit është një faktor i mundshëm i përvojës në tërësi pozitive të dhënies së dëshmisë.

Rekomandime

- **Dëshmitarëve t'u jepet informacion rregullisht i përditësuar mbi zhvillime të rëndësishme në proceset ku ata kanë dëshmuar.** Duke marrë parasysh vështirësitë në kuptimin e veprimtarisë së gjykatave ndërkombëtare, të gjithë ata që punojnë për drejtësinë ndërkombëtare duhet të bëjnë përpjekje të veçanta në informimin e publikut në përgjithësi për proceset gjyqësore dhe në veçanti për vendimet dhe përfundime me rëndësi të posaçme. Dëshmitarët janë veçanërisht të interesuar të dinë dhe të kuptojnë aktgjykimet dhe përfundimet e proceseve ku kanë dëshmuar. Bazuar në sa më sipër, i duhet kushtuar vëmendje e mëtejshme praktikës së informimit të dëshmitarëve për aktgjykimet dhe lirimimin (e parakohshëm) të fajtorëve.

8.3 Rekomandime tërësore

Qëllimi i Studimit Pilot ishte të ndriçonte disa aspekte të mirëqenies së dëshmitarëve brenda tërësisë së përvojës së tyre. Ndonëse përvoja e dhënies së dëshmisë është unike për çdo dëshmitar dhe ndikohet nga një sërë faktorësh dhe aktorësh, Studimi Pilot synoi drejt përfundimeve të përgjithësueshme dhe të dobishme për profesionistët e fushës përkatëse dhe studiuesit si edhe më gjerë për drejtësinë ndërkombëtare. Studimi Pilot u përpoq për një hulumtim më rrënjësor të përvojës së dëshmitarëve nëpërmjet metodave shkencore për nxjerrjen e një kuptimi më të qartë të domethënies së dhënies së dëshmisë dhe të mënyrave përmirësuese të strukturave mbështetëse të dëshmitarëve në të gjitha gjykatat, për t'i shërbyer sa më mirë interesave të dëshmitarëve dhe të drejtësisë ndërkombëtare. Të gjithë rezultatet dhe rekomandimet konkrete të lartpërmendura, shtjellohen më në hollësi në tri aspektet e mëposhtme.

8.3.1 Kriteret për strukturat e mbështetjes së dëshmitarëve në institucionet gjyqësore

Që para më shumë se njëzet vjetësh, SVD-ja u rrek të përvijonte konturet e konceptit “*mbështetje dhe këshillim*” brenda një institucioni juridik ndërkombëtar të cilit iu besua “realizimi i drejtësisë.” Aktualisht pranohet se mbështetja e dëshmitarëve në gjykatat ndërkombëtare si Tribunali, është pjesë përbërëse dhe e nevojshme e strukturës së gjykatës. Të intervistuarit shprehën mirënjohje dhe vlerësim të lartë për shërbimet e ofruara nga SVD-ja dhe konfirmuan se një ndihmë e tillë kishte pakësuar stresin emocional dhe probleme të tjera që kishin të bënin me dhënien e dëshmisë. Gjithashtu, rezultatet e

Studimit Pilot konfirmojnë se vijimësia me dëshmitarët prodhon të dhëna të vyera mbi nevojat dhe shqetësimet e tyre ekzistuese për dhënien e dëshmisë dhe punën e Tribunalit.

Është e rëndësishme të trajtohen problemet që mund të shkaktojnë pasoja fizike dhe mendore prej procesit të dhënies së dëshmisë. Ka individë të cilët mbase nuk kanë forcën e mjaftueshme mendore në përfundimin e krejt procesit dhe të tjerë të cilët mund të kenë përjetuar përvoja të rënda traumatike gjatë luftës prej të cilave janë bërë të thyeshëm. Këta tregues të marrë së bashku mund të bëjnë të qartë se individë të caktuar kanë më shumë nevojë për mbështetje dhe këshilla për të pasur një përvojë më pozitive me dhënien e dëshmisë. Në lidhje me këtë temë, të intervistuarit folën për një sërë strategjish përbaluese të cilat lehtësonin barrën e të dëshmuarit. Të dhënat e Studimit Pilot duhen shfrytëzuar për analizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programeve për mbështetjen e dëshmitarëve.

Raporti i numrit të punonjësve të SVD-së kundrejt numrit të dëshmitarëve dhe ndikimi i tij në mirëqenien e dëshmitarëve është me rëndësi kyçe dhe duhet studiuar e kuptuar më tej nga gjykatat e tjera. Lipset analizë e mëtejshme për të përcaktuar nëse një numër më i madh i punonjësve të SVD-së kontribuoi në shtimin e kujdesit, në kënaqësi më të madhe dhe në një përvojë më pozitive prej procesit të dhënies së dëshmisë dhe ndoshta si rrjedhim, në ekzistencën e strategjive përbaluese më të mira aktualisht.

Rekomandime

- **Të ngrihen që në fillim dhe të nguliten struktura për mbështetjen e dëshmitarëve brenda gjykatave ndërkombëtare dhe shtetërore para, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë.** Kjo është e nevojshme për mundësimin e kujdesit dhe ndihmës së duhur për viktimat dhe dëshmitarët nga punonjës të kualifikuar në selinë e gjykatës dhe në terren.
- **Të mbahen punonjës tejet të kualifikuar dhe shërbime me cilësi të lartë për viktimat dhe dëshmitarët.** Njësitë për mbështetjen e dëshmitarëve kanë nevojë për sugjerimet e dëshmitarëve në kohë, në lidhje me mënyrat e përmirësimit të përvojës së dëshmitarëve dhe të shërbimeve për plotësim më të mirë të nevojave të tyre. Duhet ndërmarrë hulumtime të mëtejshme në lidhje me pasojat mbi punonjësit të cilët punojnë me viktimat dhe dëshmitarët në procese për krime lufte. Mbajtja e cilësisë së lartë të shërbimeve automatikisht kërkon më shumë njohuri për pasojat negative mbi punonjësit mbështetës të dëshmitarëve, të cilat mund të vijnë prej kontaktit në vijimësi me individë tejet të traumatizuar (si për shembull trauma pasqyruese, rraskapitje prej dhembshurisë, sfilatje profesionale). Këto të dhëna mund të japin orientim për masa parandaluese e në të njëjtën kohë garantojnë cilësinë e shërbimeve për dëshmitarët.

8.3.2 Përkatësia gjinore

Numri i gjithsejtë i femrave të cilat dëshmuar në Tribunal është relativisht i ulët (afërsisht 13 për qind), ku përqindja e tyre rritet në çështjet e dhunës seksuale. Për Studimin Pilot femrat u përzgjedhën me tepri për të mundësuar një prani të mjaftueshme të tyre dhe në studimet e ardhshme do të jetë e rëndësishme prania e një numri më të madh femrash, duke mbajtur parasysh se ato nuk thirren aq shpesh sa meshkujt si dëshmitarë. Gjithashtu është e rëndësishme që të garantohet larmia e kontributit të dëshmitarëve për drejtësinë ndërkombëtare për të pasqyruar larminë e popullatës së prekur nga pasojat e luftës, veçanërisht në kontekstin e shpeshësisë së krimeve të dhunës seksuale. Në konfliktet në ish-Jugosllavi krimet e dhunës seksuale u kryen shpesh dhe ishin gjerësisht të përhapura po ashtu si edhe rastet e tjera të hetuara nga gjykata të tjera.

Në Studimin Pilot u konstatuan ndryshime të dallueshme midis meshkujve dhe femrave përsa i përket dhënies së dëshmisë për një sërë aspektesh, por veçanërisht përsa u përket pasojave të dhënies së dëshmisë në gjendjen fizike dhe mendore. Femrat përjetojnë më shumë ndjesi pozitive dhe negative në lidhje me dhënien e dëshmisë (para dhe pas). I rëndësishëm është përfundimi sipas të cilit femrat raportojnë se shëndeti i tyre është më keq në krahasim me meshkujt para herës së parë kur kanë dëshmuar dhe në tre muajt e fundit. Femrat të cilat raportojnë më shumë probleme shëndetësore aktuale janë më të prirura të mendojnë se gjendja e tyre shëndetësore është keqësuar për *shkak të dhënies së dëshmisë*.

Rekomandime

- **Të zhvillohen praktika dhe shërbime për mbështetjen e dëshmitarëve që pasqyrojnë evoluimin e metodave të nuancuara në lidhje me gjininë.** Nevojat e dëshmitareve femra mund të jenë të ndryshme dhe lipset analizë e mëtejshme mbi arsyen dhe mënyrën e ndikimit më të madh te femrat. Bazuar në përfundimet e këtushme dhe të hulumtimeve mbi rolin e dallimeve gjinore në rrethana të tjera pas konflikteve, është i nevojshëm zhvillimi i praktikave të domosdoshme për pakësimin e ndikimit negativ të dëshmitareve femra dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së femrave në procese gjyqësore.
- **Të vlerësohet ndikimi afatgjatë prej dhënies së dëshmisë në rastet e krimeve të dhunës seksuale.** Gjykimi i dhunës seksuale në kohë lufte ka qenë një sukses unik i Tribunalit. Edhe pse femrat janë të mbipërfaqësuar në çështjet e dhunës seksuale, si meshkujt po ashtu edhe femrat që morën pjesë në Studimin Pilot treguan se kishin qenë viktimat të dhunës seksuale prej individëve të panjohur ose njerëzve që njihnin. Studime të mëtejshme mund të shqyrtojnë ndikimin afatgjatë të dhënies së dëshmisë për dhunën seksuale mbi femrat dhe meshkujt.

8.3.3 Vijimësia pas dëshmisë

Punonjësit e SVD-së cilët kryen intervistat e Studimit Pilot konstatuan se një shumicë e gjerë e dëshmitarëve të intervistuar shprehën përkrahje për projektin dhe objektivat e tij dhe sidomos mirëpritën rivendosjen e kontaktit. Reagimet e shumta dhe intensive, ndonjëherë pozitive, e në raste të tjera negative gjatë thirrjeve telefonike për rekrutimin e pjesëmarrësve i bënë punonjësit e SVD-së të besonin se kontakti pas dhënies së dëshmisë përmbushte një nevojë të dëshmitarëve për nxjerrjen e mendimeve dhe ndjenjave të tyre në lidhje me këtë përvojë. Reagime të ngjashme pati dhe gjatë takimeve personale ku doli se shumë të intervistuar kishin qenë në pritje të mundësisë së dhënies së sugjerimeve. Të intervistuarit e tjerë kishin probleme të cilat bënin të nevojshme mbështetje, ose rekomandime shtesë. Ndoshta kontributin më të madh të këtij Studimi Pilot e shprehën ata të intervistuar të cilët u thanë punonjësve të SVD-së se pas intervistës kishin rënë në paqe me vetveten dhe kishin mundësi për ndarje nga e shkuara.

Komentet e lartpërmendura si dhe pjesëmarrja më e lartë nga sa pritej në Studimin Pilot tregojnë se studime të tilla vijuese janë të rëndësishme për drejtësinë ndërkombëtare dhe fuqizimin e praktikave më të mira në mbështetjen e efektshme të dëshmitarëve – diçka që tashmë është rekomanduar në raportin UNICRI (2009). Rezultatet e këtushme mbështesin dhe përforcojnë rekomandimet e tyre mbi mbështetjen e dëshmitarëve si një element i nevojshëm i procesit të dhënies së dëshmisë dhe madje sugjerojnë edhe kryerjen e vlerësimeve më afatgjata të mirëqenies së dëshmitarëve.

Rekomandime

- **Të gjitha institucionet gjyqësore ndërkombëtare dhe vendore duhet të zhvillojnë një program veprimtarish vijuese afatshkurtra dhe afatgjata për dëshmitarët.** Këto programe mund të shfrytëzohen për trajtimin e problemeve të mundshme që kanë të bëjnë me sigurinë, mirëqenien shpirtërore dhe gjendjen fizike. Këto veprimtari duhet të përfshihen në programin e shërbimit pas dëshmisë për të pasur një pamje më të qartë të nevojave të dëshmitarëve dhe për të mundësuar në rast nevojë marrjen në kohë të masave. Programe të tilla do t'u mundësojnë dëshmitarëve që të kuptojnë dhe vlerësojnë më mirë drejtësinë ndërkombëtare.
- **Të standardizohet përdorimi i pyetësorit pas dhënies së dëshmisë.** Për vlerësimin e saktë të ndikimit të dhënies së dëshmisë në gjendjen fizike dhe mendore të dëshmitarëve si edhe në përgjithësi në jetën e tyre, është me rëndësi thelbësore që ky lloj anketimi (i përshtatur sipas nevojave bazuar në rrethanat e një konflikti të caktuar) të kryhet nga strukturat për mbështetjen e dëshmitarëve menjëherë pas dhënies së dëshmisë. Kjo do të mundësojë saktësinë më të madhe të mundshme të kujtesës së dëshmitarëve në lidhje me probleme të ndryshme logjistike, gjendjen e tyre shëndetësore dhe ndikimin psikologjik të dhënies së dëshmisë si edhe tregues të tjerë. Gjithashtu gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj pas këtij kontakti me dëshmitarë duhet kryer edhe një anketim tjetër për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende probleme në lidhje me shëndetin apo mirëqenien e tyre të identifikuar në anketimin e parë, apo ka përmirësime. Ideale do të ishin studimet kohëzgjatëse për periudha shumëvjeçare.

8.4 Mendime përmbyllëse

Studimi Pilot u ndërмор për hulumtimin, analizimin dhe kuptimin rrënjësor dhe shkencor të natyrës së dëshmitarëve të Tribunalit dhe për të qartësuar ndikimin e dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët. Ky studim përbën ndihmesë në punimet shkencore gjithnjë e më të shumta synimi përfundimtar i të cilave është të dokumentohen përvojat e individëve të cilët shpesh janë njëkohësisht viktimat dhe dëshmitarë dhe eventualisht qytetarë të cilët kthehen në shoqëri të shkatërruara nga lufta. Si rrjedhojë, Studimi Pilot jo vetëm që ndihmon për një njohje më të mirë të dëshmitarëve të Tribunalit, por edhe për shtimin e njohurive mbi dëshmitarët brenda mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare dhe vendore. Për një funksionim sa më të mirë të drejtësisë ndërkombëtare, faktor kyç është mundësimi i mbështetjes së dëshmitarëve që ata të mund të dëshmojnë sa më efektivisht si për të mirën e tyre, po ashtu edhe për atë të gjykatave. Është gjithashtu e rëndësishme që profesionistët e fushave përkatëse dhe studiuesit të kuptojnë në thellësi ndikimin e dhënies së dëshmisë në jetën e dëshmitarëve pas përfundimit të dëshmisë së tyre në gjyq. Shpesh, dëshmitarët përfaqësojnë bashkësitë e tyre kur ata dëshmojnë në gjyq për ngjarjet që kanë dëmtuar ose shkatërruar këto bashkësi dhe gjithashtu pas kthimit në shtëpi ata mund të edukojnë bashkëvendësit e tyre mbi procesin e dhënies së dëshmisë. Për të gjithë këto arsye të përmendura dhe për të tjera, për drejtësinë ndërkombëtare është me rëndësi themelore që të vijojë me hulumtimin dhe njohjen më të mirë të dëshmitarëve dhe të përvojës së dhënies së dëshmisë.

Shtojcat

Shtojca I – Punonjësit dhe struktura e SVD-së

Organika e SVD-së 1995-2015

Figurat 1.3 dhe 1.4 ilustrojnë numrin vjetor të punonjësve, si dhe ngarkesën e çështjeve për dëshmitarët në kohë. Ndonëse numri i punonjësve mbeti relativisht i qëndrueshëm me kalimin e kohës, ngarkesa e çështjeve ishte mjaft e ndryshueshme.¹⁰⁵

Figura 1.3-Organika e SVD-së 1995-2015





Figura 1.4 – Raporti Punonjës të SVD-së/Dëshmitarë-1995-2015



Punonjësit e SVD-së përfshihen në këto kategori:¹⁰⁶

P – Kategoritë profesionale dhe më lart.

U rekrutuan punonjës ndërkombëtarë – në bazë të kriterëve të ekspertizës themelore dhe/ose aftësisë drejtuese e administrative, për nivelin e drejtorit kërkohej arsim universitar, gjithashtu mjafton diplomë universitare si edhe përvojë pune kualifikuese.

P5 Shef i Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët

P4 Zëvendësshef i Seksionit për Viktimat dhe Dëshmitarët

P3 Funkionar Mbështetës (Kreu i Njesisë Mbështetëse), Funkionar për Mbrojtje (Kreu i Njesisë Mbrojtëse), Funkionar Ndërlidhës (Kreu i Njesisë Operative)

P2 Ndhimësfunkionar Mbështetës, Ndhimësfunkionar për Mbrojtje, Ndhimësjurist

G – Kategoritë e shërbimit të përgjithshëm.

Rekrutohet personel vendas. Punë administrative dhe sekretariale si dhe punë teknike të specializuara në mbështetje të funksionimit të organizatës.

G6 Ndhimës i Lartë për Mbështetje, Ndhimës i Lartë Administrativ

G5 Ndhimës për Mbështetjen e Dëshmitarëve, Ndhimës në Terren, Ndhimës Administrativ

G4 dhe G3 Shofer


¹⁰⁵ Duhet mbajtur parasysh se Figurat 1.3 dhe 1.4 tregojnë numër vjetor të gjithsejtë të ndryshëm për shkak të: (1) financimit nga burime të jashtme dhe vende të tjera donatore, dhe (2) krijimit dhe suprimimit të vendeve të punës gjatë një cikli vjetor. Figura 1.3 tregon numra më gjithëpërfshirës, mirëpo raporton më shumë burime njerëzore të financuara dhe në dispozicion të TPNJ-së.

¹⁰⁶ Për më shumë informacion mbi vendet e punës sipas kategorive profesionale dhe të përgjithshme të Kombeve të Bashkuara shih <https://careers.un.org/lbw/home.aspx?viewtype=SC>

Zhvillimi i strukturës së seksionit për viktimat dhe dëshmitarët


1995 -Njësia për Viktimat dhe Dëshmitarët

(numri i gjithsejtë i punonjësve 6)




2005 -Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët

(numri i gjithsejtë i punonjësve 41)




2015 -Njësia Operative dhe e Mbështetjes për Viktimat dhe Dëshmitarët

(numri i gjithsejtë i punonjësve 14)




dhe Njësia për Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve - MTPN

(numri i gjithsejtë i punonjësve 5¹⁰⁷)



¹⁰⁷ Në prill 2016 kishte një post si Funksonar Mbështetës në MTPN. Detyrat dhe përgjegjësisë e këtij posti janë marrë përsipër nga funksionari përkatës në TPNJ në bazë të "rregullave për punë të dyfishtë" nëpërmjet të së cilave individët mund të punojnë në të dyja organizatat. Më 2014, SVD-ja dhe Njësia për Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve u përfshinë në Seksionin e sapokrijuar për Shërbimet Gjuqësore Mbështetëse.

Shtojca II – Hapat e rekrutimit të pjesëmarrësve



Shtojca III – Pyetësor

Letërnjoftim anonim nr _____

Pyetësor mbi Ndikimin/Pasojat e Dhënies së Dëshmisë-Seksioni për Viktima dhe Dëshmitarë-nëntor 2014

Të dhëna bazë

Data e pyetësorit _____ **Shteti në të cilin jetoni aktualisht** _____
Mosha _____ **Gjinia** Femër Mashkull

Arsimi

- Më pak se shkollë fillore
- Shkollë fillore
- Shkollë e mesme profesionale
- Shkollë e mesme/gjimnaz
- Arsim dyvjeçar ose i ngjashëm
- Diplomë universiteti
- Magjistër
- Kurs specializimi
- Doktoraturë.

Përkatësia etnike _____ (në rast se dëshironi ta shënoni)

Besimi fetar _____ (në rast se dëshironi ta shënoni)

A jeni pakicë etnike apo fetare në mjedisin ku banoni aktualisht?

- Po Jo Nuk e di

A keni martesë etnikisht të përziera në familjen e ngushtë (prindërit, partneri/partnerja, motra e vëllezër, ose fëmijë)?

- Po Jo Nuk e di

Pyetjet e mëposhtme kanë të bëjnë me të dhëna bazë për dëshminë tuaj në TPNJ

A1.A morët urdhërparaqitje për të dëshmuar në TPNJ? Po Jo Nuk mbaj mend

A2. A ndryshoi ndonjë nga datat e udhëtimit tuaj? Po Jo Nuk mbaj mend

A3. Pata kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur *para herës së parë* që dëshmova në TPNJ.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A4. Më shpjeguan si duhet procesin e dhënies së dëshmisë që të kuptoja çfarë do të ndodhte gjatë dhënies së dëshmisë sime *për herë të parë*.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A5. Jam i kënaqur me informacionin dhe ndihmën e dhënë nga SVD-ja *para herës së parë* kur dëshmova.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A6. Sa dijeni kishit për punën e TPNJ-së para se të dëshmonit *për herë të parë*?

- Shumë Deri diku Pak Aspak

A7. Sa dijeni kishit për punën e TPNJ-së pasi dëshmuat *për herë të fundit*??

- Shumë Deri diku Pak Aspak

A8. A u thirrët për të dëshmuar në ndonjë gjykatë shtetërore për shkak se kishit dëshmuar në TPNJ?

- Po, u thirra dhe dëshmuva.
 Po, u thirra por nuk dëshmuva.
 Jo, nuk u thirra dhe nuk dëshmuva.
 Nuk mbaj mend
 Tjetër _____

A9. A ngritët padi civile për kompensim në vendin tuaj bazuar në vendimin e TPNJ-së në çështjen në të cilën dëshmuat?

- Po Jo Nuk dëshiroj të përgjigjem Nuk mbaj mend

Pyetjet e mëposhtme kanë të bëjnë me arsyet e pjesëmarrjes suaj në proces gjyqësor të TPNJ-së.

A10. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoja që t'i ndihmoja gjykatësit të nxirrnin një vendim të saktë.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A11. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoja sepse dëshiroja të ballafaqohesha me të akuzuarin/akuzuarit në sallën e gjyqit.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A12. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoj sepse doja të tregoja përjetimet e mia.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A13. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoj sepse doja t'i hiqja përgjithmonë nga mendja ngjarjet nga lufta në ish-Jugosllavi.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A14. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoj sepse e kisha për detyrë të flisja për ata që vdiqën.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A15. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoj sepse nuk dua që kërkund tjetër të ndodhë çfarë ndodhi gjatë luftës në ish-Jugosllavi.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A16. Mendoj se për mua ishte e rëndësishme të dëshmoj si detyrim moral ndaj gjithë viktimave të luftës.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A17. Dëshmuva megjithëse familja dhe miqtë e mi nuk dëshironin që të dëshmoj.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A18. U ndjeva i/e detyruar që të dëshmoj sepse isha i/e shqetësuar për masa ligjore kundër meje në rast se do të refuzoja të dëshmoja.

- Pajtohem plotësisht Pajtohem Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

A19. Në rast se keni pasur arsye të tjera për të dëshmuar, ju lutemi jepni shpjegimin tuaj. Tjetër:

A20a. Kur mendoni mbi arsyet për të cilat dëshmuat, a jeni i kënaqur me dëshminë tuaj?

- Po Jo Nuk kam mendim

A20b. Në rast se përgjigja është *Po* ose *Jo*, ju lutemi përmendni shkurtimisht arsyet për kënaqësinë ose pakënaqësinë në lidhje me arsyet pse dëshmuat.

Pasojat shoqërore-ekonomike

Pyetjet e mëposhtme do të na ndihmojnë të kuptojmë cilat janë pasojat e dhënies së dëshmisë tuaj në rethanat tuaja shoqërore dhe ekonomike.

B0a. Gjendja civile

- Beqar/e
 Në lidhje
 I/e martuar
 I/e shkurorëzuar
 Vejan/vejushë

B0b. A pati ndonjë pjesë e dëshmisë tuaj për TPNJ-në pasoja në lidhjen tuaj intime?

- Po, pozitive Po, negative Jo Nuk e di

B0c. Në rast se Po, ju lutemi shpjegoni

B1a. Mendoj se *u kritikova* për shkak të bashkëpunimit tim me TPNJ-në.

- Po Jo Jo i/e sigurtë Nuk kam mendim

B1b. Në rast se përgjigjeni *Po*, ju lutemi përmendni të gjithë individët ose grupet e individëve që sipas jush *ju kritikuan si person* për shkak të bashkëpunimit tuaj me TPNJ-në. (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Familja e ngushtë (prindërit, partneri/partnerja, motra e vëllezër, ose fëmijë)
 Familja e madhe
 Shokë/shoqe
 Fqinjë
 Punëdhënësi
 Kolegë pune
 I akuzuari/të akuzuarit
 Familja e të akuzuarit/akuzuarve
 Shokë të të akuzuarit/akuzuarve
 Politikanë
 Nëpunës shtetërorë
 Drejtues fetarë
 Udhëheqësit e komunës
 Persona të përkatësisë *time* etnike
 Persona të besimit *tim* fetar
 Persona *jo të* përkatësis *time* etnike
 Persona *jo të* besimit *tim* fetar
 Të tjerë _____

B2a. Janë disa njerëz të cilët *nuk shoqërohen /kontaktojnë* me mua për shkak të dëshmisë time

- Po Jo Jo i/e sigurtë Nuk kam mendim

B2b. Në rast se përgjigjeni *Po*, ju lutemi përmendni të gjithë individët ose grupet e individëve që sipas jush *nuk shoqërohen* me ju për shkak të dhënies së dëshmisë prej jush. (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Familja e ngushtë (prindërit, partneri/partnerja, motra e vëllezër, ose fëmijë)
- Anëtarët e familjes së zgjeruar
- Shokë/shoqe
- Fqinjë
- Punëdhënës
- Kolegë pune
- I akuzuari/të akuzuarit
- Familja e të akuzuarit/akuzuarve
- Shokë të të akuzuarit/akuzuarve
- Politikanë
- Zyrtar shtetërorë
- Drejtues fetarë
- Udhëheqësit e komunës
- Persona të përkatësisë *time* etnike
- Persona të besimit *tim* fetar
- Persona *jo* të përkatësisë *time* etnike
- Persona *jo* të besimit *tim* fetar
- Të tjerë _____

B3a. *Gjatë periudhës/periudhave* të dhënies së dëshmisë tuaj në TPNJ, a pati ndryshime për ju ose pjesëtarët e familjes suaj në kushtet ekonomike të jetesës (punë, punësim) *për shkak të dhënies së dëshmisë prej jush* në TPNJ?

- Ndryshim(e) pozitiv(e)
- Asnjë ndryshim
- Ndryshim(e) negativ(e)
- Ndryshim(e) pozitiv(e) dhe negativ(e)
- Nuk jam i/e sigurtë

B3b. Në rast se përgjigja në B3a është ndryshime *pozitive ose negative*, ju lutemi shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes.

- Mëditje/Rroga/Të ardhurat
- Mundësi për të ardhura shtesë
- Mundësi për partnerë të mundshëm biznesi
- Punë e përkohshme/stinore
- Bagëtia
- Asete bujqësore
- Prona
- Ndërrhyrje e qeverisë ndaj kushteve ekonomike të jetesës
- Mundësi shkollimi
- Të tjera _____

B4a. *Pasi dëshmuat për herë të fundit* në TPNJ, a pati ndryshim në kushtet ekonomike tuaja ose të familjes tuaj (punë, punësim) *për shkak të dhënies së dëshmisë prej jush* në TPNJ?

- Ndryshim(e) pozitiv(e)
- Asnjë ndryshim
- Ndryshim(e) negativ(e)
- Ndryshim(e) pozitiv(e) dhe negativ(e)
- Nuk jam i/e sigurtë

B4b. Në rast se përgjigja në B4a është ndryshime *pozitive ose negative*, ju lutemi shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes.

- Mëditje/Rroga/Të ardhurat
 Mundësi për të ardhura shtesë
 Mundësi për partnerë të mundshëm biznesi
 Punë e përkohshme/stinore
 Bagëtia
 Asete bujqësore
 Prona
 Ndërhyrje e qeverisë ndaj kushteve ekonomike të jetesës
 Mundësi shkollimi
 Të tjera _____

B5a. A po përjetoni tashmë ju ose familja juaj ndryshime në kushtet ekonomike të jetesës *për shkak të dëshmisë tuaj* në TPNJ?

- Ndryshim(e) pozitiv(e)
 Asnjë ndryshim
 Ndryshim(e) negativ(e)
 Ndryshim(e) pozitiv(e) dhe negativ(e)
 Nuk jam i/e sigurtë

B5b Në rast se përgjigja në B5a është ndryshime *pozitive ose negative*, ju lutemi shënonin kutitë që i përgjigjen pyetjes.

- Mëditje/Rroga/Të ardhurat
 Mundësi për të ardhura shtesë
 Mundësi për partnerë të mundshëm biznesi
 Punë e përkohshme/stinore
 Bagëtia
 Asete bujqësore
 Prona
 Ndërhyrje e qeverisë ndaj kushteve ekonomike të jetesës
 Mundësi shkollimi
 Të tjera _____

B5c. Cili ishte profesioni juaj para se te dëshmoni për herë të parë në TPNJ?

- _____
 I/e papunë
 Preferoj të mos përgjigjem

B5d. Cili është profesioni juaj sot?

- _____
 I/e papunë
 Preferoj të mos përgjigjem

B6a. A ishit të kënaqur me kompensimet financiare të dhëna nga TPNJ-ja *gjatë kohës kur dëshmuat*?

- Po Jo Jo i/e sigurtë Nuk kam mendim Nuk mbaj mend

B6b. Në rast se përgjigja është *Jo*, ju lutemi shpjegoni

B7a. Në rast se keni dëshmuar në më shumë se një proces gjyqësor në TPNJ, a vutë re dallime ose ndryshime në pasojat e dhënies së dëshmive tuaja në kushtet tuaja shoqërore dhe ekonomike?

- Po Jo Nuk kam mendim Dëshmova vetëm në një proces

B7b. Në rast se përgjigja është *Po*, ju lutemi shpjegoni shkurtimisht.

Pasojat në gjendjen e sigurisë

Pyetjet vijuese janë për të kuptuar më mirë pasojat se sa i/e sigurtë ndiheni si rezultat i dhënies së dëshmisë(ve).

C1. A ju kontaktoi dikush para se të dëshmonit dhe ju tha të *mos* dëshmonit?

Po Jo Jo i/e sigurtë

C2. A u kontaktua dikush nga familja juaj apo iu tha që t'ju thoshte që të *mos* dëshmonit?

Po Jo Jo i/e sigurtë

C3a. A ju kërcënuan duke ju paralajmëruar që të *mos* dëshmonit?

Po Jo Jo i/e sigurtë

C3b. A u kërcënuat *gojarisht* për shkak të dëshmisë suaj në TPNJ?

Po Jo Jo i/e sigurtë

C3c. A u kërcënuat *fizikisht* për shkak të dëshmisë suaj në TPNJ??

Po Jo Jo i/e sigurtë

Në rast se përgjigjja është “Jo” për të gjitha pyetjet C1-C3 (a-c) atëherë kaloni në C4.

C3d. Në rast se përgjigjja për ndonjë nga pyetjet e mësipërme lidhur me kërcënimet është *Po*, për cilin mendoni se është përgjegjës për këto kërcënime? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

Familja e ngushtë (prindërit, partneri/partnerja, motra e vëllezër, ose fëmijë)

Familja e madhe (anëtarët e familjes së zgjeruar)

Shokë/shoqe

Fqinjë

Punëdhënës/

Kolegë pune

I akuzuari/të akuzuarit

Familja e të akuzuarit/akuzuarve

Shokë të të akuzuarit/akuzuarve

Politikanë

Nëpunës shtetërorë

Drejtues fetarë

Paria Udhëheqësit e komunë

Persona të përkatësisë *time* etnike

Persona të besimit *tim* fetar

Persona *jo të* përkatësis *time* etnike

Persona *jo të* besimit *tim* fetar

Të tjerë _____

C3e. Në rast se u kërcënuat, si u bënë kërcënimet? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

Thirrje telefonike

Mesazh elektronik

Personalisht

Shënime me shkrim

Në postë

Shkrime në mur

Të tjera _____

C3f. Në rast se përgjigjja për ndonjë nga pyetjet e mësipërme lidhur me kërcënimet është *Po*, a kontaktuat me autoritetet?

Po Jo Jo i/e sigurtë

C3g. Në rast se përgjija është “Jo” dhe ju nuk i kontaktuat autoritetet, ju lutemi tregoni arsyen dhe më tej kaloni në pyetjen C4.

C3h. Ju lutemi shënonin në listën e mëposhtme këdo që kontaktuat pas kërcënimeve që patët në lidhje me dëshminë tuaj në TPNJ.

- Seksioni për Viktima dhe Dëshmitarë në Hagë
- Zyrën Rajonale të Njesis për Viktima dhe Dëshmitarë në Sarajevë
- Policinë vendëse
- Avokatin
- Grup ose Shoqatë Viktimash
- Organizatë joqeveritare
- Median
- Kolegë pune
- Klerikë
- Prokurorin e TPNJ-së
- Mbrojtjen e TPNJ-së
- Të tjerë _____

C3i. Sa i kënaqur ishit me masat përfundimtare të marra nga autoritetet lidhur me denoncimin tuaj për kërcënime?

- Shumë i/e pakënaqur I/e pakënaqur Nuk kam mendim
- I/e kënaqur Shumë i/e kënaqur

C4. Sipas mendimit tuaj, a ka ndodhur ndonjë nga gjërat e mëposhtme si pasojë e vendimit tuaj për të dëshmuar në TPNJ?

- Vandalizëm në vendbanimin tim
- Vandalizëm në vendim e punës
- Dëmtim i objektit fetar ku shkoj
- Dëmtim ose lëndim ndaj meje
- Dëmtim ose lëndim ndaj familjes sime
- Dëmtime të tjera ndaj pronës sime
- Dëmtim ose lëndim ndaj shokëve/shoqeve të mi(a)
- Të tjera _____
- Asnjë nga më sipër

C5a. Në rast se keni dëshmuar në më shumë se një process gjyqësor në TPNJ, a vutë re dallime ose ndryshime në pasojat e dhënies së dëshmimeve tuaja ndaj sigurisë tuaj?

- Po Jo Nuk kam mendim Dëshmovava vetëm në një proces

C5b. Në rast se përgjigjja është *Po*, ju lutemi shpjegoni.

C6a. A kërkuat masa mbrojtëse për dhënien e dëshmisë tuaj?

- Po Jo Nuk mbaj mend

Në rast se përgjigjja është “Jo” kaloni te pyetja C9.

C6b. Në rast se *Po*, çfarë masash mbrojtëse kërkuat? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Pseudonim Shformim të zërit Shformim të fytyrës Seancë të mbyllur Nuk mbaj mend

C7a. A u miratuan masa mbrojtëse?

- Po Jo Nuk mbaj mend

C7b. Në rast se nuk u miratuan masa mbrojtëse, a dëshmuat vullnetarisht?

- Po, dëshmovava vullnetarisht
 Jo, mora urdhërparaqitje për të dëshmuar
 Nuk dëshmovava
 Nuk mbaj mend
 Të tjera _____

C7c. Në rast se përgjigjja është *Po* u miratuan masa mbrojtëse, a ju ndihmuan masat mbrojtëse të ndiheshit më i/e sigurtë *gjatë kohës* kur dëshmuat

- Pajtohem plotësisht Pajtohen Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

C7d. Në rast se përgjigjja është *Po* u miratuan masa mbrojtëse, a ju ndihmuan masat mbrojtëse të ndiheshit më i/e sigurtë *menjëherë pas* kthimit tuaj në shtëpi pasi kishit dëshmuar?

- Pajtohem plotësisht Pajtohen Jo i/e sigurtë Nuk pajtohem Nuk pajtohem aspak

C8a. A pranuat ndonjëherë ndryshim të masave mbrojtëse të miratuara më parë?

- Po, shtim
 Po, modifikim
 Po, shfuqizim
 Jo
 Nuk mbaj mend

C8b. Në rast se përgjigjja është *Po*, ju lutemi shpjegoni arsyen pse pranuat të veprimeve ashtu.

C9. Në tërësi, sa i/e sigurtë jeni ndjerë në gjashtë muajt e shkuar?

- Shumë i/e pasigurtë Disi i/e pasigurtë Nuk kam mendim
 Disi i/e sigurtë Shumë i/e sigurtë

C10a. A keni ndryshuar vendbanim përkohësisht apo përgjithmonë *brenda vendit tuaj* që kur dëshmuat?

- Po Jo Jo i/e sigurtë

Në rast se përgjigjja për pyetjen C10a është “Jo” kaloni te pyetja C11a.

C10b. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vendbanim tjetër në vendin tuaj*, sa herë e ndryshuat vendbanimin? _____

C10c. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vendbanim tjetër në vendin tuaj*, sa rëndësi kishte dhënia e dëshmisë suaj në TPNJ në vendimin tuaj për të ndryshuar vendbanimin?

- Jo i rëndësishëm Deri diku i rëndësishëm I rëndësishëm Shumë i rëndësishëm

C10d. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vendbanim tjetër në vendin tuaj*, pse ndryshuat vendbanim? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Ngjashmëri kulturore
 Ngjashmëri etnike
 Mundësi më të mirë punësimi
 Bashkim me familjen
 Siguria
 Kushtet ekonomike
 Shëndeti dhe klima
 Nisja e një jete të re
 Të tjera _____

C11a. A jeni zhvendosur përkohësisht ose përgjithmonë *në një vend tjetër* pas dhënies së dëshmisë?

Po Jo Jo i/e sigurtë

Në rast se përgjigjja për pyetjen C11a është “Jo” kaloni te pyetja D1.

C11b. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vend tjetër*, në cilin vend jeni zhvendosur?

C11c. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vend tjetër*, sa rëndësi kishte dhënia e dëshmisë suaj në TPNJ në vendimin tuaj për të ndryshuar vendin ku jetoni?

Jo i rëndësishëm Deri diku i rëndësishëm I rëndësishëm Shumë i rëndësishëm

C11d. Në rast se përgjigjja është *Po* për zhvendosje të përkohshme ose të përhershme *në një vend tjetër*, pse u zhvendosët në atë vend? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Ngjashmëri kulturore
 - Ngjashmëri etnike
 - Mundësi më të mirë punësimi
 - Bashkim me familjen
 - Siguria
 - Kushtet ekonomike
 - Shëndeti dhe klima
 - Nisja e një jete të re
 - Të jem sa më larg rajonit ku u bënë luftra
 - Të tjera
-

Pasojat fizike dhe psikologjike
--

Pyetjet e mëposhtme janë për të qartësuar pasojat e dhënies së dëshmisë ndaj gjendjes tuaj fizike dhe psikologjike.

D1. Përgjithësisht si mund ta përshkruani gjendjen tuaj shëndetësore *pas luftës dhe para herës së parë* kur dëshmuat në TPNJ.

- Jashtëzakonisht mirë
- Shumë mirë
- Mirë
- Njëfarësoj
- Keq
- Shumë keq

D2. Cilat nga problemet e mëposhtme shëndetësore patët *pas luftës dhe para se të dëshmonit* në TPNJ *për herë të parë?* (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Dhimbje koke
- Dhimbje dhëmbësh
- Probleme me shikimin
- Djersitje dhe nxehje të papritur të trupit
- Ndjenjë të ftohti
- Kolesterol i lartë
- Artrit
- Diabet
- Karcinomë
- Goditje celebrale
- Tension i lartë/shtypje e lartë e gjakut
- Plagë nga granatimet
- Konsumim më i madh se zakonisht i pijeve alkoolike
- Konsumim më i madh se zakonisht i medikamenteve dhe barnave (si hapa, barna me recetë, etj.)
- Pagjumësi dhe makth (ëndrra të frikshme)
- Probleme neurologjike dhe të kujtesës
- Probleme motorike dhe të lëvizshmërisë (aftësia për të lëvizur rretheqark dhe për të përdorur objektet)
- Probleme në mushkëri (mosmbushje me frymë, probleme në frymëmarrje)
- Probleme në zemër për shkak të sulmeve në zemër apo operacioneve në zemër, angina pektoris, etj.
- Gjendje paniku
- Të tjera _____
- Asnjë prej të lartpërmendurave

D3. Cilat nga problemet e mëposhtme shëndetësore patët në tre muajt e shkuar? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Dhimbje koke
- Dhimbje dhëmbësh
- Probleme me shikimin
- Djersitje dhe nxehje të papritur të trupit
- Ndjenjë të ftohti
- Kolesterol i lartë
- Artrit
- Diabet
- Karcinomë
- Goditje celebrale
- Tension i lartë/shtypje e lartë e gjakut
- Plagë nga granatimet
- Konsumim më i madh se zakonisht i pijeve alkooolike
- Konsumim më i madh se zakonisht i medikamenteve dhe barnave (si hapa, barna me recetë, etj.)
- Pagjumësi dhe makth (ëndrra të frikshme)
- Probleme neurologjike dhe të kujtesës
- Probleme motorike dhe të lëvizshmërisë (aftësia për të lëvizur rretheqark dhe për të përdorur objektet)
- Probleme në mushkëri (mosmbushje me frymë, probleme në frymëmarrje)
- Probleme në zemër për shkak të sulmeve në zemër apo operacioneve në zemër, angina pectoris, etj.
- Gjendje paniku
- Të tjera _____
- Asnjë prej të lartpërmendurave

D4. Si mund ta përshkruani gjendjen tuaj shëndetësore në tre muajt e shkuar?

- Shumë keq
- Keq
- Njëfarësoj
- Mirë
- Shumë mirë
- Jashtëzakonisht mirë

D5. A mendoni se gjendja jua shëndetësore është keqësuar sepse dëshmuat në TPNJ?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Jo i/e sigurtë
- Nuk pajtohem
- Nuk pajtohem aspak

D6. Duket se unë sëmurem më lehtë se të tjerët.

- Absolutisht e vërtetë
- Përgjithësisht e vërtetë
- Nuk e di
- Përgjithësisht e pavërtetë
- Absolutisht e pavërtetë

D7. Jam më i shëndetshëm/e shëndetshme se kushdo që njoh.

- Absolutisht e vërtetë
- Përgjithësisht e vërtetë
- Nuk e di
- Përgjithësisht e pavërtetë
- Absolutisht e pavërtetë

D8. Pres keqësim të gjendjes sime shëndetësore prej stresit të shkaktuar nga dhënia e dëshmisë në TPNJ.

- Absolutisht e vërtetë
- Përgjithësisht e vërtetë
- Nuk e di
- Përgjithësisht e pavërtetë
- Absolutisht e pavërtetë

Pyetjet e mëposhtme janë në lidhje me gjendjen tuaj emocionale.

D9. Ju lutemi në listen e mëposhtme shënoni të gjithë emocionet që përkojnë me gjendjen tuaj mbi dëshminë fill para se të hynit në sallën e gjyqit për herë të parë në TPNJ. (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Zemërim
- Ankth
- Turp
- I/e tradhëtuar
- Vetëbesim
- Huti
- Bashkëpunues(e)
- Kurajoz(e)
- Turpërim
- Energjik(e)
- Rraskapitje/Tejlohdhje
- Panik
- Realizim i qëllimit
- Fajtor(e)
- I/e lumtur
- Me shpresë
- Indiferent(e)
- I/e frymëzuar
- I/e vetmuar
- I/e detyruar moralisht
- Jastëzakonisht i/e emocionuar
- Pozitiv(e)
- I fuqishëm/e fuqishme
- I pafuqishëm/e pafuqishme
- Krenar(e)
- Keqardhje
- Çlirim
- I/e trishtuar
- I/e kënaqur
- I/e frikësuar
- I/e fortë
- I/e tensionuar
- I/e lodhur
- I/e shpaguear
- Të tjera _____
- Asnjë përmendur më lart

D10. Ju lutemi në listen e mëposhtme tregoni të gjithë emocionet që përkojnë me gjendjen tuaj mbi dëshminë *menjëherë pasi kishit dëshmuar për herë të fundit në TPNJ* (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes).

- Zemërim
- Ankth
- Turp
- I/e tradhëtuar
- Vetëbesim
- Huti
- Bashkëpunues(e)
- Kurajoz(e)
- Turpërim
- Energjik(e)
- Rraskapitje/Tejlodhje
- Panik
- Realizim i qëllimit
- Fajtor(e)
- I/e lumtur
- Me shpresë
- Indiferent(e)
- I/e frymëzuar
- I/e vetmuar
- I/e detyruar moralisht
- Jastëzakonisht i/e emocionuar
- Pozitiv(e)
- I fuqishëm/e fuqishme
- I pafuqishëm/e pafuqishme
- Krenar(e)
- Keqardhje
- Çlirim
- I/e trishtuar
- I/e kënaqur
- I/e frikësuar
- I/e fortë
- I/e tensionuar
- I/e lodhur
- I/e shpaguar
- Të tjera _____
- Asnjë përmendur më lart

D11. A përjetuat ndonjë nga gjendjet e mëposhtme *gjatë çfarëdo momenti* që dëshmuat, kur ishit në bankën e dëshmitarëve. (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Alivani/Gjendje të fikëti
- Qarje
- Çrregullim emocional
- Dhimbje koke
- Mungesë frymëmarrjeje
- Probleme dëgjimi
- Humbje të shikimit
- Tharje të gojës
- Gjendje paniku
- Gjendje të vjelli
- Diarre
- Rrahje të shpeshta zemre
- Të tjera _____
- Asnjë përmendur më sipër

D12. Në rast se keni dëshmuar në më shumë se një proces në TPNJ, a ndryshuan simptomat tuaja sa herë që dëshmuat?

- Po, u shtuan
 Po, u pakësuan
 Jo, nuk ndryshuan
 Nuk mbaj mend
 Dëshmova vetëm në një proces

D13. A patët *lehtësim* të problemeve fizike apo psikologjike që përjetuat *gjatë peirudhës/periudhave* kur dëshmuat në TPNJ, nëpërmjet ndonjëres prej mënyrave të mëposhtme. (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Kisha një person që më ndihmone (**jo nga Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët**)
 Periudhë pushimi ose pauza të shkurtra
 Veprimtari shlodhëse
 Ndihmë nga punonjësit e Seksionit për Viktima dhe Dëshmitarë
 Biseda me familjen (në telefon ose me praninë fizike)
 Shkurtimi i qëndrimit tim
 Zgjatja e qëndrimit tim
 Shtyrja e paraqitjes sime në gjykatë
 Vizitë te mjeku
 Seanca terapeutike me një terapist ose një punonjës social
 Bisedë më dikë që mund të më ndihmonte të kuptoja më mirë procesin e dhënies së dëshmisë
 Më pak emocione nga dhënia e dëshmisë sepse e kisha bërë më parë
 Mendimi, “nuk ka rëndësi sa i vështirë është, duhet bërë.”
 Mendimi “unë kam përjetuar shumë më keq se kjo.”
 Kërkova mbështetjen prej familjes
 Biseda me shokë/shoqe (në telefon ose me praninë fizike)
 Biseda me kolegët e punës
 Hidhja në letër mendimet dhe brengat e mia
 Kërkova mbështetje në besimin tim fetar ose ndihmën e një kleriku
 U përqëndrova në gjërat më urgjente
 E kalova procesin gradualisht, hap pas hapi
 Mendova për sukseset e mia
 Konsumim më i madh se zakonisht i pijeve alkoolike
 Konsumim më i madh se zakonisht i medikamenteve dhe barnave (si hapat, barnat me recetë etj.)
 Konsumim më i madh se zakonisht i produkteve të duhanit (cigare, puro, etj.)
 Konsumim më i madh se zakonisht i kafeinës
 Shakatë/Humori
 Shmangja e situatave që më kujtonin përjetime të vështira
 Mbyllja në vetvete
 Të tjera _____
 Asnjë përmendur më lart

D13a. A kishit dikë që ju ndihmonte gjatë dhënies së dëshmisë në Tribunal? (jo nga Seksioni për Viktimat dhe Dëshmitarët).

- Po Jo Nuk mbaj mend Tjetër

Në rast se përgjigja për pyetjen D13a është “Jo” kaloni te pyetja D14.

D13b. Kush ishte personi që ju ndihmonte? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Fëmijët
 Bashkëshorti(ja) /Partneri(ja)
 Nëna/Babai
 Motër/Vëlla
 Shok/shoqe
 Të afërm të tjerë _____ (ju lutemi përcaktoni lidhjen me ta)
 Të tjerë _____ (ju lutemi përcaktoni lidhjen me ta)

D13c. Ku ishte personi që ju ndihmonte kur po dëshmonit? (shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Në hotel
 Në sallën e gjyqit
 Në pjesën për publikun
 Në dhomën e pritjes
 Tjetër _____

D14. A pati probleme të tjera që e vështirësuan dhënien e dëshmisë *gjatë periudhës(ave)* kur dëshmuat në TPNJ?

- Periudha të gjata pritjeje
 Vonesa në dhënien e dëshmisë sime
 Shtyrjet/ndryshim datash të dhënies së dëshmisë sime
 Larg shtëpisë
 Larg familjes
 Larg shokëve/shoqeve dhe mjedisit mbështetës
 Kohëzgjatja e parapërgatitjes
 Shqetësimet lidhur me sigurinë
 Shqetësimet lidhur me pasojat e dhënies së dëshmisë
 Prania e dëshmitarëve të tjerë në hotel
 Të tjera _____
 Asnjë përmendur më lart

D14a. A pati probleme që e vështirësuan dhënien e dëshmisë prej jush në një ambient shumëgjuhësor *gjatë seancave gjyqësore* në TPNJ?(shënoni të gjitha kutitë që i përgjigjen pyetjes)

- Ndryshime midis gjuhës së folur nga përkthyesi/ja dhe nga unë
 Vështirësi për shkak se zëri i përkthyesit ishte zë mashkulli
 Vështirësi për shkak se zëri i përkthyesit ishte zë femre
 Vështirësi për shkak të folurës së ngadaltë për përkthimin
 Vështirësi sepse përkthyesi/ja fliste shumë shpejt
 Vështirësi në dëgjimin e përkthimit për shkak se shumë njerëz flisnin njëkohësisht
 Përkthimi gojor nuk pasqyroi saktësisht fjalët/çfarë doja të thosha
 Vështirësi të shkaktuara nga vonesat në procesin e përkthimit të njëkohshëm
 Vështirësi për shkak se përkthyesit ndërroheshin në çdo gjysmë ore
 Vështirësi për të kuptuar çfarë thoshte përkthyesi/ja
 Vështirësi për të dëgjuar qartësisht çfarë thoshte përkthyesi
 Vështirësi për të qenë i përqendruar në dhënien e dëshmisë për shkak se përkthimi më shpërqendronte
 Vështirësi për të qenë i përqendruar në dhënien e dëshmisë sepse paraqitja e transkriptit ose provave materiale në të njëjtën kohë në ekranin para meje, ishte shpërqendruese
 Të tjera _____
 Asnjë përmendur më lart

D15. Në tërësi sa i/e kënaqur jeni me gjendjen tuaj *të tanishme* (puna, familja, kushtet e jetesës, etj.)?

- Shumë i/e kënaqur
 I/e kënaqur
 Deri diku i/e kënaqur
 Neutral(e)
 Deri diku i/e pakënaqur
 I/e pakënaqur
 Shumë i/e pakënaqur
 Nuk e di

D16. Në tërësi sa i/e kënaqur jeni me kushtet tuaja të *tanishme* ekonomike (të ardhurat, shpenzimet), etj.)?

- Shumë i/e kënaqur
- I/e kënaqur
- Deri diku i/e kënaqur
- Neutral(e)
- Deri diku i/e pakënaqur
- I/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur
- Nuk e di

D17. Në tërësi sa i/e kënaqur jeni me gjendjen politike të *tanishme* në vendin ku jetoni aktualisht?

- Shumë i/e kënaqur
- I/e kënaqur
- Deri diku i/e kënaqur
- Neutral(e)
- Deri diku i/e pakënaqur
- I/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur
- Nuk e di

D18. Në tërësi sa i/e kënaqur jeni me marrëdhëniet e *tanishme* midis njerëzve në mjedisin ku aktualisht jetoni?

- Shumë i/e kënaqur
- I/e kënaqur
- Deri diku i/e kënaqur
- Neutral(e)
- Deri diku i/e pakënaqur
- I/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur
- Nuk e di

D19. Në tërësi sa i/e kënaqur mendoni se do të jeni me jetën tuaj në 2-5 vitet e ardhshme (puna, familja, kushtet e jetesës, etj.)?

- Shumë i/e kënaqur
- I/e kënaqur
- Deri diku i/e kënaqur
- Neutral(e)
- Deri diku i/e pakënaqur
- I/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur
- Nuk e di

D20. Në tërësi sa i/e kënaqur mendoni se do të jeni me kushtet tuaja ekonomike në 2-5 vitet e ardhshme (të ardhurat, shpenzimet, etj.)?

- Shumë i/e kënaqur
- I/e kënaqur
- Deri diku i/e kënaqur
- Neutral(e)
- Deri diku i/e pakënaqur
- I/e pakënaqur
- Shumë i/e pakënaqur
- Nuk e di

D21. Në tërësi sa i/e kënaqur mendoni se do të jeni me gjendjen politike në vendin ku aktualisht jetoni në 2-5 vitet e ardhshme?

- Shumë i/e kënaqur
 I/e kënaqur
 Deri diku i/e kënaqur
 Neutral(e)
 Deri diku i/e pakënaqur
 I/e pakënaqur
 Shumë i/e pakënaqur
 Nuk e di

D22. Në tërësi sa i/e kënaqur mendoni se do të jeni me marrëdhëniet midis njerëzve në mjedisin ku aktualisht jetoni në 2-5 vitet e ardhshme?

- Shumë i/e kënaqur
 I/e kënaqur
 Deri diku i/e kënaqur
 Neutral(e)
 Deri diku i/e pakënaqur
 I/e pakënaqur
 Shumë i/e pakënaqur
 Nuk e di

D23. A përjetuat probleme të tjera psikologjike ose fizike gjatë dhënies së dëshmisë për TPNJ-në që mendoni se është e rëndësishme të dihen prej personelit të TPNJ-së?

D24. Pyetjet në vijim janë në lidhje me përjetimet tuaja gjatë luftrave në ish-Jugosllavi. Qëllimi është që informacioni juaj të hedhë dritë mbi pasojat e sotme të vuajtjeve tuaja dhe disa pyetje janë turbulluese. Në rast se ndiheni keq mund të mos përgjigjeni. Të gjitha përgjigjet janë konfidenciale. Ju lutemi më poshtë në listën e ngjarjeve gjatë luftrave në ish-Jugosllavi shënoni çfarë keni përjetuar, porë ose çfarë keni dëgjuar në lidhje me këto ngjarje. Jeni i/e lirë të jepni aq përgjigje sa mendoni se përshkruajnë situatën tuaj.

Përjetova – do të thotë se veprimi që përmendet më poshtë ishte diçka që ju patët kontakt të drejtpërdrejtë dhe e përjetuat vetë gjatë luftrave në ish-Jugosllavi.

Pashë – do të thotë se veprimi që përmendet më poshtë ishte diçka që ju patët kontakt të drejtpërdrejtë dhe e patë vetë gjatë luftrave në ish-Jugosllavi.

Dëgjova tregime – do të thotë se veprimi që përmendet më poshtë ishte diçka për të cilën ju dëgjuat tregime nga njerëz të tjerë gjatë luftrave në ish-Jugosllavi, por që ju as e përjetuat, e as e patë vetë.

Asgjë – do të thotë se veprimi që përmendet më poshtë ishte diçka që ju as e përjetuat apo e patë vetë, e as dëgjuat për të gjatë luftrave në ish-Jugosllavi.

D24a. Mungesë e ushqimit ose e ujit

- Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24b. Asnjë ndihmë mjekësore për të sëmurët

- Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24c. Mungesë strehimi

- Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24d. Burgim

- Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24e. Arrestim/ndalim (në kamp, ndërtesë, banesë, etj.)

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24f. Lëndim i rëndë

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24g. Luftim

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24h. Përdhunim apo keqtrajtim seksual nga i/të panjohur

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24i. Përdhunim apo keqtrajtim seksual nga i/të njohur

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24j. Dhunë fizike nga i/të panjohur

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24k. Dhunë fizike nga i/të njohur

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24l. Shpërthim mine/minash

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24m. Spastrim etnik

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24n. Izolim i detyruar nga të tjerët

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24o. Të jesh afër vdekjes

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24p. Ndarje/veçim me detyrim nga familja

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24q. Zhdukje e anëtarëve të familjes, shokëve dhe të afërmeve

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24r. Vrasje e anëtarëve të familjes ose e shokëve/shoqeve apo të njohurve

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24s. Vdekje e panatyrshme e anëtarëve të familjes apo të shokëve/shoqeve (vetëvrasje, aksident, etj.)

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24t. Vrasje e të panjohurve

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24u. I/e rrëmbyer

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24v. Tortura

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24ë. I/e ekspozuar ndaj propogandës

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24x. Keqtrajtim psikologjik

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24y. Situata të tjera të frikshme ose që menduat se jeta juaj ishte në rrezik

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24z. Situata ku pati zjarr artilerie ose granatim

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24aa. Të tjera _____

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24ab. Të tjera: _____

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

D24ac. Të tjera: _____

 Përjetova Pashë Dëgjova tregime Asgjë

Më poshtë vijojnë simptomat të shfaqura pasi njerëzit kanë përjetuar ngjarje të dhimbshme ose të tmerrshme. Ju lutemi lexojini me kujdes dhe shënoni sa ju kanë shqetësuar simptomat në gjashtë muajt e shkuar.

D25. Reagim i fortë/i beftë emocional ose fizik kur ju kujtojnë ngjarjet më të dhimbshme ose më tronditëse

